



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

**Raport përfundimtar për auditimin e përputhshmërisë e ushtruar në
Korporatën e Investimeve Shqiptare**

**RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT
MBI AUDITIMIN E PËRPUTHSHMËRISË NË
“KORPORATËN E INVESTIMEVE SHQIPTARE”**

TIRANË, PRILL 2025

Përmbajtja

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	3
1. Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit.....	3
2. Përshkrimi i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve.....	3
3. Konkluzioni i përgjithshëm dhe opinionin e auditimit.....	6
II. HYRJA	8
a. Objektivat dhe qëllimi.....	8
b. Identifikimi i çështjes.....	8
c. Përgjegjësitë e Strukturave Drejtuese.....	9
d. Përgjegjësia e Audituesve të KLSH:.....	9
e. Kriteret e vlerësimit:.....	9
f. Standardet e Auditimit.....	9
g. Metodatat e auditimit.....	10
h. Dokumentimi i auditimit.....	10
III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT	11
1. Informacion i Përgjithshëm.....	11
2. Përshkrimi i auditimit, sipas drejtimeve të auditimit.....	11
2.1 Mbi organizimin, funksionimin dhe veprimtarinë e Korporatës së Investimeve Shqiptare SHA: hartimin, shqyrtimin dhe miratimin e planit të biznesit, planeve vjetore të punës, projekteve të investimeve, si dhe realizimi i tyre.....	11
2.2. Mbi veprimtarinë e Asamblesë së Përgjithshme, Këshillit Mbikëqyrës, Drejtorit Ekzekutiv dhe Bordit Këshillimor.....	59
2.3 Mbi organizimin dhe mbajtjen e kontabilitetit, inventarët dhe veprimtaria e komitetit për auditimin financiar.....	66
2.4 Mbi regjimin e prokurimit sipas llojit të kontratave, zbatimi i legjislacionit përkatës dhe procedurave të zbatueshme të prokurimit.....	81
2.5 Mbi vlerësimin i funksionimit të sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrolleve të brendshme.....	89
2.6 Mbi administrimin dhe menaxhimin e marrëdhënieve të punës dhe të pagave.....	93
IV. REKOMANDIMET	106

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

I.1. Përshkrim i shkurtër i Raportit të Auditimit.

a. Mbështetur në Ligjin nr.154/2014, datë 27.11.2014 “*Mbi organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit*”, si dhe bazuar në Programin e Auditimit nr. 1096/1, datë 16.09.2024, i ndryshuar, Kontrolli i Lartë i Shtetit (këtu e në vazhdim KLSH) auditoi Korporatën e Investimeve Shqiptare SHA, për periudhën 17.10.2019-30.06.2024, duke i kushtuar vëmendjen e posaçme, ndër të tjera, çështjeve që lidhen me:

1. Njohjen me aktivitetin ekonomik-financiar të saj dhe organizimin e funksionimin sipas rregulloreve të miratuara.

2. Vlerësimin dhe funksionimin e sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit, si dhe auditimin e pasqyrave financiare për vitin ushtrimor 2021, 2022 dhe 2023 si dhe transaksionet financiare për gjithë periudhën objekt auditimi, detyrimeve të papambetura etj.

Korporata e Investimeve Shqiptare SHA (AIC), është krijuar me Ligjin nr.71/2019 “*Për Korporatën e Investimeve Shqiptare SHA*”, si person juridik, e organizuar në formën e një shoqërie aksionare. Korporata e Investimeve Shqiptare SHA, ka si objektiva kryesorë, nxitjen e zhvillimit ekonomik nëpërmjet projekteve të investimit në nivel qendror, vendor dhe rajonal, në mbështetje të politikave shtetërore të zhvillimit, vënien në përdorim me efikasitet të pronave shtetërore, kryerjen e investimeve duke mobilizuar kapital shtetëror dhe/ose privat.

b. Rëndësia e auditimit.

Auditimi i përputhshmërisë në Korporatën e Investimeve Shqiptare është thelbësor për të garantuar transparencën dhe efektivitetin në përdorimin e fondeve publike. Kjo rëndësi rritet për shkak të rolit specifik të korporatës në menaxhimin dhe investimin e pronave publike, të cilat i janë transferuar nga institucionet shtetërore.

c. Qëllimi i auditimit.

Qëllimi i këtij auditimi ishte dhënia e opinionit mbi përputhshmërinë e veprimtarisë ekonomike dhe financiare me aktet ligjore dhe nënligjore, për periudhën e auditimit nga data 17.10.2019 deri në 30.06.2024. Për të gjitha problematikat e konstatuara janë dhënë gjetje e rekomandime për përmirësime me synim ndërmarrjen e masave dhe veprimeve korigjuese nga AIC. Në përmbushje të qëllimit të auditimit janë shqyrtuar çështjet e mëposhtme:

- *Mbi organizimin, funksionimin dhe veprimtarinë e Korporatës së Investimeve Shqiptare SHA: hartimin, shqyrtimin dhe miratimin e planit të biznesit, planeve vjetore të punës, projekteve të investimeve, si dhe realizimi i tyre;*

- *Mbi veprimtarinë e Asamblesë së Përgjithshme, Këshillit Mbikëqyrës, Drejtorit Ekzekutiv dhe Bordit Këshillimor;*

- *Zbatimi i legjislacionit për realizimin e procedurave të prokurimit publik;*

- *Mbi organizimin dhe mbajtjen e kontabilitetit, inventarët dhe veprimtaria e komitetit për auditimin financiar, etj.*

d. Metodologjia e përdorur dhe metodat e mbledhjes së të dhënave.

Metodologjia e përdorur për kryerjen këtij auditimi është mikse, sasiore dhe cilësore. Auditimi është kryer mbi bazë risku. Grupi i auditimit ka audituar mbi 50% të transaksioneve të likuidimeve nëpërmjet bankës dhe auditimin e blerjeve dhe investimeve për procedurat ku vlera e blerjeve është e konsiderueshme. Metodot e auditimit janë bazuar tek kombinimi i testeve të ndryshme të auditimit. Në varësi të çështjeve të auditimit dhe vlerësimit të Audituesve janë përdorur veçmas ose të kombinuara metodat dhe teknikat e mëposhtme:

Verifikim i transaksioneve, shqyrtimi i raporteve dhe dokumentacionit, intervistat, verifikimi në sistem dhe terren.

e. Numri i gjetjeve dhe rekomandimeve

Nga shqyrtimi i evidencave rezultoi se Korporata e Investimeve Shqiptare për periudhën në auditim, paraqet të meta dhe mangësi në disa prej drejtiveve të veprimtarisë. Grupi i auditimit ka konstatuar 17 gjetje/masa organizative, 2/Gjetje/masa për eliminimin e efekteve negative financiare dhe ka dhënë 27 rekomandime.

f. Paraqitja e gjetjeve kryesore.

- Planifikimi buxhetor i Korporatës së Investimeve Shqiptare SHA është kryer në mënyrë të pamjaftueshme dhe pa argumentim të detajuar, me mospërputhje të konsiderueshme ndërmjet parashikimeve dhe realizimeve, duke ndikuar negativisht në performancën ekonomiko-financiare të shoqërisë.
- Korporata e Investimeve Shqiptare SHA nuk ka implementuar manuale, udhëzues apo metodologji të standardizuara për hartimin, seleksionimin dhe menaxhimin e projekteve, duke cënuar procesin strategjik dhe realizimin e objektivave të saj.
- Projekt-propozimet e hartuara nga Korporata e Investimeve Shqiptare SHA gjatë viteve 2022-2024 janë realizuar pa respektuar procedurat e përcaktuara, me mungesë analizash të detajuara mbi risqet, objektivat dhe përfitueshmërinë, duke pamundësuar vlerësimin e impaktit ekonomik dhe përfitimeve të mundshme.
- Nga auditimi i veprimtarisë së AIC-së, konstatohet se ka një ndërprerje në realizimin e projekt-propozimeve të mëparshme, duke përfshirë ato në sektorin e energjisë dhe zhvillimit të zonave prioritare, edhe pse janë kryer shpenzime mbi kontraktimin e ekspertëve të jashtëm për realizimin e para-fizibilitetit.
- Korporata e Investimeve Shqiptare (AIC) miratoi një hua prej 2 miliard lekë për A. SHA për të përballuar mungesën e likuiditetit, e cila është miratuar me vendimet e Këshillit Mbikëqyrës dhe miratimit nga Asambleja e Aksionerëve. Nga auditimi u konstatua se në përfundim të afatit 1-vjeçar të kontratës së huase, nga ana e A. nuk është likuiduar, pasi ka kërkuar shtyrjen e afatit me një vit për kthimin.
- Korporata e Investimeve Shqiptare ka dorëzuar pasqyrat financiare dhe deklaratat e tatim-fitimit për vitet 2020-2023 me dy versione, duke tejkalluar afatet ligjore dhe duke u ekspozuar ndaj penalteteve dhe interesave për mosrespektimin e afateve dhe ndryshimeve. Për më tepër, përgjegjësitë për përgatitjen e pasqyrave financiare nuk janë të mirëpërcaktuara midis Drejtorit Ekzekutiv dhe Drejtorit të Financës, duke shkaktuar paqartësi dhe mungesë të qartësisë institucionale.
- Nga auditimi i procedurave të prokurimit të kryera nga AIC konstatohen problematika lidhur me mungesën e dokumentit Teknik i Konformitetit CE/Deklarata e Origjinës së Mallit sipas kushtit preferencial MSABE i cili vërteton përputhshmërinë e origjinës së mallit brenda zonës EU sipas shpjegimeve dhe përcaktimeve të Ligjit nr. 9590 date 27.07.2006 “Për ratifikimin e Marrëveshjes së Stabilizim Asocimit”
- Auditimi i sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit në AIC konstatoi vonesa në dorëzimin e deklaratave dhe vetëvlerësimeve, mungesë të manualeve, strategjive të riskut, dhe dokumentacioni të përditësuar, si dhe standardizim të pamjaftueshëm në proceset kryesore të punës.
- Nga auditimi u konstatua mungesë dokumentacioni për vërtetimin e përmbushjes së kritereve nga anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës dhe strukturë e paplotë e Këshillit, përfshirë mungesën e një kryetari gjatë periudhës 2020-2023. Gjithashtu, u konstatua se termat e shpërblimit për anëtarët e pavarur "jo ndërkombëtarë" nuk ishin të përcaktuara qartë, duke rezultuar në shpërblime të ndryshme me ato të anëtarëve nga institucionet qendrore.
- Nga verifikimi i procedurave të rekrutimit, rezultoi se për 4 nga 6 raste të përzgjedhura nga grupi i auditimit nuk disponohet informacion mbi procedurat e rekrutimit të tyre, pasi janë punësuar përpara hyrjes në fuqi të Rregullores së brendshme, ndërsa për dy punonjësit e tjerë ku janë kryer procedura standarde rekrutimi rezultuan mangësi në dokumentacion.

Me qëllim zgjidhjen e problematikave dhe përmirësimin e situatës, janë dhënë disa rekomandime si vijon:

h. Paraqitja e rekomandimeve kryesore.

Me qëllim zgjidhjen e problematikave, janë dhënë disa rekomandime si vijon:

- Nga AIC të merren masat e nevojshme për hartimin dhe miratimin e një rregulloreje specifike ku të respektohet kuadri ligjor i Republikës së Shqipërisë për ruajtjen dhe sigurinë e pronës publike, për të përcaktuar qartë procedurat e përzgjedhjes dhe administrimit të pronave shtetërore, me qëllim sigurimin e transparencës, konkurrencës së ndershme dhe trajtimit të barabartë në proceset e menaxhimit të këtyre pronave, përpara inicimit të procedurave për shpalljen e tyre për investim.

- Nga ana e Strukturave Drejtuese të AIC-së, të merren masa konkrete mbi hartimin e një manuali ose rregullore të detajuar me fokus të veçantë për hartimin e projekt-ideve gjatë miratimit të Planeve të Punës të Shoqërisë, me qëllim identifikimin e hapave që do të ndiqen, përshkrimin e proceseve të punës dhe ciklit të projektit, duke filluar me studimin paraprak të përfitueshmërisë së investimit e deri te zbatimi i kontratës.

- Nga ana e Strukturave Drejtuese të AIC-së, të merren masa konkrete mbi hartimin e një metodologjie mbi seleksionimin e projekt-ideve që do të përfshihen në Planet e Punës, me qëllim përzgjedhjen e tyre me analiza të detajuara dhe të mirë argumentuara mbi objektivat dhe qëllimet që do të arrihen.

- Nga ana e Këshillit Mbikëqyrës së AIC-së, në bashkëpunim me strukturat përkatëse, të marrin masat e nevojshme për hartimin e një Plani Strategjik Afatmesëm, me qëllim përcaktimin e objektivave strategjik të Korporatës, seleksionimit të Projekt-Propozimeve që do të zhvillohen, me qëllim që të mos çënohet vijueshmëria e Institucionit.

- Nga ana e Këshillit Mbikëqyrës si Organ Drejtues i AIC-së, në bashkëpunim me Strukturat Drejtuese, të merren masat e nevojshme për analizimin e shkaqeve/arsyeve të ndërprejres së projekt propozimeve të mëparshme, duke identifikuar edhe përgjegjësitë përkatëse, me qëllim shmangien në të ardhmen të këtij fenomeni.

- Nga ana e Strukturave Drejtuese të AIC-së, të merren masa konkrete që gjatë hartimit të projekt-propozimeve (koncept-ideve), të kryhet më përpara transferimi i pronës/asetit në pronësi, duke vazhduar me identifikimin e objektivave, vlerësimi dhe përgatitja e projektit, analiza e detajuara e risqeve potenciale, analizë e thelluar mbi kostot me përshkrim për secilin zë të buxhetit, si dhe analizë të detajuar mbi përfitueshmërinë që paraqet projekt-propozimi me qëllim vlerësimin e treguesve ekonomik të mirë përcaktuar.

- Nga ana e Strukturave Drejtuese të AIC-së, të merren masat e nevojshme që për projekt-propozimet në fushën e pronave shtetërore, të identifikohen në mënyrë të qartë dhe të dokumentuar arsyet e përzgjedhjes së tyre, me qëllim sigurimin e transparencës.

- Nga ana e Strukturave Drejtuese të AIC-së, të merren masat e nevojshme që për projekt-propozimet e vitit 2024, përpara se të vijohet me fazat e tjera të shpalljes së projektit apo publikimit për përcjelljen e interesit për kontraktim, të hartohen analiza të detajuara dhe shteruese mbi përfitueshmërinë e palëve, kostot financiare, risqet potenciale, vlerës së shtuar të parasë, rentabilitetit të investimit, si dhe të hartohen analiza krahasuese nëse do të zhvilloheshin me financim të brendshëm nga buxheti i shtetit.

- Nga ana e Strukturave Drejtuese të AIC-së në bashkëpunim me Divizionin e Financës, të merren masat e nevojshme për përmirësimin e procesit të planifikimit dhe zbatimit financiar dhe operacional, duke hartuar plane biznesi dhe buxhete të detajuara të bazuara në nevojat reale të Shoqërisë.

- Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, si Aksionari i vetëm i Korporatës Shqiptare të Investimeve, dhe Këshilli Mbikëqyrës i Shoqërisë së Korporatës së Investimeve Shqiptare SHA, në cilësinë e organeve drejtuese të kësaj shoqërie aksionare me kapital shtetëror, të marrin të gjitha masat e

menjëhershme administrative konform legjislacionit përkatës si dhe kushteve të trajtuara në kontratën e huasë midis shoqërisë aksionare Korporatës së Investimeve Shqiptare dhe shoqërisë A. SHA, për shumën e dhënë hua 2 (dy) miliard lekë, me qëllim kthimin e menjëhershëm të shumës së huasë së dhënë në funksion të ruajtjes së stabilitetit financiar dhe mbarëvajtjes dhe funksionimit të shoqërisë Korporata e Investimeve Shqiptare, në cilësinë e huadhënësit nisur edhe nga fakti që këto aktive kanë prekur më shumë se 5% të aktiveve dhe kapitalit total të kësaj shoqërie.

- Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, si Aksionari i vetëm i Korporatës Shqiptare të Investimeve dhe Këshilli Mbikëqyrës i Shoqërisë së Korporatës së Investimeve Shqiptare SHA, në cilësinë e organeve drejtuese të kësaj shoqërie aksionare në vijim të veprimtarisë së tyre, të eliminojnë marrjen e vendimeve të natyrës huadhënie kundrejt shoqërive aksionare me kapital shtetëror pasi mbarin risk të mundshëm në sigurinë dhe stabilitetin financiar gjatë ushtrimit të veprimtarisë së kësaj shoqërie aksionare me fushë operimi në objektiva të rëndësishme dhe strategjike për zhvillimin e pronës shtetërore bazuar në ligjin specifik mbi të cilin operon kjo shoqëri aksionare.

- Korporata Shqiptare e Investimeve në funksion të parimit të efijencës, efektivitetit dhe economicitetit, gjatë veprimtarisë së funksionimit të aktivitetit të saj në rastet kur do të jetë e nevojshme përzgjedhja e ofertave dhe lidhja e kontratave për marrje të ambienteve me qira për procedura ushtrimi aktiviteti për nevoja të shoqërisë, të gjykojë të gjitha mundësitë objektive në respektim të plotë të kushteve dhe kritereve të vendosura paraprakisht duke gjykuar nëse do të jetë e mundur dhe e shprehur në ofertimin e bërë nga subjektet ofertues, kontraktimi për çmime të ofertuara në referim të përcaktimeve të VKM-së nr.168 datë 27.03.2019 “Për disa ndryshime në vendimin nr. 132, datë 7.3.2018, të Këshillit të Ministrave” dhe VKM-së nr.469, datë 3.6.2015 “Për përcaktimin e vlerës minimale të çmimit të referencave të qirave të ndërtesave për qëllime tatimore”, në funksion të uljes dhe reduktimit të shpenzimeve të shoqërisë.

- Nga Korporata e Investimeve Shqiptare, të merren masa për të plotësuar strukturën e Bordit dhe shpërblimet e tyre të bëhen, prej datës efektive të punësimit të tyre.

- Nga Divizioni i Financiar dhe Administrativ të merren masa për të plotësuar dosjet e personelit me dokumentacionin e kërkuar, si dhe të propozohen ndryshime në rregullore, për të siguruar dosje me dokumentacion të plotë, i cili duhet të jetë origjinal ose i vërtetuar me noteri.

1.2. Konkluzioni dhe Opinioni i auditimit.

Opinion për auditimin e përputhshmërisë (i Kualifikuar¹).

Në kemi audituar veprimtarinë e subjektit Korporata e Investimeve Shqiptare në zbatim të Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, ISSAI 4000 dhe ISSAI 100, paragrafi 42. Auditimi u krye në përputhje me kërkesat e Manualit të Auditimit të Përputhshmërisë të KLSH-së si dhe Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit të zbatueshme për Institucionet Supreme të Auditimit (ISSAI-s); me parimet INTOSAI-PI, “Deklarata e Limës”; INTOSAI P-10, “Deklarata e Meksikës mbi Pavarësinë e SAI-t”, si dhe INTOSAI P-12, INTOSAI P-20 dhe INTOSA P-50, apo edhe çështje të tjera që lidhen me auditimin përputhshmërisë, të cilat janë përmendur në ISSAI-n 4000 “Standardi i Auditimit të Përputhshmërisë”. Ne i kemi përmbushur përgjegjësitë tona etike, në përputhje me standardet e sipërpërmendura, përfshirë këtu edhe Kodin e Etikës së KLSH-së, miratuar me Vendimin nr. 217, datë 15.11.2024, të Kryetarit të KLSH-së. Sipas kërkesave etike, të cilat janë relevante për auditimin tonë në institucionet publike, KLSH është e pavarur nga AIC dhe përgjegjësitë janë përmbushur në pajtim me këto kërkesa.

Opinion i modifikuar/ kualifikuar mbi auditimin e përputhshmërisë

¹ **Opinion i modifikuar/ kualifikuar** Audituesi duhet të shprehë një opinion të kualifikuar: kur audituesi ka marrë dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit dhe arrin në përfundimin se anomali të apo rastet e mospërputhshmërisë, individualisht ose së bashku, janë materiale por jo të përhapura”.

“Në opinionin tonë, bazuar në evidencat e auditimit dhe dokumentacionin e vënë në dispozicion kemi konstatuar se në veprimtarinë e AIC-së, janë evidentuar devijime nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi, të përshkruara në paragrafin e “Bazës për Opinionin”, të cilat nën gjykimin profesional të audituesit të pavarur janë materiale por jo të përhapura dhe justifikojnë dhënien e një opinionit të kualifikuar të përputhshmërisë”.

Baza për opinionin e përputhshmërisë

- Planifikimi buxhetor i Korporatës së Investimeve Shqiptare SHA është kryer në mënyrë të pamjaftueshme dhe pa argumentim të detajuar, me mospërputhje të konsiderueshme ndërmjet parashikimeve dhe realizimeve, duke ndikuar negativisht në performancën ekonomiko-financiare të shoqërisë.

- Korporata e Investimeve Shqiptare SHA nuk ka implementuar manuale, udhëzues apo metodologji të standardizuara për hartimin, seleksionimin dhe menaxhimin e projekteve, duke cënuar procesin strategjik dhe realizimin e objektivave të saj.

- Projekt-propozimet e hartuara nga Korporata e Investimeve Shqiptare SHA gjatë viteve 2022-2024 janë realizuar pa respektuar procedurat e përcaktuara, me mungesë analizash të detajuara mbi risqet, objektivat dhe përfitueshmërinë, duke pamundësuar vlerësimin e impaktit ekonomik dhe përfitimeve të mundshme.

- Nga auditimi i veprimtarisë së AIC-së, konstatohet se ka një ndërprerje në realizimin e projekt-propozimeve të mëparshme, duke përfshirë ato në sektorin e energjisë dhe zhvillimit të zonave prioritare, edhe pse janë kryer shpenzime mbi kontraktimin e ekspertëve të jashtëm për realizimin e para-fizibilitetit.

- Nga auditimi i projekt-propozimeve në kuadër të Zhvillimit të Pronave Shtetërore, konstatohet se nuk ka një dokument/rregullore/manual, mbi identifikimin dhe përzgjedhjen e tyre, si dhe nuk ka një analizë mbi përfitueshmërinë, kostove financiare, risqet potenciale, vlerën e shtuar të parasë, rentabilitetin e investimit, apo për hapat konkrete që do duhet të ndiqen për cdo projekt propozim përpara shpalljes së tij, të tilla si parafizibiliteti/fizibiliteti sikundër vepruar për projektet e periudhës 2022-2023; si dhe një analizë krahasuese nëse këto projekt-propozimet do të zhvilloheshin nga vetë Institucionet, me financim të brendshëm nga buxheti i shtetit.

- Korporata e Investimeve Shqiptare (AIC) miratoi një hua prej 2 miliard lekë për A. SHA për të përballuar mungesën e likuiditetit, e cila është miratuar me vendimet e Këshillit Mbikëqyrës dhe miratimit nga Asambleja e Aksionerëve. Nga auditimi u konstatua se në përfundim të afatit 1-vjeçar të kontratës së huasë, nga ana e A. nuk është likuiduar, pasi ka kërkuar shtyrjen e afatit me një vit për kthimin e huasë.

- Korporata e Investimeve Shqiptare ka dorëzuar pasqyrat financiare dhe deklaratat e tatim-fitimit për vitet 2020-2023 me dy versione, duke tejkalluar afatet ligjore dhe duke u ekspozuar ndaj penalteteve dhe interesave për mosrespektimin e afateve dhe ndryshimeve. Për më tepër, përgjegjësitë për përgatitjen e pasqyrave financiare nuk janë të mirëpërcaktuara midis Drejtorit Ekzekutiv dhe Drejtorit të Financës, duke shkaktuar paqartësi dhe mungesë të qartësisë institucionale.

- Auditimi i sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit në AIC konstatoi vonesa në dorëzimin e deklaratave dhe vetëvlerësimeve, mungesë të manualeve, strategjive të riskut, dhe dokumentacioni të përditësuar, si dhe standardizim të pamjaftueshëm në proceset kryesore të punës.

- Nga auditimi u konstatua mungesë dokumentacioni për vërtetimin e përmbushjes së kritereve nga anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës dhe strukturë e paplotë e Këshillit, përfshirë mungesën e një kryetari gjatë periudhës 2020-2023. Gjithashtu, u konstatua se termat e shpërblimit për anëtarët e pavarur "jo ndërkombëtarë" nuk ishin të përcaktuara qartë, duke rezultuar në shpërblime të ndryshme me ato të anëtarëve nga institucionet qendrore.

- Lidhja e kontratës së qirasë me çmim mbi referencën fiskale për ambiente zyrash tregon mungesë efektiviteti në shpenzimet operative dhe shmangien nga parimi i ekonomicitetit. Nga verifikimi i procedurave të rekrutimit, rezultoi se për 4 nga 6 raste të përzgjedhura nga grupi i auditimit nuk disponohet

informacion mbi procedurat e rekrutimit të tyre, pasi janë punësuar përpara hyrjes në fuqi të Rregullores së brendshme, ndërsa për dy punonjësit e tjerë ku janë kryer procedura standarde rekrutimi rezultuan mangësi në dokumentacion.

II. HYRJA

Mbështetur në Ligjin Nr.154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funkcionimin e KLSH”, në zbatim të Programit të Auditimit nr.1097/1, datë 16.09.2024, i ndryshuar, miratuar nga Kryetari i KLSH, në subjektin Korporata e Investimeve Shqiptare SHA për aktivitetin e kryer për periudhën nga 17.10.2019-30.06.2024, u krye auditimi Përputhshmërie nga grupi i auditimit me përbërje:

1. A. H., Përgjegjësi i Grupit të Auditimit
2. A. D., anëtar
3. K. N., anëtar
4. A. Gj., anëtar
5. E. C., anëtar

OBJEKTIVAT, FUSHËVEPRIMI DHE METODOLOGJIA

a. Objektivat dhe qëllimi i auditimit

Objektivi i auditimit është arritja e një konkluzioni dhe dhënia e opinionit nëse aktiviteti i zhvilluar në AIC është në përputhje ose jo me dispozitat ligjore, nënligjore dhe rregullatore përkatëse. Qëllimi i auditimit është vlerësimi i funksionimit të sistemeve të ngritura, procedurave të ndjekura nga AIC gjatë procesit të realizimit të objektivave në përputhje me legjislacionin në fuqi, vlerësimi objektiv i përputhjes së veprimeve procedurale, administrative, ekonomike e financiare, me kriteret dhe kërkesat e legjislacionit në fuqi në lidhje me administrimin e vlerësimin e saktësisë së aktiviteteve dhe transaksioneve financiare, çështjeve që lidhen me organizimin dhe funksionimin e agjencisë etj. Mbi bazën e akt-konstatimeve, diskutimeve me zyrtarët e subjektit të audituar, vërejtjeve dhe sugjerimeve në takimin përmbyllës në terren, observacioneve të sjella është hartuar Projekt Raporti i Auditimit. Pas observacioneve të sjella mbi Projekt Raportin e Auditimit, është haruar Raporti Përfundimtar i Auditimit.

b. Identifikimi i çështjes

Sipas përcaktimit të ISSAI 100 “Auditimi i përputhshmërisë, përcakton se deri në çmasë subjekti i audituar ndjek rregullat, legjislacionin dhe aktet normative, politikat, kodet e miratuara apo kushtet e përcaktuara si, kushtet e kontratës apo klauzolat e një marrëveshjeje financimi”. Raporti i auditimit, synon të identifikojë nëse veprimtaria e AIC-së lidhur me objektiva kryesorë, si nxitjen e zhvillimit ekonomik nëpërmjet projekteve të investimit në nivel qendror, vendor dhe rajonal, në mbështetje të politikave shtetërore të zhvillimit, vënien në përdorim me efikasitet të pronave shtetërore, kryerjen e investimeve duke mobilizuar kapital shtetëror dhe/ose privat.

Në bazë të kriterëve të vlerësimit e gjykimit profesional, audituesit kanë bërë vlerësimin e rezultateve të testeve të kontrollit, analizimin dhe klasifikimin e gabimeve të zbuluara, si dhe është bërë vlerësimi i evidencave të grumbulluara përsa i përket mjaftueshmërisë dhe përshtatshmërisë për qëllimet e auditimit. Procedurat e kryera, varen nga gjykimi profesional i audituesit, përfshirë vlerësimin e riskut material, për shkak të mashtrimit apo gabimit. Nisur nga procedurat e ndjekura për auditim besojmë se evidencat e mbledhura janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të dhënë opinionin tonë mbi veprimtarinë e Korporatës së Investimeve Shqiptare.

c. Përgjegjësitë e Strukturave Drejtuese

Drejtimi i institucionit të AIC-së është përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare dhe njerëzore në përputhje me politikat, ligjet dhe rregulloret e aplikuara. Staf i drejtues është përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare në përputhje me të gjitha ligjet dhe rregulloret në fuqi.

d. Përgjegjësia e Audituesve të KLSH:

Objektivi ynë lidhet me garantimin e sigurisë së arsyeshme mbi përputhshmërinë e aktivitetit të AIC-së, me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi, si dhe mbi përdorimin e duhur dhe eficient të burimeve financiare të institucionit. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet mundëson identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mund të ekzistojë. Përveç standardeve ISSAI, audituesi i KLSH, gjithashtu aplikon edhe gjykimin dhe skepticizmin profesional në punën audituese. Gjithashtu ne krijojmë një ide fillestare mbi kontrollin e brendshëm në mënyrë që të planifikojmë procedurat e auditimit që i përshtaten situatës aktuale. Ne komunikojmë me drejtuesit ndër të tjera, edhe për planifikimin në kohë dhe përmbajtjen e auditimit si dhe konkluzionet/gjetjet, duke përfshirë edhe të metat e kontrollit të brendshëm, që ne kemi identifikuar gjatë auditimit tonë. Ne identifikojmë çështjet më të rëndësishme lidhur me auditimin dhe i përshkruajmë ato në raportet e auditimit, me përjashtim të rasteve kur kuadri ligjor nuk lejon vënien në dispozicion të tyre për publikun ose në raste të rralla kur vetë ne vendosim që këto çështje nuk duhet të përfshihen në raport për shkak të pasojave negative që publikimi i tyre mund të sjellë në publikun e gjerë.

e. Kriteret e vlerësimit:

Auditimi u krye duke mbajtur parasysh legjislacionin e mëposhtëm:

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë;
- Ligji organik i KLSH-së nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “*Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit*”;
- Ligji 10296, datë 08.07.2010 “*Mbi menaxhimin Financiar dhe Kontrollin*”, i ndryshuar;
- Ligji nr.71/2019 “*Për Korporatën e Investimeve Shqiptare*”;
- Ligji nr. 162/2020 “*Për prokurimin publik*” i ndryshuar;
- Ligji nr.25/2018 “*Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare*”;
- VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”;
- VKM nr.137, datë 06.03.2024 “*Për përcaktimin e kriterëve dhe të procedurës për dhënien e pronës shtetërore me qira, enfitozë, leasing, shitje, përdorim si kolateral dhe të përdorimit në forma të tjera nga ana e Korporatës së Investimeve Shqiptare*”;
- VKM nr.328, datë 29.05.2024 “*Për transferimin të Korporata e Investimeve Shqiptare të pronave shtetërore, në përgjegjësi administrimi të disa Institucioneve Shtetërore, për realizimin e projektit të investimit “Për zhvillimin dhe menaxhimin e pronave shtetërore”*”
- Rregullore e brendshme “*Mbi Procedurat e auditimit në KLSH*”, miratuar me vendimin nr. 7, datë 17.01.2024 të Kryetarit të KLSH-së;
- Rregullore e brendshme e “*Korporatës së Investimeve Shqiptare*” SHA (AIC);
- Statuti i shoqërisë “*Korporata e investimeve shqiptare*” SHA (AIC);
- Akte të tjera ligjore/nënligjore në zbatim të ligjeve të sipërcituar.

f. Standardet e Auditimit

Auditimi është kryer në përputhje me procedurat e përgjithshme të pranuar të kuadrin ligjor, rregullator dhe Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit. Raporti Përfundimtar i Auditimit është hartuar në përputhje me kërkesat e Rregullores së Procedurave të Auditimit në KLSH, nr .07, dt 17.01.2024, mbështetur në:

- Ligjin nr. 154/2014 “*Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit*”;
- INTOSAI – P – 1 “*Deklarata e Limës*”;
- INTOSAI – P – 10 - 99 “*Parimet themelore të INTOSAI*”;

- INTOSAI – P - 10 “*Deklarata e Meksikës mbi pavarësinë e SAI*”;
- INTOSAI – P - 12 “*Vlerat dhe përfitimet e SAI – sjellja e ndryshimit në jetën e qytetarëve*”;
- INTOSAI – P - 20 “*Parimet e Transparencës dhe Llogaridhënies*”;
- INTOSAI – P - 50 “*Parimet e juridiksionit të SAI*”;
- ISSAI 100 - 129 “*Parimet themelore të auditimit të sektorit publik*”;
- ISSAI 400 “*Parimet e Auditimit të Përputhshmërisë*”;
- ISSAI 4000 “*Standardet e Auditimit të Përputhshmërisë*”;
- Manualin e Auditimit të Përputhshmërisë, miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH nr. 245, datë 29.12.2022.

g) Metodatat e auditimit

Metodat e auditimit janë bazuar tek kombinimi i testeve të ndryshme të auditimit; në funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm; në procedurat bazë dhe në procedurat analitike pas testeve të kryera me qëllim arritjen e objektivave të auditimit.

Në varësi të çështjeve të auditimit dhe vlerësimit të audituesve, janë përdorur veçmas ose të kombinuara, metodat dhe teknikat e mëposhtme:

- a. *Verifikimi i transaksioneve* - duke marrë informacion për një rrethanë ose transaksion nga një burim i caktuar, dhe krahasimin me një informacion të marrë për të njëjtat transaksione, por me origjinë nga një burim tjetër;
- b. *Intervistimi* - duke marrë informacion nëpërmjet pyetjeve drejtuar personelit kyç të subjektit për një çështje të caktuar, e kombinuar kjo me shqyrtimin e evidencave përkatëse;
- c. *Raportet dhe informacione* - shfrytëzimi i raporteve/ informacioneve relevante dhe të që kanë lidhje me objektivat e auditimit dhe specifikisht drejtimeve të auditimit;
- d. *Pyetësorët për vlerësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm* - duke marrë informacionet e funksionimit të sistemit të kontrollit të brendshëm dhe menaxhimit financiar të subjektit;
- g. *Modelimet e thjeshta statistikore* – në lidhje me përzgjedhjen sa më përfaqësuese të shembullit për shqyrtim në çështje të caktuara të auditimit;
- h. *Verifikimi në sistem dhe në terren*- me përzgjedhje i çështjeve të veçanta të auditimit, sipas drejtimeve të auditimit;
- g. *Të kombinuara*, sipas rastit dhe vlerësimit të Audituesve.

Audituesit e KLSH janë përpjekur në çdo rast në përzgjedhjen e arsyeshme dhe të mjaftueshme të metodave dhe teknikave veçmas dhe/ose të kombinuara, si dhe shtrirjen e tyre për të dhënë siguri të arsyeshme në arritjen e konkluzioneve të auditimit.

Auditimi ynë ka përfshirë përputhshmërinë e aktivitetit të AIC-së, me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi lidhur me parashikimin dhe realizimin e të ardhurave, planifikimin mbi identifikimin vlerësimin dhe menaxhimin e riskut nga institucioni, ruajtjen, arkivimin e informacioneve dokumenteve , procedurat për qarkullim e dokumentacionit, prokurimet duke filluar nga buxheti i fondit, hartuesi i specifikimeve, komisionet e vlerësimit, kontraktuesi, zbatuesi i kontratës, procedurat për pagesat, etj.

h) Dokumentimi i auditimit

Nga audituesit u përgatit dokumentacioni i auditimit i mjaftueshëm për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit të kryera në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullatore, rezultatet e këtyre procedurave dhe evidencat e marra të auditimit, si dhe çështje të rëndësishme, që dolën gjatë auditimit, janë reflektuar në përfundimet e arritura në drejtim të tyre dhe gjykimet profesionale në arritjen e këtyre konkluzioneve. Në këtë mënyrë, dokumentimi i auditimit është kryer nëpërmjet shënimeve, pyetësorëve, intervistave, verifikimeve të finalizuara në Akt Konstatimet, Projekt Raporti i Auditimit, si dhe observacionet e subjektit, të cilat kanë shërbyer si bazë për hartimin e këtij Raporti Përfundimtar të Auditimit.

III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT

1. Informacion i Përgjithshëm

Korporata e Investimeve Shqiptare (AIC) është krijuar për të luajtur një rol të rëndësishëm në menaxhimin dhe investimin e pronave publike, duke mbështetur zhvillimin ekonomik dhe duke rritur vlerën e aseteve publike. Veprimtaria e saj rregullohet nga Ligji nr.71/2019 “Për Korporatën e Investimeve Shqiptare”, i cili përcakton objektivat, funksionet dhe detyrimet e korporatës si një institucion që synon të maksimizojë përfitimet nga pronat publike të transferuara nga institucionet shtetërore.

Misioni i AIC-së është menaxhimi i aseteve me qëllim përmirësimin e efikasitetit dhe tërheqjen e investimeve strategjike, duke promovuar zhvillimin e qëndrueshëm në sektorë të ndryshëm ekonomikë. Ky mision reflekton rëndësinë e saj si një instrument kyç në hartimin dhe zbatimin e politikave publike që lidhen me asetet shtetërore.

Auditimi i AIC ka një rëndësi të veçantë për të garantuar transparencën, përgjegjshmërinë dhe efektivitetin në përdorimin e fondeve dhe pronave publike. Përmes procesit të auditimit, sigurohet që aktiviteti i korporatës të jetë në përputhje me ligjet dhe standardet e zbatueshme, duke forcuar besimin e publikut dhe institucioneve në veprimtarinë e saj.

Struktura dhe organika e AIC janë miratuar në përputhje me vendimet ligjore përkatëse, duke përcaktuar qartë funksionet dhe përgjegjësitë e saj, si dhe burimet njerëzore të nevojshme për realizimin e objektivave strategjike. Veprimtaria dhe monitorimi i performancës së korporatës kryhet në përputhje me programet dhe raportet e miratuara, duke iu referuar analizave të thelluara mbi trendet dhe realizimet.

2. Përshkrimi i auditimit, sipas drejtimeve të auditimit.

2.1 Mbi organizmin, funksionimin dhe veprimtarinë e Korporatës së Investimeve Shqiptare SHA: hartimin, shqyrtimin dhe miratimin e planit të biznesit, planeve vjetore të punës, projekteve të investimeve, si dhe realizimi i tyre

2.1.1.Mbi auditimin e veprimtarisë së Korporatës së Investimeve Shqiptare (AIC)

Referuar Ligjit nr.71/2019 “Për Korporatën e Investimeve Shqiptare”, organizimi i institucionit është përcaktuar në nenin 11 “Organet Drejtuese të Korporatës”, konkretisht:

- 1.Asambleja e Përgjithshme, e cila merr vendime mbi miratimin e statutit të Korporatës, miratimin e strategjisë si dhe të pasqyrave financiare;
- 2.Këshilli Mbikëqyrës, i cili ka numër tek anëtarësh, jo më pak se 5, ku shumica janë të pavarur. Kompetencat e Këshillit Mbikëqyrës, lidhen me propozimin e strategjisë së institucionit, miratimin e planeve të biznesit dhe planeve të punës, miratimin e projekteve të investimit, mbikëqyrjen për zbatimin e politikave dhe projekteve të investimit, krijimin e komiteteve të posaçme lidhur me kontrollet e brendshme, etj;
- 3.Drejtori Ekzekutiv, i cili administron veprimtarinë e Korporatës, përfaqëson institucionin me palët e treta, raporton te Këshilli Mbikëqyrës për zbatimin e politikave dhe projekteve të investimit;
- 4.Bordi Këshillimor, i cili përbëhet nga 9 anëtarë që zgjidhen nga Asambleja e Përgjithshme. Bordi Këshillimor ka funksion këshillues në raport me Këshillin Mbikëqyrës dhe Drejtorin Ekzekutiv.

Misioni i Korporatës së Investimeve Shqiptare SHA

Në kuptim të Ligjit nr.71/2019 “Për Korporatën e Investimeve Shqiptare”, AIC ka si qëllim:

- Realizimin e projekteve të qëndrueshme të investimit;

- Krijimin e impaktit në ekonomi nëpërmjet diversifikimit të saj dhe rritjes së punësimit, në përmbushje të objektivave publike të zhvillimit;
- Përgatitjen dhe zbatimin e projekteve të investimit, sidomos ato projekte në të cilat sektori privat has vështirësi për shkak të një shkalle të lartë kompleksiteti dhe koordinimi të inuteve publike;
- Rivitalizimin e aseteve publike për t'u menaxhuar në mënyrë efektive dhe efçente;
- Strukturimin financiar dhe ligjor të propozimeve të ndryshme të investimit;
- Transformimin e inuteve publike në kapital në projektet e investimit.

Referuar nenit 22 “Dispozita kalimtare”, të Ligjit nr.71/2019 “Për Korporatën e Investimeve Shqiptare”, specifikohet se: “Ministria përgjegjëse për ekonominë, brenda 90 ditëve nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji, ndjek procedurat e nevojshme për: 1. Sigurimin e kapitalit fillestar. 2. Zgjedhjen e anëtarëve të organeve drejtuese të Korporatës. 3. Miratimin e statutit të Korporatës. 4. Regjistrimin e Korporatës pranë regjistrimit tregtar”.

Nga auditimi rezulton se AIC, nuk është formuar dhe nuk ka funksionuar për periudhën nga hyrja në fuqi e Ligjit deri në 30.06.2021.

1.1.Mbi organizimin dhe funksionimin e AIC-së

6 mujori i II-të, Viti 2021

- Mbi zbatimin e Statutit të AIC-së, për vitin 2021

Nga verifikimi i të dhënave rezulton se AIC, ka filluar veprimtarinë në muajin Korrik të vitit 2021, me konstituimin e Bordit Mbikqyrës (i cili është një nga organet e vendim-marrjes). Përgjatë 6 mujorit të II-të të 2021, nga ana e AIC-së, kanë patur 2 objektiva të cilat janë:

- 1.Ngritja e strukturës manaxheriale dhe kapaciteteve të brendshme të Korporatës
- 2.Zhvillimi i një cikli projektesh, duke bashkëpunuar kryesisht me Ministrinë e Mbrojtjes, Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, Fondin Shqiptar të Zhvillimit, Bashkinë Tiranë, etj., me qëllim identifikimin e projekteve dhe aseteve shtetërore me potencial dhe impakt në diversifikimin ekonomik të vendit në fushat e industrisë/logjistikë, turizëm dhe bujqësi.

Marrëveshjet e Bashkëpunimit viti 2021

1.Memorandum Bashkëpunimi midis AIC dhe Bashkisë Tiranë me nr.12/15 prot, datë 15.12.2021, për identifikimin e projekteve potenciale të përbashkëta, hartimin dhe zbatimin e tyre si dhe financimin ose bashkëfinancimin. Palët udhëhiqen nga parimet e zhvillimit të vlerës së aseteve, fizibilitetit ekonomik dhe tregtar të projekteve, dhe përfitueshmërisë së tyre.

- Mbi qeverisjen e Korporatës gjatë vitit 2021

Referuar Statutit, Bordi Mbikqyrës i AIC-së përbëhet nga 7 (shtatë) anëtarë, ku 3 (tre) prej tyre vijnë nga institucionet qendrore dhe 4 (katër) anëtarë janë të pavarur, të cilët caktohen nga aksioneri i shoqërisë. Referuar Ligjit nr.71/2019 “Për Korporatën e Investimeve Shqiptare” mazhoranca në Bord duhet të jetë me anëtarë të pavarur, me qëllim distancimin nga ndikimi politik dhe autonominë e vendim-marrjes së Korporatës. Përgjatë vitit 2022, Bordi Mbikqyrës ka patur në përbërje 5 (pesë) anëtarë nga 7 (shtatë), duke rezultuar i pa plotësuar me 2 (dy) vakanca.

Në lidhje me Bordin Këshillimor, i cili nuk ka përgjegjësi vendimarrëse, por ka fokus në ofrimin e ekspertizës dhe ngritjen e përgjegjshmërisë së funksionimit ndaj menaxhimit dhe Bordit Mbikqyrës, ku konstatohet se përgjatë 6 mujorit të II-të të vitit 2021 nuk ka funksionuar.

Nga auditimi i “Raportit mbi ecurinë e veprimtarisë së AIC për 2021”, të miratuar në muajin Korrik 2022, e pa protokolluar, gjatë vitit të parë të funksionimit të tyre (6 mujori II-të 2021), objektivat e AIC-së paraqiten si vijon:

- 1) ndërtimin e ekipit bazë dhe kapaciteteve të brendshme korporative;
- 2) zhvillimin e një project-pipeline;
- 3) sigurimin e rritjes së nevojshme të kapitalit për financimin e aktiveteve investuese.

Kapitali i shoqërisë në mbyllje të vitit ushtrimor 2021 paraqitet në shumën 2,198,000,000 lekë.

Konkluzion:

Nga auditimi i veprimtarisë së AIC për periudhën 2021, rezulton se shoqëria ka paraqitur humbje në vlerën (19,465,000) lekë, shumë e cila përfaqëson shpenzime për personelin dhe shpenzime për shërbime si dhe nuk ka gjeneruar të ardhura përgjatë vitit 2021.

Nga ana e grupit të auditimit konstatohet se Raporti i Veprimtarisë së AIC-së nuk është protokolluar, veprim në kundërshtim me Rregulloren e Brendshme të AIC-së, pika 16 “Arkiva dhe Protokolli”, ku citohet ... “Punonjësi i ngarkuar me protokollimin administron regjistrin e posaçëm për protokollimin e shkresave që lëvizin nga AIC në drejtim të palëve të treta dhe anasjelltas si dhe shkresat dhe dokumenteve që lëvizin ndërmjet Divizioneve si dhe administron vulën e AIC.”

Nga ana tjetër, konstatohet se një pjesë e dokumentacionit, është përpiluar në gjuhën angleze, por nuk rezulton të jetë nënshkruar kopja e dokumentit edhe në shqip si variant origjinal, fraksion i së cilës protokollohet kopja në gjuhë të huaj. Veprimet e mësipërme janë kryer në kundërshtim me VKLA Nr. 4, datë 19.6.2017 “Për miratimin e “rregullores së njësuar të punës me dokumentet në autoritetet publike të RSH”, neni 4, pika 9 ku citohet ... “Në rastin e komunikimit me institucione apo individë të huaj, dokumentet mund të përpilohen edhe në gjuhë të huaj. Në këtë rast nënshkruhet kopja e dokumentit edhe në shqip si variant origjinal, fraksion i së cilës protokollohet kopja në gjuhë të huaj”.

Viti 2022

- Mbi qeverisjen e Korporatës gjatë vitit 2022

Përgjatë vitit 2022, Bordi Mbikqyrës ka patur në përbërje 5 (pesë) anëtarë nga 7 (shtatë), duke rezultuar i pa plotësuar me 2 (dy) vakanca.

Në lidhje me Bordin Këshillimor, i cili nuk ka përgjegjësi vendimarrëse, por ka fokus në ofrimin e ekspertizës dhe ngritjen e përgjegjshmërisë së funksionimit ndaj menaxhimit dhe Bordit Mbikqyrës, ku konstatohet se përgjatë vitit 2022 nuk ka funksionuar.

Gjithashtu gjatë vitit 2022, ka rezultuar se në organikën e AIC-së kanë qenë të punësuar 13 punonjës me kohë të plotë dhe të pjesshme.

Marrëveshjet e Bashkëpunimit viti 2022

1.Memorandum Bashkëpunimi midis AIC dhe Ministrisë së Mbrojtjes me nr.16/1 prot, datë 08.08.2022, për identifikimin e projekteve potenciale të përbashkëta, hartimin dhe zbatimin e tyre si dhe financimin ose bashkëfinancimin.

2.Memorandum Bashkëpunimi midis AIC dhe Bashkisë Korçë me nr.32 prot, datë 14.12.2022, për identifikimin e projekteve potenciale të përbashkëta, hartimin dhe zbatimin e tyre si dhe financimin ose bashkëfinancimin.

Nga auditimi i raportit mbi ecurinë e veprimtarisë së AIC për vitin 2022, të miratuar në korrik 2023 dhe pa protokolluar, konstatohet se objektivat e parashikuara për t’u realizuar gjatë vitit 2022 nuk janë arritur. Në mënyrë specifike, nuk ka pasur progres në identifikimin dhe hartimin e projekteve të investimit, një nga objektivat kryesore të veprimtarisë së AIC-së, ashtu si edhe në gjenerimin e të ardhurave për shoqërinë dhe reduktimin e shpenzimeve.

Gjithashtu, objektivat e përcaktuara për vitin 2023 janë të njëjta me ato të vitit 2022, duke reflektuar mungesën e një analize të thelluar mbi shkaqet e mosrealizimit të objektivave.

Përgjatë vitit 2022, ka patur disa herë ndryshime të kapitali më konkretisht:

Me Vendim të Asamblesë së Përgjithshme të Aksionarëve nr.98, datë 15.09.2022, ka patur një zmadhim të kapitalit në vlerën 200,000,000 lekë.

Me Vendim të Asamblesë së Përgjithshme të Aksionarëve nr.112, datë 28.12.2022, ka patur një zvogëlim të kapitalit në vlerën (2,000,000,000) lekë.

Me Vendim të Asamblesë së Përgjithshme të Aksionarëve nr.112/1, datë 28.12.2022, ka patur një zmadhim të kapitalit në vlerën 2,000,000,000 lekë.

Me Vendim të Asamblesë së Përgjithshme të Aksionarëve nr.113, datë 28.12.2022, ka patur shfuqizim të Vendimit nr.98, datë 15.09.2022, mbi zmadhimin e kapitalit në vlerën (200,000,000) lekë.

Me Vendim të Asamblesë së Përgjithshme të Aksionarëve nr.113/1, datë 28.12.2022, ka patur një zmadhim të kapitalit në vlerën 120,000,000 lekë.

Në mbyllje të vitit ushtrimor 31.12.2022, kapitali i shoqërisë paraqitet në vlerën 2,318,000,000 mijë lekë.

Konkluzion:

Sa më sipër, gjatë vitit 2022 janë marrë gjithsej 5 (pesë) vendime të Asamblesë për ndryshimin e kapitalit të shoqërisë, prej të cilave 4 (katër) janë miratuar brenda një dite, konkretisht në datë 28.12.2022. Ky fakt tregon një paqëndrueshmëri të lartë dhe një risk të konsiderueshëm për funksionimin e aktivitetit të AIC-së.

Nga auditimi i veprimtarisë së AIC për vitin 2022, rezulton se shoqëria ka paraqitur humbje në vlerën prej (69,051,000) lekë, e cila përbëhet nga shpenzime për personelin, shërbime dhe shpenzime të tjera, ndërkohë që nuk janë gjeneruar të ardhura gjatë këtij viti. Për më tepër, shpenzimet dhe humbjet e akumuluaru kanë vijuar të rriten, duke arritur në 31.12.2022 një vlerë prej (88,516,000) lekë. Si rezultat, kjo situatë ka ndikuar në treguesit e performancës ekonomike-financiare të shoqërisë, ndërsa nga ana e Strukturave Drejtuese të AIC-së nuk janë marrë masa konkrete apo kryer analiza për të adresuar situatën ekonomike-financiare, duke përfshirë eliminimin e humbjeve dhe reduktimin e shpenzimeve.

Gjithashtu nga ana e grupit të auditimit konstatohet se Raporti i Veprimtarisë së AIC-së nuk është protokolluar, veprim në kundërshtim me Rregulloren e Brendshme të AIC-së, pika 16 “*Arkiva dhe Protokoll*”, ku citohet ... “*Punonjësi i ngarkuar me protokollimin administron regjistrin e posaçëm për protokollimin e shkresave që lëvizin nga AIC në drejtim të palëve të treta dhe anasjelltas si dhe shkresat dhe dokumenteve që lëvizin ndërmjet Divizioneve si dhe administron vulën e AIC.*”

Nga ana tjetër, konstatohet se një pjesë e dokumentacionit, është përpiluar në gjuhën angleze, por nuk rezulton të jetë nënshkruar kopja e dokumentit edhe në shqip si variant origjinal, fraksion i së cilës protokollohet kopja në gjuhë të huaj. Veprimet e mësipërme janë kryer në kundërshtim me VKLA Nr. 4, datë 19.6.2017 “*Për miratimin e “rregullores së njësuar të punës me dokumentet në autoritetet publike të RSH*”, neni 4, pika 9 ku citohet ... “*Në rastin e komunikimit me institucione apo individë të huaj, dokumentet mund të përpilohen edhe në gjuhë të huaj. Në këtë rast nënshkruhet kopja e dokumentit edhe në shqip si variant origjinal, fraksion i së cilës protokollohet kopja në gjuhë të huaj*”.

Viti 2023

- *Mbi qeverisjen e Korporatës gjatë vitit 2023*

Përgjatë vitit 2023, Bordi Mbikqyrës ka patur në përbërje 6 (gjashtë) anëtarë nga 7 (shtatë), duke rezultuar i pa plotësuar me 1 (një) vakancë.

Në lidhje me Bordin Këshillimor, i cili ka për qëllim ofrimin e ekspertizës dhe ngritjen e përgjegjshmërisë së funksionimit ndaj menaxhimit dhe Bordit Mbikëqyrës, konstatohet se gjatë vitit 2023 ky organ nuk ka ushtruar funksionet e tij.

Kapitali i Shoqërisë në vitin 2023 është 4,318,000,000 lekë, me aksionar të vetëm Ministrinë e Ekonomisë Kulturës dhe Inovacionit.

Nga auditimi i raportit mbi ecurinë e veprimtarisë së AIC për vitin 2023, të miratuar në korrik 2024 dhe të pa protokolluar, konstatohet se objektivat e përcaktuara dhe parashikuara për këtë periudhë nuk janë arritur. Konkretisht, nuk është arritur identifikimi dhe hartimi i projekteve të investimit, një ndër objektivat kryesorë të veprimtarisë së AIC-së. Gjithashtu, nuk janë regjistruar përparime në gjenerimin e të ardhurave për shoqërinë apo në reduktimin e shpenzimeve.

Nga auditimi i veprimtarisë së AIC për vitin 2023, rezulton se shoqëria ka raportuar humbje në vlerën prej (51,167,000) lekë, ku kjo shumë përfaqëson kryesisht shpenzime për personelin, shpenzime për shërbime dhe shpenzime të tjera operative.

Sa më sipër, shoqëria ka vijuar të shtojë shpenzimet dhe humbjet ndër vite, duke arritur një vlerë të akumuluar prej (139,683,000) lekë deri më 31.12.2023. Gjatë kësaj periudhe, nuk është gjeneruar asnjë e ardhura nga projektet për investime, duke ndikuar negativisht tek treguesit e performancës ekonomike-financiare. Për më tepër, nga Strukturat Drejtuese të AIC-së nuk janë ndërmarrë masa konkrete apo analiza të mjaftueshme për të adresuar situatën, duke përfshirë eliminimin e humbjeve dhe uljen e niveleve të shpenzimeve.

6 mujori i I-rë 2024

- Mbi qeverisjen e Korporatës gjatë vitit 2024

Me Vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr.17 prot, datë 04.10.2023, është emëruar Drejtori i ri Ekzekutiv i AIC-së znj.E. K.

Në 6 mujorin e I-rë të 2024, Bordi Mbikëqyrës ka patur në përbërje 6 (gjashtë) anëtarë nga 7 (shtatë), duke rezultuar i pa plotësuar me 1 (një) vakancë.

Në lidhje me Bordin Këshillimor, i cili ka si funksion kryesor ofrimin e ekspertizës dhe rritjen e përgjegjshmërisë së funksionimit ndaj menaxhimit dhe Bordit Mbikëqyrës, konstatohet se gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2024 ky organ nuk ka funksionuar edhe pse janë emëruar 2 (dy) anëtarë në muajin Prill, duke reflektuar një mungesë të mbështetjes së nevojshme për proceset menaxheriale dhe mbikëqyrëse të shoqërisë.

Kapitali i Shoqërisë në 6 mujorin e I-rë të 2024 është 4,318,000,000 lekë, me aksionar të vetëm Ministrinë e Ekonomisë Kulturës dhe Inovacionit.

Gjithashtu, në 6 mujorin e I-rë të vitit 2024, janë miratuar aktet ligjore si vijon:

- VKM nr.137, datë 06.03.2024 *“Për përcaktimin e kritereve dhe të procedurës për dhënien e pronës shtetërore me qira, enfiteozë, leasing, shitje, përdorim si kolateral dhe të përdorimit në forma të tjera nga ana e Korporatës së Investimeve Shqiptare”*, ku janë përcaktuar kriteret dhe procedurat që zbaton AIC-ja për dhënien e pronës shtetërore me qira, enfiteozë, leasing, përdorimin e pronës për sigurimin e një kredie apo detyrimi tjetër, sipërmarrje, shitje apo përmes formash të tjera përdorimi dhe zhvillimi të pronës.

- VKM nr.328, datë 29.05.2024 *“Për transferimin të Korporatave të Investimeve Shqiptare të pronave shtetërore, në përgjegjësi administrimi të disa institucioneve shtetërore, për realizimin e projektit të investimit për zhvillimin dhe menaxhimin e pronave shtetërore”*, ku bazuar në VKM nr.137, datë 06.03.2024 të sipërcituar, me propozim të Ministrit të Ekonomisë Kulturës dhe Inovacionit, Këshilli i Ministrave ka vendosur transferimin në pronësi të AIC-së të 17 pronave/aseteve si dhe me funksion vetëm publik për të cilat Korporata vepron si zhvillues të 11 pronave/aseteve.

Marrëveshjet e Bashkëpunimit 6 mujori i I-rë 2024

1.Marrëveshje Bashkëpunimi midis AIC dhe Agjencisë së Zhvillimit të Territorit (AZHT) me nr.1202 prot, datë 12.03.2024, me objekt të marrëveshjes përcaktimin e angazhimeve reciproke, vendosja e procedurës së kërkimit të informacioneve apo rekomandimeve për nismat/projektet/zhvillimet e ndryshme si dhe përcaktimi i rregullave dhe afateve të komunikimit.

2.Marrëveshje Bashkëpunimi midis AIC dhe Agjencisë së Trajtimit të Pronave (ATP) me nr.1285 prot, datë 12.03.2024, me objekt vendosjen e procedurës së kërkimit të informacioneve si dhe përcaktimi i rregullave të komunikimit. Marrëveshja zbatohet për të gjitha të dhënat, informacionet që lidhen, drejtpërsëdrejti apo indirekt, me pronat shtetërore të cilat mund të jenë objekt i misionit të AIC-së për zhvillim dhe menaxhim.

3.Marrëveshje Bashkëpunimi midis AIC dhe Agjencisë Kombëtare të Planifikimit të Territorit (AKPT) me nr.305 prot, datë 12.03.2024, me objekt të marrëveshjes përcaktimin e angazhimeve reciproke, vendosja e procedurës së kërkimit të informacioneve apo rekomandimeve për nismat/projektet/zhvillimet e ndryshme si dhe përcaktimi i rregullave dhe afateve të komunikimit. Marrëveshja zbatohet për të gjitha të dhënat, informacionet që lidhen, drejtpërsëdrejti apo indirekt, me dokumentat e planifikimit të territorit të projekteve apo nismave në të cilat AIC ka autorizim të zhvillojë dhe menaxhojë pronat shtetërore.

4.Marrëveshje Bashkëpunimi midis AIC dhe Agjencisë Shtetërore të Kadastrës (ASHK) me nr.44 prot, datë 07.03.2024, me objekt të marrëveshjes përcaktimin e angazhimeve reciproke, vendosja e procedurës së kërkimit të informacioneve apo rekomandimeve për nismat/projektet/zhvillimet e ndryshme si dhe përcaktimi i rregullave dhe afateve të komunikimit. Marrëveshja zbatohet për të gjitha të dhënat, informacionet që lidhen, drejtpërsëdrejti apo indirekt, me pronat shtetërore të cilat mund të jenë objekt i misionit të AIC-së për zhvillim dhe menaxhim. Me kërkesë të AIC-së, ASHK angazhohet të vërë në dispozicion të gjitha informacionet mbi pronat e specifikuar ose kopje të dokumentave pronësore për këto prona, sipas kuadrit ligjor në fuqi.

5.Marrëveshje Bashkëpunimi midis AIC dhe Autoritetit Shtetëror për informacionin Gjeohapësinor (ASIG) me nr.46 prot, datë 07.03.2024, me objekt të marrëveshjes për shkëmbimin e informacionit, dokumentave apo konsultimit për nismat dhe projektet e ndryshme të zhvillimit që prekin sektorin e gjeoinformacionit.

2.1.2.Mbi auditimin e hartimit, shqyrtimit dhe miratimit të Planeve të Biznesit

Plani i Biznesit për 6 mujorin e II-të viti 2021

Gjatë gjashtëmujorit të dytë të vitit 2021, AIC ka nisur funksionimin e saj, por konstatohet se për këtë periudhë nuk është miratuar plani i buxhetit.

Nga ana tjetër janë kryer shpenzimet për 6 mujorin e II-të 2021 si më poshtë:

'në lekë

Përshkrimi	Vlera
1.Të ardhura	-
<i>Të ardhura nga konsulencat</i>	-
2.Shpenzimet	(19,395,039)
<i>Kosto e Stafit</i>	<i>(7,449,406)</i>
<i>Këshilli Mbikëqyrës</i>	<i>(8,997,645)</i>
<i>Zhvierësimi</i>	-
<i>Kosto të tjera operationale</i>	<i>(2,947,988)</i>
3.Kostot Financiare	(70,297)
<i>Të ardhura nga interesi</i>	-
<i>Komisionet Bankare</i>	<i>(70,297)</i>
<i>Fitimi/Humbja nga kursi i këmbimit</i>	-

Fitimi / Humbja	(19,465,336)
------------------------	---------------------

Burimi: AIC, përpunuar nga GA

Nga auditimi konstatohet se AIC për periudhën e 6 mujorit të II-të të vitit 2021, ka kryer shpenzime në shumën 19,465,336 lekë, si dhe nuk janë gjeneruar të ardhura.

Shpenzimet e kryera për personelin janë në shumën 7,449,406 lekë ose rreth 38.2 % të totalit të shpenzimeve.

Shpenzimet e kryera për Këshillin Mbikëqyrës janë në shumën 8,997,645 lekë ose rreth 46.2 % të totalit të shpenzimeve.

Shpenzimet e kryera për kosto të tjera operationale janë në shumën 3,018,285 lekë ose rreth 15.1 % e totalit të shpenzimeve.

Plani i Biznesit për vitin 2022

Me Vendimin e Këshillit Mbikëqyrës të AIC-së me nr.10, datë 21.12.2021, është miratuar Plani i Biznesit për vitin 2022, ku është konkluduar Buxheti për periudhën 2022 si më poshtë:

Në vitin 2022 nga ana e AIC-së janë hartuar projekt buxheti i vitit me parashikimet si dhe realizimi i të ardhurave dhe kryerja e shpenzimeve si më poshtë të përmbledhura:

'në lekë

Përshkrimi	Parashikimi 2022	Realizimi 2022	Diferenca midis realizimit dhe parashikimit	% e Realizimit
1.Të ardhura	-	-	-	-
<i>Të ardhura nga konsulencat</i>	-	-	-	-
2.Shpenzimet	(123,019,287)	(74,765,569)	(48,253,717)	61%
<i>Kosto e Stafit</i>	<i>(49,603,014)</i>	<i>(33,817,489)</i>	<i>(15,785,525)</i>	<i>68%</i>
<i>Këshilli Mbikëqyrës</i>	<i>(34,478,998)</i>	<i>(20,257,693)</i>	<i>(14,221,306)</i>	<i>59%</i>
<i>Zhvlerësimi</i>	<i>(1,941,309)</i>	<i>(567,316)</i>	<i>(1,373,993)</i>	<i>29%</i>
<i>Kosto të tjera operationale</i>	<i>(36,995,965)</i>	<i>(20,123,072)</i>	<i>(16,872,893)</i>	<i>54%</i>
3.Kostot Financiare	(194,916)	3,819,697	(4,014,613)	2159%
<i>Të ardhura nga interesi</i>	-	4,488,058	(4,488,058)	-
<i>Komisionet Bankare</i>	<i>(194,916)</i>	<i>(137,143)</i>	<i>(57,773)</i>	<i>70%</i>
<i>Fitimi/Humbja nga kursi i këmbimit</i>	-	<i>(531,218)</i>	<i>531,218</i>	
Fitimi / Humbja	(123,214,203)	(70,945,873)	(52,268,330)	58%

Burimi: AIC, përpunuar nga GA

Nga auditimi konstatohet se AIC për vitin 2022, ka kryer shpenzime në shumën 74,765,569 lekë, si dhe nuk janë gjeneruar të ardhura nga aktiviteti.

Shpenzimet e kryera për personelin janë në shumën 33,817,489 lekë ose rreth 46 % të totalit të shpenzimeve.

Shpenzimet e kryera për Këshillin Mbikëqyrës janë në shumën 20,257,693 lekë ose rreth 27 % të totalit të shpenzimeve.

Shpenzimet e kryera për kosto të tjera operationale janë në shumën 20,123,072 lekë ose rreth 27 % e totalit të shpenzimeve.

Nga auditimi konstatohet se të ardhura nga interesat janë në shumën 4,488,058 lekë dhe rezultojnë të pa planifikuara. Këto të ardhura përfaqësojnë interesin e depozitave monetare të cilat burojnë nga kapitali i shoqërisë, në bankën e nivelit të II-të (A. Bank) në llogari rrjedhëse prej 2 miliardë lekë në datën 27.01.2022

Në analizë parashikimi dhe realizimi i detajuar mbi shpenzimet e personelit

'në lekë

Përshkrimi	Parashikimi 2022	Realizimi 2022	Diferenca midis realizimit dhe parashikimit	% e Realizimit
------------	------------------	----------------	---------------------------------------------	----------------

Pagat	35,640,274	29,821,977	5,818,297	83%
Kontributet shoqërore dhe sigurimet shëndetsore	3,433,510	3,433,510	-	
Ndërtimi i Kapaciteteve - Trajnime	8,560,000	87,000	8,473,000	1%
Sigurimi për jetën dhe shëndetin - Drejtuesit	568,260	197,918	370,342	34%
Sigurimi Profesional për Drejtuesit	738,000	-	-	
Sigurimi për jetën dhe shëndetin - Stafi	662,970	277,085	385,886	41%
Totali	49,603,014	33,817,489	15,047,524	68%

Burimi: AIC, përpunuar nga GA

Nga auditimi konstatohet se për shpenzimet e personelit ka një realizim në masën 83% në raport me planifikimin në fillim të vitit, si rezultat i mos plotësimit të organikës me punonjës.

Në lidhje me zërin e trajnimeve konstatohet se nuk është realizuar gjatë vitit 2022 shuma e cila ishte parashikuar në fillim të vitit.

Në zërin sigurime për jetën dhe shëndetin, janë parashikuar shpenzimet për drejtuesit dhe për të gjithë stafin në lidhje me sigurimin në skemë private të jetës dhe shëndetit, ku janë realizuar në shumën 277,085 lekë ose në masën 41%.

Në zërin sigurime profesionale, janë parashikuar shpenzimet për drejtuesit në lidhje me sigurimin profesional gjatë ushtrimit të detyrës, për të cilat nuk janë kryer shpenzime faktike.

Në analizë parashikimi dhe realizimi i detajuar mbi shpenzimet për Bordet

'në lekë

Përshkrimi	Parashikimi 2022	Realizimi 2022	Diferenca midis realizimit dhe parashikimit	% e Realizimit
Tarifat e Këshillit Mbikëqyrës	25,435,045	20,257,693	5,177,352	80%
Tarifat e Bordit Këshillimor	4,500,000	-	4,500,000	-
Sigurimet profesionale për Këshillin Mbikëqyrës	246,000	-	246,000	-
Të tjera shpenzime të lidhura me Organet Drejtuese	4,297,954	-	4,297,954	-
Totali	34,478,998	20,257,693	14,221,305	59%

Burimi: AIC, përpunuar nga GA

Nga auditimi konstatohet se për vitin 2022 janë kryer shpenzime vetëm për pagesat për anëtarët në Këshillin Mbikëqyrës me një realizim në masën 80%. Gjithashtu nuk janë kryer pagesa për anëtarët e Bordit Këshillimor pasi nuk ka funksionuar gjatë vitit 2022.

Në zërin sigurime profesionale, janë parashikuar shpenzimet për Këshillin Mbikëqyrës në lidhje me sigurimin profesional gjatë ushtrimit të detyrës, për të cilat nuk janë kryer si shpenzime faktike.

Në lidhje me shpenzimet e tjera të lidhura me Bordin janë planifikuar shpenzime udhëtimi dhe të tjera që lidhen me funksionimin e Këshillit Mbikëqyrës në shumën 4,297,954 lekë por nuk janë kryer shpenzime faktike.

Në analizë parashikimi dhe realizimi i detajuar mbi shpenzimet Operacionale

'në lekë

Përshkrimi	Parashikimi 2022	Realizimi 2022	Diferenca midis realizimit dhe parashikimit	% e Realizimit
Qiraja e Zyrës	8,339,400	8,092,948	246,452	97%
Mirëmbajtja dhe Riparimet	-	-	-	-
Taksat Vendore	184,965	-	184,965	
Kostot utilitare	480,000	238,842	241,158	50%
Shërbimet profesionale	7,380,000	3,431,654	3,948,346	47%
Kancelari	500,000	304,842	195,158	61%
Kostot e Marketingut	100,000	100,000	-	100%
Pagesat vjetore të internetit etj.	1,230,000	1,129,637	100,363	91%
Kostot e Printimit	100,000	86,419	13,581	86%
Shërbimet e pastrimit	200,000	109,728	90,272	55%
Kostot e telefonit	780,000	-	780,000	-
Posta	45,000	10,536	34,464	23%
Shpenzime për ujë	220,000	-	220,000	-

Tarifat e Auditimit	3,075,000	1,875,089	1,199,911	61%
Shpenzime karburanti	1,440,000	96,880	1,343,120	7%
Mirëmbajtja e automjeteve	57,600	-	57,600	-
Makina me qira	1,476,000	91,210	1,384,790	6%
Dieta	1,476,000	493,547	982,453	33%
Shërbime udhëtimi	6,420,000	3,631,152	2,788,848	56%
Kostot të tjera të transportit	492,000	-	492,000	-
Kosto të tjera operacionale	3,000,000	430,587	2,569,413	14%
Totali	36,995,965	20,123,072	16,872,893	54%

Burimi: AIC, përpunuar nga GA

Nga auditimi konstatohet se shpenzimet operacionale në total janë kryer në shumën 20,123,072 lekë ose në masën 54 % në raport me parashikimin.

Peshën më të madhe të shpenzimeve operacionale përfaqësohet nga shpenzimet për qiranë e zyrës, shërbimet profesionale, shërbimet e auditimit si dhe shërbimet e udhëtimit.

Kostot për qiranë e zyrës janë realizuar në shumën 8,092,948 lekë ose në masën 97% të parashikimit, përfaqësojnë shpenzimet e kryera për qiranë e zyrës ku AIC ushtron aktivitetin.

Në lidhje me kostot për shërbimet profesionale të realizuara në shumën 3,431,654 lekë, ose në masën 47% nga parashikimi janë shpenzime për ekspertë të jashtëm të kontraktuar në hartimin e projekt-propozimeve, si më poshtë:

<i>'në lekë</i>		
Eksperti	Përshkrimi	Shuma
Arben Dushi	Ekspert i jashtëm për Energjinë	105,900
Edmond Zhupani	Ekspert i jashtëm për Pash-Alimanin	337,080
Simon Battisti	Shërbime projektimi Arkitekt	1,600,000
Ridvana Ruci	Shpenzime Noteriale	12,400
GREEN EAGLE CONSULTING	Vlerësuesi i Pasurisë	300,000
Denis Demiri	Ekspert i jashtëm Ligjor	200,000
COSMOS TRANSLATION	Përkthime	46,980
Artan Burimi	Ekspert i jashtëm për procedurën e blerjeve të mobiljeve	94,000
Olgen Cikopana	Shërbime konsulence IT	735,294
Totali		3,431,654

Burimi: AIC, përpunuar nga GA

Kostot e shërbimeve të auditit janë realizuar në shumën 1,875,089 lekë ose në masën 61% nga parashikimi, të cilat janë shpenzime të kryera për kontraktimin e shoqërive të auditimit me qëllim kryerjen e auditimit ndaj pasqyrave financiare të AIC-së.

Kostot e shërbimeve të udhëtimit janë realizuar në shumën 4,124,699 lekë ose në masën 64% nga parashikimi, ku sipas informacionit të dhënë nga AIC, përfaqësojnë shpenzime të kryera nga stafi i AIC-së për udhëtime të ndryshme në lidhje me evidentimin e pronave si dhe takime brenda dhe jashtë vendit.

Shpenzimet kapitale për projektet

Nga ana e AIC-së për buxhetin e vitit 2022, janë parashikuar shpenzime kapitale për projekte në shumën 1,057,800,000 por të cilat nuk janë të detajuara për secilin projekt, si dhe nuk ka realizim deri në fund të 2022.

Plani i Biznesit për vitin 2023

Me Vendimin e Këshillit Mbikëqyrës të AIC-së me nr.13, datë 05.12.2022, është miratuar Plani i Biznesit për vitin 2023.

Me Vendimin e Këshillit Mbikëqyrës të AIC-së me nr.20, datë 13.11.2023, është miratuar rishikimi i buxhetit të AIC-së për vitin 2023, në funksion të huadhënies në vlerën 2 miliardë lekë në favor të shoqërisë A. SHA.

Në vitin 2023 nga ana e AIC-së janë hartuar projekt buxheti i vitit me parashikimet si dhe realizimi i të ardhurave dhe kryerja e shpenzimeve si më poshtë të përmbledhura:

'në lekë

Përshkrimi	Parashikimi 2023	Buxheti i Rishikuar	Realizimi 2023	Diferenca midis realizimit dhe parashikimit	% e Realizimit
1.Të ardhura	-	-	-	-	-
<i>Të ardhura nga konsulentat</i>	-	-	-	-	-
2.Shpenzimet	(157,633,800)	(88,524,662)	(77,887,755)	(79,746,045)	49%
<i>Kosto e Stafit</i>	<i>(70,594,390)</i>	<i>(45,933,399)</i>	<i>(43,843,839)</i>	<i>(26,750,550)</i>	<i>62%</i>
<i>Këshilli Mbikëqyrës</i>	<i>(36,167,000)</i>	<i>(22,356,222)</i>	<i>(18,709,601)</i>	<i>(17,457,399)</i>	<i>52%</i>
<i>Zhvlerësimi</i>	<i>(2,350,371)</i>	<i>(1,733,092)</i>	<i>(1,599,744)</i>	<i>(750,628)</i>	<i>68%</i>
<i>Kosto të tjera operacionale</i>	<i>(48,522,039)</i>	<i>(18,501,949)</i>	<i>(13,734,571)</i>	<i>(34,787,468)</i>	<i>28%</i>
3.Kostot Financiare	943,953	13,914,427	27,816,216	27,530,753	2916%
<i>Të ardhura nga interesi</i>	<i>1,143,513</i>	<i>14,500,282</i>	<i>28,345,021</i>	<i>27,201,508</i>	<i>2378%</i>
<i>Komisionet Bankare</i>	<i>(199,561)</i>	<i>(149,913)</i>	<i>(132,398)</i>	<i>(67,163)</i>	<i>66%</i>
<i>Fitimi/Humbja nga kursi i këmbimit</i>	-	<i>(435,942)</i>	<i>(396,408)</i>	<i>396,408</i>	
Fitimi / Humbja	(156,689,847)	(74,610,235)	(50,071,540)	(52,215,292)	33%

Burimi: AIC

Nga auditimi konstatohet se në projekt buxhetin e miratuar në vitin 2023 janë parashikuar shpenzime në shumën 157,633,800 lekë, të cilat më pas kanë ardhur në ulje me buxhetin e rishikuar në nëntor të 2023 në shumën 88,524,662 lekë, me një diferencë në shumën 69,109,138 lekë ose në masën 43% më pak krahasuar me shpenzimet e parashikuara në fillim të vitit. Realizimi i shpenzimeve paraqitet në shumën 77,887,755 lekë ose në masën 49% krahasuar me parashikimin në fillim të vitit 2023. Kjo situatë tregon një planifikim të dobët dhe të pa argumentuar nga ana e AIC-së në fillim të vitit 2023, vijuar më pas me rishikimin e buxhetit në nëntor të 2023 duke ardhur me një rënie të konsiderueshme.

Gjithashtu në lidhje me kostot financiare në fillim të vitit janë parashikuar në vlera pozitive prej 943,953 lekë, duke ardhur në rritje me buxhetin e rishikuar në nëntor të 2023 në vlerën 13,914,427 lekë dhe me tejkalim në realizim në shumën 27,816,216 lekë. Këto të ardhura janë realizuar nga interesi i vendosjes në llogari rrjedhëse në bankën e nivelit të II-të A. Bank në shumën 2 miliardë lekë në datën 27.01.2022 duke u shtuar edhe me 2 miliardë lekë në datën 28.07.2023 si dhe me pakësim po me 2 miliardë lekë në datën 30.11.2023 si pasojë e dhënies së huasë në favor të shoqërisë A. SHA. Gjithashtu janë llogaritur interesa të huasë për periudhën nga data e disbursimit 30.11.2023 deri në 31.12.2023

Në analizë parashikimi dhe realizimi i detajuar mbi shpenzimet e personelit

'në lekë

Përshkrimi	Parashikimi 2023	Buxheti i Rishikuar Nëntor 2023	Realizimi 2023	Diferenca midis realizimit dhe parashikimit	% e Realizimit
Pagat	53,997,200	38,129,682	38,129,682	15,867,518	70%
Kontributet shoqërore dhe sigurimet shëndetsore	5,674,090	5,089,077	5,043,976	630,114	88%
Ndërtimi i Kapaciteteve - Trajnime	8,560,000	2,140,000	95,541	8,464,459	1%
Sigurimi për jetën dhe shëndetin - Drejtuesit	-	-	-	-	-
Sigurimi Profesional për Drejtuesit	-	-	-	-	-
Sigurimi për jetën dhe shëndetin - Stafi	2,363,100	574,640	574,640	1,788,460	24%
Totali	70,594,390	45,933,399	43,843,839	26,750,550	62%

Burimi: AIC, përpunuar nga GA

Nga auditimi konstatohet se për shpenzimet e personelit ka një realizim në masën 70% në raport me planifikimin në fillim të vitit, si rezultat i mos plotësimit të organikës me punonjës.

Në lidhje me zërin e trajnimeve konstatohet se nuk është realizuar gjatë vitit 2023 shuma e cila ishte parashikuar në fillim të vitit.

Në zërin sigurime për jetën dhe shëndetin, janë parashikuar shpenzimet për të gjithë stafin në lidhje me sigurimin në skemë private të jetës dhe shëndetit, ku janë realizuar në shumën 1,788,460 lekë ose në masën 24%.

Në zërin sigurime profesionale, janë parashikuar shpenzimet për drejtuesit në lidhje me sigurimin profesional gjatë ushtrimit të detyrës, për të cilat nuk janë kryer shpenzime faktike.

Në analizë parashikimi dhe realizimi i detajuar mbi shpenzimet për Bordet

'në lekë

Përshkrimi	Parashikimi 2023	Buxheti i Rishikuar Nëntor 2023	Realizimi 2023	Diferenca midis realizimit dhe parashikimit	% e Realizimit
Tarifat e Këshillit Mbikëqyrës	26,628,000	17,025,358	16,527,787	10,100,213	62%
Tarifat e Bordit Këshillimor	4,500,000	1,800,000	-	4,500,000	-
Sigurimet profesionale për Këshillin Mbikëqyrës	331,000	331,000	-	331,000	-
Të tjera shpenzime të lidhura me Organet Drejtuese	4,708,000	3,199,864	2,181,814	2,526,186	46%
Totali	36,167,000	22,356,222	18,709,601	17,457,399	51%

Burimi: AIC, përpunuar nga GA

Nga auditimi konstatohet se për vitin 2023 janë kryer shpenzime për pagesat për anëtarët në Këshillin Mbikëqyrës me një realizim në masën 62%. Gjithashtu nuk janë kryer pagesa për anëtarët e Bordit Këshillimor pasi nuk ka funksionuar gjatë vitit 2023.

Në zerin Sigurime Profesionale, janë parashikuar shpenzimet për Këshillin Mbikëqyrës në lidhje me sigurimin profesional gjatë ushtrimit të detyrës, për të cilat nuk janë kryer si shpenzime faktike.

Në lidhje me shpenzimet e tjera të lidhura me Bordin janë planifikuar shpenzime udhëtimi dhe të tjera që lidhen me funksionimin e Këshillit Mbikëqyrës në shumën 4,708,000 lekë si dhe janë kryer shpenzime faktike në shumën 2,526,186 lekë ose në masën 46%, të cilat janë shpenzime udhëtimi për anëtarët e huaj në Këshillin Mbikëqyrës si më poshtë:

'në lekë

Përshkrimi	Shuma
Biletë udhëtimi - David Kennedy, mbledhje Bordi Korrik	476,746
Shpenzime akomodimi - David Kennedy, mbledhje Bordi Korrik	173,112
Biletë Avioni David Kennedy USA-Alb-USA	1,149,900
Qira afatshkurtër për eventin e Këshillit Mbikëqyrës	382,056
Totali	2,181,814

Burimi: AIC, përpunuar nga GA

Në analizë parashikimi dhe realizimi i detajuar mbi shpenzimet Operacionale

'në lekë

Përshkrimi	Parashikimi 2023	Buxheti i Rishikuar Nëntor 2023	Realizimi 2023	Diferenca midis realizimit dhe parashikimit	% e Realizimit
Qiraja e Zyrës	8,628,500	7,947,502	7,371,386	1,257,114	85%
Mirëmbajtja dhe Riparimet	100,000	97,383	383	99,617	0.3%
Taksat Vendore	300,000	394,334	394,334	-94,334	131%
Kostot utilitare	345,500	338,417	295,643	49,857	85%
Shërbimet profesionale	7,380,000	995,600	680,600	6,699,400	9%
Kancelari	500,000	94,315	85,765	414,235	17%
Kostot e Marketingut	2,376,000	711,240	154,302	2,221,698	6%
Pagesat vjetore të internetit etj.	1,480,300	1,136,248	571,456	908,844	39%
Kostot e Printimit	120,000	119,503	99,120	20,880	83%
Mirëmbajtje serveri IT	100,000	-	-	100,000	-
Abonimet	2,320,339	594,000	-	2,320,339	-
Shpenzime për përfaqësim (Konferenca)	1,939,000	143,937	143,937	1,795,063	7%
Shërbimet e pastrimit	200,000	199,311	104,311	95,689	52%
Shpenzime komunikimi, Telefonie	900,000	331,783	199,894	700,106	22%
Shpenzimet postare	100,000	59,700	9,700	90,300	10%
Shpenzime për ujë	162,000	-	-	162,000	-%
Tarifat e Auditimit	4,000,000	2,219,384	1,682,820	2,317,180	42%
Shpenzime karburanti	1,500,000	129,800	109,800	1,390,200	7%
Sigurimi i Automjeteve	121,000	100,000	100,000	21,001	83%
Mirëmbajtja e automjeteve	124,400	9,300	9,300	115,100	7%
Makina me qira	1,080,000	52,201	52,201	1,027,799	5%
Dieta	2,451,600	173,973	173,973	2,277,627	7%
Shpenzime udhëtimi	8,193,400	2,411,768	1,253,395	6,940,005	15%
Kostot të tjera të transportit	500,000	-	-	500,000	-

Kosto të tjera operacionale	3,600,000	242,250	242,250	3,357,750	7%
Totali	48,522,039	18,501,949	13,734,571	34,787,468	28%

Burimi: AIC, përpunuar nga GA

Nga auditimi konstatohet se shpenzimet operacionale në total janë kryer në shumën 13,734,571 lekë ose në masën 28 % në raport me parashikimin.

Peshën më të madhe të shpenzimeve operacionale përfaqësohet nga shpenzimet për qiranë e zyrës, shërbimet profesionale, shërbimet e auditimit si dhe shërbimet e udhëtimit.

Kostot për qiranë e zyrës janë realizuar në shumën 7,371,386 lekë ose në masën 97% të parashikimit, përfaqësojnë shpenzimet e kryera për qiranë e zyrës ku AIC ushtron aktivitetin.

Në lidhje me kostot për shërbimet profesionale të realizuara në shumën 680,600 lekë, ose në masën 9% nga parashikimi janë shpenzime për ekspertë të jashtëm të kontraktuar si më poshtë:

Eksperti	Përshkrimi	Shuma
Loriana Robo	Shpenzime Noteriale	5,600
Artian Plasari	Ekspert i jashtëm për prokurimet	255,000
Laureta Spahiu	Ekspert i jashtëm për PR	360,000
Xhevahir Datja	Ekspert i jashtëm për prokurimin e makinës	60,000
Totali		680,600

'në lekë

Burimi: AIC, përpunuar nga GA

Kostot e shërbimeve të auditit janë realizuar në shumën 1,682,820 lekë ose në masën 42% nga parashikimi, të cilat janë shpenzime të kryera për kontraktimin e shoqërive të auditimit me qëllim kryerjen e auditimit ndaj pasqyrave financiare të AIC-së.

Kostot e shërbimeve të udhëtimit janë realizuar në shumën 1,253,395 lekë ose në masën 15% nga parashikimi, ku sipas informacionit të dhënë nga AIC, përfaqësojnë shpenzime të kryera nga stafi i AIC-së për udhëtime të ndryshme në lidhje me evidentimin e pronave si dhe takime brenda dhe jashtë vendit.

Shpenzimet kapitale për projektet

Nga ana e AIC-së për buxhetin e vitit 2023, janë parashikuar shpenzime kapitale për projekte në shumën 366,598,000 lekë por të cilat nuk janë të detajuara për secilin projekt, si dhe nuk ka realizim deri në fund të 2023.

Plani i Biznesit për 6 mujorin e I-rë viti 2024

Me Vendimin e Këshillit Mbikëqyrës të AIC-së nr.28, datë 28.12.2023, është miratuar buxheti për vitin 2024.

Në relacionin e miratuar mbi projekt buxhetin e vitit 2024 dhe projeksioneve për vitet 2025 dhe 2026, nga ana e AIC-së janë kryer analizat mbi mos realizimet e buxhetit gjatë vitit 2023, ku kryesisht vijnë si pasojë e mos realizimit të shpenzimeve të personelit në masën 38%, mos realizimit të shpenzimeve për organet drejtuese në masën 49%, mos realizimi i shpenzimeve operacionale në masën 70% si dhe mos realizimi i shpenzimeve kapitale për projektet në masën 100% pasi Këshilli Mbikëqyrës në 2023 nuk miratoi asnjë nga projekt-identë e planifikuara duke qenë se ato nuk u formësuan në projekt të gatshëm për miratim.

Për vitin 2024, vlera e kapitalit të AIC gjatë planifikimit të buxhetit rezulton në vlerën 4,318,000,000 lekë, i financuar plotësisht nga aksionari i vetëm.

Nga ana e AIC-së është planifikuar që buxheti i vitit 2024 të ndahet në zërat kryesorë si më poshtë:

“Shpenzimet Kapitale për Projekte” në vlerën prej rreth 873.6 milion lekë, vlerë e cila sipas AIC-së do të qëndrojë e padetajuar deri në momentin kur Këshilli Mbikëqyrës do të miratojë buxhetin për secilin projekt; “Shpenzimet Administrative” në vlerën prej rreth 246 milion lekë në të cilat përfshihen: shpenzimet për organet qeverisëse të shoqërisë, shpenzimet e personelit, shpenzimet e amortizimit të aseteve fikse, shpenzime operacionale të tjera, blerje e Aktiveve Fikse (Pajisjet) si dhe Likuiditet.

Të ardhurat dhe shpenzimet

në lekë

Përshkrimi	Fakt 2023	Planifikimi 2024	Parashikimi 2025	Parashikimi 2026	Realizimi 6 mujor i I-rë 2024
1.Të ardhura	-	5,156,000	5,156,000	5,156,000	4,186,250
<i>Të ardhura nga konsulentat</i>	-	<i>5,156,000</i>	<i>5,156,000</i>	<i>5,156,000</i>	<i>4,186,250</i>
2.Shpenzimet		(246,109,300)	(244,311,025)	(279,276,295)	(50,718,601)
<i>Shpenzimet e Personelit</i>		<i>(104,895,810)</i>	<i>(122,378,445)</i>	<i>(157,343,715)</i>	<i>(28,875,751)</i>
<i>Këshilli Mbikëqyrës dhe Bordi Këshillimor</i>		<i>(43,212,798)</i>	<i>(43,212,798)</i>	<i>(43,212,798)</i>	<i>(8,391,332)</i>
<i>Amortizimi</i>		<i>(5,272,129)</i>	<i>(7,969,679)</i>	<i>(7,969,679)</i>	<i>(1,218,565)</i>
<i>Shërbime të tjera operationale</i>		<i>(92,728,563)</i>	<i>(70,750,103)</i>	<i>(70,750,103)</i>	<i>(12,232,953)</i>
3.Të ardhurat financiare		69,445,096	32,414,969	11,352,237	27,235,847
<i>Të ardhura nga interesi</i>		<i>70,467,860</i>	<i>33,437,732</i>	<i>12,375,000</i>	<i>27,251,938</i>
<i>Komisionet Bankare</i>		<i>(416,778)</i>	<i>(416,778)</i>	<i>(416,778)</i>	<i>(82,478)</i>
<i>Fitimi/Humbja nga kursi i këmbimit</i>		<i>(605,985)</i>	<i>(605,985)</i>	<i>(605,985)</i>	<i>66,388</i>
Fitimi / Humbja		(171,508,204)	(206,740,056)	(262,768,058)	(19,296,504)

Burimi: AIC, përpunuar nga GA

Të ardhurat

Në lidhje me të ardhurat nga ana e AIC-së janë evidentuar të ardhurat faktike në 2023 në vlerën 17.8 milion lekë, ku përfshihen, të ardhurat nga interesi i huasë së dhënë nga AIC në favor të A. Sha me interes 3%, për periudhën Nëntor – Dhjetor 2023 në vlerën 5.1 milion lekë, dhe të ardhurat nga interesat bankare në vlerën 12,7 milion lekë.

Parashikimi i të ardhurave sipas AIC-së për vitin 2024 paraqiten në shumën 74.5 milion lekë të ndara si më poshtë:

-Shërbimet e Konsulencës për Fondacionin Dyrrah City Football Academy sipas një marrëveshje të lidhur mes palëve, me miratimin edhe të Ministrisë përgjegjëse për sportin, me objekt këshillimin në realizimin e procedurave të projektit zhvillimor të korpusit sportiv të Akademisë së Futbollit Dyrrah City të ngritur në bashkëpunim me Manchester City Football Club. Të ardhurat nga ky shërbim parashikohet në vlerën 1% të investimit për zhvillim e korpusit sportiv, investimi i cili parashikohet të jetë rreth 10 milion Euro. Për këtë arsye vlera e kontratës së konsulencës parashikohet te jetë rreth 100,000 Euro, e cila mbulohet 50% nga Fondacionin Dyrrah City Football Academy dhe 50% nga entiteti fitues i procedurës përzgjedhëse të partnerit zhvillues të korpusit vlerë e cila në vitin 2024 parashikohet rreth 50,000 Euro (5.156 milion Lekë). Po ashtu gjatë vitit 2024 priten të sigurohen të ardhura nga konsulencia/këshillime/autorizime të ndryshme si psh në lidhje më kontratën e pritshme me objekt zhvillimin e Qendrës së Panairëve (EKSPOR Albania) si dhe me autorizimin e Këshillit të Ministrave për caktimin e AIC si Zhvillues e DURANA Park Tech, të cilat janë ende të papërcaktuara në kohën e planifikimit.

-Të ardhurat neto financiare të pritshme planifikohen në vlerën 69.38 milion lekë, të cilat përbëhen nga të ardhurat nga interesi i huasë ndaj A. me interes vjetor 3% i pagueshëm në fund të periudhës një vjecare në vlerën rreth 54.9 milion lekë; të ardhurat nga interesi i investimi i flukseve të lira monetare në bono thesari, depozita bankare të diversifikuara në afate depozite 3-mujor, 6-mujor dhe 12-mujor, në vlerën rreth 15.5 milion lekë; nga keto zbriten shpenzimet për komisionet bankare dhe efekti i rivlersimit respektivisht në vlerën -416.7 mijë Lekë dhe -605.9 mijë lekë.

Nga auditimi konstatohet se të ardhurat e realizuara deri në 30.06.2024, janë të ardhurat e arëktuara nga shërbimi i konsulencës të cilin AIC ka kryer për Fondacionin Dyrrah City Football Academy në shumën 4,186,250 lekë, si dhe të ardhura nga interesat e depozitave në shumën 27,251,938 lekë.

Shpenzimet Administrative

Shpenzimet për Organet Drejtuese

Shpenzimet e parashikuara në Buxhetin e vitit 2024 nga ana e AIC-së për Organet Drejtuese, përfaqësojnë shpenzimet mbi shpërblimet për anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës dhe anëtarët e Bordit Këshillimor, si dhe sigurimi profesional dhe shpenzime të tjera të detajuara si më poshtë:

'në lekë

Përshkrimi	Parashikimi 2024	Parashikimi 2025	Parashikimi 2026	Realizimi 6 mujori I-rë 2024
Shpërblimet e Organeve Qeverisëse	40,358,528	40,358,528	40,358,528	8,391,332
Sigurimi Profesional	360,920	360,920	360,920	-
Shpenzime të tjera	2,493,350	2,493,350	2,493,350	-
Totali	43,212,798	43,212,798	43,212,798	8,391,332

Burimi: AIC, përpunuar nga GA

Nga auditimi konstatohet se për vitin 2024 janë parashikuar shpenzime për shpërblimet e anëtarëve të Organeve Drejtuese të AIC-së në shumën 40,358,528 lekë shumë e njëjtë edhe për projeksionet e viteve 2025 dhe 2026. Gjithashtu edhe shpenzimet për sigurimin profesional dhe shpenzime të tjera në lidhje me Organet Drejtuese janë parashikuar në shumën 360,920 lekë dhe 2,493,520 lekë të cilat janë të njëjta me projeksionet e viteve 2025 dhe 2026.

Deri në 30.06.2024, nga ana e AIC-së janë kryer shpenzime në shumën 8,391,332 lekë të cilat janë për anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës dhe për 2 anëtarë të Bordit Këshillimor të cilët janë emëruar në Prill të 2024.

Shpenzimet për Personelin e AIC-së

Në relacion e miratuar të buxhetit nga AIC, është evidentuar se shpenzimet për personelin gjatë 2023 kanë qenë në shumën 43.8 milion lekë ose në masën 38% krahasuar me parashikimin, si rezultat i mos plotësimit të organikës së punonjësve ku përgjatë vitit 2023 kanë rezultuar 17 punonjës nga 25 punonjës të miratuar në strukturë.

AIC ka parashikuar se në vijim të projekteve që do të zhvillohen për vitin 2024 numri total i punonjësve do të jetë 35 punonjës.

Shpenzimet e parashikuara në Buxhetin e vitit 2024 nga ana e AIC-së për personelin, përfaqësojnë shpenzimet mbi pagat dhe shpërblimet e stafit, kontributet shoqërore dhe shëndetësore, trajnimet e punonjësve, sigurimi profesional dhe sigurimi i shëndetit dhe jetës së punonjësve të detajuara si më poshtë:

'në lekë

Përshkrimi	Parashikimi 2024	Parashikimi 2025	Parashikimi 2026	Realizimi 6 mujori I-rë 2024
Pagat	81,827,000	95,464,833	122,740,500	25,410,908
Sigurimet Shoqërore dhe Shëndetësore	11,958,810	13,951,945	17,938,215	3,464,843
Ngritje kapacitetesh	8,560,000	9,986,667	12,840,000	-
Sigurimi Profesional	900,000	1,050,000	1,350,000	-
Sigurimi i shëndetit dhe jetës	1,650,000	1,925,000	2,475,000	-
Totali	104,895,810	122,378,445	157,343,715	28,875,751

Burimi: AIC, përpunuar nga GA

Nga auditimi konstatohet se për vitin 2024 janë parashikuar shpenzime për pagat e stafit të AIC-së në shumën 81,827,000 lekë shumë e cila vjen në rritje për vitin 2025 në vlerën 95,464,833 lekë dhe në vitin 2026 në vlerën 122,740,500 lekë, pasi për vitin 2025 nga ana e AIC-së është parashikuar një rritje me 5 punonjës dhe në vitin 2026 me 10 punonjës, për një numër total prej 45 punonjësish. Gjithashtu edhe zërat e tjerë të shpenzimeve paraqiten në rritje krahasuar me parashikimin e vitit 2024.

Gjithashtu deri në 30.06.2024, janë kryer shpenzime në vlerën 28,875,751 lekë, të cilat janë paga dhe kontributet për stafin e AIC-së.

Shpenzimet Operacionale

Në relacion e miratuar të buxhetit për vitin 2024 nga AIC, janë paraqitur shpenzimet operacionale të detajuara si më poshtë:

në lekë

Përshkrimi	Parashikimi 2024	Parashikimi 2025	Parashikimi 2026	Realizimi 6 mujori I-rë 2024
Shpenzime Operacionale Administrative	21,201,883	21,201,883	21,201,883	5,904,758
Qira zyra	10,456,800	10,456,800	10,456,800	4,800,662
Mirëmbajtja dhe Riparimi	300,000	300,000	300,000	-
Taksat Vendore	300,000	300,000	300,000	225,570
Utilitete	529,083	529,083	529,083	130,469
Kancelari dhe materiale zyre	800,000	800,000	800,000	87,650
Pastrimi	800,000	800,000	800,000	62,760
Shpenzime telefonie	2,016,000	2,016,000	2,016,000	145,268
Tarifa Postare	600,000	600,000	600,000	-
Shpenzime të tjera operative	5,400,000	5,400,000	5,400,000	452,379
Shpenzime Operacionale të tjera	71,526,680	49,548,220	49,548,220	6,328,196
Shërbime Profesionale	22,140,000	1,500,000	1,500,000	3,656,000
Shpenzime Marketingu	6,692,300	5,353,840	5,353,840	29,000
Abonime të ndryshme	4,124,800	4,124,800	4,124,800	-
Shpenzime vjetore për internetin dhe paketat	6,000,000	6,000,000	6,000,000	417,460
Shpenzimet e Përfaqësimit (Konferencat)	6,929,440	6,929,440	6,929,440	80,500
Shpenzime auditimi dhe prokurimi	8,500,000	8,500,000	8,500,000	502,850
Shpenzime karburanti	2,200,000	2,200,000	2,200,000	-
Sigurimi i makinës	720,000	720,000	720,000	-
Mirëmbajtja e makinave	720,000	720,000	720,000	-
Makina me qira	1,484,800	1,484,800	1,484,800	-
Shpenzime për dieta	3,299,840	3,299,840	3,299,840	-
Shpenzime printimi	600,000	600,000	600,000	47,414
Shpenzime udhëtimi	8,115,500	8,115,500	8,115,500	1,594,972
Totali	97,728,680	70,750,103	70,750,103	12,232,953

Burimi: AIC, përpunuar nga GA

Në lidhje me zërat kryesorë mbi shpenzimet operacionale nga ana e AIC-së në relacionin e përgatitur është përcaktuar se shpenzimet për qiranë e zyrës ku ushtron aktivitetin AIC, gjatë vitit 2023 paraqiten në shumën prej 7.4 milion lekë, si dhe AIC ka parashikuar që në vitin 2024 të shtojë hapësirat e zyrave me rreth 164 m² në godinën aktuale si rrjedhojë e shtimit të numrit të punonjësve duke parashikuar vlerën prej 10,456,800 lekë, e pa ndryshuar në projeksionet e viteve 2025 dhe 2026.

Në lidhje me shpenzimet për shërbime profesionale nga ana e AIC-së në relacionin e përgatitur përcaktohet se gjatë vitit 2023 janë realizuar shpenzime faktike prej 680 mijë lekë, ku mos realizimi vjen si rrjedhojë e një planifikimi të pa bazuar. Për vitin 2024 janë parashikuar shpenzime për shërbime profesionale në vlerën 22.1 milion lekë, të cilat sipas AIC-së lidhen me tarifat për konsolidimin e pronës ku parashikohen që në AIC të transferohen rreth 100 asete/prona për zhvillim dhe do të nevojitet kryerja e hapave parapërgatitore për konsolidimin e tyre. Gjithashtu parashikohen shpenzime për realizimin e marrëveshjeve kuadër për konsulencë profesionale apo kontrata publike, ku për 2024 AIC në funksion të zhvillimit të pronave, zhvillimin e parqeve teknologjike dhe planifikimin e koncept-ideve për zbatimin e projekteve, të cilat do të jenë shpenzime për kontraktimin e ekspertëve në disa fusha.

Nga auditimi konstatohet se deri në 30.06.2024, janë realizuar shpenzime faktike prej 12,232,953 lekë, ose në masën 12% krahasuar me parashikimin në fillim të vitit, të cilat janë shpenzime për qiranë e zyrave, shpenzime udhëtimi dhe shpenzime për shërbime profesionale kryesisht.

Shpenzimet kapitale për projektet

Nga ana e AIC-së në relacionin e përgatitur për buxhetin e vitit 2024, janë parashikuar shpenzime për disa projekte që priten të fillojnë sipas planit të punës, të paraqitura si më poshtë:

Projektet sipas viteve	Viti I	Viti II	Viti III
	35%	45%	20%
2,496,079,239	873,627,734	1,123,235,658	499,215,848

Burimi: AIC, përpunuar nga GA

Nga auditimi konstatohet se për shpenzimet kapitale për projektet për vitin 2024 janë parashikuar në shumën 873,627,734 lekë në total, por të cilat nuk janë të detajuara për secilin projekt.

Konkluzion:

Nga ana e Grupit të Auditimit është konstatuar se në projekt-buxhetet e viteve 2022 dhe 2023 nuk është hartuar një relacion shoqërues apo analizë e detajuar mbi parashikimet buxhetore sipas zërave përkatës, e cila të reflektojë një vlerësim të plotë dhe të argumentuar të nevojave konkrete të AIC-së. Mungesa e një analize të tillë ka rezultuar në planifikim buxhetore të dobët, duke ndikuar në mosrealizimin e disa zërave kryesorë, përfshirë të ardhurat dhe shpenzimet.

Gjithashtu, lidhur me shpenzimet kapitale për projekte, është konstatuar se nuk ka një analizë të detajuar për secilin projekt individual. Parashikimet buxhetore janë kryer në nivel total, pa identifikuar nevojat dhe alokimet specifike për secilin projekt.

Grupi i auditimit ka konstatuar se, në lidhje me monitorimin e zbatimit të buxhetit, AIC nuk ka hartuar një relacion që të pasqyrojë në mënyrë të qartë zbatimin e zërave buxhetorë dhe arsyet e mosrealizimit të tyre. Kjo mungesë analize dhe dokumentimi kufizon aftësinë për të adresuar problemet dhe për të përmirësuar zbatimin e buxhetit në periudhat pasuese.

Për projekt-buxhetin e vitit 2024, Grupi i Auditimit ka konstatuar se AIC ka përgatitur një relacion të miratuar nga Këshilli Mbikëqyrës, ku janë përcaktuar parashikimet për të ardhurat dhe shpenzimet për vitin 2024, si dhe projeksionet për vitet 2025 dhe 2026. Gjithashtu, në relacion janë përfshirë shpenzimet kapitale për projektet që do të zhvillohen.

Megjithatë, parashikimet për shpenzimet kapitale për projektet janë kryer në mënyrë të përgjithshme dhe në total, pa një detajim të specifik për secilin projekt.

Veprimet e mësipërme janë kryer në kundërshtim me Ligjin nr.10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar, neni 3 ku përcaktohet “Fusha e zbatimit të Ligjit”, pika 2: “Shoqëritë tregtare, organizatat jofitimprurëse dhe autoritetet e përbashkëta, të cilat zotërohen, kontrollohen, financohen ose garantohen financiarisht nga një njësi e qeverisjes së përgjithshme” dhe Udhëzimin e METE nr. 394, datë 21.08.2014 “Mbi programet e zhvillimit ekonomik të shoqërive tregtare me kapital tërësisht shtetëror” i ndryshuar me udhëzimin e MFE nr. 15, datë 02.05.2018 “Mbi programet e zhvillimit ekonomik të shoqërive tregtare me kapital tërësisht shtetëror”.

2.1.3.Mbi auditimin e planeve vjetore të punës, projekteve të investimeve, si dhe realizimi i tyre.

Plani i punës për 6 mujorin e II-të viti 2021

Me Vendimin e Këshillit Mbikëqyrës të AIC-së me nr.9, datë 07.09.2021, është miratuar Plani i Punës për 6 mujorin e II-të të Vitit 2021, ku është konkluduar si më poshtë:

1.Ngritja e kapaciteteve të AIC-së

- Organizimi i mbledhjeve të bordit dhe ngritja e komiteteve të veçanta;
- Rekrutimi i personelit financë, çështje ligjore, operacionale e zhvillimit të biznesit dhe administratë logjistike;
- Identifikimi i selisë së re;
- Organizimi i llogarive të Korporatës dhe kryerja e operacioneve dhe shërbimeve;
- Përgatitja e politikave dhe rregulloreve të brendshme;

- Raportimet tatimore dhe rregullatore.

Me shkresën nr. 13 prot, datë 21.12.2021, Drejtori Ekzekutiv, z. E. F., i është drejtuar Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë me kërkesë për informacion mbi asetet që janë në administrim të Ministrisë. Kjo kërkesë është bërë në kuadër të realizimit të një analize paraprake mbi asetet që kanë potencial të lartë ekonomik për zhvillimin e vendit. (*Zona e teknologjisë dhe zhvillimit ekonomik në Vlorë, Fabrika e telave në Shkodër, Objekti Syri i Kaltër në Sarandë, Ambiente jo funksional të ndërmarrjeve shtetërore Tiranë, Kompania Ital-Druri Elbasan, Asete që janë në administrim të kompanisë Prodhim-Mobilje, Shoqërinë Kripa SHA Vlorë, Shoqërinë Duhan-Cigare Shkodër SHA, Aksionet minorancë që zotëron Ministria në shoqëritë tregtare*).

Sa më sipër, nga dokumentacioni i vënë në dispozicion, konstatohet se Ministria e Financave dhe Ekonomisë nuk ka kthyer përgjigje ndaj kërkesës së Drejtorit Ekzekutiv të AIC-së, z. E. F., për informacion mbi asetet në administrim të saj.

Me shkresën nr. 10 prot, datë 12.10.2021, Drejtori Ekzekutiv, z. E. F., i është drejtuar Ministrisë së Mbrojtjes me kërkesë për informacion mbi asetet që janë në administrim të saj. Kjo kërkesë është bërë në kuadër të realizimit të një analize paraprake për identifikimin e aseteve me potencial të lartë ekonomik në zhvillimin e vendit. (*Ofiçinë riparimi Krujë/Rinas, Ish baza ndihmëse ambiente shërbimi Lezhë/Shëngjin, Poligoni i qitjes me mjete detare ish bacteria ABD në Durrës/Kepi i Rodonit, Kantieri i Ndërtimit dhe riparimit të anijeve Vlorë/Orikum, Shkolla e Marinës Vlorë, Objektet e marinës shtëpia e pushimit të ushtarakëve Vlorë/Himarë/Jalë, Ish brigade e nëndetëseve PSV 113 Vlorë/Porto Palermo/Qafë Lerë*)

Sa më sipër, nga dokumentacioni i vënë në dispozicion, konstatohet se Ministria e Mbrojtjes nuk ka kthyer përgjigje ndaj kërkesës së Drejtorit Ekzekutiv të AIC-së, z. E. F., për informacion mbi asetet në administrim të saj.

Plani i Punës për vitin 2022

Më datë 19.01.2022, Drejtori Ekzekutiv, përmes një e-maili drejtuar stafit të brendshëm të strukturës, ka dërguar Planin e Punës për vitin 2022. Gjithashtu, në këtë komunikim është përcaktuar se sektorët kryesorë ku AIC do të fokusohet gjatë vitit 2023 janë turizmi, logjistika, energjia dhe industria.

Sipas Planit të Punës të përgatitur nga Drejtori Ekzekutiv, për vitin 2022 duke parashikuar që fokusi të jetë në 4 drejtime kryesore:

1. Organizimi i brendshëm dhe rritja e kapaciteteve
2. Zhvillimi i projekteve
3. Angazhimi i palëve të interesit
4. Zmadhimi i kapitalit

Mbi zhvillimin e Projekteve gjatë vitit 2022, sipas planit të punës

Në hartimin e Planit të Punës për vitin 2022, AIC ka parashikuar që, gjatë vitit të parë të funksionimit të saj, të synojë lidhjen e disa marrëveshjeve mirëkuptimi dhe zhvillimi me institucione partnere si Bashkia e Tiranës, Ministria e Financës dhe Ekonomisë, Fondi Shqiptar i Zhvillimit, Ministria e Mbrojtjes, Ministria e Bujqësisë, dhe të tjera. Qëllimi i këtyre marrëveshjeve ishte nisja e studimeve të para fizibilitetit për 4 deri në 6 projekte si vijon:

- Ndërtimi i parqeve fotovoltaike si prodhues i energjisë alternative
- Baza e Pashalimanit
- Parku kombëtar Divjaka dhe Karavasta
- Objektet turistike në pronësi të Ministrisë së Mbrojtjes
- Parku verior i biznesit në Shkodër

- Teknoparku Bashkia Tiranë

Me vendimin nr.10, datë 21.12.2021 “Për miratimin e Planit të Biznesit të vitit 2022” nga Këshilli Mbikëqyrës, ndër të tjera është pjesë e planit të biznesit edhe shtojca mbi ciklin e projekteve në lidhje me zhvillimin e aseteve të sektorit publik si një fokus kryesor të veprimtarisë së AIC-së, për të cilat janë përcaktuar fazat që do të ndiqen për çdo projekt-propozim të cilat janë:

- *Transferimi i aseteve në AIC;*
- *Përgatitja e projektit, studimi i para-fizibilitetit, masterplani, vlerësimi mjedisor, lejet dhe licensat dhe kërkesat për zhvillim tregtar të zonave me potencial;*
- *Strukturimi i projektit, konsulencat ligjore dhe financiare, ofertat, dokumentacioni dhe procesi i prokurimit;*
- *Negocimi i kontratës me ofertuesin fitues;*
- *Përfundimi i punimeve;*
- *Fillimi i aktiviteteve tregtare.*

Konstatim:

Nga auditimi u konstatua se plani i punës për vitin 2022 nuk është miratuar nga Këshilli Mbikëqyrës si organi vendimarrës.

Korrespondenca e Drejtorit Ekzekutiv me Këshillin Mbikëqyrës dhe Stafin e AIC-së.

- Me e-mailin e datës 10.03.2022, Drejtori Ekzekutiv drejtuar anëtareve të Këshillit Mbikëqyrës ka dërguar disa projekt propozime të planit të hartuar për t’u konsideruar, duke kërkuar mbështetjen për marrëveshjet e zhvillimit me palët e treta dhe autorizimin për financimin e aktiviteteve dhe studimeve të para fizibilitetit.

- Me e-mailin e datës 04.07.2022, Drejtori Ekzekutiv i është drejtuar anëtareve të Këshillit Mbikëqyrës duke dërguar përditësimin e statusit të projekt-propozimeve të AIC-së, si dhe kërkesën për kontraktimin e konsulentëve/ekspertëve të fushave për të avancuar me studimin e fizibilitetit (dizenjimi i projekteve, analiza e tregut, plani i biznesit).

- Me e-mailin e datës 17.08.2022, Drejtori Ekzekutiv ka vënë në dijeni anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës për disa çështje, për memorandumet e mirëkuptimit me Ministrinë përkatëse, kërkesat e financimit të fizibilitetit për projekt-idetë duke specifikuar se gjatë kësaj periudhe është punuar sa i përket vlerësimeve të para-fizibilitetit, së bashku me kërkesën e aprovimit nga ana e Këshillit Mbikëqyrës.

- Me e-mailin e datës 31.08.2022, Drejtori Ekzekutiv i ka dërguar anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës termat e referencës për vlerësimet e fizibilitetit për projekt-idetë (Parku verior i biznesit, Energjia e rinovueshme, Baza e Pashalimanit), si dhe ka kërkuar autorizimin e tyre për të avancuar me fizibilitetin e tyre.

Me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr.12, datë 04.10.2022, është miratuar autorizimi i Drejtorit Ekzekutiv për të filluar vlerësimet e fizibilitetit për projektet e investimeve dhe miratimin e përdorimit të fondeve të AIC-së për këtë qëllim me propozim të tij.

Nga verifikimi i relacionit me nr.06 prot, datë 04.10.2022 mbi minutat e takimit, Drejtori Ekzekutiv i ka prezantuar Këshillit Mbikëqyrës zhvillimet në lidhje me çështjet e brendshme të Korporatës ku ka specifikuar se stafi i AIC-së po përgatitet për projektet si vijon:

- Gjenerimi i energjisë së rinovueshme
- Zhvillimi i parkut të biznesit në veri
- Ngritjen e Teknoparkut
- Zhvillimi i Divjakës

Sa më sipër nga ana e Këshillit Mbikëqyrës është miratuar autorizimi për fillimin e fizibilitetit të këtyre projekteve të propozuara.

Konstatim:

Nga auditimi konstatohet se AIC dhe Këshilli Mbikëqyrës kanë proceduar me miratimin e autorizimit për fillimin e fizibilitetit, pa një Plan Pune të miratuar për vitin 2022, veprim që bie në kundërshtim me Ligjin nr. 71/2019 “Për Korporatën e Investimeve Shqiptare”, neni 13 “Këshilli Mbikëqyrës”, dhe Statutin e Shoqërisë AIC, neni 17 “Kompetencat e Këshillit Mbikëqyrës”, pika c, ku specifikohet qartë se Këshilli Mbikëqyrës “miraton planin e biznesit, buxhetin dhe planet vjetore të punës”.

Gjithashtu, një pjesë e konsiderueshme e dokumentacionit të vënë në dispozicion të Grupit të Auditimit, rezulton se është përpiluar në gjuhën angleze, por nuk rezulton të jetë nënshkruar kopja e dokumentit edhe në shqip si variant origjinal, fraksion i së cilës protokollohet kopja në gjuhë të huaj. Veprimet e mësipërme janë kryer në kundërshtim me VKLA Nr. 4, datë 19.6.2017 “Për miratimin e “rregullores së njësuar të punës me dokumentet në autoritetet publike të RSH”, neni 4, pika 9 ku citohet ... “Në rastin e komunikimit me institucione apo individë të huaj, dokumentet mund të përpilohen edhe në gjuhë të huaj. Në këtë rast nënshkruhet kopja e dokumentit edhe në shqip si variant origjinal, fraksion i së cilës protokollohet kopja në gjuhë të huaj”.

Plani i Punës për vitin 2023

Me vendimin nr. 13, datë 05.12.2022, Këshilli Mbikëqyrës ka miratuar Planin e Punës të AIC-së për vitin 2023. Sipas këtij plani, sektorët kryesorë ku AIC do të fokusohet gjatë vitit 2023 përfshijnë turizmin, logjistikën, energjinë, industrinë, agrikulturën dhe fushën detare.

Sipas Planit të Punës të përgatitur nga AIC, për vitin 2023 është parashikuar të jetë në 4 drejtime kryesore:

1. Organizimi i brendshëm dhe rritja e kapaciteteve
2. Zhvillimi i projekteve
3. Angazhimi i palëve të interesit
4. Zmadhimi i kapitalit

Mbi zhvillimin e Projekteve gjatë vitit 2023, sipas planit të punës

Në hartimin e Planit të Punës për vitin 2023, AIC ka parashikuar zhvillimin e 6 projekt-propozimeve, si vijon:

- Ndërtimi i parqeve fotovoltaike si prodhues i energjisë alternative
- Baza e Pashalimanit
- Parku kombëtar Divjaka dhe Karavasta
- Objektet turistike në pronësi të Ministrisë së Mbrojtjes
- Parku verior i biznesit në Shkodër
- Teknokparku Bashkia Tiranë

Konstatim:

Nga auditimi konstatohet se Plani i Punës i vënë në dispozicion të Grupit të Auditimit është përpiluar në gjuhën angleze, por nuk rezulton të jetë nënshkruar kopja e dokumentit edhe në shqip si variant origjinal, fraksion i së cilës protokollohet kopja në gjuhë të huaj. Veprimet e mësipërme janë kryer në kundërshtim me VKLA Nr. 4, datë 19.6.2017 “Për miratimin e “rregullores së njësuar të punës me dokumentet në autoritetet publike të RSH”, neni 4, pika 9 ku citohet ... “Në rastin e komunikimit me institucione apo individë të huaj, dokumentet mund të përpilohen edhe në gjuhë të huaj. Në këtë rast nënshkruhet kopja e dokumentit edhe në shqip si variant origjinal, fraksion i së cilës protokollohet kopja në gjuhë të huaj”.

Projekt-Propozimet viti 2022 dhe 2023

1. Projekt-Propozimi - Ndërtimi i parqeve fotovoltaike si prodhues i energjisë alternative

Nga ana e AIC-së është hartuar projekt-propozimi për ndërtimin e parqeve fotovoltaike duke analizuar sektorin e energjisë si dhe rëndësinë ekonomike, vizionin dhe objektivat e projektit. Gjithashtu është parashikuar zhvillimin e projektit duke identifikuar vendndodhjen e pronave të cilat rezultojnë të jenë asete shtetërore.

Kontraktimi i ekspertëve të fushës

Për realizimin e projekt-idesë nga ana e AIC-së, është proceduar me kontraktimin e ekspertëve të fushës si vijon:

1. Ekspert Inxhinier

- Me shkresën nr.32, datë 23.08.2022, znj. F. K. me detyrë Drejtore e Divizionit të Zhvillimit të Biznesit në AIC, i është drejtuar Drejtorit Ekzekutiv z.E. F. me objekt kërkesë për angazhim eksperti duke kërkuar kontraktimin e një eksperti inxhinier me kohë të pjesshme për një periudhë 1 deri 2 mujore për të hartuar projekt-ide dhe draft plane biznesi për asetet e identifikuar nga AIC në fushën e energjisë së rinovueshme, duke bashkëlidhur edhe termat e referencës.

- Me Urdhrin e Drejtorit Ekzekutiv me nr. 32/1 prot, datë 23.08.2022, “për fillimin e procedurave për angazhimin e një eksperti me kohë të pjesshme”, është caktuar Komisionin e Përzgjedhjes me 3 anëtarë, i cili ngarkohet për përgatitjen e njoftimit dhe publikimit në faqen elektronike të AIC-së, ku në përfundim të procedurës duhet të hartojë një relacion me propozimet përkatëse.

- Me shkresën nr. 32/2 prot, datë 24.08.2022, Komisioni i Përzgjedhjes ka informuar Drejtorin Ekzekutiv se publikimi i njoftimit për angazhimin e ekspertit është bërë në faqen elektronike të AIC-së në datën 16.08.2022. Nga shqyrtimi i dokumentacionit mbi jetëshkrimin dhe intervistës komisioni ka gjykuar se eksperti i përmbush kërkesat e shoqërisë dhe vazhdimin me procedurat për lidhjen e kontratës. Gjithashtu u darkordësua që pagesa e ekspertit të jetë në vlerën 105,900 lekë për të gjithë kohëzgjatjen e kësaj kontrate. Kontraktimi i ekspertit është miratuar nga Drejtori Ekzekutiv dhe është proceduar me lidhjen e kontratës protokolluar me nr.32/3, datë 24.08.2022.

- Me shkresën nr.32/4, prot datë 17.10.2022, znj. F. K. me detyrë Drejtore e Divizionit të Zhvillimit të Biznesit në AIC, i është drejtuar Drejtorit Ekzekutiv z. E. F. me objekt kërkesë për miratimin e kryerjes së pagesë së ekspertit në shumën 105,900 lekë, dhe se shërbimi i kryer nga eksperti është në përputhje me detyrat dhe afatet e përcaktuara në shtojcën 1 të kontratës.

- Nga ana e Ekspertit Inxhinier, z. A. D., është hartuar dhe depozituar në AIC më datë 17.10.2022, përmes emailit, një relacion me titull “Relacion për site-visit AIC, detajet teknike dhe të dhënat e pronave për AIC-në, analizë tregu për AIC-në, plan biznesi, analizë short-list për AIC si dhe raport final”.

2. Ekspert vlerësues pasurish

Eksperti për vlerësimin e pasurive shtetërore është angazhuar në bazë të një kontrate me objekt marrjen e shërbimit për vlerësimin e pasurive të paluajtshme. Kjo kontratë është lidhur nëpërmjet procedurës së prokurimit të thjeshtuar të blerjeve të vogla. Shlyerja e detyrimit është kryer me urdhër-pagesën nr. 226 prot., datë 27.12.2022, bazuar në faturën nr. 16/2022, për një vlerë totale prej 300,000 lekë me TVSH.

Konstatim:

-Nga auditimi konstatohet se për projekt-propozimin “*Ndërtimi i parqeve fotovoltaike si prodhues i energjisë alternative*”, i cili është nisur gjatë vitit 2022, nuk është marrë miratimi paraprak nga Këshilli Mbikëqyrës, duke qenë se për atë vit nuk ka një Plan Pune të miratuar.

-AIC ka vijuar me kontraktimin e ekspertëve të jashtëm, përfshirë inxhinierë dhe vlerësues pasurish, për përgatitjen e projekt-propozimi, pa marrë paraprakisht miratimin nga Këshilli Mbikëqyrës.

-Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion, konstatohet se nga ana e AIC-së nuk janë ndjekur hapat e përcaktuara për përgatitjen e projekt-propozimit. Konkretisht, është iniciuar përgatitja e projekt-propozimit, përfshirë studimin e para-fizibilitetit dhe kontraktimin e ekspertëve të jashtëm për finalizimin e projektit, pa u siguruar më parë transferimi i pronës/asetit shtetëror në administrimin e AIC-së, veprim në kundërshtim me Vendimin nr.10, datë 21.12.2021 “Për miratimin e Planit të Biznesit të vitit 2022” nga Këshilli Mbikëqyrës, ndër të tjera është pjesë e planit të biznesit edhe shtojca mbi ciklin e projekteve në lidhje me zhvillimin e aseteve të sektorit si vijon:

1. *Transferimi i aseteve në AIC;*

2. *Përgatitja e projektit, studimi i para-fizibilitetit, masterplani, vlerësimi mjedisor, lejet dhe licensat dhe kërkesat për zhvillim tregtar të zonave me potencial;*

3. *Strukturimi i projektit, konsulencat ligjore dhe financiare, ofertat, dokumentacioni dhe procesi i prokurimit;*

4. *Negocimi i kontratës me ofertuesin fitues;*

5. *Përfundimi i punimeve;*

6. *Fillimi i aktiviteteve tregtare.*

-Nga ana e strukturave drejtuese të AIC-së është proceduar me kontraktimin e një eksperti me kohë të pjesshme dhe me pagesë, pavarësisht mungesës së një Plani Pune të miratuar për vitin 2022.

-Gjatë procedurës së përzgjedhjes së ekspertit nga komisioni i AIC-së, është konstatuar se publikimi i procedurës më datë 16.08.2022 është kryer para miratimit zyrtar të kërkesës për angazhimin e ekspertit, që është bërë më datë 23.08.2022. Ky rend kronologjik ka krijuar parregullsi në procedurë dhe shkelje të praktikave të përcaktuara.

-Sa më sipër, veprimi i kontraktimit të ekspertit ka shkaktuar një efekt negativ financiar në buxhetin e AIC-së në shumën prej 405,900 lekë, duke ndikuar negativisht në menaxhimin financiar të shoqërisë.

Për Projekt-Propozimin e mësipërm, konstatohet se nuk janë respektuar afatet e parashikuara në planet e punës së AIC-së, si dhe aktualisht rezulton se nuk janë ndërmarrë hapa të mëtejshëm për zhvillimin e projektit.

2. Projekt-Propozimi - Rivitalizimi i Bazës Detare të Pashalimanit

Nga ana e AIC-së është hartuar projekt-propozimi për rivitalizimin e Kantierit të Anijeve Pashaliman, që përfshin transformimin e kantierit në një qendër për ndërtimin dhe riparimin e anijeve si dhe promovimin e Pashalimanit si një atraksion turistik, duke ruajtur vlerat historike dhe kulturore.

Projekt-propozimi është përgatitur në muajin Shkurt të vitit 2022, ku është parashikuara kthimi në një kantier aktiv me përdorim të dy-fishtë komercial dhe ushtarak i specializuar në riparimin dhe mirëmbajtjen e anijeve.

Hapat e parashikuara sipas AIC-së për 2022

Periudha 2022	Përshkrimi
14.03.2022	Miratimi nga Këshilli Mbikëqyrës
21.03.2022	Marrëveshja me Ministrinë e Mbrojtjes
30.03.2022	Përgatitja e termave të referencës për para fizibilitetin
11.04.2022	Prokurimi i ekspertit për parafizibilitetin dhe kosto përfitim
10.06.2022	Përfundimi i parafizibilitetit dhe analizës së kosto përfitim
15.06.2022	Miratimi nga Këshilli Mbikëqyrës
20.06.2022	Përgatitja e termave të referencës për fizibilitetin
30.06.2022	Prokurimi për fizibilitetin
30.09.2022	Përfundimi i fizibilitetit

Burimi: AIC, përpunuar nga GA

Kontraktimi i ekspertëve të fushës

Për realizimin e projekt-idesë nga ana e AIC-së, është proceduar me kontraktimin e ekspertit të fushës si vijon:

Ekspert Inxhinier

- Me shkresën nr. 21/1 prot., datë 01.08.2022, znj. F. K., me detyrë Drejtore e Divizionit të Zhvillimit të Biznesit në AIC, i është drejtuar Drejtorit Ekzekutiv, z. E. F., me kërkesë për miratimin e pagesës së ekspertit, z. E. Z., duke argumentuar se shërbimi i kryer nga eksperti është në përputhje me detyrat dhe afatet e përcaktuara në Shtojcën 1 të kontratës.

- Nga ana e Ekspertit Inxhinier, z. E. Z., është hartuar një relacion me datë 03.06.2022, "Termat e Referencës për studimin e fizibilitetit për rivitalizimin e Bazës së Pashalimanit".

- Sa më sipër, për kontraktimin e ekspertit inxhinier, konstatohet se nga ana e AIC-së nuk janë vënë në dispozicion dokumente mbështetëse si kërkesa për kontraktimin e ekspertit, miratimi i kësaj kërkesë dhe dokumentacioni që lidhet me procedurën e kontraktimit.

Konstatim:

-Nga auditimi konstatohet se për projekt-propozimin "*Rivitalizimi i Bazës Detare të Pashalimanit*", i cili është nisur gjatë vitit 2022, nuk është marrë miratimi paraprak nga Këshilli Mbikëqyrës, duke qenë se për atë vit nuk ka një Plan Pune të miratuar.

-AIC ka vijuar me kontraktimin e ekspertit të jashtëm inxhinier për përgatitjen e projekt-propozimi, pa marrë paraprakisht miratimin nga Këshilli Mbikëqyrës.

-Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion, konstatohet se nga ana e AIC-së nuk janë ndjekur hapat e përcaktuara për përgatitjen e projekt-propozimit. Konkretisht, është iniciuar përgatitja e projekt-propozimit, përfshirë studimin e para-fizibilitetit dhe kontraktimin e ekspertëve të jashtëm për finalizimin e projektit, pa u siguruar më parë transferimi i pronës/asetit shtetëror në administrimin e AIC-së, veprim në kundërshtim me Vendimin nr.10, datë 21.12.2021 "Për miratimin e Planit të Biznesit të vitit 2022" nga Këshilli Mbikëqyrës, ndër të tjera është pjesë e planit të biznesit edhe shtojca mbi ciklin e projekteve në lidhje me zhvillimin e aseteve të sektorit si vijon:

1.Transferimi i aseteve në AIC;

2.Përgatitja e projektit, studimi i para-fizibilitetit, masterplani, vlerësimi mjedisor, lejet dhe licensat dhe kërkesat për zhvillim tregtar të zonave me potencial;

3.Strukturimi i projektit, konsulencat ligjore dhe financiare, ofertat, dokumentacioni dhe procesi i prokurimit;

4.Negocimi i kontratës me ofertuesin fitues;

5.Përfundimi i punimeve;

6.Fillimi i aktiviteteve tregtare.

-Nga ana e strukturave drejtuese të AIC-së është proceduar me kontraktimin e një ekspertit me kohë të pjesshme dhe me pagesë, pavarësisht mungesës së një Plani Pune të miratuar për vitin 2022.

-Sa më sipër, veprimi i kontraktimit të ekspertit ka shkaktuar një efekt negativ financiar në buxhetin e AIC-së në shumën prej 337,080 lekë, duke ndikuar negativisht në menaxhimin financiar të shoqërisë.

Për Projekt-Propozimin e mësipërm, konstatohet se nuk janë respektuar afatet e parashikuar në planet e punës së AIC-së, si dhe aktualisht rezulton se nuk janë ndërmarrë hapa të mëtejshëm për zhvillimin e projektit.

3.Projekt-Propozimi - Ndërtimi i parkut verior të biznesit në Shkodër

Nga ana e AIC-së është hartuar projekt-propozimi për përdorimin e pronës së Ish Uzinës së Telave dhe kthimin e sipërfaqes në një park modern në funksion të bizneseve, ndërtesave industriale dhe ofrimit të

shërbimeve. Projekti do të rifinancojë ndërtimin e infrastrukturës bazë si dhe menaxhimi do të kryhet nga AIC dhe/ose në bashkëpunim me partnerë të tjerë privatë me eksperiencë.

Me shkresën nr.10 prot, datë 28.06.2022, Drejtori Ekzekutiv z. E. F. drejtuar Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, ka kërkuar transferim të asetit në pronësi të AIC-së, bazuar në nenin 7 të Ligjit nr. 71/2019 “Për Korporatën e Investimeve Shqiptare”, të Ish Uzinës së Telave në Shkodër me një sipërfaqe prej 85,000 m² në zonën industriale të qytetit.

Impakti i llogaritur është 15-20 biznese, krijimi i mbi 40,000 m² sipërfaqe të shfrytëzueshme për biznes, krijimi i 500-1,000 vendeve të punës brenda parkut, krijimi i një modeli të ri të zhvillimit të industrisë në vend, tërheqja e vlerës monetare për investime të reja në zonë. Aktualisht, stafi i AIC-së ka përgatitur studimin e parafizibilitetit që përfshin studimin e tregut në zonë, alternativat për zhvillimin e zonës dhe kostot përkatëse, projekt-idenë e planifikimit urban dhe arkitektonik dhe analizën financiare. AIC ka identifikuar hapat e mëtejshëm të projektit që janë kalimi i pronësisë së asetit nga MFE tek AIC, hartimi i fizibilitetit dhe projektit të detajuar teknik, marrja e lejeve të nevojshme, ndërtimi i infrastrukturës dhe operacionalizimi, rreth 2.5 deri 3 vite për ndërtimin e infrastrukturës dhe bërjen gati për operim të parkut.

Me shkresën nr.6621/3 prot, datë 05.08.2022, MFE ka kthyer përgjigje AIC-së për raport vlerësimet e Ish Uzinës së Telave dhe Kablllove në Shkodër, si dhe informacion lidhur me detyrimet të mbartura nga ky subjekt të dërguara me shkresën nr.255, datë 29.07.2022, ku Administratori i shoqërisë z. A. S. ka kthyer përgjigje MFE-së, ku ka vënë në dispozicion raport vlerësimin e ish uzinës së telave dhe kablllove në Shkodër, duke përcaktuar se shoqëria ka një sërë problematikash, por më kryesorja është mungesa në inventarin e aktiveve afatgjata materiale të vlerës 89,474,219 lekë, si dhe shoqëria është braktisur nga shoqëria koncesionare A.-C. në vitin 2018. Gjithashtu detyrimet totale për ish shoqërinë janë në shumën 219,508,625 lekë të cilat janë të certifikuara dhe të miratuara nga Asambleja e Përgjithshme e MFE-së.

Konstatim:

-Nga auditimi konstatohet se për projekt-propozimin “Ndërtimi i parkut verior të biznesit në Shkodër”, i cili është nisur gjatë vitit 2022, nuk është marrë miratimi paraprak nga Këshilli Mbikëqyrës, duke qenë se për atë vit nuk ka një Plan Pune të miratuar. Për vitin 2023 ky projekt-propozim ka qenë i përfshirë në planin e punës së miratuar.

-Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion, konstatohet se nga ana e AIC-së nuk janë ndjekur hapat e përcaktuara për përgatitjen e projekt-propozimit. Konkretisht, është iniciuar përgatitja e projekt-propozimit, përfshirë studimin e para-fizibilitetit dhe kontraktimin e ekspertëve të jashtëm për finalizimin e projektit, pa u siguruar më parë transferimi i pronës/asetit shtetëror në administrimin e AIC-së, veprim në kundërshtim me Vendimin nr.10, datë 21.12.2021 “Për miratimin e Planit të Biznesit të vitit 2022” nga Këshilli Mbikëqyrës, ndër të tjera është pjesë e planit të biznesit edhe shtojca mbi ciklin e projekteve në lidhje me zhvillimin e aseteve të sektorit si vijon:

1. *Transferimi i aseteve në AIC;*

2. *Përgatitja e projektit, studimi i para-fizibilitetit, masterplani, vlerësimi mjedisor, lejet dhe licencat dhe kërkesat për zhvillim tregtar të zonave me potencial;*

3. *Strukturimi i projektit, konsulencat ligjore dhe financiare, ofertat, dokumentacioni dhe procesi i prokurimit;*

4. *Negocimi i kontratës me ofertuesin fitues;*

5. *Përfundimi i punimeve;*

6. *Fillimi i aktiviteteve tregtare.*

Për Projekt-Propozimin e mësipërm, konstatohet se nuk janë respektuar afatet e parashikuar në planet e punës së AIC-së, si dhe aktualisht rezulton se nuk janë ndërmarrë hapa të mëtejshëm për zhvillimin e projektit.

4.Projekt-Propozimi - Teknopark Tirana TPT

Nga ana e AIC-së është hartuar projekt-propozimi për zhvillimin e një Parku të Teknologjisë dhe Shkencës në Shqipëri, për të garantuar se Shqipëria si vendet e rajonit investon në teknologji, shkencë dhe inovacion si sektorë me potencial të madh ekonomik. Sipas Projekt-Propozimit parku do të zërë një sipërfaqe prej 5 ha brenda zonës së TEDA Kashar, ose rreth 14% të hapësirës së dizenuar prej 35 ha.

Sipas Projekt-Propozimit, AIC në këtë projekt-propozim paraqitet si aktori i vetëm me qasjen e nevojshme strategjike për të garantuar se investimi në një Park të Teknologjisë dhe Shkencës do të kthehet në pjesë të zgjidhjes për disa nga problemet strukturore të ekonomisë shqiptare.

Hapat e parashikuara sipas AIC-së për 2023

Periudha 2023	Përshkrimi
Tremujori i I-rë	Konceptimi i draftit të analizës së biznesit
Tremujori i II-të	Studimi i Parafizibilitetit
Tremujori i III-të	Marrëveshja me investitorët potencial
Tremujori i IV	Sigurimi i suportit për grante shtetërore ose donacione

Burimi: AIC, përpunuar nga GA

Konstatim:

-Nga auditimi konstatohet se për projekt-propozimin “*Teknopark Tirana TPT*”, i cili është nisur gjatë vitit 2022, nuk është marrë miratimi paraprak nga Këshilli Mbikëqyrës, duke qenë se për atë vit nuk ka një Plan Pune i miratuar. Për vitin 2023 ky projekt-propozim ka qenë i përfshirë në planin e punës së miratuar.

-Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion, konstatohet se nga ana e AIC-së nuk janë ndjekur hapat e përcaktuara për përgatitjen e projekt-propozimit. Konkretisht, është iniciuar përgatitja e projekt-propozimit, përfshirë studimin e para-fizibilitetit dhe kontraktimin e ekspertëve të jashtëm për finalizimin e projektit, pa u siguruar më parë transferimi i pronës/asetit shtetëror në administrimin e AIC-së, veprim në kundërshtim me Vendimin nr.10, datë 21.12.2021 “Për miratimin e Planit të Biznesit të vitit 2022” nga Këshilli Mbikëqyrës, ndër të tjera është pjesë e planit të biznesit edhe shtojca mbi ciklin e projekteve në lidhje me zhvillimin e aseteve të sektorit si vijon:

1. *Transferimi i aseteve në AIC;*
2. *Përgatitja e projektit, studimi i para-fizibilitetit, masterplani, vlerësimi mjedisor, lejet dhe licencat dhe kërkesat për zhvillim tregtar të zonave me potencial;*
3. *Strukturimi i projektit, konsulencat ligjore dhe financiare, ofertat, dokumentacioni dhe procesi i prokurimit;*
4. *Negocimi i kontratës me ofertuesin fitues;*
5. *Përfundimi i punimeve;*
6. *Fillimi i aktiviteteve tregtare.*

Për Projekt-Propozimin e mësipërm, konstatohet se nuk janë respektuar afatet e parashikuar në planet e punës së AIC-së, si dhe aktualisht rezulton se nuk janë ndërmarrë hapa të mëtejshëm për zhvillimin e projektit.

5.Projekt-Propozimi - Korça Aerodrome

Nga ana e AIC-së është hartuar projekt-propozimi për ndërtimin e një Aerodrome në zonën e Korçës, pranë aeroportit ushtarak në Lumalas, me një sipërfaqe prej 16 ha. Qëllimi kryesor është investimi në ndërtimin e infrastrukturës moderne dhe pajisjeve për qendrën e testimit të dronëve. Projekti parashikon gjithashtu ngritjen e një qendre testimi për dronët, kooperimi me të gjitha palët e interesit, përfshirja e

akademisë si dhe institucioneve të kërkimit shkencor, përshtatja dhe lehtësimi për pilotët sportivë të cilët mund të përdorin aerodromin për qëllimet e tyre.

Në lidhje me fazat që do të ndiqen sipas këtij projekt-propozimi AIC ka parashikuar fazën e parë e cila do të jetë përcaktimi i qendrës së testimit dhe faza 2 e cila do të jetë zgjerimi i qendrës së testimit si dhe ngritja e infrastrukturës.

Konstatim:

-Nga auditimi konstatohet se për projekt-propozimin “*Korça Aerodrome*”, i cili është nisur gjatë vitit 2022, nuk është marrë miratimi paraprak nga Këshilli Mbikëqyrës, duke qenë se për atë vit nuk ka një Plan Pune i miratuar. Për vitin 2023 ky projekt-propozim ka qenë i përfshirë në planin e punës së miratuar.

-Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion, konstatohet se nga ana e AIC-së nuk janë ndjekur hapat e përcaktuara për përgatitjen e projekt-propozimit. Konkretisht, është iniciuar përgatitja e projekt-propozimit, përfshirë studimin e para-fizibilitetit dhe kontraktimin e ekspertëve të jashtëm për finalizimin e projektit, pa u siguruar më parë transferimi i pronës/asetit shtetëror në administrimin e AIC-së, veprim në kundërshtim me Vendimin nr.10, datë 21.12.2021 “Për miratimin e Planit të Biznesit të vitit 2022” nga Këshilli Mbikëqyrës, ndër të tjera është pjesë e planit të biznesit edhe shtojca mbi ciklin e projekteve në lidhje me zhvillimin e aseteve të sektorit si vijon:

1. *Transferimi i aseteve në AIC;*

2. *Përgatitja e projektit, studimi i para-fizibilitetit, masterplani, vlerësimi mjedisor, lejet dhe licencat dhe kërkesat për zhvillim tregtar të zonave me potencial;*

3. *Strukturimi i projektit, konsulencat ligjore dhe financiare, ofertat, dokumentacioni dhe procesi i prokurimit;*

4. *Negocimi i kontratës me ofertuesin fitues;*

5. *Përfundimi i punimeve;*

6. *Fillimi i aktiviteteve tregtare.*

Për Projekt-Propozimin e mësipërm, konstatohet se nuk janë respektuar afatet e parashikuar në planet e punës së AIC-së, si dhe aktualisht rezulton se nuk janë ndërmarrë hapa të mëtejshëm për zhvillimin e projektit.

6.Projekt-Propozimi - Zhvillimi i një modeli turizmi me natyrën në Syrin e Kaltër

Nga ana e AIC-së është hartuar projekt-propozimi për investimin dhe zhvillimin në monumentin e natyrës Syri i Kaltër duke përcaktuar ndërtimin dhe ofrimin e shërbimit vetëm në modele të cilat nxisin efikasitetin energjitike, menaxhimin e mbetjeve, krijimi i një pakete akomodimi, shërbimi dhe argëtimi, zhvillimi i mëtejshëm në zonat e Sarandës dhe Gjirokastrës, si dhe promovimi i një produkti turistik të integruar duke përmirësuar imazhin e vendit.

Hapat e mëtejshëm në zhvillimin e këtij Projekt-Propozim të përgatitur nga AIC, janë miratimi nga Bordi i inicimit të projektit, konkludimi i një marrëveshje zhvillimi midis AIC dhe Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, miratimi i Bordit për avancimin e projektit, përgatitja dhe detajimi i projektit teknik, projektit të fizibilitetit, vlerësimi i ndikimit mjedisor dhe social, termave të referencës si dhe hapja e thirrjes për shprehje interesi për investitorët strategjikë në menaxhimin e asetit dhe zhvillimin e zonës.

Hapat e parashikuara sipas AIC-së për 2022

Periudha 2022	Përshkrimi
14.03.2022	Miratimi nga Këshilli Mbikëqyrës
21.03.2022	Marrëveshja me Ministrinë e Turizmit
30.03.2022	Përgatitja e termave të referencës për para fizibilitetin
11.04.2022	Prokurimi i ekspertit për para fizibilitetin dhe kosto përfitim
10.06.2022	Përfundimi i para fizibilitetit dhe analizës së kosto përfitim
15.06.2022	Miratimi nga Këshilli Mbikëqyrës
20.06.2022	Përgatitja e termave të referencës për fizibilitetin

30.06.2022	Prokurimi për fizibilitetin
30.09.2022	Përfundimi i fizibilitetit

Burimi: AIC, përpunuar nga GA

Konstatim:

-Nga auditimi konstatohet se për projekt-propozimin “Zhvillimi i një modeli turizmi me natyrën në Syrin e Kaltër”, i cili është nisur gjatë vitit 2022, nuk është marrë miratimi paraprak nga Këshilli Mbikëqyrës, duke qenë se për atë vit nuk ka një Plan Pune të miratuar. Për vitin 2023 ky projekt-propozim ka qenë i përfshirë në planin e punës së miratuar.

-Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion, konstatohet se nga ana e AIC-së nuk janë ndjekur hapat e përcaktuara për përgatitjen e projekt-propozimit. Konkretisht, është iniciuar përgatitja e projekt-propozimit, përfshirë studimin e para-fizibilitetit dhe kontraktimin e ekspertëve të jashtëm për finalizimin e projektit, pa u siguruar më parë transferimi i pronës/asetit shtetëror në administrimin e AIC-së, veprim në kundërshtim me Vendimin nr.10, datë 21.12.2021 “Për miratimin e Planit të Biznesit të vitit 2022” nga Këshilli Mbikëqyrës, ndër të tjera është pjesë e planit të biznesit edhe shtojca mbi ciklin e projekteve në lidhje me zhvillimin e asetëve të sektorit si vijon:

1. *Transferimi i asetëve në AIC;*

2. *Përgatitja e projektit, studimi i para-fizibilitetit, masterplani, vlerësimi mjedisor, lejet dhe licencat dhe kërkesat për zhvillim tregtar të zonave me potencial;*

3. *Strukturimi i projektit, konsulentat ligjore dhe financiare, ofertat, dokumentacioni dhe procesi i prokurimit;*

4. *Negocimi i kontratës me ofertuesin fitues;*

5. *Përfundimi i punimeve;*

6. *Fillimi i aktiviteteve tregtare.*

Për Projekt-Propozimin e mësipërm, konstatohet se nuk janë respektuar afatet e parashikuara në planet e punës së AIC-së, si dhe deri në fund të periudhës së auditimit, rezulton se nuk janë ndërmarrë hapa të mëtejshëm për zhvillimin e projektit.

7. Projekt-Propozimi – Divjaka, një destinacion zhvillimi me modele të qëndrueshme të biznesit

Nga ana e AIC-së është hartuar projekt-propozimi në muajin Mars të vitit 2022, për ndërtimin e një resorti turistik me model të qëndrueshëm turizmi 12-mujor në zonën e Divjakës, duke ndërtuar vendqëndrim / hotel me standard 4 ose 5 yje. Nëpërmjet këtij zhvillimi synohet të krijohet një ndërthurje midis agroturizmit dhe argrokulturës dhe ofrimit të shërbimeve që nxisin kohëzgjatjen e qëndrimit të turistit në këtë destinacion.

Hapat e mëtejshëm në këtë Projekt-Propozim, janë përcaktuar të jenë miratimi nga Bordi i AIC së inicimit të projektit, hartimi dhe nënshkrimi i marrëveshjes për kalimin e pronës në pronësi ose menaxhim të AIC-së nga institucionet përkatëse, përgatitja e studimit të parafizibilitetit dhe analizës së kostove, miratimi nga Bordi i AIC-së avancimi i projektit, përgatitja e detajimit të projektit / projektit teknik, vlerësimit të ndikimit mjedisor dhe social, hapja e thirrjes për shprehje interesi për investitorë privatë, zhvillimi i mëtejshëm i masterplanit të zhvillimit për gjithë zonën.

Hapat e parashikuara sipas AIC-së për 2022

Periudha 2022	Përshkrimi
14.03.2022	Miratimi nga Këshilli Mbikëqyrës
21.03.2022	Marrëveshja me Ministrinë e Turizmit
30.03.2022	Përgatitja e termave të referencës për para fizibilitetin
11.04.2022	Prokurimi i ekspertit për parafizibilitetin dhe kosto përfitim
10.06.2022	Përfundimi i parafizibilitetit dhe analizës së kosto përfitim
15.06.2022	Miratimi nga Këshilli Mbikëqyrës
20.06.2022	Përgatitja e termave të referencës për fizibilitetin
30.06.2022	Prokurimi për fizibilitetin

Për realizimin e projekt-idesë nga ana e AIC-së, është proceduar me kontraktimin i ekspertit të jashtëm si vijon:

Ekspert Arkitekt

-Është lidhur kontrata midis AIC-së dhe Ekspertit të Jashtëm z. S. G. B., me nr.13 prot, datë 01.05.2022, me objekt aktivizimin si ekspert të jashtë “Arkitekt” pranë AIC-së, me pagesë në shumën bruto 200,000 lekë në muaj, me afat të kontratës nga data 01.05.2022 deri 31.12.2022, me detyrat ndërmarrjen e kërkimeve dhe përpilimi i raporteve të fizibilitetit dhe impaktit mjedisor, përcaktimin dhe ndjekjen e buxhetit dhe afateve të projektit, menaxhimi i grupit të projektit dhe bashkëpunimi me bashkëpunëtorë të tjerë në fushën e ndërtimit, etj.

-Me shkresën nr.13/1 prot, datë 20.10.2022, nga Drejtori Ekzekutiv është miratuar dërgimi i informacionit për miratimin e pagesës për ekspertin e jashtëm nga znj.H. X. (Këshilltare Ekonomike), e cila ka konfirmuar se puna e kryer nga eksperti është në përputhje me kushtet dhe kërkesat e parashikuara në kontratë.

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion, konstatohet se në dosjen e projektit paraqitet një projekt-propozim i përgatitur në formatin power-point i cili është hartuar në muajin Tetor 2022, me rendera dhe fotografi, analizë të përgjithshme të zonës dhe kosto potenciale.

Sa më sipër konstatohet se në dosjen se nuk paraqiten dokumenti i kërkimeve dhe përpilimi i raportit të fizibilitetit dhe impaktit mjedisor, përcaktimi dhe ndjekja e buxhetit dhe afateve të projektit, veprime në kundërshtim me Kontratën nr.13 prot, datë 01.05.2022, Aneksi 1 “Përgjegjësitë e Punës”.

Konstatim:

-Nga auditimi konstatohet se për projekt-propozimin “*Divjaka, një destinacion zhvillimi me modele të qëndrueshme të biznesit*”, i cili është nisur gjatë vitit 2022, nuk është marrë miratimi paraprak nga Këshilli Mbikëqyrës, duke qenë se për atë vit nuk ka një Plan Pune i miratuar.

-AIC ka vijuar me kontraktimin e ekspertit të jashtëm Arkitekt për përgatitjen e projekt-propozimi, pa marrë paraprakisht miratimin nga Këshilli Mbikëqyrës.

-Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion, konstatohet se nga ana e AIC-së nuk janë ndjekur hapat e përcaktuara për përgatitjen e projekt-propozimit. Konkretisht, është iniciuar përgatitja e projekt-propozimit, përfshirë studimin e para-fizibilitetit dhe kontraktimin e ekspertëve të jashtëm për finalizimin e projektit, pa u siguruar më parë transferimi i pronës/asetit shtetëror në administrimin e AIC-së, veprim në kundërshtim me Vendimin nr.10, datë 21.12.2021 “Për miratimin e Planit të Biznesit të vitit 2022” nga Këshilli Mbikëqyrës, ndër të tjera është pjesë e planit të biznesit edhe shtojca mbi ciklin e projekteve në lidhje me zhvillimin e aseteve të sektorit si vijon:

1. *Transferimi i aseteve në AIC;*

2. *Përgatitja e projektit, studimi i para-fizibilitetit, masterplani, vlerësimi mjedisor, lejet dhe licencat dhe kërkesat për zhvillim tregtar të zonave me potencial;*

3. *Strukturimi i projektit, konsulencat ligjore dhe financiare, ofertat, dokumentacioni dhe procesi i prokurimit;*

4. *Negocimi i kontratës me ofertuesin fitues;*

5. *Përfundimi i punimeve;*

6. *Fillimi i aktiviteteve tregtare.*

-Nga ana e strukturave drejtuese të AIC-së është proceduar me kontraktimin e një eksperti me kohë të pjesshme dhe me pagesë, pavarësisht mungesës së një Plani Pune të miratuar për vitin 2022.

-Sa më sipër, veprimi i kontraktimit të ekspertit ka shkaktuar një efekt negativ financiar në buxhetin e AIC-së në shumën prej 1,600,000 lekë, duke ndikuar negativisht në menaxhimin financiar të shoqërisë. Për Projekt-Propozimin e mësipërm, konstatohet se nuk janë respektuar afatet e parashikuar në planet e punës së AIC-së, si dhe aktualisht rezulton se nuk janë ndërmarrë hapa të mëtejshëm për zhvillimin e projektit.

8.Projekt-Propozimi – Porto Palermo Marina Resort

Nga ana e AIC-së është hartuar projekt-propozimi në muajin Mars të vitit 2022, për zhvillimin e zonës së Porto Palermos me investime strategjike që përfshijnë ndërtimin e portit si dhe resorteve me 5 vje, ndërtimin e kapacitetit për vende ankorimi për yachte dhe varka, ndërtimin e një resorti model elite, shërbimet e mirëmbajtjes, rivitalizimi i tuneleve të nëndetëseve duke i kthyer në muze. Në fazën e parë nga AIC është parashikuar përgatitja e fizibilitetit për asetin si dhe përgatitja e shprehjes së interesit nga investitorët privatë.

Hapat e mëtejshëm në këtë Projekt-Propozim, janë përcaktuar të jenë miratimi nga Bordi i AIC së inicimit të projektit, miratimi nga Kryeministri, marrëveshja e zhvillimit midis AIC Ministrisë së Mbrojtjes dhe Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë për përgatitjen e para fizibilitetit për zhvillimin e zonës dhe asetit, miratimi i Bordit për fazat e mëtejshme, përgatitja e projektit teknik, fizibilitetit si dhe vlerësimit të ndikimit mjedisor dhe social, hapja e thirrjes së interesit për investitorët.

Hapat e parashikuara sipas AIC-së për 2022

Periudha 2022	Përshkrimi
17.03.2022	Miratimi nga Këshilli Mbikëqyrës
30.03.2022	Marrëveshja me Ministrinë e Mbrojtjes dhe MFE
11.04.2022	Përgatitja e termave të referencës për para fizibilitetin
13.04.2022	Prokurimi i ekspertit për parafizibilitetin dhe kosto përfitim
13.07.2022	Përfundimi i parafizibilitetit dhe analizës së kosto përfitim
16.07.2022	Miratimi nga Këshilli Mbikëqyrës
10.08.2022	Përgatitja e termave të referencës për fizibilitetin
30.08.2022	Prokurimi për fizibilitetin
30.01.2023	Përfundimi i fizibilitetit

Burimi: AIC, përpunuar nga GA

Konstatim:

-Nga auditimi konstatohet se për projekt-propozimin “Porto Palermo Marina Resort”, i cili është nisur gjatë vitit 2022, nuk është marrë miratimi paraprak nga Këshilli Mbikëqyrës, duke qenë se për atë vit nuk ka një Plan Pune i miratuar.

-Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion, konstatohet se nga ana e AIC-së nuk janë ndjekur hapat e përcaktuara për përgatitjen e projekt-propozimit. Konkretisht, është iniciuar përgatitja e projekt-propozimit, përfshirë studimin e para-fizibilitetit dhe kontraktimin e ekspertëve të jashtëm për finalizimin e projektit, pa u siguruar më parë transferimi i pronës/asetit shtetëror në administrimin e AIC-së, veprim në kundërshtim me Vendimin nr.10, datë 21.12.2021 “Për miratimin e Planit të Biznesit të vitit 2022” nga Këshilli Mbikëqyrës, ndër të tjera është pjesë e planit të biznesit edhe shtojca mbi ciklin e projekteve në lidhje me zhvillimin e aseteve të sektorit si vijon:

1.Transferimi i aseteve në AIC;

2.Përgatitja e projektit, studimi i para-fizibilitetit, masterplani, vlerësimi mjedisor, lejet dhe licensat dhe kërkesat për zhvillim tregtar të zonave me potencial;

3.Strukturimi i projektit, konsulencat ligjore dhe financiare, ofertat, dokumentacioni dhe procesi i prokurimit;

4.Negocimi i kontratës me ofertuesin fitues;

5.Përfundimi i punimeve;

6.Fillimi i aktiviteteve tregtare.

Për Projekt-Propozimin e mësipërm, konstatohet se nuk janë respektuar afatet e parashikuar në planet e punës së AIC-së, si dhe aktualisht rezulton se nuk janë ndërmarrë hapa të mëtejshëm për zhvillimin e projektit.

Konkluzion:

-Në lidhje me përgatitjen e Projekt-Propozimeve për investime nga ana e AIC-së, konstatohet se nuk ka një rregullore ose manual për proceset e punës mbi përcaktimin e procedurave të përgatitjes së projekteve të fazave si dhe ciklit të tyre, veprime në kundërshtim me Ligjin nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, neni 4, pika 19 ku citohet... “Gjurma e auditimit përfaqëson rrjedhën e dokumentuar të transaksioneve financiare dhe të transaksioneve të tjera, nga fillimi deri në përfundim të tyre, që synon të ripërshkojë të gjitha veprimtaritë individuale dhe vendimmarrjen lidhur me to. Ajo përfshin mbajtjen e dokumentacionit, raportimin, kontabilitetin dhe sistemin e mbajtjes së dosjeve” dhe neni 16 “Detyrimi për përgatitjen dhe dokumentimin e gjurmës së auditimit”, dhe VKM-në nr.887, datë 27.12.2022 “Për procedurat e menaxhimit të investimeve publike”, aneksi nr.1 “Procedurat e menaxhimit të investimeve publike”, ku përcaktohen procedurat të cilat aplikohen në procesin e planifikimit të investimeve publike për projektet e investimeve si dhe ciklet e një projekti duke filluar nga identifikimi, vlerësimi dhe përgatitja e projektit, aprovimi dhe financimi, zbatimi, monitorimi i zbatimit si dhe raportimi vlerësimi dhe auditimi.

-Nga grupi i auditimit u konstatua se për të gjithë procedurat e projekt-propozimeve të audituara nuk është kryer inventarizimi i dosjeve, veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 9154, datë 06.11.2003 “Për arkivat”, si dhe nenit 21 “Norma tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë” dhe me pikën 3 të nenit 16 të Ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, dhe manualit të MFK miratuar me Urdhrin nr. 108, datë 17.11.2016, ku mungesa e gjurmëve të auditimit nuk i jep mundësinë audituesit të përcaktojë radhën e ngjarjeve, që ndodhin brenda çdo procesi.

Planet e Punës për 6 mujorin e I-rë, 2024 (tetor 2023 – qershor 2024)

Me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr.17 prot, datë 04.10.2023, është zgjedhur Drejtori i ri Ekzekutiv i AIC-së, znj.E. K.

Me shkresën nr.17 prot, datë 20.11.2023, të Këshillit Mbikëqyrës janë mbajtur minutat e takimit me pjesëmarrës anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës, Drejtori Ekzekutiv znj.E. K. dhe disa punonjës të AIC-së, ku janë prezantuar fokuset e investimeve strategjike si vijon:

Drejtori i ri në takimin e Këshillit Mbikëqyrës të datë 20.11.2023 prezantoi prioritetet të fokusuar në investime strategjike.

- 1.Zhvillimi dhe menaxhimi i pronave dhe projekteve në mbështetje të politikave shtetërore të zhvillimit.
- 2.Këshillimi i Institucioneve publike dhe/ose private në hartimin, analizimin dhe rekomandimin e projekteve.
- 3.Financimi ose bashkëfinancimi i projekteve ose subjekteve për qëllime të veçanta (SPV) të ngritura për realizimin e tyre.
- 4.Me autorizim të Këshillit të Ministrave, AIC merr rolin e zhvilluesit sipas legjislacionit për Zonat Teknologjike dhe Zhvillimit Ekonomik (TEDA).
- 5.Këshilli i Ministrave mund të autorizojë Korporatën të kryejë funksione të tjera, sipas legjislacionit në fuqi.

Në lidhje me vijueshmërinë e Projekt-Propozimeve të hartuara nga AIC dhe të miratuara me Planet e Punës nga Këshilli Mbikëqyrës për vitet e mëparshme, u diskutua nga ana e pjesëmarrësve konkretisht:

Fokusi kryesor i diskutimeve gjatë mbledhjes nuk ishte ndryshimi i drejtuesit të AIC, por përqendrimi në strategjinë dhe prioritetet e reja nën drejtimin e Drejtorit Ekzekutiv, znj. E. K. Ndryshimi i qasjes strategjike lidhet me disa aspekte kryesore:

Ristrukturimi i fokusit të AIC

Znj. K., pas një muaji në detyrë, evidentoi rëndësinë e përshtatjes së strategjisë së AIC me prioritetet e qeverisë. Fokus i ri i AIC është në menaxhimin e aseteve ekzistuese dhe realizimin e projekteve me impakt të shpejtë dhe të qëndrueshëm.

Projektet kryesore dhe prioritetet

Pasuritë e paluajtshme: Ky projekt është përparësor dhe ka nisur një proces i detajuar për identifikimin dhe zhvillimin e pronave shtetërore në përputhje me interesat publike.

Zhvillimi i sektorit të panairëve kombëtare: Një marrëveshje ndërmjet Italisë dhe Shqipërisë është theksuar, duke përfshirë një kredi prej 15 milionë euro.

TEDA dhe teknoparqet: Përballen me sfida për gjetjen e zhvilluesve, por synohet zhvillimi i zonave si qendra tërheqëse për teknologjinë dhe nomadët digjitalë.

Shërbimet e Konsulencës: Rol i rëndësishëm në reforma shtetërore dhe bashkëpunime me partnerë ndërkombëtarë, me qasje të diferencuar nga strukturat tradicionale publike.

-Në lidhje me rivlerësimin e projekt-propozimeve të mëparshme si ato në sektorin e energjisë janë kaluar nën autoritetin e Korporatës Energjitike Shqiptare (KESH), ndërsa të tjera, për shkak të kompleksitetit ligjor dhe prioriteteve të reja, janë riformatuar ose lënë në pritje.

Konkluzion:

Nga auditimi u konstatua se mungesa e një Plani Strategjik Afatmesëm mbi veprimtarinë e AIC-së ka çenuar vijueshmërinë Institucionale të AIC-së.

Gjithashtu konstatohet një ndërprerje në realizimin e projekt-propozimeve të mëparshme, edhe pse përbërja e Këshillit Mbikëqyrës ka qenë pothuajse e njëjtë, duke përfshirë ato në sektorin e energjisë dhe zhvillimit të zonave prioritare, edhe pse janë kryer shpenzime mbi kontraktimin e ekspertëve të jashtëm për realizimin e para-fizibilitetit, përfshirë edhe miratimin me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr.12, datë 04.10.2022 “Mbi autorizimin e Drejtorit Ekzekutiv për të filluar vlerësimet e fizibilitetit për projektet e investimeve dhe miratimin e përdorimit të fondeve të AIC-së për këtë qëllim me propozimin e tij”, për rrjedhojë kjo situatë ndikon negativisht në vijueshmërinë e Institucionit.

Me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr.26, datë 20.12.2023, është miratuar Plani i Punës për Vitin 2024, përfshirë projektet që Korporata autorizohet të fillojë punën për të zhvilluar projekt-identetë dhe hapat e tjera të nevojshme.

Në vijim të Planit të Punës, AIC ka ndërmarrë hapat e mëposhtme:

1. Projekte të Zhvillimit dhe Menaxhimit të Pronave Shtetërore

Qëllimi i këtij projekti është përmirësimi i cilësisë së ndërtesave dhe hapësirave për shërbime publike, duke siguruar ambiente moderne dhe të përshtatshme për zyrat e Institucioneve.

-*Kompleksi Governativ:* Projekti përfshin ndërtimin e një Kompleksi Governativ i cili do të integrojë Institucionet shtetërore të ndërlidhura.

-*Ndërtesa e Kadastrës Shtetërore:* Projekti përfshin ndërtimin e një ndërtese të re për Kadastrën Shtetërore, e cila do të shërbejë si një qendër e përqendruar për Institucionet shtetërore të lidhura me administrimin dhe menaxhimin e pronës.

-*Korpusi i Policisë:* Projekti përfshin krijimin e një Korpusi të Policisë, i cili do të bashkojë në një kompleks të vetëm Institucionet e lidhura me sigurinë dhe policinë.

2. *EXPO Albania* - Qëllimi i këtij projekti është të përfshijë një qendër ekspozitash dhe eventesh, dizenuar për të promovuar Shqipërinë si një qendër rajonale për evente ndërkombëtare, mbi një pronë prej 61,817 m² me hotele, salla kongresi dhe hapësira ekspozimi të jashtme.

3. *Durana Tech Park* - Krijimi i një parku shkencor dhe teknologjik me sipërfaqe prej 14 ha duke ofruar hapësira për zyra, konferenca dhe qendra kërkimore.

4. *Konsulenca dhe bashkëpunimet ndërkombëtare* - AIC ka ofruar konsulencë për zhvillimin e akademisë së futbollit Durrës / Manchester City në Durrës.

5. *Marrëveshjet me partnerët vendas* - AIC përveç marrëveshjeve për projekte specifike me partnerë publikë, ka lidhur edhe disa marrëveshje me disa Institucione shtetërore si ATP, ASHK, AZHT, AKPT dhe ASIG.

6. *Draftim dhe miratim i akteve rregulluese për funksionimin e Korporatës.*

Kuadri rregullator gjatë 6 muajve të I-rë, viti 2024

Në 6 muajve të I-rë të vitit 2024, janë miratuar aktet ligjore si vijon:

- VKM nr.137, datë 06.03.2024 “Për përcaktimin e kriterëve dhe të procedurës për dhënien e pronës shtetërore me qira, enfiteozë, leasing, shitje, përdorim si kolateral dhe të përdorimit në formë të tjera nga ana e Korporatës së Investimeve Shqiptare”;

- VKM nr.328, datë 29.05.2024 “Për transferimin të Korporatave të Investimeve Shqiptare të pronave shtetërore, në përgjegjësi administrimi të disa institucioneve shtetërore, për realizimin e projektit të investimit për zhvillimin dhe menaxhimin e pronave shtetërore”, ku bazuar në VKM nr.137, datë 06.03.2024 të sipërcituar, me propozim të Ministrit të Ekonomisë Kulturës dhe Inovacionit, Këshilli i Ministrave **ka vendosur transferimin në pronësi të AIC-së të 17 pronave/aseteve si dhe me funksion vetëm publik për të cilat Korporata vepron si zhvillues të 11 pronave/aseteve, (pronat e kaluara sipas VKM-së nr.328, datë 29.05.2024, paraqiten në Aneksin nr.1, Tabelat 2.1.2 dhe 2.1.3)**

Në funksion të Ligjit nr.71/2019 “Për Korporatën e Investimeve Shqiptare” neni 7, pika 2, ku citohet se: “Kriteret dhe procedurat për dhënien e pronës, e cila ka kaluar te Korporata, sipas pikës 1, të këtij neni, me qira, enfiteozë, leasing, përdorimit, transferimit, shitjes, përdorimit si kolateral, ose të përdorimit në formë të tjera, përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave”, është hartuar dhe miratuar VKM nr. 137, datë 06.03.2024 “Për përcaktimin e kriterëve dhe të procedurës për dhënien e pronës shtetërore me qira, enfiteozë, leasing, shitje, përdorim si kolateral dhe të përdorimit në formë të tjera nga ana e Korporatës së Investimeve Shqiptare”.

Ligji dhe VKM-ja funksionojnë të lidhura me njëra tjetrën, ku Ligji 71/2019 përcakton misionin dhe objektivat themelore të AIC-së, ndërsa VKM-ja nr.137 krijon rregullat operative për të realizuar këto objektiva për pronat shtetërore.

Ligji përcakton fushën e përgjegjësisë së AIC-së, ndërsa VKM-ja detajon zbatimin praktik në lidhje me pronat shtetërore, me qëllim që projektet të jenë transparente, konkurruese dhe në përputhje me politikat zhvillimore.

Në lidhje me procedurat e transferimit, të pronave/aseteve, si dhe të drejtën për të shitur pronat në administrim nga Korporatë së bashku me kriteret ligjore mbi të cilat vepron AIC, paraqitet si vijon:

-Sipas nenit 5 të Ligjit nr.71/2019 “Për Korporatën e Investimeve Shqiptare”, përcaktohen: Funksionet kryesore të Korporatës janë: 1. Zhvillimi dhe menaxhimi i pronave dhe projekteve në mbështetje të politikave shtetërore të zhvillimit. 2. Këshillimi i institucioneve publike dhe/ose private në hartimin, analizimin, dhe rekomandimin e projekteve. 3. Financimi ose bashkëfinancimi i projekteve ose subjekteve për qëllime të veçanta (SPV) të ngritura për realizimin e tyre. 4. Me autorizim të Këshillit të Ministrave, merr rolin e zhvilluesit, sipas legjislacionit për Zonat Teknologjike dhe Zhvillimit Ekonomik. 5. Këshilli i Ministrave mund të autorizojë Korporatën të kryejë funksione të tjera, sipas legjislacionit në fuqi.

-Gjithashtu në nenin 7 të Ligjit nr.71/2019 “Për Korporatën e Investimeve Shqiptare”, përcaktohen: Transferimi i pronave shtetërore, 1. Prona shtetërore, në kuptim të këtij ligji, janë pronat e luajtshme, të paluajtshme shtetërore, të drejtat reale mbi to, të drejtat e shfrytëzimit, si dhe titujt e pronësisë së shtetit mbi kapitalin e shoqërive tregtare dhe/ose ndërmarrjeve shtetërore. Kur Korporata identifikon prona shtetërore me interes për të realizuar projekte investimi, i propozon Këshillit të Ministrave, nëpërmjet ministrit përgjegjës për ekonominë, transferimin e tyre te Korporata. Me transferim kuptohet kalimi i së drejtës së përdorimit dhe/ose i së drejtës së pronësisë të pronave shtetërore nga pushteti qendror ose vendor te Korporata. **2. Kriteret dhe procedurat për dhënien e pronës, e cila ka kaluar te Korporata, sipas pikës 1, të këtij neni, me qira, enfiteozë, leasing, përdorimit, transferimit, shitjes, përdorimit si kolateral, ose të përdorimit në forma të tjera, përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.**

Në zbatim të nenit 7, pika 2 e Ligjit nr.71/2019 “Për Korporatën e Investimeve Shqiptare”, Këshilli i Ministrave ka miratuar VKM nr.137, datë 06.03.2024 “Për përcaktimin e kritereve dhe të procedurës për dhënien e pronës shtetërore me qira, enfiteozë, leasing, shitje, përdorim si kolateral dhe të përdorimit në forma të tjera nga ana e Korporatës së Investimeve Shqiptare”, ku:

Kreu I “**Dispozita të Përgjithshme**”, janë përcaktuar kriteret si vijon:

f) “Kriteri bazë”, vlera/kufiri/kushti minimal i përmbushjes së kushtit të përzgjedhjes në procedurat e organizuara nga Korporata, sipas parashikimeve të këtij vendimi.

g) “Kriteri përzgjedhës”, kriteri i parashikuar në vlerën/kufirin/kushtin mbi kriterin bazë, i cili përcaktohet në thirrjen e procedurës së konkurrimit dhe orienton përzgjedhjen e kandidatit fitues në formën ofrimit të: i. çmimit më të lartë të qirasë/enfiteozës për dhënien e pronës me qira/enfiteozë; ii. përqindjes më të lartë të ofruar në favor të Korporatës, në kuadër të angazhimit në sipërmarrje; iii. çmimit më të lartë të shitjes dhe në afatin e mënyrën e pagesës së çmimit në shitjen e pronës; iv. përqindjes më të ulët të interesit të ofruar, si dhe në kohëzgjatjen e shlyerjes së detyrimit në rastin e garancisë, kredisë apo të sigurimit të detyrimeve; v. kriteret të tjera cilësore të përcaktuara në thirrje.

gj) “Pasaportë e eficiencës së pronës”, dokumenti identifikues i pronës shtetërore në pronësi apo në përdorim të Korporatës, i cili përmban tërësinë e elementeve për vlerësimin e mënyrës së përdorimit të pronës nëpërmjet dhënies me qira, enfiteozë, leasing, sipërmarrje, përdorimin e pronës për sigurimin e një kredie apo detyrimi tjetër, zhvillimi, shitjes, apo përmes formash të tjera përdorimi të pronës; interesin e autoritetit publik, faktorët e suksesit dhe output-et që duhet të arrihen në zbatimin dhe realizimin e projekteve të investimit.

h) “Procedura konkurruese me përzgjedhje dinamike apo me zarf”, procedura konkurruese publike që zhvillohet me dy faza, faza e kualifikimit dhe faza e përzgjedhjes, sipas një metode përzgjedhjeje dinamike apo me zarf, ndërmjet subjekteve të kualifikuara në fazën e parë, ku kandidati fitues përcaktohet në bazë të kriterit përzgjedhës të caktuar në thirrjen e procedurës konkurruese.

i) “Procedura konkurruese me përzgjedhje me pikëzim”, procedura konkurruese publike që synon të përzgjedhë propozimin më të mirë mbi bazën e një sistemi pikëzimi. Procedura zhvillohet në një fazë ose më shumë faza sipas përcaktimit në thirrjen përkatëse dhe kandidatët paraqesin të gjithë dokumentacionin e kërkuar në dokumentin e konkurrimit për kualifikimin dhe vlerësimin e tyre, në bazë të një metodologjie pikëzimi, të miratuar nga Korporata.

j) “Procedura konkurruese me negociim dinamik”, procedura konkurruese publike e përzgjedhjes së partnerit privat, e cila organizohet me dy faza, faza e parë e kualifikimit dhe faza e dytë e negociimit, e cila zhvillohet në bazë të vlerësimit dhe negociimit të propozimeve dhe termave të partneritetit.

k) “Procedura e negociimit të drejtpërdrejtë”, procedura e përzgjedhjes drejtpërdrejtë të partnerit publik, si dhe e përzgjedhjes së partnerit privat, bazuar në raportin e posaçëm të tij me projektin e investimit apo me cilësitë e lidhura me pronën ose kur propozimi i subjektit privat ka të bëjë me ofrimin e një projekti

investimi që përbën një inovacion/ është risi në tregun vendas apo rrit në mënyrë të dukshme dhe të drejtpërdrejtë vlerën e pronës, duke siguruar rritjen e eficiencës së përdorimit të pronës.

II. Kushtet për Kalimin e Pronës - Këshilli i Ministrave ka rolin kryesor në miratimin e transferimeve të pronës shtetërore të AIC, por këto transferime ndodhin vetëm kur janë të nevojshme për të përmbushur objektivat publike dhe zhvillimore. Procesi përfshin një kordinim të ngushtë me Agjencinë Shtetërore të Kadastrës për konsolidimin e dokumentacionit pronësor. Gjithashtu, nëse prona përdoret për projekte specifike investimi, mund të përfshihen autorizime për ndërtim, zhvillim dhe prishje objektesh ekzistuese për t'i hapur rrugë realizimit të projekteve.

III. Objektivat dhe Parimet e Përdorimit - AIC ka një fokus të qartë për të përdorur pronat shtetërore për projekte investimi që mbështesin rritjen ekonomike dhe përmbushin interesin publik. Këto projekte mund të ideohen nga vetë AIC ose nga partnerë publikë dhe privatë, përfshirë investitorë strategjikë. Për të siguruar efektivitetin maksimal, Korporata ka të drejtë të krijojë subjekte për qëllime të veçanta (SPV) dhe të lidhë partneritete.

IV. Kriteret dhe Procedurat për Dhënien e Pronës - 1. Kriteret Kryesore (Përdorimi i pronës shtetërore mbështetet në kritere që sigurojnë përzgjedhjen e subjekteve më të përshtatshme:

Kriteret administrativo-ligjore ndalojnë pjesëmarrjen e subjekteve me detyrime të papaguara, probleme me falimentimin ose penalitete ligjore.

Kriteret teknike përfshijnë vlerësimin e planeve të propozuara për përdorimin e pronës, përmirësimet e planifikuara dhe përvojën e aplikantëve në projekte të ngjashme.

Kriteret financiare vërtetojnë stabilitetin ekonomik të aplikantëve dhe aftësinë për të përballuar projektet e propozuara.) 2. Procedurat Konkurruese – (Procedurat përfshijnë faza konkurrimi transparente, ku aplikantët paraqesin dokumentacionin dhe ofertat e tyre. Metodat e përzgjedhjes përfshijnë oferta dinamike, përzgjedhje me pikëzim ose negociime të drejtpërdrejta. Për shembull, në rastet kur prona jepet me qira, fituesi përcaktohet nga oferta më e lartë për qiranë ose angazhimet më të favorshme)

V. Monitorimi dhe Zbatimi - Korporata do të ngrejë struktura të veçanta si Komisioni i Eficiencës së Përdorimit të Pronës (KEPP), Njësia e Vlerësimit të Aplikimeve (NJVA) dhe Njësia e Trajtimit të Ankesave (NJTA), me qëllim që proceset të jenë të drejta dhe të ndjekin standardet e përcaktuara. Nëse shfaqen parregullsi, ato kanë kompetencën të rivlerësojnë procedurat ose të nisin një proces të ri.

VI. Përdorimi i Pronës për Shitje dhe Garanci - Për pronat që shiten ose përdoren si kolateral, procesi bazohet në një vlerësim të hollësishëm të përfitimeve ekonomike dhe të nevojës për financim. Shitja realizohet përmes procedurave konkurruese transparente, ndërsa përdorimi si garanci bëhet në rastet kur Korporata ka nevojë për financime ose për të mbuluar detyrime.

VII. Pika të Veçanta - Në rastet kur prona nuk gjen interes në procedurat konkurruese, Korporata ka të drejtë ta përdorë atë në forma të tjera si huapërdorje ose qiradhënie për projekte të veçanta.

AIC ka fleksibilitet për të krijuar partneritete ose të bashkëpunojë me SPV, duke shmangur procedurat standarde konkurruese kur është e nevojshme.

Konkluzion:

Nga auditimi konstatohet se Korporata e Investimeve Shqiptare (AIC), në lidhje me projekt-propozimet në fushën e pronave shtetërore, funksionon bazuar në Ligjin nr. 71/2019 “Për Korporatën e Investimeve Shqiptare” dhe VKM nr. 137, datë 06.03.2024 “Për përcaktimin e kriterëve dhe të procedurës për dhënien e pronës shtetërore me qira, enfitëozë, leasing, shitje, përdorim si kolateral dhe të përdorimit në forma të tjera nga ana e Korporatës së Investimeve Shqiptare”, të cilat funksionojnë të lidhura me njëra-tjetrën, ku ligji përcakton misionin dhe objektivat themelore të AIC-së, ndërsa VKM-ja krijon rregullat operative për të realizuar këto objektiva për pronat shtetërore.

Baza ligjore e sipërcituar i jep AIC-së një pavarësi në administrimin, menaxhimin dhe përdorimin e pronave shtetërore, duke përfshirë dhënien e tyre me qira, enfitozë, leasing, shitje apo përdorim si kolateral, si dhe zhvillimin e projekteve përmes procedurave të veçanta konkurrimi dhe negocimi të drejtpërdrejtë. Kjo pavarësi paraqet një risk të lartë operacional dhe institucional mbi menaxhimin e pronave shtetërore, pasi proceset e saj nuk bazohen në legjislacionin shqiptar mbi Prokurimet Publike, por mbështeten ekskluzivisht në kompetencat dhe procedurat e vetë AIC-së. Sa më sipër, nga ana e grupit të auditimit konstatohet se AIC-ja nuk ka hartuar deri në 30.06.2024, akte nënligjore / rregullore / manual specifike për procedurat se si do të kryhet përzgjedhja dhe administrimi i pronave shtetërore për t'u zhvilluar si dhe si llojet e procedurave specifike mbi të cilat do të operojë AIC në përputhje me këtë bazë ligjore.

Veprimet e mësipërme janë kryer në kundërshtim me *Ligjin nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”*.

Komisioni i Eficiencës së Përdorimit të Pronës (KEPP)

Nga auditimi konstatohet se me Vendim të Këshillit Mbikëqyrës nr.11, datë 28.06.2024, është miratuar Rregullorja për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Eficiencës së Përdorimit të Pronës (KEPP). Në vijim, me urdhrin e Drejtorit Ekzekutiv nr.142/10 prot, datë 08.07.2024 është ngritur Komisioni i Eficiencës së Përdorimit të Pronës (KEPP) me përbërje 5 (pesë) anëtarë, ku tre anëtarë janë staf i brendshëm në AIC, dhe dy anëtarë janë të ekspert të jashtëm, veprime në përputhje me VKM nr. 137, datë 06.03.2024 *“Për përcaktimin e kritereve dhe të procedurës për dhënien e pronës shtetërore me qira, enfitozë, leasing, shitje, përdorim si kolateral dhe të përdorimit në forma të tjera nga ana e Korporatës së Investimeve Shqiptare”*, në Kreun IV, seksioni A, pika 7 citohet se: *“Pranë Korporatës ngrihet dhe funksionon Komisioni i Eficiencës së Përdorimit të Pronës (KEPP), i cili ka në përbërje jo më pak se 5 (pesë) persona, punonjës të Korporatës dhe ekspertë të jashtëm. Në çdo rast, numri i anëtarëve duhet të jetë tek. Komisioni rregullohet dhe funksionon sipas rregullores së miratuar nga Këshilli Mbikëqyrës dhe merr vendime me shumicën e anëtarëve të pranishëm”*.

Projekt-Propozimet 6 mujori i I-rë viti 2024

Me Vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr.1, datë 02.02.2024, është miratuar autorizimin e Drejtorit Ekzekutiv për të vazhduar negocimin e marrëveshjeve për:

- Menaxhimin dhe zhvillimin e Korpunit të Policisë
- Menaxhimin dhe zhvillimin e Godinës shtetërore të Kadastrës
- Menaxhimin dhe zhvillimin e Kompleksit Governativ

Me Vendimin nr. 4, datë 26.03.2024, Këshilli Mbikëqyrës ka miratuar buxhetin për fazën e parë të projektit të zhvillimit të godinave shtetërore, të ndara në tre nën-projekte, me një vlerë totale prej 113,600 mijë lekë.

Nga ana tjetër, në buxhetin e parashikuar në fillim të vitit, AIC kishte planifikuar në zërin e shpenzimeve kapitale për projekte një vlerë prej 873,672 mijë lekë, të cilat janë parashikuar për t'u përdorur për të gjitha projekt propozimet që priten të realizohen.

Nga auditimi konstatohet se nga ana e AIC-së janë përgatitur projekt-propozimet për studimet e parafizibilitetit për 3 (tre) projekte në zhvillimin dhe menaxhimin e godinave shtetërore sipas përcaktimeve të VKM-së nr.137, datë 06.03.2024 *“Për përcaktimin e kritereve dhe të procedurës për dhënien e pronës shtetërore me qira, enfitozë, leasing, shitje, përdorim si kolateral dhe të përdorimit në forma të tjera nga ana e Korporatës së Investimeve Shqiptare”*, Kreu III, pika 7, ku citohet se: *“Korporata, për të identifikuar dhe/ose vlerësuar mundësitë e përdorimit të një prone të caktuar, për të hartuar/ideuar projekte, mund të kryejë një studim parafizibiliteti nëpërmjet mbledhjes së propozimeve*

nga tregu dhe vlerësimin të tyre apo konsultimit me ekspertë, subjekte publike dhe/ose private, vendase apo të huaja, duke lidhur marrëveshje të posaçme bashkëpunimi”.

1.Projekt- Propozim – Zhvillimi dhe menaxhimi i Godinave Shtetërore

Qëllimi i këtij projekti është përmirësimi i cilësisë së ndërtesave dhe hapësirave për shërbime publike, duke siguruar ambiente moderne dhe të përshtatshme për zyrat e Institucioneve, i cili është i ndarë në 3 (tre) nënprojekte.

Projekti synon transformimin dhe zhvillimin e pronave shtetërore në Shqipëri, me fokus në qytetet kryesore, veçanërisht Tiranën, ku tregu i pasurive të paluajtshme luan një rol të rëndësishëm ekonomik. Ky projekt realizohet nëpërmjet një partneriteti ndërmjet Korporatës së Investimeve Shqiptare (AIC), institucioneve publike dhe partnerëve privatë, të përzgjedhur përmes procedurave konkurruese ndërkombëtare.

Objektivat Kryesore:

- 1.Rritja e vlerës dhe efektivitetit të pronave shtetërore përmes zhvillimeve të qëndrueshme dhe menaxhimit të përshtatshëm.
- 2.Krijimi dhe përmirësimi i infrastrukturës publike, për të rritur standardet e punës dhe efikasitetin e institucioneve.
- 3.Promovimi i zhvillimit ekonomik nëpërmjet përdorimit efektiv të pronave shtetërore.

Aktorët dhe Përfitimet:

-Partneri Publik: Përfiton infrastrukturë moderne, hapësira pune më efektive dhe standarde më të larta për funksionarët publikë.

-AIC: Përfiton nga tarifat e ndërmjetësimit, zhvillimi i projektit dhe pozicionimi strategjik në tregun e pronave shtetërore.

-Partneri Privat: Investon dhe përfiton kthim të sigurt dhe të qëndrueshëm të investimeve me risk të ulët, duke kontribuar në zhvillimin urban.

Zbatimi:

Projekti përbëhet nga nënprojekte që lidhen me ndërtimin dhe mirëmbajtjen e godinave shtetërore, duke përfshirë ekspertizën ndërkombëtare dhe partneritetet me institucione të specializuara. Procedurat e përzgjedhjes së partnerit privat do të bazohen në konkurse të hapura dhe transparente, ku vlerësohet funksionaliteti dhe vlera ekonomike e propozuar.

1.1.Projekt-Propozim - Ndërtimi dhe Menaxhimi i Korpusit të Policisë

Zhvillimi këtij nën projekti bazohet në përdorimin e disa pronave të vëna në dispozicion nga Ministria e Brendshme - Akademia e Policisë dhe nga Ministria e Mbrojtjes. Nëpërmjet këtij nën projekti AIC në bashkëpunim me Akademinë e Policisë synon të zhvillojë një pronë shtetërore e cila ndodhet në zonë me potencial të lartë zhvillimi në Tiranë, për të gjeneruar përfitime për të gjitha Institucionet Publike të përfshira.

Kërkesat e Institucionit

Ministria e Brendshme – Policia e Shtetit	Punonjës, Sip zyrash, Salla mbledhjesh etj.
Drejtoria e Përgjithshme e Policisë	22,270 m2
Akademia e Policisë	19,000 m2
Garda e Republikës	17,000 m2
IKMT	2,500 m2
Agjencia e Mbikëqyrjes Policore	1,300 m2
Total m2 që nevojiten	43,070 m2

Në projektin e propozuar nga AIC, bazuar në këto nevoja parashikohet ndërtimi i një Poli të Policisë në zonën e Petrelës me sipërfaqe rreth 165,000 m2 të vënë në dispozicion nga Ministria e Mbrojtjes. Për të mundur zhvillimin e pronës në mënyrë që Ministria e Brendshme të përfitojë pa kosto 43,000 m²

ndërtim që i nevojiten vihet në dispozicion për zhvillim prona e Policisë në Sauk ku ndodhet Akademia e Policisë aktualisht.

Karakteristikat dhe parametrat zhvillimorë për pronën e Akademisë së Policisë në Sauk

Përshkrimi	Të dhëna
Titulli i Pronësisë	Certifikatë Pronësie
Totali i Truallit	60,000 nga 85,000 m ²
Sipërfaqe totale e Godinave funksionale	9,825 m ²
M2 që mund të zhvillohen sipas intensitetit	180,000 m ²
Cmimi i Referencës	85,700 lekë/m ²
Cmimi i Tregut	170,000 lekë/m ²

Karakteristikat dhe parametrat zhvillimorë të pronës nr.153, Reparti Ushtarakak 661 Petrelë

Përshkrimi	Të dhëna
Titulli i Pronësisë	Certifikatë Pronësie
Totali i Truallit	165,000 m ²
Sipërfaqe totale e Godinave funksionale	9,825 m ²
M2 që mund të zhvillohen sipas intensitetit	85,200 m ²
Cmimi i Referencës	85,500 lekë/m ²
Cmimi i Tregut	95,000 lekë/m ²

Plani i zbatimit dhe afatet

Sipas AIC-së parashikohet që projekti të zbatohet në 3 deri 5 vjet të ndara në nëfaza si vijon:

Përshkrimi	Afatet
Hartimi i Kuadrit Rregullator (VKM që përcakton kriteret dhe procedurat) Janar 2024	6 – 12 muaj
Identifikimi dhe konsolidimi i pronave shtetërore që do të përfshihen	3 – 6 muaj
VKM për kalimin e pronës tek AIC, Shkurt 2024	1-3 muaj pas VKM-së
Marrëveshja me Institucionin Partner	1 – 2 muaj
Rregulloret e Brendshme dhe Vendimet e Bordit	3 – 6 muaj
Thirrje për garën ndërkombëtare për projektimin, Mars 2024	1 – 2 muaj
Thirrje për garën ndërkombëtare për partnerët privatë	3 – 6 muaj
Krijimi i SPV (Special Purpose Vehicle)	6 – 12 muaj
Faza e zbatimit të projektit dhe ndërtimit	24 – 36 muaj
Përfundimi dhe dorëzimi i projektit	6-12 muaja pas përfundimit të ndërtimit

Nga auditimi i këtij projekt-propozimi, konstatohet se nuk ka një analizë se si janë arritur sipërfaqet e propozuara dhe që do të vihen në dispozicion nga institucionet në bashkëpunim.

Gjithashtu konstatohet se në lidhje me këto prona, janë kryer vetëm analiza të përgjithshme mbi çmimet referencë të tyre ose të tregut, por nuk janë të mirë argumentuara si dhe paraqesin paqartësi mbi përfitueshmërinë që mund të gjenerohet për AIC-në dhe Institucionet në bashkëpunim. Nga auditimi konstatohet se edhe për afatet për realizimin e projekt-propozimit, të cilat janë 3-5 vite, janë të pa argumentuara dhe të pa shoqëruara me analiza specifike dhe të detajuara.

Në lidhje me këtë projekt-propozim, konstatohet se deri në 30.06.2024, nuk është proceduar pasi Institucionet në bashkëpunim janë tërhequr nga projekt-propozimi i AIC-së, për të cilën nuk ka një argumentim të bashkëlidhur.

1.2. Projekt-Propozim - Zhvillimi dhe menaxhimi i godinave shtetërore, Godina e Kadastrës

Zhvillimi i projektit “Godina e Kadastrës” synon bashkëpunim me Institucionet Publike ASHK, ASHSH dhe ATP, synon zhvillimin e pronës në rrugën “Muhamet Gjollësia”(tek Fakulteti i Inxhinierisë së

Ndërtimit), për përmirësimin e cilësisë së Godinave dhe Zyrave për këto institucione publike. Kërkesat për hapësirë nga këto institucione, të dërguara me shkresë zyrtare dhe të analizuara nga AKPT paraqiten si vijon:

Nevojat e Institucioneve	Sipërfaqe zyrash, sallë mbledhje etj.
Nevoja për sipërfaqe zyrash	10,455 m ²
Sipërfaqe kalimi + sipërfaqe e përbashkët	4,335 m ²
Totali i nevojave të institucionit	14,790 m²

Burimi: AIC

Bazuar në nevojat e mësipërme, AIC propozon ndërtimin e një Poli të Kadastrës Shqiptare në një truall prej 5,000 m², e cila është vënë në dispozicion nga ASHK dhe për ndërtimin dhe zhvillimin pa kosto 14,790 m² ndërtim sipas parametrave të pronës të vënë në dispozicion nga ATP-ja (në rrugën “Muhamet Gjollësia”), pronë e cila ka një gjurmë 2,060 m². Institucionet publike, nuk kanë asnjë implikim/kontribut financiar sa i përket kostove dhe shpenzimeve do të ndërtohen 100% me kapitalin financiar të partnerit privat.

Plani i zbatimit dhe afatet

Sipas AIC-së parashikohet që projekti të zbatohet në 3 deri 5 vjet të ndara në nëfaza si vijon:

Përshkrimi	Afatet
VKM nr. 137, datë 06.03.2024	06.03.2024
VKM nr. 328, datë 29.05.2024	29.05.2024
Marrëveshja me Institucionin Partner	Brenda qershorit 2024
Veprime parapërgatitore për ngritjen e Komisionit të Eficiencës së Përdorimit të Pronës sipas VKM nr. 137, datë 06.03.2024	30-60 ditë nga miratimi i VKM-së
Rregulloret e Brendshme dhe Vendimet e Bordit	Brenda muajit Gusht 2024
Thirrje për garën ndërkombëtare për projektimin	Brenda datës 3 shtator
Thirrje për garën ndërkombëtare për partnerët privatë	Brenda 3 muajve nga përfundimi i konkursit të projektimit
Krijimi i SPV (Special Purpose Vehicle)	Brenda vitit 2024
Faza e zbatimit të projektit dhe ndërtimit	24-36 muaj nga marrja e lejes
Përfundimi dhe dorëzimi i projektit	6-12 muaj pas përfundimit të ndërtimit

Burimi: AIC

Nga auditimi i këtij projekt-propozimi, konstatohet se nuk ka një analizë se si janë arritur sipërfaqet e propozuara dhe që do të vihen në dispozicion nga institucionet në bashkëpunim.

Gjithashtu konstatohet se në lidhje me këto prona, janë kryer vetëm analiza të përgjithshme mbi çmimet referencë të tyre ose të tregut, por nuk janë të mirë argumentuara si dhe paraqesin paqartësi mbi përfitueshmërinë që mund të gjenerohet për AIC-në dhe Institucionet në bashkëpunim. Nga auditimi konstatohet se edhe për afatet për realizimin e projekt-propozimit, të cilat janë 3-5 vite, janë të pa argumentuara dhe të pa shoqëruara me analiza specifike dhe të detajuara, e cila deri në fazën e përfundimit të punës audituese në terren nuk ishte vijuar me fazat e sipërcituara në tabelë.

1.3. Projekt-Propozim - Zhvillimi dhe menaxhimi i godinave shtetërore, Kompleksi Governativ

Zhvillimi i projektit “Kompleksi Governativ” synon bashkëpunim me institucionet publike si Drejtoria e Shërbimeve Qeveritare, Autoriteti i Aviacionit Civil dhe Ministria e Arsimit me qëllim zhvillimin e pronave të këtyre institucioneve, për përmirësimin e cilësisë së godinave dhe zyrave për këto institucione publike si disa institucione varësie të Kryeministrit, AAC-ja, disa institucione varësie të MIE-s dhe MTM-ja.

Kërkesat për hapësirë nga këto institucione, të dërguara me shkresë zyrtare dhe të analizuara nga AKPT paraqiten si vijon:

Nevojat e Institucioneve	Sipërfaqe zyrash, sallë mbledhje etj.
--------------------------	---------------------------------------

Nevoja për sipërfaqe zyrash	16,818 m ²
Sipërfaqe kalimi + sipërfaqe e përbashkët	8,061 m ²
Mjedise për shërbime që i dedikohen punonjësve dhe komunitetit	5,000 m ²
Totali i nevojave të institucionit	29,879 m²

Burimi: AIC

Bazuar në nevojat e mësipërme, AIC propozon ndërtimin e një Poli Administrativ në zonën e Stadiumit Dinamo në një truall prej 9,400 m², e vënë në dispozicion. Për të mundësuar zhvillimin e zonës së sipërcituar në mënyrë që institucioni të përfitojë pa kosto 29,879 m² ndërtim, AIC-së do t'i vihet në dispozicion nga MAS për zhvillim me sipërmarrjen, prona tek Bulevardi Zhan D'Ark(ish-ATSH) me sipërfaqe prej 2,890 m². Institucionet publike, nuk kanë asnjë implikim/kontribut financiar sa i përket kostove dhe shpenzimeve do të ndërtohen 100% me kapitalin financiar të partnerit privat.

Plani i zbatimit dhe afatet

Sipas AIC-së parashikohet që projekti të zbatohet në 3 deri 5 vjet të ndara në nëfaza si vijon:

Përshkrimi	Afatet
VKM nr. 137, datë 06.03.2024	06.03.2024
VKM nr. 328, datë 29.05.2024	29.05.2024
Marrëveshja me Institucionin Partner	Brenda qershorit 2024
Veprime parapërgatitore për ngritjen e Komisionit të Eficiencës së Përdorimit të Pronës sipas VKM nr. 137, datë 06.03.2024	30-60 ditë nga miratimi i VKM-së
Rregulloret e Brendshme dhe Vendimet e Bordit	Brenda muajit Gusht 2024
Thirrje për garën ndërkombëtare për projektimin	Brenda datës 3 shtator
Thirrje për garën ndërkombëtare për partnerët privatë	Brenda 3 muajve nga përfundimi i konkursit të projektimit
Krijimi i SPV (Special Purpose Vehicle)	Brenda vitit 2024
Faza e zbatimit të projektit dhe ndërtimit	24-36 muaj nga marrja e lejes
Përfundimi dhe dorëzimi i projektit	6-12 muaj pas përfundimit të ndërtimit

Burimi: AIC

Nga auditimi i këtij projekt-propozimi, konstatohet se nuk ka një analizë se si janë arritur sipërfaqet e propozuara dhe që do të vihen në dispozicion nga institucionet në bashkëpunim.

Gjithashtu konstatohet se në lidhje me këto prona, janë kryer vetëm analiza të përgjithshme mbi çmimet referencë të tyre ose të tregut, por nuk janë të mirë argumentuara si dhe paraqesin paqartësi mbi përfitueshmërinë që mund të gjenerohet për AIC-në dhe Institucionet në bashkëpunim.

Sa më sipër konstatohet se në projekt-propozim nuk përcaktohen me emra specifike se cilat institucione pritet të jenë pjesë e sipërfaqeve që do të zhvillohen, për rrjedhojë duke mos patur një analizë të plotë dhe shteruese mbi identifikimin e tyre.

Nga auditimi konstatohet se edhe për afatet për realizimin e projekt-propozimit, të cilat janë 3-5 vite, janë të pa argumentuara dhe të pa shoqëruara me analiza specifike dhe të detajuara e cila deri në fazën e përfundimit të punës audituese në terren nuk ishte vijuar me fazat e sipërcituara në tabelë.

Për sa më sipër, për 3 (tre) nën projektet e sipërcituara në kuadër të Zhvillimit të Pronave Shtetërore, konstatohet se nuk ka një dokument/rregullore/manual, mbi identifikimin dhe përzgjedhjen e tyre, si dhe nuk ka një analizë mbi përfitueshmërinë, kostove financiare, risqet potenciale, vlerën e shtuar të parasë, rentabilitetin e investimit, si dhe një analizë krahasuese nëse këto projekt-propozimet do të zhvilloheshin nga vetë Institucionet, me financim të brendshëm nga buxheti i shtetit.

Veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 71/2019 “Për Korporatën e Investimeve Shqiptare”, dhe me Ligjin nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”.

2.Projekti: EXPO Albania

Expo Albania përfshin një qendër ekspozitash dhe eventesh, dizenuar për të promovuar Shqipërinë si një qendër rajonale për evente ndërkombëtare, mbi një pronë prej 61,817 m² me hotele, salla kongresi dhe hapësira ekspozimi të jashtme.

Me Urdhrin e Kryeministrit nr. 95 datë 03.08.2023 *“Për ngritjen e grupit ndërinstitucional të punës për vlerësimin e modeleve të suksesshme të qendrave të panairëve/expo, përzgjedhjen e modelit të biznesit më të përshtatshëm për Shqipërinë, vlerësimin e kuadrit ligjor, identifikimin e modeleve të financimit të projektit dhe menaxhimin e tij, identifikimin e objektivit të punës me mundësi potenciale zhvillimit e termave të referencës së projektimit për Qendrën Multifunkionale Tirana-Expo”*, është urdhëruar ngritja e grupit ndërinstitucional të punës, i cili do të kryesohet nga zv. Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Ministrave dhe në përbërje të tij do të ketë nga një anëtar përfaqësues nga institucionet si vijon: MFE, MM, Bashkia Tiranë, Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit(AKPT), Agjencia e Zhvillimit të Territorit (AZHT), Fondi Shqiptar i Zhvillimit (FSHZH) dhe Agjencia Shtetërore e Programimit Strategjik dhe Koordinimit të Ndihmës.

Me shkresën nr. 4472 prot., datë 02.10.2023, zv. Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Ministrave i ka kërkuar MFE-së hartimin e planit të biznesit dhe gjetjen e praktikave më të mira të menaxhimit të qendrave dhe panairëve në Evropë, në kuadër të bashkëpunimit të grupit ndërinstitucional të punës me autoritetet italiane, konkretisht Universitetin e Veronës, Bashkinë Verona, Verona Fiere dhe me Agjencinë Italiane të Tregtisë(ITA).

Me shkresën nr. 4473 prot., datë 02.10.2023, zv. Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Ministrave drejtuar Ministrisë së Mbrojtjes, ka propozuar mundësinë e ngritjes së qendrës multifunkionale të panairëve Tirana-Expo një pjese të pronës së saj, specifikuar repartin e helikopterëve në Farkë.

Me Urdhrin e Kryeministrit nr. 44 datë 13.03.2024 *“Për disa ndryshime në Urdhrin nr. 95 datë 03.08.2023 të Kryeministrit”*, është urdhëruar ndryshimi i emërimit të qendrës multifunkionale nga Tirana-Expo në Expo Albania, si dhe Grupi Ndërinstitucional i Punës do të kryesohet nga znj. E. K., këshilltar i Kryeministrit, dhe në përbërje do të ketë nga një anëtar përfaqësues nga institucionet si vijon: MF, MEKI, MM, Ministër për Pushtetin Vendor, Ministër i Shtetit për Sipërmarrjen dhe Klimën e Biznesit, Bashkia Tiranë, Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit(AKPT), Agjencia e Zhvillimit të Territorit (AZHT), Fondi Shqiptar i Zhvillimit (FSHZH) dhe Agjencia Shtetërore e Programimit Strategjik dhe Koordinimit të Ndihmës.

Me shkresën nr. 2581/1 prot., datë 13.05.2024, Kryetari i Grupit Ndërinstitucional të Punës drejtuar MF dhe MEKI, në vijim të shkresës nr. 377/02 prot., datë 07.05.2024 së AKPT me lëndë *“Kërkesë për akordimin e fondeve për procedurën ‘Konkurs Projektimi’, me objekt ‘Ide projektimi për Expo Albania’”*, ka kërkuar procedimin me përparësi të kërkesës së sipërcituar.

Me shkresën nr. 2581/2 prot., datë 14.05.2024, Kryetari i Grupit Ndërinstitucional të Punës drejtuar Bashkisë Tiranë dhe Agjencisë së Zhvillimit të Territorit, ka cituar organizimin e konkursit ndërkombëtar për Expo-Albania nga ana e AZHT-së, ku është shpallur fituesi dhe ka kërkuar marrjen e masave për rishikimin dhe përditësimin e planit të menaxhimit ekzistues dhe hartimin e një masterplani, në përputhje me kuadrin rregullator për zonën që do të zhvillohet *“Expo-Albania”*.

Me shkresën 2581/3 prot., datë 14.05.2024, Kryetari i Grupit Ndërinstitucional të Punës drejtuar Agjencisë Italiane për Kooperim dhe Zhvillim, për dijeni Ambasadës Italiane në Tiranë, ka kërkuar ekspertizën e tyre për Analizën e tregut, Zhvillimin e Brand-it, analizën e kostove Operacionale, projeksionet financiare, e cila duhet të përgatitet deri në datën 01.09.2024.

Me shkresën nr. 2581/4 prot., datë 24.05.2024, Kryetari i Grupit Ndërinstitucional të Punës drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm në MM, ka kërkuar vënien në dispozicion të pronës së Bazës Ajrore Ushtarake në Farkë, e cila është në pronësi të MM-së, me qëllim procedimin më tej në funksion të realizimit të projektit.

Me shkresën nr. 2581/6 prot., datë 24.05.2024, Kryetari i Grupit Ndërinstitucional të Punës drejtuar MTM-së, ka kërkuar nga MTM identifikimin dhe mobilizimin e projekteve apo donatorëve potencialë me të cilët MTM bashkëpunon me qëllim financimin për mbështetje për konsulencë nga IFEMA Madrid, koordinimin dhe lehtësimin e proceseve të nevojshme administrative për të mundësuar implementimin e kësaj konsulence, si dhe suportin dhe bashkëpunimin me MTM në hartimin e ligjit për Expo Albania. IFEMA Madrid është një nga organizatorët kryesor të panairove dhe kongreseve në Evropë dhe ka një eksperiencë të gjatë në këtë fushë.

Kostot e parashikuara për realizimin e projektit nga ana e AIC-së janë vlerësuar si vijon:

‘Euro

Kostot e Projektit Arkitektonik	3,252,918 Euro
Kostot e Konstruksionit	39,054,838 Euro
Kosto Totale	42,307,756 Euro

Burimi: AIC

Sa më sipër, në këtë kuadër, janë ndërmarrë hapat për hartimin e draft-Termave të Referencës për angazhimin e ekspertizës me mbështetjen e qeverisë italiane, konkretisht u angazhua ekspertiza e Universitetit të Veronës dhe Veronafiore s.p.a., ku deri në fund të punës audituese nuk paraqitej procedim të hapave të mëtejshëm.

3.Projekti Durana Tech Park

Për projektin “Durana Tech Park” është miratuar Ligji nr.58/2022 “Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e parqeve teknologjike dhe shkencore”, me qëllim zhvillimin e industrive të teknologjisë së lartë dhe inovacionit.

Bazuar në Ligjin e cituar më sipër, Këshilli i Ministrave ka miratuar vendimet më poshtë:

-Vendimin nr.337, datë 31.05.2023 “Për përcaktimin e procedurave dhe kritereve të përzgjedhjes së zhvilluesit të parqeve teknologjike dhe shkencore” (VKM – Zhvilluesi)

-Vendimin nr.418, datë 07.07.2023 “Për miratimin e procedurave për përzgjedhjen e përdoruesit në parqet teknologjike dhe shkencore” (VKM – Përdoruesi)

-Vendimin nr.417, datë 07.07.2023 “Për përdorimin e pasurive të paluajtshme shtetërore në parqet teknologjike dhe shkencore dhe miratimin e modelit të kontratës së qirasë” (VKM – Pasuritë e paluajtshme)

-Vendimin nr.416, datë 07.07.2023 “Për miratimin e kritereve, rregullave dhe procedurave për përfitimin e lehtësirave fiskale nga zhvilluesit dhe përdoruesit që operojnë në parqet teknologjike dhe shkencore”

-Vendimin nr.835, datë 28.12.2023 “Për disa shtesa në Vendimin nr.337, datë 31.05.2023”

-Vendimin nr.185, datë 27.03.2024 “Për kalimin në përgjegjësi administrimi nga Radio Televizioni Shqiptar te Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit të pasurive të paluajtshme shtetërore nr.336, nr.338/1, nr.318 në zonën kadastrale nr.3852, Xhafzotaj, Bashkia Durrës dhe miratimin e hapjes së parkut teknologjik dhe shkencor “Durana Tech Park”.

Analiza e zhvillimit të Projektit nga AIC

Në zbatim të VKM nr.185, datë 27.03.2024 “Për kalimin në përgjegjësi administrimi nga Radio Televizioni Shqiptar te Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit të pasurive të paluajtshme shtetërore nr.336, nr.338/1, nr.318 në zonën kadastrale nr.3852, Xhafzotaj, Bashkia Durrës dhe miratimin e hapjes së parkut teknologjik dhe shkencor “Durana Tech Park”, **në pikën 2 është përcaktuar** “Miratimin e hapjes së parkut teknologjik dhe shkencor, me emërtimin “DURANA Tech Park”, me sipërfaqe 140 400 (njëqind e dyzet mijë e katërqind) m2, me vendndodhje në Xhafzotaj, Bashkia Durrës, në pasurinë me nr.336, e llojit “truall”, në zonën kadastrale 3852, sipas kufijve dhe shtrirjes territoriale, që përcaktohen në fragmenthartën kadastrale, dhënë në shtojcën nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij”.

Në pikën 4 të VKM-së sipërcituar është vendosur *“Autorizimin e Korporatës së Investimeve Shqiptare, sh.a., një shoqëri tregtare aksionare me kapital shtetëror, regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit me numër unik identifikimi subjekti M01917011D, në rolin e zhvilluesit të parkut teknologjik dhe shkencor “DURANA Tech Park”.*

Gjithashtu AIC-ja është ngarkuar **sipas pikës 5 të VKM-së** *“Korporata e Investimeve Shqiptare, sh.a., brenda 150 (njëqind e pesëdhjetë) ditëve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, të paraqesë në ministrinë përgjegjëse për ekonominë, planin e zhvillimit të detajuar, cili përfshin elementet e parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “c”, “ç”, “d” të pikës 4, të nenit 3, të vendimit nr.337, datë 31.5.2023, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e procedurave dhe kritereve të përzgjedhjes së zhvilluesit të parqeve teknologjike dhe shkencore”, të ndryshuar, si dhe kapacitetet financiare, shoqëruar me projekt marrëveshjen në të cilën parashikohen angazhimet e ndërsjella të palëve, sipas pikës 2, të nenit 8, të ligjit nr.58/2022”.*

Nisur nga përcaktimet e VKM-së, AIC duhet që brenda 150 (ditëve) ose 5 muaj pas hyrjes në fuqi të VKM-së miratuar në 27.03.2024, të kryejë planin e zhvillimit të detajuar. Afati i kryerjes së planit të zhvillimit të detajuar është 27.08.2024.

AIC ka ndërmarrë disa hapa si vijon:

Përshkrimi	Të dhëna
VKM nr.185, datë 27.03.2024	Mars 2024
Përgatitja e dokumentave të Parkut Teknologjik të Durana për procedurën konkurruese	Prill 2024
Hapja e fazës së parë të procedurës konkurruese dhe promovimi për hapjen e thirrjes për përzgjedhjen e menaxherit të Durana	Prill – Maj 2024

Burimi: AIC

Sa më sipër AIC-ja, ka hapur në faqen zyrtare të internetit, njoftime për shprehje interesi paraprake për përfshirjen e start-up në Durana Tech Park, të cilat përgjatë fazës së terrenit të Grupit të Auditimit kanë vijuar të jenë aktive.

4.Konsulenca për Akademinë e Futbollit Durrrah

Me shkresën nr.109 prot, datë 14.12.2023, Fondacioni “Durrrah City Football Academy” i themeluar nga Ministria e Arsimit dhe Sporteve (MAS) drejtuar AIC-së, ka kërkuar shërbime konsulence. Këshilli i Ministrave ka vendosur në dispozicion të Fondacionit një pronë përmes VKM nr.580, datë 11.10.2023 në të cilën do të ndërtohet qendra sportive. Fondacioni është krijuar në zbatim të Urdhrit nr.422, datë 28.07.2023 të MAS në kuadër të zbatimit të marrëveshjes së bashkëpunimit mes MAS dhe Klubit të Futbollit të Manchester City dhe City Football Services (CFS) për krijimin e kampusit sportiv në qytetin e Durrësit.

Nëpërmjet kësaj shkrese Fondacioni bën të ditur se nuk i zotëron mjetet financiare për të ndërtuar një qendër të tillë sportive dhe po planifikon të kryejë thirrje për bashkëpunim tek klubet e ndryshme të superligës të cilët mund të jenë të interesuar në këtë projekt.

Për këtë arsye Fondacion kërkon asistencën nga AIC-ja në formën e konsulencës për:

- Ekspertizë dhe konsulencë në hartimin e kushteve administrative, teknike dhe financiare të thirrjes publike për prokurim, kërkimin e tregut, kujdesin e duhur dhe publicitet. Këshilla për financimin e projektit të Akademisë.
- Hartimi dhe negocimi i kontratës
- Mbikëqyrja do të kryhet në bashkëpunim me zhvilluesin
- E drejta për të menaxhuar infrastrukturën (pasi të krijohet)
- Angazhimi për fillimin e negociatave

- Hartimi i kontratave
- Thirrje për sponsorizim

AIC-ja ka lidhur kontratë shërbimi konsulence me Fondacionin Durrah City Football Academy, me nr.3/1 prot, datë 09.01.2024, me objekt këshillimin/asistencën profesionale që do të ofrojë AIC në kuadër të zhvillimit të projektit dhe mundësisë së bashkëpunimit në fazën e menaxhimit të korpusit sportiv në vazhdimësi. Kohëzgjatja e kontratës është me afat 2 vjeçar. Në nenin 5 të kontratës përcaktohen detyrimet e AIC-së, ku në përfundim të realizimit të shërbimit i paraqet Fondacionit një raport mbi punën e bërë së bashku me faturën përkatëse.

Në nenin 6 të kontratës është përcaktuar çmimi i kontratës, e cila është 1% e vlerës së investimit për zhvillimin dhe ndërtimin e Korpusit. Ky çmim i paguhet AIC-së 50% nga ana e Fondacionit dhe 50% nga ana e zhvilluesit, i cili përzgjidhet fitues në procedurën konkurruese përzgjedhëse përkatëse. Pjesa takuese e çmimit paguhet nga Fondacioni me dorëzimin e faturave përkatëse nga AIC. Çmimi fitues i kontratës që paguhet nga subjekti fitues i procedurës përzgjedhëse për AIC, si partner i Fondacionit është kusht bazë për kualifikimin e subjektit, si dhe i paguhet AIC në kohën e përzgjedhjes së subjektit fitues të garës.

Me faturën nr.100, datë 14.05.2024, AIC ka prerë faturën për shërbimin e konsulencës në shumën 50,000 Euro, shumë e cila është e arkëtuar.

Konkluzion:

Për sa më sipër, në lidhje me projekt-propozimet e sipërcituara, konstatohet se nuk është realizuar një analizë e detajuar mbi përfitueshmërinë e tyre. Sipas informacionit të vënë në dispozicion nga strukturat përgjegjëse të AIC-së, deri më datë 30.06.2024, këto projekt-propozime ndodhen në fazën e para-fizibilitetit, duke bërë të pamundur vlerësimin e impaktit ekonomik dhe përfitimeve potenciale që ato mund të gjenerojnë.

Gjithashtu, lidhur me metodologjinë e përzgjedhjes së projekt-ideve, konstatohet se nga ana e strukturave përgjegjëse të AIC-së nuk është hartuar apo miratuar një metodologji specifike dhe e standardizuar për seleksionimin e projekt-ideve. Mungesa e një metodologjie të miratuar cenon procesin e identifikimit dhe përzgjedhjes së projekteve, duke krijuar ndikime negative në menaxhimin strategjik dhe realizimin e objektivave të shoqërisë.

Për sa më sipër, në lidhje me problematikat e konstatuara nga ana e grupit të auditimit, sa i takon realizimit të misionit të AIC-së, mbi hartimin e projekt-ideve ose projekt-propozimeve, konstatohet se nuk ka urdhra për ngritjen e grupeve të punës për secilin projekt-propozime më vete, si dhe për realizimin e tyre sipas vetë AIC-së, janë angazhuar i gjithë stafi duke u përfshirë edhe këshilltarë të jashtëm.

Për sa më sipër trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit, në lidhje me veprimtarinë e AIC-së, konstatohet se gjatë hartimit të projekt-propozimeve, si pjesë e misionit të AIC-së, për shkak të mungesës së ngritjes së grupeve të punës me urdhra të veçantë si dhe bazuar në informacionet e dhënë nga përfaqësuesit e AIC-së, gjatë hartimit të projekt-propozimeve janë angazhuar pothuajse i gjithë stafi i AIC-së, për rrjedhojë mbajnë përgjegjësi si më poshtë:

1. Anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës të AIC-së, për periudhën objekt auditimi (Aneks 1 – Tabela 2.1.1.)
2. Znj. E. K., si Drejtor Ekzekutiv i AIC-së, nga Tetor 2023 deri 30.06.2024;
3. Z. E. F., si ish-Drejtor Ekzekutiv i AIC-së, nga fillimi i funksionimit të AIC-së deri Shtator 2023.;
4. Z. G. S., në funksionin e Drejtorit të Divizionit të Financës dhe Administratës në AIC, nga fillimi i funksionimit të AIC-së deri në 30.06.2024.;
5. Znj. F. K., në funksionin e Drejtorit të Divizionit të zhvillimit të Biznesit në AIC, nga Janari 2022 deri në 30.06.2024.;
6. Znj. L. G., në funksionin e ish-Drejtorit të Divizionit Juridik, për periudhën objekt auditimi.;
7. Z. J. A., në funksionin e Drejtorit të Zhvillimit të Operacioneve, nga muaji mars 2024 deri 30.06.2024.;

8.I gjithë stafi i angazhuar për hartimin e projekt-propozimeve.

Sa trajtuar më sipër në këtë pjesë të RPA-së, subjekti ka paraqitur observacione përmes shkresës nr.97/1 prot., datë 03.03.2025, protokolluar në KLSH me shkresën me nr.1096/6 prot., datë 03.03.2025, nga Drejtori Ekzekutiv i AIC-së znj. E. K., si vijon:

1.Në lidhje me Rekomandimin 1.1 të PRA-së, ju sqarojmë se AIC pas miratimit të Ligjit nr.71/2019 “Për Korporatën e Investimeve Shqiptare” dhe regjistrimit të akteve të themelimit të saj në QKB, proces i cili ka përfunduar në datën 17.07.2020, në Korrik të vitit 2021, ka filluar operacionalizimi i Korporatës, e cila operon në tregun Shqiptar si një shoqëri aksionere me aksioner të vetëm MFE-në, me opsionin që edhe Institucione Ndërkombëtare mund të bëhen aksionere në të. Gjatë vitit të parë dhe të dytë, fokusi i punës së AIC-së ka qenë në: 1) Ndërtimin e ekipit bazë dhe kapaciteteve të brendshme të Korporatës; 2) Zhvillimin e një projekt-pipeline; 3) Sigurimin e rritjes së nevojshme të kapitalit për financimin e aktiviteteve investuese; 4) Angazhimi i palëve të interesit. Në përfundim të kësaj periudhe, AIC ka ndërtuar një ekip koheziv ekspertësh me kohë të plotë dhe të pjesshme, si dhe është ngritur Këshilli Mbikëqyrës, në përbërje të të cilit ka anëtarë nga institucionet qendrore dhe ekspertë të pavarur. Në këtë periudhë AIC ka krijuar raporte me partner institucionalë për të identifikuar asete dhe projekte të mundshme, organizata multilaterale, dhe organizata simotra në vende të tjera. Në këtë drejtim, ekipi i AIC ka shqyrtuar dhjetëra asete dhe projekte potenciale investimi në fushat e industrisë dhe logjistikës, turizmit, energjisë dhe bujqësisë, me qëllim identifikimin e atyre që ushqejnë potencialin transformues nga këndvështrimi i qëndrueshmërisë tregtare dhe ndikimi në zhvillimin ekonomik të Shqipërisë, i matur nëpërmjet diversifikimit të aktiviteteve ekonomike, dhe akumulimit të know-how për të ndërtuar kapacitete të reja në vend. Gjatë muajve Shtator 2021-Mars 2022 dhe vazhdimisht më pas, janë shqyrtuar ide projektësh, dhe nga ky proces janë identifikuar projektet fillestare dhe të mëpasshme të investimit si (Business Plan North, Divjaka Eco-Tourism, KNRA në Pashaliman, Renewable Energy, Technopark, Drone Testing, Syri i Kaltër, etj.) të cilët janë analizuar më në detaj, kanë kaluar në disa faza adaptimi dhe iterimi, për fizibilitetin e tyre nga ana e përfitueshmërisë komerciale, impaktit në diversifikimin e kapaciteteve të ekonomisë, kompleksitetit dhe risqeve të tyre. AIC gjatë ushtrimit të veprimtarisë së saj ka marrë masa për reduktuar shpenzimet (shpenzimet që janë kryer kanë qenë shpenzime të një kategoria bazë, kryesisht: pagat, tarifat e Këshillit Mbikëqyrës, tarifa shërbimi auditi si dhe shpenzime për licensa për programe kompjuterike) dhe për të qenë eficientë në përmbushjen e misionit të saj të përcaktuar në aktet e themelimit. Gjithashtu nga AIC është ngritur grupi i punës, me Urdhër nr.113/1, datë 18.12.2023, “Për hartimin e strategjisë, planit të biznesit dhe treguesit e performancës”, më herë në muajin Nëntor 2023 është ngritur grupi i punës për marrjen e masave për uljen e shpenzimeve në zbatim të Vendimit të Asamblesë së Përgjithshme të Aksionarit nr.56, datë 07.08.2023, dhe me qëllim përmbushjen e objektivave të parashtruara për analizimin e reduktimit të shpenzimeve dhe përmirësimin e situatës financiare të shoqërisë, si identifikimin e mundësive për uljen e shpenzimeve operative; propozimin e strategjive për rritjen e të ardhurave dhe implementimin e masave dhe monitorimin e efektivitetit të tyre. Gjatë vitit 2024, AIC ka negociuar me bankat e nivelit të dytë duke rritur ndjeshëm të ardhurat nga interesi përmes investimit të likuiditeteve të disponueshme në depozita, po ashtu ka realizuar të ardhurat e para operacionale në masën 4,18 milion lekë nga konsulencat. Shpenzimet faktike kanë qenë ndjeshëm më të ulta (duke ndjekur politikë kursimi) se shpenzimet e planifikuara përgjatë ecurisë së AIC, respektivisht në vitin 2022, planifikimi fillestar ka qenë në masën 123 milion lekë, ndërkohë shpenzimet faktike kanë qenë në masën 74,7 milion lekë, me një kursim prej 39% ose 48.2 milion lekë të kursyera. Në vitin 2023, planifikimi fillestar ka qenë në masën 157.6 milion lekë, ndërkohë shpenzimet faktike kanë qenë në nivelin 77.9 milion lekë, me një kursim prej 51% ose 79.7 milion lekë. Ndërsa në vitin 2024, planifikimi fillestar ka qenë në masën 246 milion lekë, ndërkohë shpenzimet faktike kanë qenë në nivelin 118.8 milion lekë, me një kursim prej 52% ose 127 milion lekë, nga ana tjetër AIC përgjatë vitit 2024 ka realizuar të ardhura 126.5 milion lekë nga interesat dhe 4,18 milion lekë nga konsulencat duke e parashikuar vitin 2024 me gjendje positive, ku të ardhurat mbulojnë plotësisht shpenzimet.

2.Në lidhje me Rekomandimin 2.1 të PRA-së, ju sqarojmë se nga AIC në zbatim të Ligjit nr.71/2019 “Për Korporatën e Investimeve Shqiptare” dhe Vendimit nr.137, datë 06.03.2024, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e kritereve dhe të procedurës për dhënien e pronës shtetërore me qira, enfiteozë, leasing, shitje, përdorim si kolateral dhe të përdorimit në forma të tjera nga ana e Korporatës së Investimeve Shqiptare”, i

ndryshuar, gjatë 6-mujorit të II-të të vitit 2024, me Vendim të Këshillit Mbikëqyrës të saj me Vendimet nr.11 (nr.08/2 prot.), datë 28.06.2024, nr.15 (nr.11/01 prot.) datë 07.10.2024 dhe nr.16 (nr.11/2 prot.) datë 07.10.2024, nr.5 (nr.05/1 prot.) datë 08.04.2024, janë miratuar rregullore dhe manuale në funksion të proceseve të punës që do të kryejë, në përmbushje të funksioneve dhe objektivave të saj, konkretisht: - Rregullore e Brendshme e AIC-së; - Rregullore për zhvillimin e procedurës konkurruese, formës dhe përmbajtjes së dokumentave tip të procedurave konkurruese; - Manuali i Negocimit; - Metodologjia e përlllogaritjes së vlerave zhvillimore të pronave në pronësi apo përdorim të Korporatës së Investimeve Shqiptare; - Format i Pasaportës së Efiçencës së Pronës (PEP); - Aneksi 2 - DSK - Procedura Konkurruese me Përzgjedhje me Zarf; - Aneksi 5 - DSK - Procedura Konkurruese me Përzgjedhje me Pikëzim - 2 Faza/3 zarfa; - Aneksi 8 – DSK – Kontrata Tip/Standard për Sipërmarrjen; - Rregullore “Për funksionimin e Komisionit të Efiçencës së Përdorimit të Pronës”; - Rregullore “Për përzgjedhjen e partneriteteve për zhvillimin / menaxhimin / administrimin dhe përzgjedhjen e përdoruesve të një parku teknologjik / zonë ekonomike nga Korporata e Investimeve Shqiptare, në cilësinë e zhvilluesit të autorizuar”; - Rregullore për funksionimin e Komiteteve të Posaçme; - Rregullore për funksionimin e Komitetit për Partneritetet në Zonat Ekonomike dhe Parqet Teknologjike. (këto akte janë të publikuara në faqen zyrtare të AIC-së).

3.Në lidhje me Rekomandimin 3.1 dhe 3.2 të PRA-së, ju sqarojmë se AIC ka marrë masat duke filluar punën për hartimin e një manuali për hartimin e projekt-ideve dhe procedurave që do të ndiqen.

Sqarojmë se Korporata, në funksion të realizimit të një projekti investimi apo në rastet e autorizuar nga organi vendimmarrës sipas legjislacionit përkatës, si dhe për mirëadministrimin e pronave të saj me qëllim përdorimin me efiçencë të pronës, i referohet Vendimit nr.137, datë 06.03.2024, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e kriterëve dhe të procedurës për dhënie të pronës shtetërore me qira, enfitozoë, leasing, shitje, përdorim si kolateral dhe të përdorimit në formë të tjera nga ana e Korporatës së Investimeve Shqiptare”, i ndryshuar, Kreu III “Objektivat dhe parimet e përdorimit të pronës nga Korporata”, pika 1. AIC nuk zhvillon vetëm projektet që mund t’i përzgjedhë me iniciativën e vet në funksion të përmbushjes së funksioneve të saj, por zhvillon dhe projekte që vijnë me kërkesë nga Partnerë Publik/Privat apo me akte të veçanta të miratuara. Në rastin e zbatimit të projekteve të krijuara me iniciativën e saj AIC mbështetet në metodologjinë e përlllogaritjes së vlerave zhvillimore të pronave në pronësi apo përdorim të Korporatës së Investimeve Shqiptare, e cila është miratuar me vendim të Këshillit Mbikëqyrës të saj.

4.Në lidhje me Rekomandimin 4.1 të PRA-së, ju sqarojmë se drejtuar nga ligji i saj organik ku përcaktohen qartë funksionet dhe objektivat e AIC, si dhe nga planet vjetore të punës, hartimi i strategjisë së AIC ka nisur si një draft-dokument në fillim të vitit 2023. Ky draft kishte për qëllim të krijonte një bazë për orientimin e projekteve konkrete dhe metodologjinë e operimit të AIC. Megjithatë duke patur parasysh se vitet e para të punës së Korporatës kanë qenë një vlerësim i opsioneve dhe mudnësive të saj, si dhe një ripozicionim të aktivitetit të Korporatës gjatë fundit të vitit 2023 e në vijim, Korporata në fillim të vitit 2024 rihartoi draftin e strategjisë si një document bazë për orientim. Në vijim, Korporata ka kërkuar ekspertizë nga ekspertë dhe konsulentë partner të saj për të asistuar në finalizimin e strategjisë. Konkretisht, në Korrik 2024, për këtë qëllim, kanë nisur takimet dhe diskutimet me konsulentët e GIZ Albania me synim rishikimin, përmirësimin dhe finalizimin e draft-dokumentit të strategjisë, duke reflektuar një vision më të qartë dhe prioritizim efektiv të projekteve dhe objektivave të AIC. Konsulentët e GIZ Albania kanë miratuar draftin fillestar të strategjisë dhe kanë rekomanduar pikat e tyre në vazhdimin e draftimit të dokumentit. Ndërkohë, vijon organizimi i takimeve të rregullta mes ekipeve të AIC dhe konsulentëve për integrimin e feedback-ut nga palët e interesuara për të siguruar një dokument të plotë dhe të përditësuar. Gjithashtu, sqarojmë se në mbledhjen e datës 23.12.2024 Këshilli Mbikëqyrës i Korporatës vendosi si një nga objektivat strategjik për vitin 2025 miratimin e Strategjisë së Korporatës. Për këtë arsye, ky dokument do të miratohet brenda vitit 2025. Aktualisht (pas qershorit 2024) AIC ka një numër të konsiderueshëm projekt-konceptesh në vlerësim dhe është orientuar në plotësimin e të gjitha dokumentave që rregullojnë veprimtarinë e saj brenda vitit 2025.

Në lidhje me Rekomandimin 4.2 të PRA-së, ju sqarojmë se arsyet e mos konkretizimit të këtyre projekteve kanë ardhur për shkak që nuk varehin nga Korporata apo organet e saj drejtuese. Bazuar në përcaktimet e Ligjit nr.71/2019 “Për Korporatën e Investimeve Shqiptare” në përmbushje të funksioneve të saj, Korporata ka ndërmarrë të gjitha hapat e nevojshëm për konceptimin e projekteve duke plotësuar të gjithë elementët e nevojshëm të tilla si studimet e parafizibilitetit, analizat financiare, etj., në mënyrë që projektet të finalizoheshin me sukses. Në kushtet kur nuk u arrit të merrej miratimi nga ministritë që kishin nën administrim pronat përkatëse AIC e pa të pa mundur të vijonte me fazën e mëtejshme për këto projekte. Duhet theksuar se projektet e investimit nuk mund të jenë një

strukturë statike, por një system në lëvizje që ndikohet nga faktorë të ndryshëm që në rastin e ACI nuk varen gjithnjë prej vullnetit të saj. Gjithashtu për projektet që lidhen me sektorin e energjisë, ndodhi një ndryshim i rëndësishëm në prioritetet qeveritare dhe Korporata Shqiptare e Energjisë u përcaktuar si enti i vetëm i autorizuar për të zhvilluar projekte në këtë sektor. Përsa i takon projekteve të tjera të lidhura me zonat prioritare si Pashalimani dhe Divjaka, për të cilat zhvillimet në këto zona kërkojnë miratimin nga Komiteti Kombëtar i Investimeve (KIS), projekte që përfshijnë subjekte të nivelit të lartë dhe me kompleksitet ligjor, u lanë në pritje, pasi ishte e nevojshme një qasje e ndryshme e angazhimit ligjor. Gjithashtu projekti i Uzinës së Telave, një ide për transformimin e uzinës në një qendër për zhvillime të reja industrial, pas analizës së kryer për të vlerësuar mundësitë e përdorimit të Uzinës për qëllime të reja industrial dhe analiza e tregut dhe vlerësimet financiare të përfitueshmërisë të projektit AIC ka dërguar kërkesë MFE për të iniciuar transferimin e asetit dhe avancimin e projektit në fazën tjetër. AIC ishte në pritje për miratimin e kërkesës dhe incimin e transferimit të asetëve nga Ministria e Financave, në mënyrë që të mund të procedonte më tej dhe duke qenë se transferimi nuk u miratua, AIC u detyrua të mos vazhdonte me zhvillimin e këtij projekti.

5.Në lidhje me Rekomandimin 5.1 të PRA-së, ju sqarojmë se në funksion të përmbushjes së qëllimeve të saj për nxitjen e zhvillimit ekonomik nëpërmjet projekteve të investimit në nivel qendror, vendor dhe rajonal, në mbështetje të politikave shtetërore të zhvillimit dhe vënien në përdorim me efikasitet të pronave shtetërore, AIC identifikon prona shtetërore me interes për të realizuar projekte investimi dhe i propozon Këshillit të Minsitrave, nëpërmjet ministrit përgjegjës për ekonominë, transferimin e tyre te Korporata. Për të proceduar me propozimin në Këshillin e Ministrave për transferim të pronës shtetërore në përdorim apo në pronësi të Korporatës, duhet më parë që AIC të ketë përgatitur një projekt, i cili në vetvete është një seri aktivitetesh, që synojnë zgjidhjen e një problemi të caktuar (zhvillimin e një prone) nëpërmjet arritjeve të objektivave të qarta brenda një afati kohor dhe një buxheti të përcaktuar, që të argumentojë në Këshillin e Ministrave kërkesën për transferim të tyre.

6.Në lidhje me Rekomandimin 6.1 dhe 6.2 të PRA-së, ju sqarojmë se detajimi i përfitueshmërisë që AIC mund të gjenerojë, përcaktohet në fazën e fizibilitetit, fazë e cila në momentin e auditimit ishte në proces. Për periudhën e auditimit nga AIC nuk është shpallur asnjë garë për zhvillim të pronave. Të gjithë elementët e cituar në rekomandim janë të pasqyruara në Pasaportën e Efikasitetit të Përdorimit të Pronës (PEP), e cila plotësohet për të gjitha pronat, të cilat janë transferuar në pronësi apo në përdorim të AIC-së, me vendim të Këshillit të Ministrave, për t'u zhvilluar. Plotësimi i këtij dokumenti (PEP) bëhet mbi analiza të hartuara nga ekspertë të jashtëm të fushës, të cilët kontraktohen me kërkesë të Komisionit të Efikasitetit të Përdorimit të Pronës, dhe bazuar në Metodologjinë e përlllogaritjes së vlerave zhvillimore të pronave në pronësi apo përdorim të Korporatës së Investimeve Shqiptare.

7.Në lidhje me Rekomandimin 7.1 të PRA-së, ju sqarojmë se për projekt-buxhetet për vitin 2022 dhe 2023 nga Drejtori Ekzekutiv i AIC-së, në rrugë elektronike i janë dërguar relacionet shpjeguese (memo) të projekt buxhetit për këto vite Këshillit Mbikëqyrës, respektivisht në datat 21.01.2022 për Projekt-Buxhetin e vitit 2022 dhe më datë 21.11.2022 për Projekt-Buxhetin e vitit 2023. Lidhur me shpenzimet e miratuara, por pjesërisht të realizuara duhet patur parasysh se Korporata ka patur në fokusin e saj reduktimin e shpenzimeve faktike. Në rastin e Korporatave, shpenzimet bëhen sipas nevojës dhe është normale që shpesh herë të jetë nën nivelin e buxhetuar. Po kështu, buxheti zakonisht përgatitet sipas një trendi, dhe parashikimet e fund-vitit 2022 ishin të tilla që justifikonin një rritje të shpenzimeve për vitin 2023. Buxhetet janë përgatitur në bashkëpunim me Divizionet përkatëse, me diskutime të hapura në Këshillin Mbikëqyrës dhe në një linjë me perspektivën e drejtimit të Korporatës. Duke mbajtur në konsideratë që AIC është një entitet i ri dhe nuk ka patur historik dhe nuk ka patur projekte ekzistente, buxhetet janë detajuar deri në nivelin e mundshëm si dhe kanë ardhur në përmirësim vit pas viti. Sa i takon përcaktimit të shpenzimeve kapitale për secilin projekt individual apo hartimin e planeve të biznesit, sqarojmë se projektet të cilat janë identifikuar dhe do të zhvillohen nga AIC janë komplekse, në kohën e auditimit ishin në fazë konceptimi/zhvillimi dhe nuk kanë arritur akoma fazën e maturimit të Planit të Biznesit dhe do të detajohen në një fazë të mëpasshme, pasi të qartësohen të gjitha detajet e projektit. Parashikimet ligjore të cituara në PRA parashikojnë projekte të cilat janë të identifikueshme dhe të identifikuara në vlera dhe nuk mund të referohen për projektet e AIC-së. Në procesin për miratimin e Projekt Buxhetit për vitin 2024 janë bërë diskutime me Këshillin Mbikëqyrës (i cili është miratuar) dhe qasja ka qenë që shpenzimet për projektet të jenë të përgjithshme, dhe detajimi dhe realizimi i tyre të bëhet hap pas hapim, në konsultim me Këshillin Mbikëqyrës.

Në lidhje me Rekomandimin 7.2 të PRA-së, ju sqarojmë se monitorimi i buxheti të AIC-së është bërë në faza 3-mujore, 6-mujore, 9-mujore dhe vjetore, të cilat janë diskutuar më parë me strukturat e AIC-së dhe më pas i janë

përcjellë me e-mail anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës. Sqarojmë se shpenzimet kapitale janë kërkuar nga Bordi Drejtues të jenë të miratuara në total në nivelin e buxhetit pasi çdo projekt do kalojë individualisht në faza miratimi si projekti dhe buxheti i tij.

8.Në lidhje me Rekomandimin 8.1 të PRA-së, ju sqarojmë se nga e AIC po merren masa organizative me qëllim inventarizimin e plotë të dosjeve të projekt-propozimeve objekt i rekomandimit.

Në lidhje me Rekomandimin 8.2 të PRA-së, ju sqarojmë se projekt-propozimet hartohen nga grupe të posaçme ose nga punonjësit e Divizionit që ka detyrë funksionale hartimin e tyre.

Në lidhje me Rekomandimin 8.3 të PRA-së, ju sqarojmë se aktualisht AIC vijon me protokollimin e rregullt dhe korrekt të të gjitha dokumentave dhe raporteve zyrtare.

9.Në lidhje me Rekomandimin 1.1 të PRA-së, “B” Masa për eliminimin e efekteve negative të konstatuara, ju sqarojmë se të gjitha projektet për të cilat janë kontraktuar ekspertë të jashtëm, janë projekte të diskutuara dhe konsultuara vazhdimisht me Këshillin Mbikëqyrës, individualisht dhe në grup, po ashtu edhe të diskutuara me aksionerin dhe partner të tjerë vendimmarrës, si pjesë e planit të punës për vitin 2022. Me kërkesë të aksionerit, ato janë prezantuar gjithashtu edhe në takime qeveritare me investitorë të ndryshëm. Shpenzimet për angazhimin e ekepertëve individual kanë qenë minimale në raport me nevojat, si dhe të miratuara në buxhetin e vitit 2022. Angazhimi i ekspertëve të jashtëm ka qenë i autorizuar dhe në funksion të përgatitjes së projekteve të investimit. Pa ekspertizën teknike ishte e pamundur të bëhej përgatitja e projekteve dhe vlerësimi paraprak nëse duhej avancuar apo jo më tej me projekt-idenë. Po kështu, kjo ekspertizë (si në rastin e ekspertit të energjisë, në rastin e vlerësimit të pasurive, po ashtu në rastin e ekspertizës inxhinierike dhe detare për zhvillimin e KNRA, dhe arkitekturës dhe planifikimit urban në rastin e projektit të Divjakës) ishte e domosdoshme për të krijuar vlerësimin nëse duhej apo jo të procedohej me kërkimin e transferimit të aseteve, gjë që u realizua më pas, p.sh. me kërkesat që i’u paraqitën Ministrisë së Mbrojtjes, apo kërkesat për marrjen e autorizimeve specifike. Pa ato vlerësime e analiza teknike që dhanë ekspertët e jashtëm nuk mund të procedohej me vlerësimin e risqeve dhe “*liabilities*” që tipikisht paraqet çdo projekt investimi. Ekspertiza e jashtme shërben edhe si një “*safeguard*”, për validimin e analizës teknike dhe projekt-idesë, dhe është praktikë e njohur nëpër shoqëri si AIC që merret me rivitalizimin e aseteve shtetërore i duhet të ketë një kapacitet që zotëron planifikimin urban dhe arkitekturën, për vetë faktin se ndërhyrjet në asete kërkojnë njohuri mbi planifikimin hapësinor. Angazhimi i arkitektëve nga tregu privat është i kushtueshëm, dhe në rastin e ekspertit z.S. B., ai është një ekspert i njohur në vend dhe më gjerë, dhe është fat që ka rënë dakord të angazhohet në AIC me një tarifë modeste. z. B. ka dhënë kontribut të vlefshëm dhe sinjifikativ në detajimin dhe planifikimin e zhvillimit të projektit të Divjakës, ku janë bërë kostimet, planifikimet urbane dhe arkitekturore, analizat e planeve rajonale dhe lokale zhvillimore, renderat dhe video-t e projektimit të cilat janë prezantuar rregullisht në ekipin e AIC gjatë raportimit të ecurisë së projekteve. Zakonisht kur bëhen kontrata pune, krijohet gjithmonë fleksibilitet në parametrat që vihen për objektivat e punës, dhe brenda kohëzgjatjes së kontratës është në diskrecionin e palës kërkuese të kërkojë ato lloj inputesh që i nevojiten më shumë në një moment të caktuar. Gjithashtu nga AIC është miratuar dhe Udhëzimi nr.142/3 prot., datë 04.07.2024, në të cilin parashikohet procedura për përzgjedhjen e ekspertëve të jashtëm në funksion të përmbushjes së detyrave të KEPP dhe AIC-së.

Në lidhje me Rekomandimin 1.2. të PRA-së“B” Masa për eliminimin e efekteve negative të konstatuara, ju sqarojmë se mosvijimi i fazave të projekteve të propozuara në vitet 2022-2023 nuk ka ndodhur nga fakti që ekspertët e kontraktuar nuk kanë kryer shërbimin e kërkuar, por për shkaqe që nuk varen prej tyre apo nga AIC. Gjithashtu sqarojmë se vlerat e paguara për ekspertët në projekt-propozimet e sipërcituara nuk mund të konsiderohen si efekt negativ financiar, pasi ekspertët e kontraktuar kanë kryer shërbimin e paguar në përputhje me kontratën e nënshkruar nga palët (ekspert dhe AIC) dhe kanë dorëzuar ekspertizat e kërkuara, të cilat dhe pse këto projekte nuk kanë vijuar të zhvillohen, janë materiale në përdorim për AIC-në dhe me vlerë për të sepse mund të përdoren në çdo moment, për projekte të ngjashme ose të së njëjtës fushë, ndaj nuk konsiderohen me efekt negativ financiar. Sa i takon konstatimit se AIC ka kontraktuar ekspertë dhe ka përgatitur studimin e para-fizibilitetit pa u siguruar më parë transferimi i pronës shtetërore, sqarojmë se në funksion të përmbushjes së qëllimeve të saj për nxitjen e zhvillimit ekonomik nëpërmjet projekteve të investimit në nivel qendror, vendor dhe rajona, në mbështetje të politikave shtetërore të zhvillimit dhe vënien në përdorim me efikasitet të pronave shtetërore, AIC identifikon prona shtetërore me interes për të realizuar projekte investimi dhe i propozon Këshillit të Ministrave, nëpërmjet ministrit përgjegjës për ekonominë, transferimin e tyre te Korporata. Për të proceduar me propozimin në Këshillin e Ministrave për transferim të pronës shtetërore në përdorim apo në pronësi të Korporatës, duhet më para që AIC të ketë përgatitur

një projekt, i cili në vevete është një seri aktivitete, që synojnë zgjidhjen e një problem të caktuar (zhvillimin e një prone) nëpërmjet arritjeve të objektivave të qarta brenda një afati kohor dhe të një buxheti të përcaktuar, që të argumentojë në Këshillin e Ministrave kërkesën për transferim të tyre. Meqenëse AIC kishte mungesa në staf ishte i nevojshëm kontraktimi i ekspertëve të jashtëm për përgatitjen e studimit të para-fizibilitetit për projektet e planifikuara për t'u realizuar.

Qëndrimi i Grupit të Auditimit:

1. Në lidhje me observacionin e paraqitur nga AIC mbi Rekomandimin nr.1.1 të PRA, grupi i auditimit sqaron se në Projekt Raportin e Auditimit është analizuar situata e Korporatës së Investimeve Shqiptare për periudhën objekt auditimi, ku janë konstatuar humbjet e Korporatës si dhe mos gjenerimi i të ardhurave deri në fund të vitit 2023. Nga ana juaj janë dhënë vetëm komente dhe përshkrime mbi veprimtarinë e kësaj periudhe por jo dokumentacione mbi situatën e viteve objekt auditimi, për rrjedhojë nga ana e Grupit të Auditimit është lënë rekomandimi përkatës për përmirësimin e situatës së Korporatës së Investimeve Shqiptare.

2. Në lidhje me observacionin e paraqitur nga AIC mbi Rekomandimin nr.2.1 të PRA, grupi i auditimit sqaron se edhe pse nga ana juaj është cituar Ligji nr.71/2019 “Për Korporatën e Investimeve Shqiptare” dhe VKM nr.137, datë 06.03.2024 “Për përcaktimin e kriterëve dhe të procedurës për dhënien e pronës shtetërore me qira, enfitozoë, leasing, shitje, përdorim si kolateral dhe të përdorimit në formë të tjera nga ana e Korporatës së Investimeve Shqiptare”, të cilat funksionojnë të lidhura me njëra-tjetrën së bashku me Rregulloret dhe Manualët të miratuar me Vendime të Këshillit Mbikëqyrës, në Projekt Raportin e Auditimit është lënë rekomandimi mbi respektimin e plotë të kuadrit ligjor të R.SH. për ruajtjen dhe sigurinë e pronës publike, përfshirë këtu edhe rregullat dhe ligjet e procedurave të prokurimit publik si një standard i lartë mbi besueshmërinë e proceseve dhe procedurave me qëllim uljen e riskut të lartë operacional dhe institucional që paraqitet në fushën e pronave shtetërore të cilat AIC i menaxhon.

3. Në lidhje me observacionin e paraqitur nga AIC mbi Rekomandimet nr.3.1 dhe nr.3.2. të PRA, grupi i auditimit konstaton se Rekomandimi 3.1. është pranuar nga ana juaj dhe keni marrë masat për hartimin e një manuali për hartimin e projekt-ideve dhe procedurave. Në lidhje me Rekomandimin 3.2., komentet tuaja i referohen VKM nr.137, datë 06.03.2024, dhe në rastin e përzgjedhjes së vetë AIC të projekteve mbështetet në metodologjinë e përlllogaritjes të miratuar nga Këshilli Mbikëqyrës, grupi i auditimit sqaron se Rekomandimi 3.2. i adresohet hartimit të një metodologjie mbi përzgjedhjen e projekt-ideve, me qëllim përzgjedhja e tyre të jetë e mirë argumentuar dhe me analiza të detajuara, si një tregues i sigurimit të transparencës gjatë fazës së përzgjedhjes dhe mirë argumentimit të secilit projekt-ide të seleksionuar.

4. Në lidhje me observacionin e paraqitur nga AIC mbi Rekomandimet nr.4.1 dhe nr.4.2. të PRA, grupi i auditimit konstaton se Rekomandimi nr.4.1 është pranuar dhe është duke u përgatitur Plani Strategjik Afatmesëm. Në lidhje me Rekomandimin nr.4.2. nga ana juaj janë dhënë komente mbi mos vazhdimin e projekt-propozimeve të mëparshme përfshirë këtu edhe politikat e qeverisë, grupi i auditimit sqaron se Rekomandimi ka për qëllim shmangien e këtij fenomeni në të ardhmen duke siguruar vijueshmërinë e projekt-propozimeve të mëparshme si punë e kryer nga Korporata e Investimeve Shqiptare nëpërmjet përdorimit të buxhetit të saj dhe stafit të punonjësve.

5. Në lidhje me observacionin e paraqitur nga AIC mbi Rekomandimin nr.5.1 të PRA, grupi i auditimit sqaron se observacioni juaj paraqesin komente dhe jo dokumentacione shtesë, gjithashtu përtej propozimeve të projekteve Rekomandimi i adresohet projekt-propozimeve mbi të cilat më pas janë kontraktuar edhe ekspertë të jashtëm si kosto e buxhetit të AIC-së, ku gjatë hartimit të këtyre projekt-propozimeve duhet të kryhet më përpara transferimi i pronës/asetit në pronësi.

6. Në lidhje me observacionin e paraqitur nga AIC mbi Rekomandimet nr.6.1 dhe nr.6.2 të PRA, grupi i auditimit sqaron se Rekomandimet janë pranuar nga ana juaj dhe se janë duke u zbatuar gjatë fazave të fizibilitetit të projekteve së bashku me elementët e përfitueshmërisë financiare.

7. Në lidhje me observacionin e paraqitur nga AIC mbi Rekomandimet nr.7.1 dhe nr.7.2 të PRA, grupi i auditimit sqaron se observacioni juaj paraqet përshkrim dhe komente, por Rekomandimi i adresohet fazës së planifikimit dhe zbatimit të buxhetit ku duhen të hartohen plane biznesi dhe buxhete të detajuara për shpenzimet kapitale dhe korrente, duke u bazuar në nevojat reale të Korporatës, të shoqëruara me analiza shteruese mbi zbatimin e tyre. Gjithashtu në lidhje me detajimin e shpenzimeve kapitale duhet të parashikohen për secilin projekt me qëllim paraqitjen reale të treguesve financiar.

8.Në lidhje me observacionin e paraqitur nga AIC mbi Rekomandimet nr.8.1, nr.8.2 dhe nr.8.3. të PRA, grupi i auditimit konstaton se janë pranuar nga AIC dhe janë në fazë zbatimi.

9.Në lidhje me observacionin e paraqitur nga AIC mbi Rekomandimi nr.1.1. “Masa për eliminimin e efekteve negative të konstatuara...”, grupi i auditimit sqaron se observacioni juaj paraqet përshtetë dhe jo dokumentacion shtesë, për rrjedhje Rekomandimi i adresohet AIC-së, që të merren masa në vijimësi që për ekspertët e jashtëm të mos kryhet kontraktimi i tyre, nëse nuk është transferuar prona/aseti në përdorim të AIC-së për të cilën do të zhvillohet. Në lidhje me rekomandimin nr.1.2, grupi i auditimit sqaron se shpenzimet për ekspertët e jashtëm janë kryer për projekte pa u siguruar më parë prona në përdorim apo në pronësi të AIC-së, si dhe materialet e hartuara prej tyre nuk kanë shërbyer me vazhdimin e mëtejshëm të fazave të projektit, për rrjedhje observacioni juaj është përshtetë dhe jo dokumentacion shtesë.

Në lidhje me observacionet mbi Projekt Raportin e Auditimit nëpërmjet “MEMO-s”, të dërguar nga z. E. F. në datë 25.02.2025, si ish-Drejtor Ekzekutiv i AIC-së, paraqiten si më poshtë:

1.Protokollimi, në përgjithësi lidhur me manaxhimin e dokumentacionit, duhet thënë se AIC përdori mjete bashkëkohore (Google Drive, Dropobox, Microsoft etj.) e-maile, dhe komunikime virtuale për të mbledhur, shpërndarë, dhe manaxhuar dokumentacionin. Është kosto administrative dhe jo domosdoshmërisht efçente përdorimi i shkresave dhe protokollimi i tyre në mënyrë rutinore. Në rastin e Raportit Vjetor 2021, ai raport nuk u bë për të sjellë efekte tek palët e treta, por u bë me qëllim informimi dhe nuk bie ndesh me Rregulloren e Brendshme.

2.Lidhur me konkluzionin mbi mungesën e relacionit shoqëruar të projekt-buxheteve për vitet 2022 dhe 2023, sqarohet se këto projekt-buxhete janë shoqëruar me memo. Gjithashtu si pjesë e praktikës së punës janë diskutuar rregullisht si në grupin manaxherial po ashtu edhe në Bord, lidhur me risqe, synimet, objektivat dhe progresin e punës.

-Lidhur me shkallën e detajimit të buxhetit dhe projekteve, duhet thënë se detajimi i tyre bazohen në informacionin aktual të disponueshëm. Zërat specifikë në buxhet do të detajoheshin në vazhdimësi sipas nevojave, rrethanave, dhe specifikave të çdo projekti investimi. Ndërsa projektet e investimit kaluan në disa raunde iterimi dhe pune të brendshme analitike në ekipe të vogla për t'i adaptuar vazhdimisht me informacion të ri dhe përshtatur me nevojat që dilnin nga praktika.

3.Lidhur me konstatimet mbi planin e punës 2022, sqarohet se plani i punës është shpërndarë tek të gjithë organet ekzistuese qeverisëse të AIC (Bord dhe Aksioner), është diskutuar individualisht dhe në grup me anëtarët e Bordit, dhe ka qenë i miratuar, gjë që është lehtësisht e verifikueshme nga kontaktimi dhe komunikimi që mund të merret me anëtarët e Bordit, dhe ecuria e tij është raportuar periodikisht në organet qeverisëse, dhe partner të tjerë vendimmarrës.

-Lidhur me projektet e investimit, ato janë diskutuar dhe konsultuar vazhdimisht me Bordin, individualisht dhe në grup, ku janë dhe miratuar, po ashtu edhe konsultuar dhe diskutuar me aksionerin, dhe prezantuar tek partnerët të tjerë vendim-marrës, si pjesë e planit të punës për 2022. Me kërkesë të aksionerit, ato janë prezantuar gjithashtu edhe në takime qeveritare me investitorë të ndryshëm ndërkombëtarë. Të gjitha këto janë lehtësisht të verifikueshme nga komunikimet me personat në fjalë.

-Lidhur me angazhimin e ekspertëve individual, ato kanë qenë minimale në raport me nevojat si dhe të miratuara në buxhetin e vitit 2022. Duhet theksuar sërish se angazhimi i ekspertëve të jashtëm ka qenë i autorizuar dhe i nevojshëm në funksion të përgatitjes së projekteve të investimit. Pa ekspertizën teknike ishte e pamundur të bëhej përgatitja e projekteve dhe vlerësimi paraprak nëse duhej avancuar apo jo më tej me një projekt-ide. Po kështu, kjo ekspertizë ishte e domosdoshme për të krijuar vlerësimin nëse duhej apo jo të procedohej me kërkimin e transferimit të aseteve, gjë që u realizua më pas me kërkesat që i'u paraqitën Ministrisë së Mbrojtjes, apo kërkesat për marrjen e autorizimeve specifike. Pa ato vlerësime e analiza teknike që dhanë ekspertët e jashtëm nuk mund të procedohej me vlerësimin e risqeve dhe “liabilities” që tipikisht paraqet çdo projekt investimi apo aset. Plus që ekspertiza e jashtme shërben si një “safeguard”, për validimin e analizës teknike të brendshme dhe projekt-idesë, dhe është praktikë e njohur nëpër Korporata. Në këtë kontekst, duhet specifikuar se sekuenca e këshillueshme e veprimeve është që analiza e projektit të investimit (ku hyn roli ekspertëve) duhet t'i paraprijë aktit të transferimit të një asemi, dhe jo anasjelltas, në mënyrë që të minimizohen risqet që dalin nga marrja në pronësi apo posedim të një asemi, pa patur qartësi mbi liabilities që mund të kenë dhe përdorimin fundor të tyre.

4.Lidhur me konstatimin se ka munguar manuali i përgatitjes së projekteve, duhet thënë se si parim i përgjithshëm nga teoria e të drejtës, rregullimet ligjore informohen nga praktika dhe e ndjekin atë duke bërë formalizimet /

kodifikimet e nevojshme, pra nga natyra janë ex-post. Në momentin ku ndodhej AIC, në fillimet e saj, nuk ishte e këshillueshme të krijoheshin manuale apo procedura operimi abstrakte, dhe nuk mund të pretendohet detyrimi për t'i patur ato që në fillim, sepse nuk do ishin relevante dhe do të ishin të izoluar nga praktika. Adoptimi i rregulloreve u bë sipas një sekuence dhe nevojës, duke filluar me Rregulloren e Brendshme dhe Kodin e Etikës, për të vazhduar më tej me aktet e tjera, në përputhje dhe me vetë ciklet e evoluimit të AIC.

Qëndrimi i Grupit të Auditimit:

1. Në lidhje me observacionin tuaj të paraqitur mbi protokollimin dhe mënyrën e mbajtjes së dokumentacionit, grupi i auditimit sqaron se Korporata e Investimeve Shqiptare është një shoqëri shtetërore në varësi të Ministrisë së Ekonomisë, për rrjedhojë duhet t'i nënshtrohet rregullave dhe akteve ligjore përkatëse mbi inventarizimin e dosjeve, arkivën e protokollit dhe gjurmimit të dokumentacionit shkresor.

2. Në lidhje me observacionin tuaj të paraqitur mbi relacionet shpjeguese për projekte buxhetet 2022 dhe 2023, grupi i auditimit sqaron se rekomandimet përkatëse i adresohen fazës së planifikimit dhe zbatimit të buxhetit ku duhen të hartohen plane biznesi dhe buxhete të detajuara për shpenzimet kapitale dhe korrente, duke u bazuar në nevojat reale të Korporatës, të shoqëruara me analiza shteruese mbi zbatimin e tyre. Gjithashtu në lidhje me detajimin e shpenzimeve kapitale duhet të parashikohen për secilin projekt me qëllim paraqitjen reale të treguesve financiar.

3. Në lidhje me observacionin tuaj të paraqitur mbi planin e punës për vitin 2022 dhe për shpenzimet për ekspertë të jashtëm, grupi i auditimit sqaron se për vitin 2022 nuk ka një plan pune të miratuar me vendim të Këshillit Mbikëqyrës. Përsa i përket angazhimit të ekspertëve të jashtëm grupi i auditimit sqaron se observacioni juaj paraqet përshkrim dhe jo dokumentacion shtesë, për rrjedhojë Rekomandimi i adresohet AIC-së, që të merren masa në vijimësi që për ekspertët e jashtëm të mos kryhet kontraktimi i tyre, nëse nuk është transferuar prona/aseti në përdorim të AIC-së për të cilën do të zhvillohet.

4. Në lidhje me observacionin tuaj të paraqitur mbi manualin e përgatitjes së projekteve, grupi i auditimit sqaron se hartimi i një manuali ose rregullore të detajuar me fokus të veçantë për hartimin e projekt-ideve gjatë miratimit të Planeve të Punës të Shoqërisë, ka për qëllim identifikimin e hapave që do të ndiqen, përshkrimin e proceseve të punës dhe ciklit të projektit, duke filluar me studimin paraprak të përfitueshmërisë së investimit e deri te zbatimi i kontratës. Observacioni juaj nuk merret në konsideratë pasi nuk paraqet dokumentacion shtesë për Grupin e Auditimit.

2.2. Mbi veprimtarinë e Asamblesë së Përgjithshme, Këshillit Mbikëqyrës, Drejtorit Ekzekutiv dhe Bordit Këshillimor

Referuar Ligjit nr.71/2019 “Për Korporatën e Investimeve Shqiptare”, si dhe Statutit të AIC-së i miratuar në datën 15.07.2020, funksionet dhe kompetencat e organeve drejtuese paraqiten si më poshtë:

-Asambleja e Përgjithshme, e cila merr vendime mbi miratimin e statutit të Korporatës, miratimin e strategjisë si dhe të pasqyrave financiare;

-Këshilli Mbikëqyrës, i cili ka numër tek anëtarësh, jo më pak se 5, ku shumica janë të pavarur. Kompetencat e Këshillit Mbikëqyrës, lidhen me propozimin e strategjisë së institucionit, miratimin e planeve të biznesit dhe planeve të punës, miratimin e projekteve të investimit, mbikëqyrjen për zbatimin e politikave dhe projekteve të investimit, krijimin e komiteteve të posaçme lidhur me kontrollin e brendshme, etj;

-Drejtori Ekzekutiv, i cili administron veprimtarinë e Korporatës, përfaqëson institucionin me palët e treta, raporton te Këshilli Mbikëqyrës për zbatimin e politikave dhe projekteve të investimit;

-Bordi Këshillimor, i cili përbëhet nga 9 anëtarë që zgjidhen nga Asambleja e Përgjithshme. Bordi Këshillimor ka funksion këshillues në raport me Këshillin Mbikëqyrës dhe Drejtorin Ekzekutiv.

I-Në lidhje me veprimtarinë e Këshillit Mbikëqyrës konstatohet se ky organ e ka ushtruar veprimtarinë e vet bazuar në bazë të përcaktimeve ligjore të nenit 11, 13 dhe 14 të Ligjit specifik nr.71/2019 “Për Korporatën e Investimeve Shqiptare” si dhe bazuar në nenin 9, neni 14 deri 17, të Statutit të Shoqërisë “Korporata e Investimeve Shqiptare SHA”. Këshilli mbikëqyrës është mbledhur për herë të parë në vitin

2021, *(trajtuar në Aneksin nr. 1, Tabela 2.2.1)*, duke përmbledhur veprimtarinë e Këshillit Mbikëqyrës të Korporatës Shqiptare të Investimeve për periudhën nën juridiksion auditimi.

Neni 17 paragrafi 1 pika (c) e Statutit të Korporatës së Investimeve Shqiptare, përcakton se Këshilli Mbikëqyrës ka kompetenca të shumta dhe konkretisht në *“miratime planin e biznesit, buxhetin, planet vjetore te punës”* etj., paragrafi 2 neni 167 i Ligjit nr.9901, *“Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”* Këshilli Mbikëqyrës është përgjegjës për të gjitha funksionet në pikat 1 shkronjat (b) deri (i) të nenit 154 të këtij Ligji. Këshilli Mbikëqyrës bazuar në paragrafin nr.4 dhe nenin 154 të Ligjit nr.9901, *“Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”*, ka detyrimin të thërrasë Asambleenë e Përgjithshme, kur ndryshojnë vlera më të mëdha se 5% e asetëve apo aktiveve të shoqërisë aksionare.

1-Në lidhje me Vendimin nr.20, datë 13.11.2023, të Bordit Mbikëqyrës *(anëtarë znj. E. L., z..E. F., znj. R. Xh., znj. E. M. dhe kryetare znj. A. Xh.)* është rishikuar Buxheti i Korporatës së Investimeve Shqiptare me shumën 2 (dy) miliard lekë në funksion të huadhënies së një huaje në vlerën 2 (dy) miliard lekë në favor të shoqërisë A. SHA, bazuar në shkresën nr.2440 prot, datë 09.11.2023 të A. SHA, dhe protokolluar me shkresën nr.92 prot, datë 09.11.2023, të AIC-së, për një mbështetje financiare në shumën 2 (dy) miliard lekë, si pasojë e mungesës së likuiditetit dhe lëshimit të një Urdhri Ekzekutimi nga Gjykata Belge, kundrejt llogarisë së kompanisë A. SHA, ku palë në këtë proces gjyqësor është edhe Republika e Shqipërisë duke theksuar edhe situatën e mirë financiare të shoqërisë A. SHA, deri në zhbllokimin e situatës për përthithjen e fondeve të akumuluar nga veprimtaria ajrore e cila është aktive dhe arkëton të ardhura.

Sipas ***Librit të Proces Verbalit /Vota/Vendime*** të mbajtur nga znj. L. G. sipas numrit të protokollit 16 datë 13.11.2023 me pjesëmarrës të drejtpërdrejtë znj. A. Xh., znj E. L., znj E. M., z. E. F. dhe znj. R. Xh. është vendosur:

1-Rishikimi i Buxhetit të Korporatës së Investimeve Shqiptare për vitin 2023, në funksion të huadhënies në vlerën 2 (dy) miliard lekë në favor të shoqërisë “A. SHA” sipas vendimit nr.16/1 prot nr. 20 AIC datë 13.11.2023;
2-Të miratojë në parim dhe ti propozojë Asamblesë së Përgjithshme të Aksionareve të Korporatës, dhënie e Huasë në shumën 2 (dy) miliard lekë sipas termave të kontratës së huasë sipas Vendimit nr.16/2 prot AIC datë 13.11.2023.

Administrohet edhe shkresa nr.16 prot, datë 13.11.2023, të AIC-së, mbi minutat e takimit nëpërmjet platformës Microsoft Teams, ora 16 lokale me anëtarë:

1-znj. A. Xh. /Kryetare/Zv min/financave dhe ekonomisë
2-znj. E. L. anëtare/Profesore Fakulteti Ekonomik
3-znj. E. M. anëtare/Zv Ministër Min/Infrastrukturës dhe Energjisë
4-znj. R. Xh. anëtare/Sekretare e Përgjithshme Min/financave dhe ekonomisë
5-z. E. F., anëtar ish Drejtor Ekzekutiv AIC
6-z. D. W. K. i pavarur /ndërkombëtar

Nga **proces verbali i minutave të takimit** konstatohet se:

Është diskutuar për rritjen dhe forcimin e stabilitetit dhe kapacitetit financiar të Korporatës AIC nisur edhe nga takimi i zhvilluar me Aksionarin e vetëm Ministrin e Financave i cili ka shprehur vullnetin për mbështetje financiare duke anuluar vendimet për zvogëlimin e kapitalit dhe se vendimi i Ministrisë së Financave për konsolidimin e kapitalit të AIC do të analizohet duke marrë në konsideratë edhe shoqëritë e tjera shtetërore ku aksionar i vetëm është Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe propozimi i Ministrisë së Aksionar i Vetëm është:

1-Konsolidimi i Kapitalit të Korporatës AIC;
2-Në përputhje me kapitalin e konsoliduar, AIC të japë 2 (dy) miliard lekë, hua në favor të shoqërisë A. SHA pasi aksionar i vetëm është Ministria e Financave dhe Ekonomisë.

Drejtori Ekzekutiv ka përcjellë kërkesën e bërë nga shoqëria A. SHA, situatën për të cilën është kërkuar kjo hua, afatin e kërkuar si dhe faktin që afati i huadhënies është përdorur edhe nga shoqëri të tjera aksionare dhe se në çdo rast aksionari vetëm Ministri i Financave do të ndërhyjë për kthimin e huasë.

Nisur nga këto arsye u paraqit për vendimmarrje kjo kërkesë pranë anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës si dhe ftoi anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës të bëjnë pyetje në lidhje me këtë problematikë nisur nga fakti që të dyja shoqëritë aksionare “Korporata Investimeve Shqiptare” dhe shoqëria “A. ” kanë aksionar të përbashkët.

Nga **Kryetarja e Këshillit Mbikëqyrës**, znj.Xh. është shprehur fakti që të miratohet në parim dhënia e huasë dhe ti propozojë aksionarit miratimin duke dhënë komente edhe për mos vendosjen e kushteve për garantimin e huasë përderisa të dyja shoqëritë kanë të njëjtin aksionar, Ministrinë e Financave dhe të Ekonomisë, si dhe kërkoi një analizë financiare të huamarrësit, shoqërisë A. SHA për vlerësimin e mundësisë së kthimit të huasë duke komentuar edhe faktin se ka rënë dakord me z. E. M. (Ministër i Financave) për nënshkrimin e huasë nga ana e aksionarit me kushtin që AIC të miratojë biznes plan dhe buxhetet e ardhshme.

Nga **Kryetarja e Këshillit Mbikëqyrës** znj. Xh. është kërkuar konfirmim nga z. G. Sh. (Drejtor Divizioni Financiar) nëse është i përfshirë kapitali prej 2 (dy) miliard lekë dhe pas konfirmimit është sugjeruar që buxheti i Korporatës AIC të rishikohet vetëm për pjesën e shumës që do të jepet hua duke konfirmuar se buxheti i paraqitur për vitin 2024 është parashikuar të mbyllet me 2.7 miliard lekë likuiditet nga të cilat 2.5 miliard lekë janë të lira dhe në këtë vlerë nuk është përfshirë vlera e huasë.

Anëtari i Këshillit Mbikëqyrës z. E. F. në lidhje me procedurat e miratimit të huasë është shprehur se kjo është një procedurë normale duke theksuar faktin që ky operacion huadhënie të jetë i mirë mbështetur dhe i mjaftueshëm për efekt auditimi të AIC, të merret informacion nëse të tilla shoqëri aksionare japin hua në këtë shumë monetare si dhe të ketë një justifikim të fortë nga shoqëria përfituese A. SHA, mbi nevojën e huasë, përdorimin e saj, si dhe garancisë për shlyerjen duke konkluduar në kryerjen e një analize risku nëse shoqëria A. SHA mund të shlyejë huanë dhe çfarë masa kontingjente do të kemi në një rast të kundërt.

Anëtari i Këshillit Mbikëqyrës znj. E. M. ka aprovuar dhënien e kontratës së huasë duke trajtuar faktin që vendimi do të merret nga aksionari i vetëm dhe kërkoi hedhjen në votim. Vendimi merret me shumicën e votave të shumicës të anëtarëve të pranishëm të cilët votojnë pro ndërsa z.E. F. abstenon. Në përfundim u vendos dhe miratimi në parim me shumicë të anëtarëve të pranishëm dhënia e huasë në shumën 2 (dy) miliard lekë, në favor të shoqërisë A. SHA.

2-Në lidhje me Vendimin e Këshillit Mbikëqyrës për vitin 2023 rezulton se me Vendimin nr.21 datë 13.11.2023 është miratuar në parim që ti propozohet Asamblesë së Aksionarëve të Korporatës (Ministria e Financave) miratimi për dhënien e huasë në shumën 2 (dy) miliard lekë sipas kushteve dhe termave të draft kontratës dhe thërritjen e Asamblesë së Përgjithshme të Aksionarëve të Korporatës AIC me qëllim Vendimmarrjen sipas këtij objekti (*anëtarë znj. E. L., z. E. F., znj. R. Xh., znj. E. M. dhe kryetare znj. A. Xh.*)

Me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës datë 13.11.2023, është vendosur sipas rendit të ditës konsolidimi i kapitalit të korporatës AIC në shumën **4 (katër) miliard** lekë nisur nga miratimi i propozimit për miratimin e huasë prej 2 (dy) miliard lekë për shoqërinë A. SHA.

Me shkresën nr. 94 prot, AIC datë 16.11.2023, është informuar Aksionari ligjor i Korporatës së Investimeve, Ministri i Financave z. E. M. mbi vendimet e marra nga Këshilli Mbikëqyrës në lidhje me dhënien e pëlqimit dhe miratimin në parim të dhënies së huasë në shumën 2 (dy) miliard lekë.

Në këtë shkresë informohet Ministri i Financave për shumën prej 2 (dy) miliard lekë e cila prek aktivet e Korporatës bazuar sipas të dhënave të pasqyrave financiare të miratuara të certifikuara dhe bazuar në kushtet e nenit 154 dhe 167 të Ligjit për “Tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, kur këto aktive përbëjnë mbi 5% të aseteve të shoqërisë që rezultojnë në pasqyrat financiare, duhet të thirret Asambleja e Përgjithshme e Aksionareve të Shoqërisë për marrjen e vendimit përkatës. Në këtë shkresë theksohen dhe trajtohen

bashkëlidhur edhe vendimet përkatëse të marra nga Këshilli Mbikëqyrës në lidhje me dhënien e miratimit për dhënien e huasë në shumën 2 (dy) miliard lekë.

Me shkresën nr.21329 prot., MFE datë 20.11.2023 është marrë Vendimi i Asamblesë së Aksionarit sipas Vendimit nr.103 datë 20.11.2023 për “*Miratimin e Vendimit nr.21 datë 13.11.2023*” të Këshillit Mbikëqyrës të Shoqërisë Korporata e Investimeve Shqiptare SHA, për dhënien e huasë në shumën 2 (dy) miliard lekë në favor të shoqërisë A. SHA Tiranë, sipas kushteve të kontratës si dhe ngarkohet Drejtori Ekzekutiv i shoqërisë së Korporatës së Investimeve Shqiptare, të negociojë, nënshkruajë dhe administrojë këtë kontratë huadhënie për llogari të Korporatës së Investimeve Shqiptare si dhe të vijojë me procedurat ligjore për zbatimin e këtij vendimi.

Korporata e Investimeve Shqiptare bazuar në Vendimet e mësipërme të Këshillit Mbikëqyrës, Asamblesë së Aksionarit dhe Vendimit të Aksionarit si dhe bazuar në nenin 4 paragrafi 1 të Ligjit “*Për Korporatën e Investimeve Shqiptare*”, Ligjin nr.9901, datë 14.04.2008 “*Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare*” i ndryshuar, nenet 29, 30, 659 dhe 1050 të “*Kodit Civil në RSH*” i ndryshuar, në cilësinë e personit juridik me statusin e shoqërisë aksionare ka lidhur kontratë huaje sipas marrëveshjes së huasë trajtuar sa më sipër vijon duke marrë në konsideratë të plotë edhe Buxhetin e Rishikuar të Vitit 2023 që do të pasojë me procesin e dhënies së huasë në shumën 2 (dy) miliard lekë.

Pas Vendimit të Aksionarit të vetëm të Korporatës së Investimeve Shqiptare për miratimin e dhënies së kontratës në shumën 2 (dy) miliard lekë nga ana e Korporatës së Investimeve Shqiptare është nënshkruar kontrata e huasë me datën 24.11.2023 sipas nr. 97 prot AIC dhe nr. 2570 prot A. SHA për dhënien e një huaje me afat 1 vjeçar dhe zgjatja e saj përtej këtij afati sipas vendimit të marrë nga organet drejtuese të AIC me interes depozite 3%, e cila është akorduar më parë për shumën 2 (dy) miliard lekë për depozitën e kapitalit të dhënë hua dhe nga ky operacion bankar deri me datë 30.11.2024 të cilat kanë sjellë një të ardhur pozitive në shumën 6,000,000 lekë për Korporatën AIC. Në vijim nga Korporata AIC janë ndjekur hapat ligjore sa më poshtë vijon:

Në lidhje me gjenerimin e të ardhurave nga likuiditetet dhe asetet monetare të Korporatës AIC si pasojë e vjeljes së interesit të depozitës së kapitalit konstatohet se që nga momenti i dhënies së kapitalit nga Aksionari në shumën 198,000,000 lekë, me datë 22.01.2021 deri më datë 27.01.2022 për vlerën e kapitalit prej 2,198,000,000 lekë gjendje në llogari të Korporatës AIC nuk janë vjelë dhe përfituar interesa pozitive të cilat për kohën e qëndrimit të depozitës në Bankën R. ose bankë alternative të nivelit të dytë sipas një interesi minimal prej 2%-3% do të ishin gjeneruar efekte pozitive në likuiditetet dhe asetet monetare të Korporatës AIC.

Nga depozitimi i kapitalit të Korporatës AIC në bankat e nivelit të dytë (A. B.) pas datës 27.01.2022 për vitin 2022 deri në fund të periudhës së auditimit 30.06.2024 janë përfituar si interesa depozite shuma prej **27,737,188 lekë** dhe shuma prej **6,000,000 lekë** si interesa të huasë së kredisë së dhënë për shoqërinë A. dhe në total shuma **prej 33,737,188 lekë** si interesa të depozitave dhe kapitalit të dhënë hua.

Në vijim të kontratës së huasë:

-Me shkresën nr. 253 prot AIC datë 06.11.2024, Drejtori Ekzekutiv i Korporatës AIC ka kërkuar kthimin e shumës së huasë dhe interesave respektive sipas objektit të huasë së nënshkruar sipas shkresës nr. 97 prot AIC datë 24.11.2023;

-Me shkresën nr. 253/1 prot AIC datë 13.11.2024, Drejtori Ekzekutiv i Shoqërisë A. ka kërkuar shtyrjen e afatit të kthimit të huasë edhe me një vit kalendarik sipas pikës 1.2/a/b të kontratës konform miratimeve përkatëse dhe detyrimeve të nënshkruara;

-Me shkresën nr. 253/2 prot AIC datë 18.11.2024, Drejtori Ekzekutiv i Shoqërisë AIC ka kërkuar shtyrjen e afatit të kthimit të huasë vetëm nëse nuk çënohet interesi ekonomik dhe operacional i korporatës AIC duke theksuar se “*Zgjatja e afatit të kontratës do të jetë objekt i shqyrtimit në mbledhjen më të parë të*

Këshillit Mbikëqyrës të AIC”, duke informuar si autoritetin e Këshillit Mbikëqyrës të AIC ashtu edhe Aksionarin dhe Asamblenë e Përgjithshme për këtë situatë;

-Me emal-in qarkullues të datës 26 nëntor 2024 janë njoftuar anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës për mbledhje të përsheptuar për marrjen e vendimit për çështjen e huasë së dhënë shoqërisë A. ;

-Me shkresën nr. 253/3 date 26.11.2024 është njoftuar Ministria e Ekonomisë Kulturës dhe Inovacionit si Aksionari i vetëm i Korporatës AIC, duke e vënë në dijeni për kërkesën e shoqërisë A. për shtyrjen e huasë dhe kalimin për mendim në Këshillin Mbikëqyrës dhe pastaj në Asamblenë e Aksionareve sipas nenit 154 paragrafi 4 të Ligjit 9901 “Për Shoqëritë Tregtare” pasi asetet dhe kapitali i dhënë ka vlerë më të lartë se 5% e aktiveve.

Në lidhje me Vendimin nr.2 datë 07.03.2024 të marra nga Këshilli Mbikëqyrës konstatohet se është shpërblyer z. E. F. (anëtar për kontribut 3 vjeçar në veprimtarinë e korporatës AIC) me 35% mbi shpërblimin bazë të anëtarit të Këshillit Mbikëqyrës së Korporatës së Investimeve Shqiptare jo në përputhje me metodikën dhe praktikën ligjore të miratuara nga Këshilli Mbikëqyrës sipas Vendimit nr. 23 datë 20.12.2023 pika 8 gërma (e), “Anëtarët e këshillit mbikëqyrës gëzojnë të drejtën të përfitojnë shpërblim performancës në masën 35% të shpërblimit mujor në rast angazhimi në më shumë se 5 mbledhje Këshilli në një muaj kalendarik nga të cilat 3 mbledhje të rezultojnë me vendim”, duke sjellë pasojë një efekt financiar në **shumën 63,000 lekë** në Buxhetin dhe të Ardhurat e Korporatës së Investimeve. Neni 167 ligjit 9901 “Për Shoqëritë Tregtare” Përbërja, të drejtat e detyrimit e këshillit mbikëqyrës dhe administratorët, përcakton se:

Anëtarët e këshillit mbikëqyrës përgjigjen për dëmet e shkaktuara nga shkelja e detyrave të tyre dhe standardit të kujdesit, të përcaktuara në pikat 1, 2 e 3 të nenit 163 të këtij Ligji. Për shkeljet e kryera nga administratorët, sipas parashikimeve të pikës 4 të nenit 163 të këtij Ligji, anëtarët e këshillit mbikëqyrës janë përgjegjës, kur nuk njoftojnë asamblenë e përgjithshme, edhe pse kanë dijeni për këto shkelje, apo kur nuk kanë zbuluar ngaqë funksioni i mbikëqyrjes, sipas kërkesave të këtij ligji, nuk është kryer në mënyrë korrekte e sipas standardeve të kërkuara.

Persona përgjegjës, znj. E. L., znj. E. M., znj. R. Xh., znj. A. Xh., anëtarë të këshillit mbikëqyrës nënshkruer dhe prezent në mbledhje.

3-Me Vendimin nr.5 datë 22.07.2021 të Këshillit Mbikëqyrës të Korporatës së Investimeve Shqiptare është vendosur miratimi në parim i strukturës së pagave të anëtarëve të këshillit mbikëqyrës për anëtarët që vijnë nga Institucionet Qendrore dhe anëtarët e pavarur ndërkombëtare sipas nivelit të pagave në nivelin 1/3 të pagës të Drejtorit Ekzekutiv shoqëruar me shpenzime të duhura në funksion të aktivitetit të korporatës të njohura nga korporata e cila bazohet në kredencialet, imazhin, kapacitetin vlerën globale që gëzojnë dhe kredibilitetin që do ti japin korporatës si dhe shpërblimi vjetor për anëtarët e Bordit Këshillimor në nivelin sa 1/4 e pagës minimale të Drejtorit Ekzekutiv.

4-Me vendimin nr.11 prot AIC datë 28.06.2024 të Këshillit Mbikëqyrës të Korporatës së Investimeve Shqiptare është vendosur Miratimi i Rregullores për funksionimin e Komisionit të Eficiencës së Përdorimit të Pronës KEPP i cili nuk ka funksionuar.

5-Në lidhje me deklarinimin e konfliktit të Interesit Private të antërave të këshillit mbikëqyrës
Neni 14 “Këshilli Mbikëqyrës” sipas pikës 3 dhe 6 zgjidhen ata persona që;

3(a)-Nuk kanë qenë të dënuar me vendim gjykatë të formës së prerë për kryerjen e një veprë penale ose kundërvajtje penale.
3(b)-Zotërojnë të paktën gradën “master shkencor” në fusha ekonomike, financë, biznes, drejtësisë ose fusha të ngjashme si dhe minimalisht të paktën 7 vite pune në pozicion drejtues në sektorin publik ose privat.

6-Anëtarët e Këshillit nuk mund të bëjnë pjesë në më shumë se dy këshilla të shoqërive tregtare me seli në RSH.

Rezulton nga auditimi se neni 6 i Ligjit nr.9367, datë 7.4.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike” i ndryshuar, me Ligjin nr.9475, datë 9.2.2006 dhe me Ligjin nr.9529, datë 11.5.2006, me Ligjin 86/2012 datë 18.09.2012 dhe me Ligjin nr.44/2014 datë 24.4.2014 përcakton

se “Mënyra e kryerjes së detyrave publike dhe detyrimi për parandalimin e konfliktit të interesit” detyron zyrtarin publik që:

1. Me zgjedhjen ose emërimin e tij e në vazhdim, zyrtari ka për detyrë të parandalojë dhe të zgjidhë vetë, sa më parë dhe në mënyrën më të frytshme të mundshme, çdo gjendje të konfliktit të tij të interesit. Në rast se zyrtari nuk është i bindur për ekzistencën apo jo të një konflikti interesi të lidhur me të, ai duhet të këshillohet sa më parë me eprorët.
2. Çdo epror dhe institucion epror duhet të marrin të gjitha masat e nevojshme për të parandaluar dhe zgjidhur rastet e konfliktit të interesit.

Neni 3 “Përkufizime”

1. “Konflikt i interesit” është gjendja e konfliktit ndërmjet detyrës publike dhe interesave privatë të një zyrtari, në të cilën ai ka interesa privatë, të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, që ndikojnë, mund të ndikojnë ose duket sikur ndikojnë në kryerjen në mënyrë të padrejtë të detyrave dhe përgjegjësisë të tij publike.

Neni 3 pika 4

- a- “konflikt faktik i interesit” është gjendja, në të cilën interesat privatë të zyrtarit ndikojnë, kanë ndikuar ose mund të kenë ndikuar në kryerjen në mënyrë të padrejtë të detyrave dhe përgjegjësisë të tij zyrtare;
- c) “konflikt i mundshëm i interesit” është gjendja, në të cilën interesat privatë të zyrtarit mund të shkaktojnë, në të ardhmen, shfaqjen e konfliktit faktik ose në dukje të interesit, nëse zyrtari do të përfshihej në detyra apo përgjegjësi të caktuara;
- ç) “konflikt rast për rast i interesit” është gjendja me konflikt interesi, në njërën nga tri llojet e mësipërme, që shfaqet rast për rast dhe lidhet me një vendimmarrje të veçantë;
- d) “konflikt i vazhdueshëm i interesit” është gjendja, në të cilën konflikti i interesit mund të shfaqet në mënyrë të përsëritur dhe/ose të shpeshtë në të ardhmen.

Pika 10

“**Institucion epror**” është një institucion publik (ose organ i një institucioni publik) që, sipas ligjeve në fuqi, ka kompetenca rregulluese, emëruese, drejtuese, urdhëruese, vlerësuese ose kontrolluese mbi një institucion tjetër publik (ose organ të tij), ku, në këtë të fundit, një zyrtar kryen detyrat dhe ushtron kompetencat e tij. Roli epror ushtrohet në përputhje me ligjet, që rregullojnë organizimin dhe funksionimin e institucioneve publike. Pavarësisht nëse një institucion epror mund të ketë njërën nga kompetencat e mësipërme, ai nuk mund të vlerësohet i tillë, nëse kjo do të çonte në cenimin e parimeve kushtetuese të ndarjes së pushteteve dhe të autonomisë institucionale.

Neni 22 “Ndalime në sigurimin e të ardhurave për shkak të funksionit të veçantë”

2. Zyrtarit, që është përfaqësues i një institucioni publik në zotërimin e aksioneve ose të pjesëve në kapital të shoqërive tregtare, gjatë ushtrimit të këtij funksioni i ndalohet:
 - a) marrja drejtpërdrejt ose tërthorazi, me ndërmjetësimin e palëve të treta, e çdo përfitimi financiar, përfshirë krijimin e një burimi të ardhshëm financiar, që lidhet ose përfihet për shkak të detyrës së tij si përfaqësues;
 - b) pranimi, në favor të tij, i dhuratave ose pjesëve në kapital nga shoqëria, anëtarët ose organet e saj;
 - c) blerja e pjesëve në kapital, aksioneve ose pasurive të këtyre shoqërive;
 - ç) përfitime të drejtpërdrejta ose të tërthorta nga furnizues apo klientë të këtyre shoqërive

Neni 31 “Kufizimet për zyrtarin e nivelit të lartë dhe të mesëm, drejtues të administratës publike, institucioneve të tjera publike, Policisë së Shtetit dhe Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”

- b) Nuk mund të jenë anëtarë në organet drejtuese të një shoqërie tregtare ose në një organizatë jofitimprurëse, kur këta ushtrojnë veprimtari në një sferë që përputhet ose pritet me sferën e juridiksionit të zyrtarit dhe të kompetencës së tij për të vepruar. me akte të nxjerra nga ai, ose kur zyrtari ka rol thelbësor dhe përcaktues në nxjerrjen e këtyre akteve. me akte të cilat krijojnë pasoja juridike, përfitime ose kosto mbi këto shoqëri a organizata apo mbi shoqëri ose organizata të tjera që bashkëpunojnë ose konkurrojnë me shoqërinë në fjalë, përjashtuar rastet kur ky pozicion në shoqëri ose organizatë vjen për shkak të funksionit dhe/ose të statusit:

Në përfundim,

1-Konstatohet nga auditimi se deri në periudhën nën juridiksion auditimi nga anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës të cilët kanë qenë të punësuar pranë organit epror institucioni publik Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe më pas me ndryshimet ligjore Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit (**Aksionari**), nuk janë plotësuar deklarime individuale personale në lidhje me rastet e mbulimit të konfliktit të interesave gjatë ushtrimit të detyrave nga zyrtarët publikë që kanë kryer detyra funksionale si në organin epror ashtu edhe në organet drejtuese të shoqërisë së Korporatës Shqiptare të Investimeve në

zbatim të përcaktimeve të Ligjit nr.9367, datë 7.4.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike” i ndryshuar, me Ligjin nr.9475, datë 9.2.2006 dhe me Ligjin nr.9529, datë 11.5.2006 me Ligjin 86/2012 datë 18.09.2012 dhe me Ligjin nr. 44/2014 datë 24.4.2014, përcakton se “Mënyra e kryerjes së detyrave publike dhe detyrimi për parandalimin e konfliktit të interesit”.

2-Referuar përcaktimeve të paragrafit 3.1 deri 3.5 të nenit 3 “Të drejta dhe detyrime të AIC” nga Korporata e Investimeve Shqiptare të ezaurohet e drejta ligjore për informimin e mundshëm të kryer të konsumuar ose në dukje të dukshëm të konfliktit të interesave për anëtarët e këshillit mbikëqyrës dhe anëtare të tjerë të mundshëm në organe drejtuese të shoqërisë së Korporatës Shqiptare të Investimeve.

II-Drejtori Ekzekutiv ka kryer detyrat funksionale sipas nenit 11 “Organet Drejtuese të Korporatës”, nenit 15 “Drejtori Ekzekutiv”, neni 16 “Kompetencat e Drejtorit Ekzekutiv”, sipas Ligjit 71/2019 “Për Korporatën e Investimeve Shqiptare” sipas neni 9, “Organet e Korporatës” dhe neni 23 deri 26 të Statutit të Shoqërisë “Korporata e Investimeve Shqiptare SHA” datë 15.07.2020. Që nga krijimi i statutit të shoqërisë deri në momentin e juridiksionit të auditimit kanë kryer rolin e Drejtorit Ekzekutiv 4 persona:

- 1-E. F., emëruar datë 17.07.2020 dhe larguar datë 20.09.2023;
- 2-L. G., emëruar datë 22.09.2020 dhe larguar datë 19.10.2023;
- 3-G. Sh., emëruar datë 22.09.2020 dhe larguar datë 19.10.2023;
- 4-E. K., emëruar datë 19.10.2023 dhe në vijim në detyrë.

III Asambleja e Përgjithshme ka kryer detyrat funksionale sipas nenit 10 “Asambleja e Përgjithshme” sipas Statutit të Shoqërisë “Për Korporatën e Investimeve Shqiptare” sipas Ligjit 71/2019, Ligji 9901 datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” i ndryshuar datë 15.07.2020 me aksionar të vetëm Ministrinë e Ekonomisë dhe Financave. Për periudhën nën juridiksion auditimi Asambleja e Përgjithshme ka kryer veprimtari sipas (tabelës nr. 2.2.2, Aneksi nr. 1).

IV. Në lidhje me Bordin Këshillimor konstatohet se janë kryer funksione sipas parashikimeve të nenit 17 të Ligjit nr.71/2019 “Për Korporatën e Investimeve Shqiptare” për periudhën objekt auditimi janë emëruar në detyrën e anëtarit të Bordit Këshillimor të shoqërisë Korporata e Investimeve Shqiptare SHA Tiranë:

- Znj. A. K., me detyrë zv./Ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë;
- Znj. A. P., me detyrë Sekretar i Përgjithshëm pranë Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit.

V. Në lidhje me Komitetet Statutore dhe Komitete Ad Hoc.

Me vendimin nr.3 datë 07.03.2024 Këshilli Mbikëqyrës i Korporatës së Investimeve Shqiptare (AIC) ka vendosur:

1-Krijimin e Komiteteve Statutore të cilat do të jenë përkatësisht Komiteti i Auditimit të Brendshëm, Komiteti i Përputhshmërisë Ligjore dhe Etikës, Komiteti i Investimeve si dhe Komitete Ad-Hoc përkatësisht Komiteti i Inovacionit, Komiteti i Fondeve, Komiteti Rregullator, Komiteti Antikorupsion të cilat do të ngrihen rast pas rasti dhe do të përbëhen nga zyrtarë të korporatës dhe anëtarë të Këshillit Mbikëqyrës. Me vendimin nr.11 prot AIC datë 28.06.2024 të Këshillit Mbikëqyrës të Korporatës së Investimeve Shqiptare është vendosur Miratimi i Rregullores për funksionimin e Komisionit të Eficencës së Përdorimit të Pronës KEPP. Përgjatë vitit 2024 janë mbledhur Komiteti Rregullator, Komiteti Antikorupsion dhe Komiteti për Partneritet në Zonat Ekonomike dhe Parqet Teknologjike sipas Vendimeve respektive.

Sa trajtuar më sipër në këtë pjesë të RPA-së, subjekti ka paraqitur observacione përmes shkresës nr.97/1 prot., datë 03.03.2025, protokolluar në KLSH me shkresën me nr.1096/6 prot., datë 03.03.2025, nga Drejtori Ekzekutiv i AIC-së znj. E. K., si vijon:

Në lidhje me Rekomandimet 9.1. dhe 9.2. të PRA-së, ju sqarojmë se aksionari i vetëm Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit me Vendimin nr.7, nr.15011/3 prot., datë 15.01.2025 “Mbi zgjatjen e afatit të kontratës së Huasë midisi Shoqërisë Korporata e Investimeve Shqiptare sh.a. dhe A. sh.a.” ka vendosur zgjatjen e afatit të kontratës së huasë edhe për një vit tjetër me të njëjtat kushte.

Qëndrimi i Grupit të Auditimit:

Në lidhje me observacionin e paraqitur nga AIC mbi Rekomandimet nr.9.1 dhe nr.9.2. të PRA-së, grupi i auditimit sqaron se nga trajtimi i observacionit nuk ka ndryshime apo dokumentacion shtesë, për rrjedhojë i qëndron rekomandimeve të PRA-së.

2.3 Mbi organizimin dhe mbajtjen e kontabilitetit, inventarët dhe veprimtaria e komitetit për auditimin financiar.

a. Organizimi dhe mbajtja e kontabilitetit.

Korporata e Investimeve Shqiptare është krijuar me anë të ligjit nr. 71/2019, datë 17.10.2019 “Për Korporatën e Investimeve Shqiptare”. Sipas pikës 1 të nenit 19, të këtij ligji përcaktohet se: “Korporata mban kontabilitetin e veprimtarisë së saj ekonomike në përputhje me ligjin për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” dhe sipas pikës 2 të nenit 19 përcaktohet se: “Drejtori ekzekutiv dhe Këshilli Mbikëqyrës përgatisin raportin e veprimtarisë, inventarët dhe llogaritë vjetore në përputhje me legjislacionin në fuqi për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare.”

Sipas statutit të shoqërisë të miratuar, më datë 15.07.2022, nga Aksionari themelues i vetëm, Minisria e Financave dhe Ekonomisë, AIC është shoqëri aksionare, me ofertë private.

Pika 1 e nenit 5 të Statutit të Kosportaës së Investimeve Shqipëtare, përcakton se: “Kapitali i nënshkruar dhe i paguar i Korporatës është 198,000,000 lek, i përbërë nga 100 aksione të zakonshme, me vlerë nominale 1,980,000 lekësh secili.”, ndërsa pika 2 e këtij neni përcakton se: “Në çastin e themelimit, kapitali është nënshkruar dhe është shlyer tërësisht, si më poshtë vijon:

- Shteti Shqiptar, i përfaqësuar nga Minsitria e Financave dhe Ekonomisë, ka kontribuar në para në kapitalin e Korporatës, me një shumë të barabartë për 198,000,000 lekësh.”

Statuti i Shoqërisë, në lidhje me pasqyrat financiare në pikën 1 të nenit 45, përcakton se: “...Audituesit ligjor emërohen për një periudhë tre vjeçare, pa të drejtë riemërimi për të paktën tre vite” dhe në pikën 3 përcaktohet se: “Asamblea e Përgjithshme emëron Auditues ligjor/ekspert kontabël të rregjistruar Shoqërinë “D. A. A.” SHPK.”.

Nga verifikimi i pasqyrave financiare u konstatua se kontabiliteti është mbajtur në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, i ndryshuar si dhe në zbatim të Standarteve Ndërkombëtare e Kombëtare të Kontabilitetit, të përmirësuara. Mbajtja e kontabilitetit të Korporatës së Investimeve Shqiptare bëhet në programin financiar AlphaWeb.

Auditimi në drejtim të mbajtjes së kontabilitetit dhe hartimit të pasqyrave financiare u përqendrua në vlerësimin e saktësisë dhe përputhshmërisë ligjore të veprimeve ekonomiko-financiare dhe të dokumentimit të transaksioneve financiare të realizuara gjatë periudhës objekt auditimi, si dhe në lidhje me zbatimin e parimeve të përgjithshme për përgatitjen e llogarive vjetore dhe mbajtjen e kontabilitetit.

Auditimi u krye në lidhje me dy drejtime: respektimi i afatit ligjor të përcaktuar për përgatitjen e pasqyrave financiare, raporteve të audituesit të pavarur dhe në vlerësimin e rregullshmërisë dhe saktësisë së paraqitjes së zërave në pasqyrën e pozicionit financiar për çdo vit, rregjistrimi dhe dokumentimi i veprimeve në ditarin e përgjithshëm (ku janë regjistruar dhe veprimet e bankës).

Nga auditimi i Pasqyrave Financiare të AIC, rezultoi se Drejtori i Financës së AIC², përgatit dhe nënshkruan bilancin vjetor, bilancin e konosliduar dhe raportin e përfomancës dhe Drejtori Ekzekutiv dhe Këshilli³ përgatisin raportin e veprimtarisë, inventarët dhe llogaritë vjetore në përputhje me legjislacionin në fuqi për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare. Nga Statuti i Korporatës **nuk janë të ndarë në mënyrë të saktë**, ku fillon dhe ku përfundon përgjegjësia e secilit prej këtyre aktorëve.

² Sipas pikës 3, të nenit 41 të “Statutit të Korporatës së Investimeve Shqiptare”

³ Sipas pikës 2, të nenit 48 të “Statutit të Korporatës së Investimeve Shqiptare”

Për vitin 2020, sipas deklaratës së hartuesit të pasqyrave financiare dhe Drejtorit Ekzekutiv (pjesë e pasqyrave financiare për vitin 2020) pasqyrat financiare janë hartuar nga A. A. Group, të cilët sipas kësaj deklarate kanë kryer shërbimet kontabilitetit, që përfshijnë regjistrimet e veprimeve kontabël dhe përgatitjen e bilancit vërtetues. Në statutin e Korporatës nuk parashikohet përfshirja e një palë të tretë për përgatitjen e pasqyrave financiare dhe nga verifikimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion, rezultoi se nuk ka asnjë dokumentacion në lidhje me marrëdhënien me subjektin “A. A. Group”, të tipit, kontratë shërbimi, faturë, pagese, vendim i përzgjedhjes së këtij subjekti për ofrimin e shërbimit të hartimit të pasqyrave financiare. Përfaqësuesi i “A. A. Group”, z. G. Sh., është propozuar për përgatitjen e pasqyrave financiare, në mbledhjen e Këshillit Mbikëqyrës, të datës 22.07.2021 nga anëtarja e Këshillit Mbikëqyrës znj. Dh., dhe është aprovuar nga anëtarët e tjerë të Këshillit. Statuti i Korporatës parashikon si persona përgjegjës për hartimin e pasqyrave financiare Drejtorin e Financës dhe Drejtorin Ekzekutiv. Për vitin 2020 në sistemin e tatimeve e-filling është deklaruar për herë të parë punonjësi i AIC me anë të formularit esig 027, në datë 27.04.2020 punonjësi z. E. F. me pozicion “Përfaqësues shërbimesh biznesi”, i cili sipas pikës 1 të nenit 26 të Statutit të Korporatës është Drejtori Ekzekutiv i parë dhe në datën 23.08.2021 është plotësuar formulari i deklaramit të punonjësve (esig 027) për dy hyrje konkretisht, z. G. Sh. dhe znj. H. Xh.

Pra personat përgjegjës për hartimin e pasqyrave financiare për vitin 2020, nuk kanë qenë të punësuar pranë AIC dhe nuk kanë pasur kontratë shërbimi. Në lidhje me shërbimin e hartimit të pasqyrave financiare nuk është lidhur asnjë kontratë dhe nuk është kryer as pagesë, për këtë shërbim, përfaqësuesi i shoqërisë që ka hartuar pasqyrat financiare Z. Sh. është punësuar pranë AIC rreth një muaj pas ofrimit të këtij shërbimi.

Pasqyrat financiare

Nga verifikimi i afateve të hartimit të pasqyrave financiare rezultoi se ato janë ngarkuar në sistemin efilling të tatimeve brenda datës 31.03.2021, pasi sistemi nuk ka gjeneruar kamatvonesa/gjoha për mos depozitim të pasqyrave financiare dhe deklarata 1100, “*Tatimi mbi fitimin për vitin 2020*”, sipas sistemit efilling rezultoi të jetë dorëzuar 2 herë konkretisht më datë 30.03.2021 dhe më datë 28.07.2021, ku është bërë ndryshimi i versionit të parë të deklaratës. Në lidhje me versionin e parë të pasqyrave financiare të depozituar në tatime brenda datës 31 mars 2021, nuk rezultojnë gjurmë në sistem, pasi para ngarkimit në sistem të vendimit të asamblesë mund të bëhen ndryshime në pasqyra. Në sistemin e tatimeve, pasqyrat financiare (versioni 2) dhe vendimi i Asamblesë janë depozituar më 28.07.2021. Pasqyrat financiare janë miratuar me vendimin e Asamblesë së Përgjithshme të Aksionarit nr. 62, datë 27.07.2021 “*Për miratimin e pasqyrave financiare të shoqërisë "Korporata e Investimeve Shqiptare" SHA*”, brenda afatit të përcaktuar në pikën 2 të nenit 33/1, të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, të ndryshuar, ku përcaktohet se: “*Shoqëritë tregtare sipas pikës 1 të këtij neni, duhet të depozitojnë pranë organeve tatimore, jo më vonë se data 31 korrik e vitit kalendarik, vendimin e organit përgjegjës*”.

Z. E. F., ka lidhur kontratën e shërbimit si drejtor ekzekutiv i Korporatës me Këshillin Mbikëqyrës, kjo në zbatim të pikës 1 të nenit 26, të Statutit të Korporatës. Kontrata rezultoi e protokolluar me nr. 08, datë 22.12.2021, **pra më vonë** se data e deklaramit në sistemin efilling.

Për vitin 2021, pasqyrat financiare rezultojnë të jenë depozituar pranë QKB më 02.08.2022, janë certifikuar më 29.06.2022 dhe janë miratuar me Vendimin e Asamblesë së Aksionarit nr. 81, datë 22.07.2022.

Për vitin 2022, pasqyrat financiare rezultojnë të jenë depozituar pranë QKB më 04.09.2023, **në tejkallim** të afatit të përcaktuar në pikën 1 të nenit 46, të ligjit nr. 9723, datë 03.05.2007, të ndryshuar, ku përcaktohet se: “*Subjektet, që kanë detyrimin e hartimit të dokumenteve, sipas shkronjës “a”, të pikës 3, të nenit 43, të këtij ligji, dhe që nuk i kanë depozituar më parë, në përputhje me afatin e parashikuar në pikën 5, të*

nenit 22, të këtij ligji, detyrohen në çdo rast t'i depozitojnë këto dokumente jo më vonë se 7 muaj nga data e mbylljes së çdo viti financiar.”

Pasqyrat janë certifikuar më 17.07.2023 nga D. Audit dhe janë miratuar me Vendimin e Asamblesë së Aksionarit nr. 56, datë 07.08.2023, ky vendim është në tejkalim të afatit kur pasqyrat financiare dhe vendimi i Asamblesë së Aksionarit duhet të ishte depozituar pranë tatimeve dhe QKB-së, veprime të cilat i kanë sjellë Korporatës penalitete për mos depozitim në afat, të pasqyrave financiare.

Për vitin 2023, pasqyrat financiare rezultojnë të jenë depozituar pranë QKB-së më 30.07.2024, janë certifikuar më 02.05.2024, protokolluar në AIC me nr. 88, datë 09.05.2024, nga “M.” dhe janë miratuar me Vendimin e Asamblesë së Aksionarit nr. 55, datë 30.07.2024.

Për vitet 2020-2023, në sitemin e tatimeve efilling janë ngarkuar dy versione të deklaratave të tatim fitimit dhe të pasqyrave financiare, njëri brenda 31 mars dhe tjetri më pas. Neni 29, i ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, të ndryshuar “*Tatimi mbi të ardhurat*” përcakton se: “*Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar nga Ministria e Financave. Tatimpaguesit ua paraqesin deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme organeve tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës duke paraqitur, në të njëjtën kohë, edhe bilancin kontabël, llogarinë e fitimeve dhe të humbjeve për periudhën përkatëse tatimore, si dhe anekset e llogarive vjetore*”. Edhe pse ndryshimet e deklaratave tatimore lejohen të kryhen brenda 36 muajve, rideklarimet e tyre nga versioni i parë, i miratuar nga Drejtori Ekzekutiv dhe Drejtori i Financës, rrisin mundësitë, që shoqëria të jetë e ekspozuar ndaj penalteteve dhe interesave siç përcaktohet në pikën 3, të nenit 67, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008, të ndryshuar “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, ku përcaktohet se . “*Dorëzimi i një deklarate tatimore të ndryshuar përfshin: a) pagesën e çdo detyrimi tatimor shtesë; b) kamatëvonesën për periudhën ndërmjet afatit të dorëzimit të deklaratës fillestare dhe datës së dorëzimit të deklaratës tatimore të ndryshuar; c) kërkesën e tatimpaguesit për kreditimin e tatimit të paguar më tepër plus interesat e llogaritura për këtë periudhë, duke e llogaritur këtë shumë për llogari të detyrimeve tatimore të tjera, ekzistuese apo të ardhshme; ç) kërkesën për rimbursimin e tatimit të paguar më tepër, plus interesat*.” Nga verifikimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion të grupit të auditimit, rezulton se nuk ka gjurmë mbi procesin e miratimit të versionit të parë të pasqyrave financiare që është depozituar brenda datës 31 mars, të vitit pasues.

Pasqyrat Financiare

Pasqyra e Pozicionit Financiar më 31.12.2020

Pasqyra e pozicionit financiar të Korporatës së Investimeve Shqiptare, më 31.12.2020 paraqitet si në tabelën nr. 1 të Aneksit nr. 3 të Raportit të Auditimit.

AKTIVET

Aktivitet afatgjata materiale (AAM)

Në Bilancin Kontabël të datës 31.12.2020 Korporata nuk disponon asnjë AAM.

Aktivitet afatshkurtra (AASH)

Mjete monetare dhe ekuivalentët e tyre

Në bilancin kontabël të datës 31.12.2020, aktivitet afatshkurtra, konkretisht zëri “Mjete Monetare dhe ekuivalentët e tyre”, që paraqet gjendjen e mjeteve monetare në llogarinë bankare, në datën e raportimit, rezulton në shumën 198,004,150 lekë, kjo shumë nuk përputhet me gjendjen e llogarisë bankare sipas statement bankar të datës 31.12.2020, sipas këtij të fundit gjendja e mjeteve monetare në llogari ka qenë 4,150 lekë. Shuma 198,000,000 lekë, ka kaluar në llogari të Korporatës më datë 22.01.2021, me 2 referenca konkretisht:

- Referenca 1...10, me përshkrim “*Ministria e Financave kalim fond. Ngurtës. Llogarin e Shoq. Korporata e invest. Shqiptare Urdhër nr. 174, datë 31.12.2020*”;

- Referenca 1...81: me përshkrim “Ministria e Financave kalim fond. Ngurtës. Llogarin e Shoq. Korporata e invest. Shqiptare Urdhër nr. 174, datë 16.07.2020, nr. 1361”.

Pra sa më sipër mjetet monetare të kaluara nga Minsitria e Financave, janë transferuar pas datës së bilacit, por duke qenë ekuivalent i mjeteve monetare janë paraqitur nën këtë zë.

Sipas shënimeve të pasqyrave financiare në mënyrë të detajuar kjo llogari paraqitet si më poshtë:

Tabela nr. 2:“Paraqitja e llogarisë analitike të “Mjete moinetare dhe ekuivalentët e tyre”, sipas shënimeve shpjeguese”

Në lekë

Nr.	Përshkrimi	31 dhjetor 2020	31 dhjetor 2019
I	Llogari rrjedhëse	4,150	
i	Në lekë	4,150	
ii	Në monedhë të huaj		
II	Arka	-	
i	Në lekë		
ii	Në monedhë të huaj		
III	Vlera monetare në llogari të ndërmjetme	198,000,000	
IV	Totali (I +II+III)	198,004,150	

Burimi: Pasqyrat Financiare të AIC për vitin 2020, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH.

Për të verifikuar saktësinë dhe plotësinë e paraqitjes së këtij zëri nga grupi i auditimit u bë kryqëzimi i kësaj pasqyre me pasqyrën e mjeteve monetare, nga ku rezultoi se më 31.12.2020 zëri “Mjete monetare dhe ekuivalentët e tyre” paraqitet në shumën 198,004,150 lekë, nga ku 198,000,000 lekë si fluks monetar nga aktiviteti investues dhe 4,150 lekë nga veprimtaritë e shfrytëzimit.

Korporata e Investimeve Shqiptare nuk disponon aktive të tjera më 31.12.2020.

DETYRIMET

Në bilancin kontabël të datës 31.12.2020, paraqitet vetëm një zë detyrimesh konkretisht “detyrime të tjera afatshkurtra”, në shumën 10,000 lekë, të cilat sipas shënimit 13 paraqet detyrime të tjera, pa paraqitur detaje të tjera.

Nga grupi i auditimit pas verifikimit të nxjerrjes së llogarisë për vitin ushtrimor 2020, u konstata se shuma 10,000 lekë paraqet një depozitim të shumën 10,000 lekë nga z. E. F. më datë 10.12.2020 me përshkrimin “E. F. derdhje në llogari”. Nga auditimi rezultoi se z. F. sipas statutit të shoqërisë është Drejtor Ekzekutiv, por që për periudhën kur ka bërë depozitimin e shumës monetare në favor të Korporatës së Investimeve Shqiptare nuk ka pasur kontratë shërbimi/punësimi me Korporatën dhe nuk është argumentuar përse është bërë ky kalim i shumës dhe ku është bazuar.

KAPITALI

Kapitali i Aksioner i AIC më 31.12.2020 paraqitet në shumën 198,000,000 lekë, shumë e cila është në përputhje me përcaktimet e pikës 1 të nenit 5 të Statutit të AIC, ku përcaktohet se: “Kapitali i nënshkruar dhe i paguar i Korporatës është 198,000,000 lekë, përbërë nga 100 aksione të zakonshme (AZ) në shumën 1,980,000 lekë” ndërsa totali i seksionit të kapitalit, në bilancin kontabël më 31.12.2020, paraqitet në shumën 197,994,150 lekë pas reduktimit me humbjen ushtrimore në shumën 5,850 lekë. Në shënimin shpjegues 15, të pasqyrave financiarë për vitin 2020 të paraqitura nga AIC, citohet se: “Kapitali i paguar i Shoqërisë që më 6 Dhjetor 2005 është 198,000,000 lekë i cili përbëhet nga 100 aksione me vlerë nominale 198,000,000 lekë për aksion”. **Ky shënim paraqet lapus në datë dhe në vlerën nominale/aksion të zakonshëm, pasi vlera nomiale duhet të ishte 1,980,000 lekë/AZ.**

Pasqyra e performancës

Në pasqyrën e përfomancës ku paraqiten zërat e të ardhurave dhe shpenzimeve, rezulton vetëm një zë, konkretisht zëri “shpenzime financiare” në shumën 5,850 lekë, shumë e cila sipas shënimit 23 të pasqyrave financiare përfaqësojnë shpenzime për komisione bankare, të cilat janë konfirmuar nga grupi i auditimit dhe nëpërmjet statement bankar.

Raporti i Audituesit të Pavarur

Për vitin ushtrimor të mbyllur më 31.12.2020 rezulton se pasqyrat financiare nuk janë certifikuar nga auditues të pavarur.

Viti 2021

Nga verifikimi i veprimtarisë ekonomike rezultoi se AIC ka deklaruar paga të punonjësve për herë të parë në muajin gusht 2021, pasi nga data e themelimit, 15.07.2020 dhe e regjistrimit në QKB, 17.07.2020 ka pasur të regjistruar dhe deklaruar në sigurime vetëm Drejtorin Ekzekutiv, por formularët esig 025 janë dorëzuar si “pa aktivitet”.

Në lidhje me pasqyrat financiare të vitit ushtrimor 2021, për sa i përket afateve të përgatitjes rezulton se pasqyrat financiare janë depozituar në tatime në sistemin efilling brenda datës 31.03.2024, në përputhje me legjislacionin në fuqi por nuk mund të sigurohet informacion mbi versionin e dërguar, pasi në sistem figuron vetëm versioni, i përditësuar i tyre më 22.07.2022, datë në të cilën është bërë dhe depozitimi i vendimit të Asamblesë së Aksionerëve mbi pasqyrat financiare. Për verifikimin e afatit të depozitimit të pasqyrave financiare në tatime, nga grupi i auditimit u bë dhe verifikimi i datës së dorëzimit të deklaratës së tatim fitimit (Deklarata 1100), ku rezultoi se janë dy data të dorëzimit të kësaj deklarate, konkretisht data 22.03.2022 dhe data 22.07.2022.

Pasqyra e Pozicionit financiar më 31.12.2021

Pasqyra e pozicionit financiar, për vitin e mbyllur më 31.12.2021, për Korporatën paraqitet si tabelën nr. 3 të Aneksit nr. 3, të Raportit të Auditimit.

AKTIVET

Aktivet afatgjata materiale (AAM)

Në Bilancin Kontabël të datës 31.12.2021, aktivet afatgjata materiale paraqiten në shumën 34,575 lekë, në shënimet shpjeguese mungon informacion mbi llojin e tyre, por nga verifikimi i regjistrit të aktiveve të qëndrueshme, rezultoi se kjo shumë përfaqëson një “Printer Brother”, të blerë më datë 07.12.2021 në shumën 34,575 lekë. Ky AAM nuk është amortizuar për periudhën 07.12-31.12.2021, por në pasqyrat financiare është paraqitur me koston historike, kjo për shkak të vlerës jo materiale të amorizimit vjetor 2021.⁴

Aktivet afatshkurtra (AASH)

Sipas paragrafit 57 të IAS 1, klasifikohen si Aktive Afatshkurtra nëse plotësohet njëri nga kriteret vijuese: “(a) pritet që të realizohet ose mbahet për shitje ose konsum brenda ciklit normal të shfrytëzimit të njësisë ekonomike; (b) mbahet kryesisht për qëllime tregtimi; (c) pritet që të realizohet brenda dymbëdhjetë muajve pas datës së bilancit; ose (d) Është në formën e mjeteve monetare ose një ekuivalenti të mjeteve monetare me përjashtim të rastit kur ai kufizohet për t’u përdorur për këmbim ose për shlyerjen e një detyrimi për të paktën dymbëdhjetë muaj pas datës së bilancit.”

Në rastin e AIC, aktivet afatshkurtra paraqiten si më poshtë:

- Zëri “**Llogari të arkëtueshme dhe të tjera të arkëtueshme**” në shumën 6,915 lekë, në shënimet shpjeguese me referencë 20, nuk paraqet informacion. Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion

⁴ Vlera e llogaritit e amortizimit për 2021, sipas llogaritjeve të grupit të auditimit është rreth 552 lekë.

të grupit të auditimit, rezultoi se kjo shumë lidhet me gjendjen e TVSH-së kreditore, si rezultat i blerjes së AAM në shumën 34,575 lekë.⁵

- Zëri “**Mjete monetare dhe ekuivalentët e mjeteve monetare**” paraqitet në fund të vitit 2021 në shumën 2,179,282,260 lekë dhe krahasuar me një vit më parë është rritur me 1,981,277,860 lekë. Kjo shumë paraqet vetëm mjetet monetare të Korportaës në llogari bankare dhe shuma përkatëse përputhet dhe me gjendjen e llogarisë më 31.12.2021, sipas statement bankar të llogarisë rrjedhëse pranë R. Bank, në valutën lekë.

Sqarim 1: Teprica e çeljes për këtë zë nuk rakordon me tepricën përfundimtare, të paraqitur në vitin 2020, për shkak se në riparaqitjen e tepricave fillestare, nga divizioni i finacës komisioni bankar në shumën 250 lekë, i datës 31.12.2020 është llogaritur si shpenzim i vitit 2021, për shkak se datë valuta e këtij komisioni është 01.01.2021, por në fakt duhet të ishte shpenzim i vitit 2020, pasi sipas IAS 1, paragrafi 25 përcaktohet se: “Një njësi ekonomike duhet të përgatisë pasqyrat e saj financiare, me përjashtim të informacionit lidhur me fluksin monetar, duke përdorur **kontabilitetin mbi bazën e të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara.**”

KAPITALI

Ky seksion i bilancit kontabël më 31.12.2021 përbëhet nga zërat si më poshtë:

- “Kapitali aksionar” në shumën 2,198,000,000 lekë, ku krahasuar me vitin 2020 është rritur me 2,000,000,000 lekë, si rezultat i rritjes së kapitalit nga aksioneri i vetëm, Ministria e Financave. Sipas shënimit me referencë 9, të pasqyrave financiare, kapitali i Korporataës paraqitet si më poshtë:

Tabela nr. 4: “Kapitali aksioner i emëtuar më 2021 krahasuar me 2020”

Në lekë

Përshkrimi	2021			2020		
	Nr. Aks.	Vl. Nom.	Totali i Kap aks.	Nr. Aks.	Vl. Nom.	Totali i Kap aks.
Gjendje më, 01.01.2021	100,000	198,000	198,000			
Kontribute nga aksionari		2,000,000	2,000,000	100,000	198,000	198,000
Gjendje më 31.12.2021	100,000	2,198,000	2,198,000	100,000	198,000	198,000

Burimi: Pasqyrat Financiare të AIC për vitin 2021.

Nga tabela më sipër rezulton se në shënimet shpjeguese, informacioni **nuk rezulton i paraqitur saktë** pasi numri i aksioneve të Korporatës është 100 AZ me vlerë nominale 1,980,000 lekë/AZ sipas pikës 5/1 të Statutit të saj dhe shtimi i kapitalit nga Aksioneri i vetëm, duke qenë se nuk ka emëtuar aksione të reja do të konsiderohet si shtim kapitali, me efekt rritjen e vlerës nominale për aksion të zakonshëm, konkretisht nga 1,980,000 lekë në 21,980,000 lekë.

Gjatë vitit 2021, kontributi i aksionerit të vetëm, Ministria e Financave është bërë me anë të Vendimit të Asamblesë së Përgjithshme të aksionarëve nr. 98, datë 22.12.2021, protokolluar me nr. 23022, datë 22.12.2022, ky vendim është rregjitruar dhe pranë QKB, më datë 24.12.2021.

- Zëri “**Humbje e akumuluar**” paraqitet 5,600 lekë, dhe paraqet rezultatin financiar të vitit 2020, diferenca me humbjen nga pasqyrat e vitit 2020 vjen për shkak të sqarimit 1 të bërë në këtë ç-raport.
- Zëri “**Humbje e vitit**” paraqitet në shumën 19,465,336 lekë, shumë e cila është e njëjtë me rezultatin financiar të paraqitur në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve gjithëpërfshirëse.

Nga kryqëzimi i të dhënave të këtij seksioni, me të dhënat në pasqyrën e ndryshimeve në kapital, rezultoi se vlerat paraqesin në mënyrë të njëjtë totalin e kapitalit më 31.12.2021.

⁵ TVSH e arkëtueshme nga blerja e AAM= 34,575*20%=6,915 lekë.

DETYRIMET

Korporata, më 31.12.2021 disponon vetëm detyrime afatshkurtra, konkretisht llogarinë “Të tjera të pagueshme” në shumën 794,686 lekë, e cila përfaqëson detyrimet ndaj sigurimeve shoqërore, shëndetësore, tatimin mbi të ardhurat personale dhe tatimin e mbajtur në burim, për muajin dhjetor 2021. Për verifikimin e saktësisë së paraqitjes së kësaj llogarie, nga grupi i auditimit u bë rakordimi me formularin esig 025 (listëpagesa) dhe me deklaratën e tatimit të mbajtur në burim mbi të ardhurat, për periudhën dhjetor 2021. Nga verifikimi rezultoi se shuma totale, paraqitet në mënyrë të detajuar si më poshtë:

Tabela nr. 5: “Paraqitje e detajuar e llogarisë “Të tjera të pagueshme” më 31.12.2021”

Në lekë

NR.	Përshkrimi	Shuma
I	Totali i pagave bruto	1,547,344
I.I	Paga bruto për efekt të kontributeve	939,835
II	Sigurime shoqërore	230,262
	Punëdhënës	140,976
	Punëmarrës	89,286
III	Sig. Shëndetësore	52,610
	Punëdhënës	26,305
	Punëmarrës	26,305
IV	TAP	220,093
V	Tatimi në Burim	291,721
VI	Totali detyrimeve ndaj Tatimeve (II+III+IV+V)	794,686

Burimi: Deklaratat në sistemin efilling, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH.

Sa më sipër rezulton së kjo shumë është paraqitur në mënyrë të saktë dhe të drejtë.

PASQYRA E TË ARDHURAVE GJITHËPËRFSHIRËSE

Pasqyra e të ardhurave gjithëpërfshirëse për vitin 2021 paraqitet si më poshtë:

Tabela nr. 6 : “Pasqyra e të ardhurave gjithëpërfshirëse për vitin 2021”

Në lekë

Përshkrimi	31 Dhjetor 2021	31 Dhjetor 2020
Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit	-	-
Të ardhura të tjera	-	-
Total të ardhura	-	-
Shpenzime për shërbime	(8,997,645)	-
Shpenzime personeli	(7,449,406)	-
Shpenzime të tjera të shfrytëzimit	(3,018,285)	(5,600)
Total shpenzime	(19,465,336)	(5,600)
(Shpenzimet)/të ardhurat financiare, neto		
(Humbja)/fitimi nga përkthimi në monedhë të huaj, neto	-	-
Humbja financiare, neto	-	-
Humbja para tatimit dhe Amortizimit	(19,465,336)	(5,600)
Amortizimi i Aktive Afatgjata Materiale	-	-
Amortizimi i aktiveve jo materiale	-	-
Humbja para tatimit	(19,465,336)	(5,600)
Tatimi mbi fitimin	-	-
Fitimi/(humbja) e vitit	(19,465,336)	(5,600)
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse	-	-
Totali i te ardhurave gjithëpërfshirëse/(humbjes) për vitin	(19,465,336)	(5,600)

Burimi: Pasqyrat Financiare të AIC për vitin 2021.

Për vitin ushtrimor 2021 Korporata e Investimeve Shqiptare nuk ka realizuar të ardhura, por vetëm shpenzime, konkretisht në tre kategori:

- ◆ Shpenzime për shërbime në shumën 8,997,645 lekë;

- ◆ Shpenzime personeli në shumën 7,449,406 ⁶lekë dhe
- ◆ Shpenzime të tjera të shfrytëzimit në shumën 3,018,285 ⁷lekë.

Shpenzimet për shërbime dhe shpenzime të tjera të shfrytëzimit në mënyrë analitike paraqiten si në tabelën më poshtë:

Tabela nr. 7: “Paraqitja në mënyrë analitike e shpenzime të tjera për vitin 2021”

Në lekë

Shpenzime Personeli:	7,449,406	Shpenzime të tjera shfrytëzimi	3,018,285
Paga	6,833,323	Taksa vendore	186,010
Sigurime shoq. & shënd.	616,083	Shpenzime të tjera korrente	158,984
		Shp admin mirëmb etj.	500,027
		Konsulenca	500,000
		Udhëtime & akomodime	1,602,967
		Komisione bankare	70,297

Burimi: AIC, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH.

Nga kryqëzimi i të dhënave me pasqyrën e pozicionit financiar, konkretisht në seksionin e kapitalit shuma e humbjes ushtrimore, përputhet me rezultatin e pasqyrës së të ardhurave gjithë përfshirëse.

Kapitali i transferuar, në favor të Korporatës, nga buxheti i shtetit në shumën 198,000,000 lekë, ka kaluar në llogarinë e saj bankare më datë 22.01.2021. Nga Korporata, për vitin 2021, nuk është bërë përpjekje për të përdorur këtë kapital me efektivitet, por fondet kanë qëndruar në llogari pa gjeneruar të ardhura nga interesi. Grupi i auditimit, për të vlerësuar të ardhurat e mundshme nga normat e interesit i është referuar normës mesatare të interesit afatshkurtër (6 muaj-1 vit) të instrumenteve shtetërore të borxhit, të cilat janë pa risk. Bazuar në të dhënat zyrtare të publikuara nga *Banka e Shqipërisë*, konkretisht në Website në rubrikën: “*Agregate/Statistika Monetare dhe Financiare/Statistika Monetare/Normat e Interesit*”, ⁸ grupi i auditimit ka bërë përllogaritjet, sipas supozimeve më poshtë:

- Nuk është investuar i tërë kapitali, për të mos pasur ndonjë kufizim për shkak të mungesës së likuiditetit, është përdorur për llogaritje shuma e mundshme për t’u investuar 150,000,000 lekë, dhe pjesën tjetër të mjeteve monetare Korporata do ta kishte pasur të lirë;
- Në përllogaritje është përdorur norma mesatare e ponderuar për Bonot e Thesarit 12 mujore, për vitin 2021 e cila sipas të dhënave të Bankës së Shqipërisë rezulton në masën 2%.

Nga përllogaritjet rezulton se shuma e mundshme, që mund të ishte gjeneruar nga interesat do të ishte 1,629,961 lekë.

PASQYRA E MJETEVE MONETARE (CASH FLOW)

Lëvizja e mjeteve monetare për vitin ushtrimor 2021 paraqitet si në tabelën nr. 8, të Aneksit nr. 3, të këtij Ç-Raporti.

Nga kryqëzimi i të dhënave të kësaj pasqyre me pasqyrat e tjera dhe nga verifikimi i klasifikimit të flukseve të mjeteve monetare sipas aktiviteteve (aktivitete: të shfrytëzimit, investuese dhe financuese) rezultoi se kjo pasqyrë është paraqitur në mënyrë të saktë.

Viti 2022

Pasqyra e Pozicionit financiar më 31.12.2022

Pasqyra e pozicionit financiar, për vitin e mbyllur më 31.12.2022, për Korporatën paraqitet si në tabelën nr. 9, të aneksit nr. 3, të këtij ç-raporti.

⁶ E detajuar në kolonën 2 të tabelës “Paraqitja në mënyrë analitike e shpenzime të tjera për vitin 2021”.

⁷ E detajuar në kolonën 4 të tabelës “Paraqitja në mënyrë analitike e shpenzime të tjera për vitin 2021”.

⁸ Konkretisht referuar: “2. Metodologjia: Normat e interesit të titujve shtetërorë sipas afatit të maturimit. Periodiciteti mujor”.

AKTIVET

Aktivitet afatgjata materiale

Aktivitet afatgjata materiale për vitin 2022 paraqiten në shumën 4,911,460 lekë dhe krahasuar me një vit më parë janë rritur me 4,876,885 lekë.

Në mënyrë të detajuar ndryshimet e aktiveve afatgjata materiale paraqiten si në tabelën më poshtë:

Tabela nr. 10: “Ndryshimet në AAM përgjatë vitit 2022”

	Gjendja	Shtesa	Pakësime	Gjendje më	Amortiz. Akum	Vl. mbetur	Amortizimi vjetor	Vlera e mbetur
	01.01.22	Gjatë vitit 2022		01.01.2022	Deri në 01.01.22	01.01.2022	2022	31.12.2022
Shuma	34,575	5,444,200	-	5,478,775	-	5,478,775	567,316	4,911,459

Burimi: AIC, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH.

Nga tabela më sipër rezulton se AAM për vitin 2022 janë shtuar me 5,444,200 lekë.

Nga grupi i auditimit u verifikua saktësia e paraqitjes së AAM në pasqyrën e pozicionit financiar më 31.12.2022, nga ku rezultoi se normat e amortizimit vjetor janë aplikuar saktë dhe është përdorur metoda e amortizimit linear, periudha e amortizimit ka nisur kur aktivet kanë qenë të gatshme për përdorim.

Llogaria “Ndërtesa - Të drejta përdorimi” në shumën 13,857,580 lekë, përaqëson aktivet më të drejtë përdorimi, që diponon shoqëria më 31.12.2022, të njohura sipas SNRF 16 “Qiratë”

Kontrata e qirasë me nr. repertori 1615 dhe nr. koleksioni 233, datë 29.10.2021 ka si objekt ambientet e marra me qira për zyra nga ana e Korporatës, për një periudhë 3 vjeçare. Sipas paragrafit 26 të SNRF 16 përcaktohet se: “Në datën e fillimit qiramarrësi do ta masë detyrimin e qirasë me vlerën aktuale të, pagesave të qirasë të cilat nuk janë paguar ende në atë datë. Pagesat e qirasë do të skontohen duke përdorur normën e interesit të përcaktuar të qirasë, nëse kjo normë mund të përcaktohet lehtë. Nëse kjo normë nuk mund të përcaktohet lehtë qiramarrësi do të përdorë normën rritëse të huamarrjes të qiramarrësit.” nga dokumentacioni i vënë në dispozicion të grupit të auditimit rezultoi, se pavarësisht se kontrata daton më 29.10.2024, data efektive e saj është data e marrjes në dorëzim, pra datë 05.01.2022, e cila vërtetohet me procesverbalin e marrjes në dorëzim mes përfaqësuesve të AIC dhe të qiradhënësit. Në lidhje me saktësinë e paraqitjes së kësaj shume, nga grupi i auditimit u bënë verifikimet përkatëse dhe rezultoi se, njohja fillestare dhe llogaritja e amortizimit mbi të është bërë në mënyrë të saktë.

Në lidhje me dhënien e shënimeve shpjeguese, rezultoi se Korporata **nuk ka dhënë shënime** shpjeguese në përputhje me kërkesat e paragrafit C12 të SNRF 12, ku kërkohet: “Nëse qiramarrësi zgjedh të zbatojë këtë Standard në përputhje me paragrafin, qiramarrësi duhet të japë informacionet shpjeguese rreth zbatimit fillestar të kërkuara nga paragrafi 28 i me përjashtim të informacionit të specifikuar në paragrafin 28(f). Në vend të informacionit të specifikuar në paragrafin 28(f), qiramarrësi duhet të japë informacion shpjegues: (a) për mesataren e ponderuar të normës rritëse të huamarrjes të qiramarrësit të zbatuar ndaj detyrimeve të qirasë të njohura në pasqyrën e pozicionit financiar në datën e zbatimit fillestar; dhe (b) për diferencën mes: (i) angazhimeve të qirasë së zakonshme të paraqitur në zbatim të SNK 17, në fund të periudhës vjetore të raportimit që paraprin menjëherë datën e zbatimit për herë të parë, të skontuara duke përdorur normën rritëse të huamarrjes në datën e zbatimit fillestar siç përshkruhet në paragrafin C8(a); dhe (ii) detyrimeve të qirasë të njohura në pasqyrën e pozicionit financiar në datën e zbatimit për herë të parë.”

Aktivitet Afatshkurtra

Llogaria “Llogari të arkëtueshme dhe të tjera të arkëtueshme” në fund të vitit 2022 paraqitet në shumën 2,121,095,755 lekë dhe paraqet të drejta për TVSH e arkëtueshme në lidhje me blerjet e bëra në shumën 1,095,755 lekë (6,915 lekë nga blerjet e vitit 2021 dhe 1,088,840 lekë nga blerjet (shtesat e AQT) për vitin 2022, kurse pjesa tjetër në shumën 2,120,000,000 lekë sipas shënimit më referencë 8 tek shënimet shpjeguese përfaqëson: “...të arkëtueshmet nga palët e lidhura në shumën 2,120,000 mijë lekë” lidhet me

zvogëlimin e kapitalit sipas vendimit të dtës 28.12.2022, kjo shumë është arkëtuar nga shoqëria më janar 2023”.

Nga verifikimi i ekstraktit historik të shoqërisë rezulton se më datë 28.12.2022 rezultojnë dy vendime të Asamblesë së përgjithshme të Aksionarëve, të depozituara në QKB, konkretisht:

1. Vendimi nr. 112/1, datë 28.12.2022, protokolluar në Ministrinë e Financave me nr. 23965/1, kurse në AIC me nr. 38/1, datë 28.12.2022, ku sipas së cilit është vendosur zmadhimi i kapitalit të shoqërisë për vlerën 2,000,000,000 lekë kaluar me aktin normativ nr.17, datë 01.12.2022.
2. Vendimi nr. 113/1, datë 28.12.2022, protokolluar në Ministrinë e Financave me nr. 23966/1, kurse në AIC me nr. 39/1, datë 28.12.2022, ku sipas së cilit është vendosur zmadhimi i kapitalit të shoqërisë për vlerën 120,000,000 lekë.

Nga informacioni i vënë në dispozicion të grupit të auditimit në këtë datë ka dhe një vendim të asamblesë së përgjithshme të ortakëve, konkretisht Vendimi nr. 112, datë 28.12.2022 “Për zvogëlimin e kapitalit të shoqërisë “Korporata e investimeve shqiptare” SHA”, protokolluar në Ministrinë e Financave me nr. 23965, kurse në AIC me nr. 38, datë 28.12.2022 sipas së cilit është vendosur zvogëlimi i kapitalit themeltar për vlerën 2,000,000 lekë, kaluar me AN nr.17, datë 01.12.2022.

Nga sa më sipër për sa kohë kapitali nuk është kaluar në llogari të Korporatës, shuma 2,120,000,000 lekë është paraqitur në mënyrë të satë si e arkëtueshme nga palët e lidhura pasi pritet të arkëtohet për një periudhë të shkurtër kohore.

KAPITALI

Kapitali i Korporatës më 31.12.2022 paraqitet në shumën 2,318,000,000 lekë, krahasuar me një vit më parë kapitali është rritur në shumën 120,000,000 lekë, si rezultat i rritjes neto, prej ndryshimeve të bëra në kapital nëpërmjet vendimeve të datës 28.12.2022. Sipas pasqyrës së shënimeve shpjeguese, referenca 10 “Kapitali Aksionar ” rezulton se, më 31.12.2022 shoqëria disponon 100 aksione.

Në mënyrë të detajuar ndryshimet e ndodhura përgjatë vitit 2022 me kapitalin aksione paraqiten si në tabelën më poshtë:

Tabela nr. 11: “Lëvizjet e llogarisë kapital aksionar për vitin 2022”

Përshkrimi	nr. I aksioneve	Vlera nominale
Kapitali aksionar më 01.01.2022	100	2,198,000,000
Vendimi asamblesë nr.98, datë 22.12.2021		200,000,000
Vendimi nr. 112, datë 28.12.2022		- 2,000,000,000
Vendimi nr.112/1, datë 28.12.2022		2,000,000,000
Vendim nr. 113, datë 28.12.2022		- 200,000,000
vendimi nr. 113/1, datë 28.12.202		120,000,000
Kapitali më 31.12.2022 I paguar plotësisht	100	2,318,000,000

Burimi: Pasqyrat Financiare të AIC për vitin 2022.

Detyrimet

Në bilancin kontabël të datës 31.12.2022 paraqiten detyrime në shumën 2,011,903 mijë lekë, të cilat përfaqësojnë:

- “Llogari të pagueshme ndaj aksionarit”, në shumën 2,000,000 lekë, që përfaqëson detyrimin për të zvogëluar kapitalin në zbatim të vendimeve të asamblesë së përgjithshme të aksionarëve të datës 28.12.2022;
- Detyrime në lidhje me qiranë në shumën 10,672 mijë lekë;
- Llogari të tjera të pagueshme në shumën 1,106 mijë lekë përfaqëson detyrime ndaj organeve tatimore, në lidhje me kontributet e detyrimeve shoqërore dhe shëndetësore, tatimin mbi të ardhurat nga punësimi dhe tatimin në burim, të cilat janë konfirmuar dhe nga deklaratat që rezultojnë në sistemin efilling. Në mënyrë të detajuar kjo llogari paraqitet në tabelën nr. 12, të aneksit nr. 3 të këtij ç-raporti.

PASQYRA E TË ARDHURAVE GJITHËPËRFSHIRËSE

Pasqyra e të ardhurave gjithëpërfshirëse për vitin 2022 paraqitet si në tabelën nr. 13, të aneksit nr. 3, të këtij ç raporti.

Për vitin 2022, Korporata ka rezultuar me humbje në shumën 69,051,321 lekë.

- ◆ Të ardhurat janë vetëm nga interesat bankare, në shumën 4,488,058 lekë.
- ◆ Ndërsa shpenzimet paraqiten si më poshtë:
 - Shpenzime për Këshillin Mbikqyrës dhe Bordin Këshillimor, në shumën 20,257,693 lekë;
 - Shpenzime personeli në shumën 33,817,489 lekë, ku përfshihen shpenzimet e paraqitura në mënyrë të detajuar si mëposhtë:

Tabela nr. 14: “Nënzërat e shpenzimeve të personelit për vitin 2022”

Përshkrimi	Shuma në lekë
Paga	29,821,977
Sigurime shoqërore dhe shëndetësore	3,433,510
Trajnime	87,000
Sigurime	475,002

Burimi: AIC, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH.

- Zëri “Shpenzime të tjera shfrytëzimi” paraqitet në shumën 12,167,266 lekë dhe në mënyrë të detajuar paraqitet si në tabelën më poshtë:

Tabela nr. 15: “Nënzërat e shpenzimeve të tjera të shfrytëzimit për vitin 2022”

Përshkrimi	Shuma në lekë
Qira	4,312,789
Udhëtime dhe akomodime	137,143
Komisione bankare	3,431,654
Konsulencë e jashtme	1,875,089
Tarifa për shërbime auditimi, etj.	1,111,724
Shpenzime për licenca dhe Programe IT	1,298,867
Totali	12,167,266

Burimi: AIC, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH.

- Zëri “Humbja/fitimi nga përkthimi në monedhë të huaj, neto” paraqitet në shumën 681,041 lekë dhe është diferenca neto e të ardhurave minus humbjet nga përkthimi i elementëve të pasqyrave fianciare në monedhë të huaj, me kursin e datës së fundit të vitit.
- Zëri shpenzime amortizimi paraqitet në shumën 7,496,106 lekë, nga të cilat shuma 567,316 lekë i përket amortizimit të AAM dhe diferenca është amortizimi i bërë ambienteve me qira, në zbatim të SNRF 16.

Rezultati finnciar i Korporatës për vitin 2022 është humbje, në shumën 69,051,322 lekë, shumë e cila është paraqitur po kaq dhe në pasqyrën e pozicionit fiannciar të mbylur më 31.12.2022.

Pasqyra e mjeteve monetare (Cash Flow)

Pasqyra e mjeteve monetare paraqet si kanë ndryshuar mjetet monetare dhe ekuivalentët e saj, përgjatë periudhës kontabël, për vitin 2022 ajo paraqitet si në tabelën nr. 26, të aneksit nr. 3, të këtij ç raporti.

Nga verifikimi i bërë pasqyrës së ndryshimit të mjeteve monetare, rezulton se ajo është paraqitur në mënyrë të saktë, mjetet monetare dhe ekuivalentët e tyre më 31.12.2022, rakordojnë me ato të paraqitura në po të njëjtin zë, të pasqyrës së pozicionit financiar më 31.12.2022.

Pasqyra e kapitalit

Pasqyra e kapitalit ka paraqitur në mënyrë të saktë ndryshimet, që ka pësuar kapitali nga fillimi i periudhës deri më 31.12.2022, rezulton se janë paraqitur efektet e të katër vendimeve të asamblesë së përgjithsme të aksionerëve në lidhje me kapitalin. Në mënyrë të detajuar kjo pasqyrë paraqitet në tabelën nr. 17, të aneksit nr. 3, të këtij ç raporti.

Viti 2023

Pasqyra e Pozicionit financiar më 31.12.2023

Pasqyra e pozicionit financiar, për vitin e mbyllur më 31.12.2023, për Korporatën paraqitet si në tabelën nr. 18, të aneksit nr. 3 të këtij ç raporti.

AKTIVET

Aktivet afatgjata materiale

- Llogaria “Aktive afatgjata materiale” për vitin ushtrimor, të mbyllur më 31.12.2023 paraqitet në shumën 7,376,591 lekë dhe krahasuar me një vit më parë është rritur me 2,465,131 lekë.

Në mënyrë të detajuar ndryshimet e aktiveve afatgjata materiale paraqiten si në tabelën më poshtë:

Tabela nr. 19: “Ndryshimet në AAM përgjatë vitit 2023”

Në lekë

	Gjendja	Shtesa	Pakësime	Gjendje më	Amort. akum.	VI. mbetur	Amortizimi vjetor	Am.akum	VI. mbetur
	01.01.22	Gjatë vitit 2023		01.01.2023	Deri në 01.01.2023	01.01.23	2023	31.12.23	31.12.23
Shuma	5,478,775	4,064,874	-	9,543,649	567,316	4,911,459	1,599,743	7,376,590	2,167,060

Burimi: AIC, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH.

Nga tabela më sipër rezulton se shtesat në AAM për vitin 2023 janë në shumën 4,064,874 lekë, nga të cilat 476,874 janë për paisje zyre dhe paisje kompjuterike ndërsa shumë 3,588,000 lekë blerja e një automjeti. Nga verifikimi i aplikimit të normave të amortizimit dhe saktësisë së llogaritjes rezultoi se janë aplikuar normat e duhura të amortizimit dhe llogaritjet janë të sakta.

- Llogaria “Ndërtesa - Të drejta përdorimi” paraqet aktivin me të drejtë përdorimi (ambienti marrë me qira për zyra) në shumën 7,884,698 lekë, llogaritje të cilat janë bërë në zbatim të SNRF 16, duke konsideruar normën e interesit 2.76%.

Aktivet Afatshkurtra

- Llogaria “Hua afatshkurtër e arkëtueshme” paraqet huanë e dhënë kompanisë A. SHA në shumën 2,000,000,000 lekë ndërsa shuma 5,095,890 paraqet interesin e arkëtueshëm ndaj kësaj huaje, si rezultat i kryerjes së veprimeve rregulluese në lidhje me interesin në masën 3%, kjo në zbatim pikës 4.2 të nenit 4 të kontratës të protokolluar në Korporatë më nr. 97, datë 24.11.2023 dhe në A. SHA me nr. 2570, datë 24.11.2023.
- Llogaria “Llogari të arkëtueshme dhe të tjera të arkëtueshme” paraqitet në shumën 1,697,721 lekë dhe krahasuar me një vit më parë kjo shumë është zvogëluar me 2,119,398,034 lekë, ku prej të cilave 2,120,000,000 lekë janë zvogëlimi i të drejtës në lidhje me kapitalin që pritej të shtohet në fund të vitit 2022 ndërsa diferenca në shumën 1,095,755 lekë paraqet TVSH e arkëtueshme për vitet 2021 dhe 2022 në shumën 601,966 lekë dhe
- Llogaria “Mjete monetare dhe ekuivalentët e tyre” paraqitet në bilancin kontabël të datës 31.12.2023 në shumën 2,163,534,581 lekë dhe përfaqëson mjetet monetare që disponon Korporata në llogarin bankare, konfirmuar kjo nga grupi i auditimit nëpërmjet nxjerrjeve të llogarive.

Kapitali

- Llogaria “Kapitali aksionar” më 31.12.2023 paraqitet në shumën 4,318,000,000 lekë dhe krahasuar me një vit më parë është rritur në shumën 2,000,000,000 lekë, bazuar në Vendimin e Asamblesës së Përgjithshme të Aksionarëve nr. 19831/1, datë 07.11.2023, ku sipas të cilit është vendosur të anulohet vendimi nr. 112, datë 28.12.2022 “Mbi zvogëlimin e kapitalit të shoqërisë “Korporata e Investimeve Shqiptare” në vlerën 2,000,000,000 (dy miliardë) lekë”. Numri i aksioneve të zaonshme nuk ka ndryshuar vijon të mbetet po 100 dhe vlera nominale për aksion të zakonshëm në fund të vitit 2023 paraqitet në shumën 43,180,000 lekë.

- Llogaria “Fitimi/humbja e akumuluar” paraqitet në shumën -88,522,258 lekë dhe nga verifikimi i saktësisë së llogaritjes rezulton të jetë paraqitur saktë.
- Llogaria “Fitim/humbja e vitit ushtrimor” paraqitet në vlerën -51,167,839 lekë, shifër e cila përputhet dhe me rezultatit e Pasqyrës së të ardhurave gjithëpërfshirëse.

Detyrimet

Në bilancin kontabël të datës 31.12.2023 paraqiten detyrime në shumën 7,280 mijë lekë, të cilat përfaqësojnë:

- Detyrime në lidhje me qiranë, në shumën 5,796 mijë lekë;
- Furniorë, në shumën 49 mijë lekë;
- Detyrime tatimore, në shumën 1,435 mijë lekë, ku përfshihen detyrimet ndaj organeve tatimore, në lidhje me kontributet e detyrimeve shoqërore dhe shëndetësore, tatimin mbi të ardhurat nga punësimi dhe tatimin në burim, të cilat janë konfirmuar dhe nga deklaratat që rezultojnë në sistemin efilling, në mënyrë të detajuar kjo llogari përbëhet si më poshtë:

Tabela nr. 20: “Llogaria analitike e llogarisë “detyrime tatimore””

Në mijë lekë

Përshkrimi	Shuma
Sigurime shoqërore (punëdhënës + punëmarrës)	691
Sigurime shëndetësore	122
Tatimi I të ardhurave nga punësimi (TAP)	447
Tatim në burim	175
Totali	1,435

Burimi: AIC. Përpunuar nga grupi i auditimit, prej të dhënave në deklaratat tatimore për periudhën 2312.

PASQYRA E TË ARDHURAVE GJITHËPËRFSHIRËSE

Pasqyra e të ardhurave gjithëpërfshirëse për vitin 2023 paraqitet si në tabelën nr. 21, të aneksit nr. 3, të këtij ç raporti.

Për vitin ushtrimor 2023, Korporata ka rezultuar me humbje në shumën 51,167,839 lekë.

Të ardhurat e realizuara konsistojnë në të ardhura nga interesat në shumën 28,345,021 lekë, të cilat në mënyrë të detajuar paraqiten si në tabelën më poshtë:

Tabela nr. 22: “Detajimi i llogarisë të ardhura nga interesi për vitin 2023

Në lekë”

Përshkrimi	Shuma
Interes nga llogaria në A. BANK	23,249,131
Interes i llogaritur për huanë e dhënë A.	5,095,890
Totali	28,345,021

Burimi: AIC, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së.

- Interesat bankare janë gjeneruar nga llogaria pranë A. bank dhe janë kaluar në llogari me bazë 3-mujore, konfirmuar dhe me nxjerrjen e llogarisë.

Llogaria “Shpenzime personeli” në shumën 43,743,839 lekë, në mënyrë të detajuar paraqitet si më poshtë:

Tabela nr. 22: “Llogaria analitike e “Shpenzime personeli””

Përshkrimi	Viti 2023	Viti 2022
- Shpenzime Personeli	(43,843,839)	(33,817,489)
Paga	(38,129,682)	(29,821,977)
Sig Shoq & Shend	(5,043,976)	(3,433,510)
Trajnime	(95,541)	(87,000)
Sigurime për stafin	(574,640)	(475,002)

Burimi: AIC, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së.

- Llogaria “Shpenzime për shërbime” paraqitet në shumën 16,527,787 lekë dhe përfaqëson shërbime të bëra për personel jashtë njësie, sipas shënimit të pasqyrave financiare nr. 17, konkretisht për Këshillin Mbikqyrës dhe Bordin Këshillimor.

- Llogaria Shepnzime personeli, paraqet shpenzime për pagat dhe kontributet e sigurimeve shoqërore për vitin 2023 dhe në mënyrë të detajuar paraqitet si më poshtë vijon:

Tabela nr. 23: “Paraqitje analitike e llogarisë shpenzime personeli”

Në lekë

Përshkrimi	2023	2022	Diferenca
Totali Shpenzime Personeli	43,843,839	33,817,489	10,026,350
Paga	38,129,682	29,821,977	8,307,705
Sig Shoq & Shend	5,043,976	3,433,510	1,610,466
Trajnime	95,541	87,000	8,541
Sigurime për stafin	574,640	475,002	99,638

Burimi: AIC, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së.

Nga tabela më sipër rezulton se krahasuar me një vit më parë, totali i shpenzimeve të personelit është rritur me 10,026,350 lekë.

- Llogaria “Shpenzime të tjera të shfrytëzimit” paraqitet në shumën 8,677,396 lekë dhe përfaqëson shpenzime, të cilat kanë të bëjnë me shpenzime utilitare, taksa e tarifa vendore, përfaqësimi, marketingu etj.
- Shpenzimet financiare rezultojnë në total në shumën 23,487 lekë, ku, 2763,48 lekë janë shpenzime për interesa dhe komisione bankare dhe 252,861 lekë, fitim nga kursi i këmbimit.

Shpenzimet e amortizimit janë shpenzimet e llogaritura për AAM dhe amortizimi për aktivin në përdorim, në përputhje me IFRS 16 “Qiraja financiare”, shumë e cila pas verifikimit të bërë nga grupi i auditimit rezulton të jetë paraqitur saktë.

Pasqyra e Mjeteve Monetare (Cash Flow)

Lëvizja e mjeteve monetare për vitin ushtrimor 2023 paraqitet si në tabelën nr. 24, të aneksit nr. 3, të këtij ç raporti.

Nga verifikimi i bërë pasqyrës së ndryshimit të mjeteve monetare, rezultoi se ajo është paraqitur në mënyrë të saktë. Mjetet monetare dhe ekuivalentët e tyre më 31.12.2023, rakordojnë me ato të paraqitura në po të njëjtin zë të pasqyrës së pozicionit financiar në fund të vitit.

Pasqyra e kapitalit

Pasqyra e kapitalit ka paraqitur në mënyrë të saktë ndryshimet që ka pësuar kapitali nga fillimi i periudhës deri më 31.12.2022, dhe janë paraqitur efektet e të katër vendimeve të asamblesë së përgjithsme të aksionerëve në lidhje me kapitalin. Në mënyrë të detajuar kjo pasqyrë paraqitet si në tabelën nr. 25, të aneksit nr. 3, të këtij ç raporti.

Nga verifikimi i të dhënava të kësaj pasqyre rezultoi se kjo pasqyrë është paraqitur në mënyrë të saktë.

Periudha 01.01.2024-30.06.2024

Në lidhje me 6 mujorin e parë të veprimtarisë së AIC, nga grupi i auditimit u bë verifikimi i zërave të shpenzimeve dhe të ardhurave për këtë periudhë nga ku rezultoi situata si në tabelën nr. 26, të Aneksit nr. 3, të këtij ç raporti.

Nga tabela më sipër rezulton se për 6 mujorin e parë të vitit 2024, AIC ka gjeneruar të ardhura në shumën 31,438,188 lekë, ku prej të cilave 27,251,938 lekë janë nga interesat bankare dhe 4,186,250 lekë nga konsulenca, bazuar në kontratën protokolluar në AIC me nr. 109/9, datë 09.01.2024 midis palëve: Korporatës dhe Fondacionit “Durrhah City Football Academy”. Shuma ka kaluar në llogarinë bankare në euro, pranë A. Bank në kundërvleftën 50,000 euro.

Në lidhje me shpenzimet janë verifikuar me përzgjedhje në mënyrë rastësore 12 praktika, të cilat paraqiten si në tabelën nr. 27, të aneksit nr. 3, të këtij ç raporti. Nga verifikimi i bërë në lidhje me to rezulton se, dokumentacioni, pjesë e praktikës është i rregullt dhe i plotë.

Procedura e Inventarizimit në Korporatën e Investimeve Shqiptare

Nga auditimi u konstatua se Korporata për vitin 2020 dhe 2021 nuk ka kryer inventarizim.

Për vitin 2022 është kryer inventarizim i aktiveve mbështetur në ligjin nr. 10296, datë 07.07.2010 “Për menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, si dhe në Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar.

Në dosjen e inventarizimit disponohet dokumentacioni si më poshtë:

- » Raport lidhur me inventarizimin fizik periodik të Korporatën e Investimeve Shqiptare SHA, datë 29.12.2022
- » Procesverbal mbi dorëzimin e fletëve të inventarit të aktiveve për vitin 2022 i cili është i firmosur vetëm nga 2 prej 3 anëtarëve të komisionit të inventarizimit;
- » Memo mbi “Dërgimin e raportit në lidhje me inventarizimi fizik të aktiveve” të grupit të inventarizimit (mungon data dhe është e nënshkruar nga 2 prej 3 anëtarëve të komisionit të inventarizimit);
- » Regjistri i aktiveve fikse më 29.12.2022;
- » Procesverbal i datës 29.12.2022 për inventarizimin e aktiveve të AIC, i nënshkruar gjithashtu nga 2 pre 3 anëtarëve të komisionit;

Nga inventarizimi fizik i aktiveve fikse, të realizuar më datë 29.12.2022 nuk kanë rezultuar diferenca mes gjendje kontabël dhe asaj fizike.

Për vitin 2023 është kryer inventarizim i aktiveve mbështetur në ligjin nr. 10296, datë 07.07.2010 “Për menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, si dhe në Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar.

Me urdhrin e Drejtorit Ekzekutiv nr. s’ka, datë 29.12.2023, protokolluar me nr. 127/1 është ngritur komisioni i posaçëm i inventarizimit me përbërjen si më poshtë:

- ◆ z. E. D.;
- ◆ z. D. H.;
- ◆ z.O. Ç.

Dokumentacionet pjesë e dosjes janë të plota dhe të nënshkruara nga anëtarët e komisionit. Nga inventarizimi i realizuar mbi aktivet fikse më 29.12.2023 nuk kanë rezultuar diferenca mes gjendje kontabile dhe asaj fizike.

Për sa trajtuar më sipër në këtë pjesë të raportit të auditimit, në lidhje me mangësitë e konstatuara mbajnë përgjegjësi si më poshtë:

1. Anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës të AIC-së, për periudhën objekt auditimi (*Aneks 1 – Tabela 2.1.1.*)
2. zj. E. K., Drejtor Ekzekutiv i AIC-së, për periudhën objekt auditimi;
3. z.E. F., si ish-Drejtor Ekzekutiv i AIC-së, për periudhën objekt auditimi;
4. z.G. Sh., në funksionin e Drejtorit të Divizionit të Financës dhe Administratës në AIC, për periudhën objekt auditimi.

Sa trajtuar më sipër në këtë pjesë të RPA-së, subjekti ka paraqitur observacione përmes shkresës nr.97/1 prot., datë 03.03.2025, protokolluar në KLSH me shkresën me nr.1096/6 prot., datë 03.03.2025, nga Drejtori Ekzekutiv i AIC-së znj. E. K., si vijon:

1.Në lidhje me Rekomandimin 11.1. të PRA-së, ju sqarojmë se pasqyrat financiare të AIC-së janë të nënshkruara nga Drejtori Ekzekutiv, përfaqësuesi ligjor dhe Drejtori i Divizionit të Financës, nëpunës zbatues dh personi përgjegjës për hartimin e pasqyrave financiare, në përputhje më parashikimet e pikës 3 të nenit 23 “Përgjegjësitë” të ligjit nr. 25, datë 10.02.2018 “Për kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare”, i ndryshuar, ku përcaktohet se: “Pasqyrat financiare nënshkruhen nga përfaqësuesi ligjor i njësisë ekonomie dhe personi përgjegjës për hartimin e pasqyrave financiare”, të cilat janë depozituar në QKB.

Lidhur me dorëzimin e pasqyrave financiare në dy variante sqarojmë se Pasqyrat financiare janë dorëzuar Brenda afatit të përcaktuar nga ligji, megjithëse janë dorëzuar në dy variante në sistemin e-filling, pasqyrohet vetëm varianti përfundimtar, i cili është në përputhje e raportin e Auditimit të audituesit të pavarur dhe variantin e dorëzuar në QKB, pa efekte financiare shtesë. Gjithashtu saktësimi i pasqyrave financiare është i lejuar nga sistemi e-filling dhe kuadri rregullator ligjor i fushës.

Përsa i përket deklaratave të tatimit fitimit për vitin 2022 dhe 2023, sqarojmë se nuk janë bërë ndryshime të deklaratave. Dokumentacioni vërtetues bashkëlidhur. Ndërsa për vitet 2020 dhe 2021, ndryshimet janë bërë në përputhje me parashikimet e pikës 1, të nenit 67 të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, ku përcaktohet se: “Tatimpaguesi mund të dorëzojë deklaratë të re tatimore, me ndryshime, në rastet kur deklarata tatimore fillestare është e pasaktë dhe me mangësi”. Theksojmë se saktësimi i diferencave të deklaratave është bërë rreth afatit ligjor, pa kryer shkelje të procedurave tatimore, vlerat e ndryshuara janë për vitin 2020 dhe 2021 janë bërë për vlera të vogla (për vitin 2020 vlera është 5,850 lekë dhe për vitin 2021 vlera është 24,474 lekë, deklaratat bashkëlidhur).

2..Në lidhje me Rekomandimin 2.1 të PRA-së, “B” Masa për eliminimin e efekteve negative të konstatuara, ju sqarojmë se Strukturat drejtuese të Korporatës së Investimeve Shqiptare të marrin masa për të vlerësuar alternativat e mundshme me leverdi për situatën e saj financiare dhe të ndërmarrin drejtimet e duhura me qëllim përdorimin e fondeve me efikasitet. Sqarojmë se gjatë vitit 2024, AIC ka negociuar me bankat e nivelit të dytë duke rritur ndjeshëm të ardhurat nga interesi përmes investimit të likuiditeteve të disponueshme në depozita, po ashtu ku ka realizuar të ardhurat e para operacionale 4,18 milion lekë nga Konsulentat.

Qëndrimi i Grupit të Auditimit:

1.Në lidhje me observacionin e paraqitur nga AIC mbi Rekomandimin nr.11.1 të PRA-së, grupi i auditimit sqaron se nuk është evidentuar problematikë në lidhje me nënshkrimin apo përgjegjësinë e palëve mbi pasqyrat financiare, por për sa kohë sipas nenit 29, të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, të ndryshuar “Tatimi mbi të ardhurat” përcaktohet se: “Çdo tatimpaguesi për gatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar nga Ministria e Financave. Tatimpaguesit ua paraqesin deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme organeve tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës duke paraqitur, në të njëjtën kohë, edhe bilancin kontabël, llogarinë e fitimeve dhe të humbjeve për periudhën përkatëse tatimore, si dhe anekset e llogarive vjetore”, duhet që pasqyrat të jenë të miratuara, kur të depozitohen në tatime. AIC nuk disponon ndonjë dokumentacion, që të ketë miratuar e nënshkruar pasqyrat financiare nga personat përgjegjës brenda datës 31 mars të vitit pasardhës.

-Në lidhje me ndryshimet e bëra, në versionet e Deklaratës së tatimit fitimit apo pasqyrave financiare në sistemin e-filling është evidentuar “fakti” dhe nuk është bërë me përgjegjësi askush për ndryshimet, pas versionit i parë i pasqyrave financiare nuk mund të shihet në sistem për të mundësuar dhënien e gjyqimit nga ana jonë. Për sa më sipër vijojmë të rekomandojmë se pavarësisht, se lejohet ndryshimi duhet të lihen gjurmët e arsytet e ndryshimit nga versioni 1 në atë 2, kjo pjesë e observacionit nuk merret në konsideratë.

2.Në lidhje me observacionin e paraqitur nga AIC mbi Rekomandimin nr.2.1. “Masa për eliminimin e efekteve negative të konstatuara...”, sqarojmë, se viti 2024 është evidentuar dhe nga grupi i auditimit se ka gjeneruar të ardhura, por më parë jo ku janë bërë dhe analizat përkatëse, për sa më sipër kjo pjesë e observacionit nuk e ndryshon qëndrimin e grupit të auditimit.

2.4 Mbi regjimin e prokurimit sipas llojit të kontratave, zbatimi i legjislacionit përkatës dhe procedurave të zbatueshme të prokurimit.

I-Auditimi i dokumentacionit të dosjeve të prokurimeve publike të tipit të thjeshtuar për periudhën nën auditim.

1-Nga shqyrtimi i dokumentacionit në lidhje me procedurën e prokurimit me objekt: “Blerje Pajisje IT”, për Korporatën e Investimeve Shqiptare, zhvillimi i procedurës viti 2022, në lidhje zhvillimin e procedurës, faza e vlerësimit të ofertave, të vënë në dispozicion nëpërmjet dosjes fizike, procesverbaleve të vlerësimit të ofertave, njoftimit të fituesit dhe sistemit të prokurimit elektronik (SPE), u konstatuan disa parregullsi në shkelje të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, konkretisht si vijon:

Të dhëna mbi objektin e prokurimit:

a. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Blerje Pajisje IT”, 2022		
1. Lloji/Urdhri i Procedurës së Prokurimit “E hapur e thjeshtuar” Urdhri nr. 14/08 prot., datë 31.03.2022 REF 24123-04-05-2022	2 Njësia e Prokurimit 1. D. H., specialist prane Sektorit te Prokurimit 2. A. N. Drejtor i Divizionit te Operacioneve 3. D. Sh. specialist i fushes i kontraktuar	3 Komisioni i Vlerësimit Ofertave Urdhri nr. 14/09 prot., datë 31.03.2023 1. F. K. Kryetar 2. E. U. anëtar 3. D. Gj. anëtar
4. Fondi Limit (pa tvsh) 3,466,617 lekë	5. Oferta fituese (pa tvsh) 2,890,000 lekë Operatori Fitues: P. S. SHPK	6. Diferenca me fondin limit (pa tvsh) 576,617 lekë ose zbritur 16.6 % nga Fondi .Limit
7/1 Data e hapjes së tenderit: Data 28/04/2023 ndryshohet më datë 05/05/2023	8. Burimi Financimit, Fondet e Korporates se Investimeve 3,466,617 lekë pa TVSH, vënë në dispozicion për vitin 2023,	9. Operatorët Ekonomike a) Pjesëmarrës në tender Numër 2/OE b) S’kualifikuar 1 OE, c) Kualifikuar 1 OE
7/2 Kohëzgjatja e kontratës: 24 muaj		

Nga shqyrtimi i sipërcituar konstatohet që:

a-Mbi realizimin e procedurës së prokurimit.

Korporata e Investimeve Shqiptare ka miratuar në planin e investimeve për vitin pasardhës 2022 sipas kërkesës për nevoja investimi për mallra “Blerje Pajisje IT”

Me urdhrin nr.14/1 datë 28.03.2022, në bazë të nenit 42 të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, urdhërohet të zhvillohet procedura e hapur me fond 3,466,617 lekë pa TVSH dhe ngrihet njësia e prokurimit.

Me shkresën nr.14/05 date 29.03.2022 prot AIC është mbajtur akti Proces-Verbal për specifikime teknike për procedurën e prokurimit me objekt “Blerje Pajisje IT” dhe nga auditimi i këtij akti nuk jepen specifikime teknike në lidhje me mallrat Desktop/Laptop/Docking Station/Monitor/Mouse/Switch 1.248 Port/TV50/Router wireless, Access Point/Rack12 dhe VideoDooBell por është përcaktuar vetëm ana sasiore e nevojshme për nevoja të Korporatës AIC.

Me shkresën nr.14/06 datë 31.03.2022 prot AIC, është mbajtur akt proces-verbal për përcaktimin e fondit limit për procedurën e prokurimit me objekt “Blerje Pajisje IT” nisur nga ofertat e ardhura nga 3 (tre) shoqëri duke arritur në konkluzionin që vlera e fondit limit te jetë 3,466,617 lekë pa TVSH.

Me urdhrin nr. 14/9 datë 31.03.2023, ngrihet komisioni i vlerësimit të ofertave nga Korporata AIC (Njësia e Prokurimit) dhe më pas në vijim është hartuar procesverbali për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim. Me shkresën nr. 14/10 datë 04.04.2022 është hartuar Proces-Verbal per Dokumentet Teknike të Tenderit ku konstatohet se;

Pika II “Argumentimi specifikimeve teknike” konstatohet se nuk jepen specifikime teknike në lidhje me mallrat Desktop/Laptop/Docking Station/Monitor/Mouse/Switch 1.248 Port/TV50/Router wireless Access Point/Rack12 dhe VideoDooBell por është përcaktuar vetëm ana sasiore e nevojshme për nevoja të Korporatës AIC.

Me shkresën nr. 14/13 prot. datë 22.04.2022 komisioni KVO ka kualifikuar 2 operatorë OE për në fazën e vlerësimit të mëtejshëm dhe me shkresën nr.14/14 prot datë 22.04.2022, bazuar në kriterin çmim më të favorshëm ka shpallur fitues operatorin ekonomik “P. S.” me nipt. L..A, duke plotësuar edhe Formularin e Njoftimit të Fituesit me shkresën nr.14/16 prot., datë 09.05.2022.

Në përfundim konstatohet se

1-Nuk rezulton dokumenti ***Teknik i Konformitetit CE/Deklarata e Originës së Mallit*** sipas kushtit preferencial MSABE i cili vërteton përputhshmërinë e origjinës së mallit brenda zonës EU sipas shpjegimeve dhe përcaktimeve të Ligjit nr. 9590 date 27.07.2006 “Për ratifikimin e Marrëveshjes së Stabilizim Asocimit” e cila duhet të ishte marrë në vlerësim nga KVO.

2-Nuk është kryer paraprakisht investigimi i tregut për mallrat objekt tenderi me qëllim përcaktimin mesatar të vlerës së fondit nga Njësia e Prokurimit Publik që do të parashikohej në Regjistrin e Parashikimeve dhe paraqitur për miratim në pasqyrat financiare të vitit pasues ose korrent pranë Bordit sipas një Urdhri të nxjerrë nga Drejtori Ekzekutiv.

Personat që kanë nënshkruar aktet në cilësinë e anëtareve të Njesisë së Prokurimit Publik, z. D. H., specialist pranë Sektorit të Prokurimit, z. A. N., Drejtor i Divizionit të Operacioneve dhe z. D. Sh., specialist i fushës i kontraktuar dhe në cilësinë e anëtarëve të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave znj. F. K. Kryetar, znj. E. U. anëtar, z. D. Gj. anëtar dhe z. E. F., me detyrë ish Drejtor Ekzekutiv.

2. Nga shqyrtimi i dokumentacionit në lidhje me procedurën e prokurimit me objekt: “Blerje Mobilje”, për Korporatën e Investimeve Shqiptare zhvillimi i procedurës viti 2022, në lidhje zhvillimin e procedurës, faza e vlerësimit të ofertave, të vënë në dispozicion nëpërmjet dosjes fizike, procesverbaleve të vlerësimit të ofertave, njoftimit të fituesit dhe sistemit të prokurimit elektronik (SPE), u konstatuan disa parregullsi në shkelje të Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, konkretisht si vijon:

Të dhëna mbi objektin e prokurimit:

a. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Blerje Mobilje”, 2022		
1. Lloji/Urdhri i Procedurës së Prokurimit “E hapur e thjeshtuar” Urdhri nr. 13/6 prot., datë 26.04.2022 REF 27608-05-05-2022	2 Njësia e Prokurimit 1. D. H., specialist pranë Sektorit të Prokurimit 2. A. N. Drejtor i Divizionit të Operacioneve 3. A. B. specialist i fushës i kontraktuar	3 Komisioni i Vlerësimit Ofertave Urdhri nr. 13/07 prot., datë 26.04.2022 1. F. K. Kryetar 2. E. U. anëtar 3. A. S. anëtar
4. Fondi Limit (pa tvsh) 3,343,995 lekë	5. Oferta fituese (pa tvsh) 2,273.400 lekë Operatori Fitues: E. SHPK	6. Diferenca me fondin limit (pa tvsh) 1,101,543 lekë ose zbritur 31.5 % nga Fondi Limit
7/1 Data e hapjes së tenderit: Data 17/05/2022	8. Burimi Financimit, Fondet e Korporatës së Investimeve 3,474,735 lekë pa TVSH, vënë në dispozicion për vitin 2022,	9. Operatorët Ekonomike a) Pjesëmarrës në tender Numër 10/OE b) S’kualifikuar 3 OE, c) Kualifikuar 1 OE
7/2 Kohëzgjatja e kontratës: 24 muaj		

Nga shqyrtimi i sipërcituar konstatohet që:

a-Mbi realizimin e procedurës së prokurimit.

Këshilli Mbikëqyrës i Shoqërisë “Korporata e Investimeve Shqiptare”, pasi është vënë në dijeni me materialin e Planit të Biznesit (Buxhetit) për vitin 2022 të prezantuar nga Drejtori Ekzekutiv në mbledhjen e datës 21.12.2021, ka miratuar edhe kryerjen e investimit për mallrat e natyrës elektronike në nivelin prej 41,397 USD (*kursi aktual i periudhës 1 USD=107 lekë*).

Nuk rezulton kryerja e procedurës paraprake e ngritjes së komisionit për nevoja materiale mbi bazën e kryerjes dhe marrjes së ofertës mesatare të studimit të tregut me qëllim përcaktimin e çmimit mesatar orientues për propozim për parashikim në buxhetin e vitit pasardhës.

Me urdhrin nr.13/2 datë 25.03.2022, në bazë të nenit 42 të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, urdhërohet të ngrihet njësia e prokurimit me fond të miratuar prej 3,474,735 lekë.

Me shkresën nr.13/03 prot., datë 28.03.2022 AIC është mbajtur akti Proces-Verbal për specifikime teknike për procedurën e prokurimit me objekt “Blerje mobileje dhe orendi për zyrat e shoqërisë” sipas projektit të përgatitur nga personi i kontraktuar për punime arkitekture z. A.B., duke u fokusuar vetëm në anën sasiore dhe specifikime të përmasave të mobiljeve të nevojshme të projektuar për nevoja të Korporatës AIC.

Me shkresën nr. 13/4 prot., datë 12.03.2022 AIC, është mbajtur akt Proces-Verbal për përcaktimin e fondit limit për procedurën e prokurimit me objekt “Blerje Pajisje IT” nisur nga ofertat e ardhura nga 3 (tre) shoqëri duke arritur në konkluzionin që vlera e fondit limit të jetë 3,633,715 lekë pa TVSH, vlerë më e lartë se fondi i miratuar në Buxhet.

Me shkresën nr.13/6 prot., datë 26.04.2022 AIC është ngritur Urdhër Prokurimi me objekt “Blerje Pajisje IT” me fondit limit 3,343,995 lekë pa TVSH.

Me urdhrin nr.13/7 datë 26.04.2022, ngrihet komisioni i vlerësimit të ofertave. Korporata AIC (Njësia e Prokurimit) dhe më pas në vijim ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim.

Me shkresën nr.13/9 datë 04.05.2022 është hartuar Proces-Verbal për Dokumentet Teknike të Tenderit ku konstatohet se:

Me shkresën nr.13/14 prot., datë 02.06.2022, komisioni KVO ka kualifikuar 7 (shtatë) operatorë “OE” për në fazën e vlerësimit të mëtejshëm dhe me shkresën nr.14/15 prot., datë 02.06.2022 bazuar në kriterin çmim më të favorshëm ka shpallur fitues operatorin e ekonomik “E. Shpk” me nipit J...T, duke plotësuar edhe Formularin e Njoftimit të Fituesit me shkresën nr.14/15 prot date 09.06.2022.

Në përfundim konstatohet se

1-Nuk rezulton të jetë vendosur si kriter në Dokumentet e Tenderit paraqitja e dokumentit teknik të nevojshëm “Dokumenti Teknik te Konformitetit” dhe Deklarata e Origjinës së Mallit prodhuar në territorin Shqiptar ose sipas kushtit preferencial MSABE, i cili vërteton përputhshmërinë e origjinës së mallit brenda zonës EU sipas shpjegimeve dhe përcaktimeve të Ligjit nr.9590, datë 27.07.2006 “Për ratifikimin e Marrëveshjes së Stabilizim Asocimit” e cila duhet të ishte vendosur si kriter përcaktues nga Njësia e Prokurimit Publik.

2-Nuk janë dhënë specifikime teknike për pajisjet objekt tenderi nga Njësia e Prokurimit Publik.

3-Nuk është kryer paraprakisht investigimi i tregut për mallrat objekt tenderi me qëllim përcaktimin mesatar të vlerës së fondit që do të parashikohej në Regjistrin e Parashikimeve dhe paraqitur për miratim në pasqyrat financiare të vitit pasues ose korrent pranë Bordit sipas një Urdhri të nxjerrë nga Drejtori Ekzekutiv.

Personat që kanë nënshkruar aktet në cilësinë e anëtarëve të Njesisë së Prokurimit Publik, z. D. H., specialist pranë Sektorit të Prokurimit, z. A. N., Drejtor i Divizionit të Operacioneve dhe z.D. Sh., specialist i fushës i kontraktuar dhe në cilësinë e anëtarëve të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, znj. F. K. Kryetar, znj. E. U. anëtar, znj. A. S. anëtar dhe z. E. F., me detyrë ish Drejtor Ekzekutiv.

3.Nga shqyrtimi i dokumentacionit në lidhje me procedurën e prokurimit me objekt: “Blerje Pajisje IT”, 2024 për Korporatën e Investimeve Shqiptare, zhvillimi i procedurës viti 2024, në lidhje me zhvillimin e procedurës, faza e vlerësimit të ofertave, të vënë në dispozicion nëpërmjet dosjes fizike, procesverbaleve të vlerësimit të ofertave, njoftimit të fituesit dhe sistemit të prokurimit elektronik (SPE), u konstatuan disa parregullsi në shkelje të Ligjit Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, konkretisht si vijon:

Të dhëna mbi objektin e prokurimit:

a. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Blerje Pajisje IT”,2024		
1. Lloji/Urdhri i Procedurës së Prokurimit “E hapur e thjeshtuar” Urdhri nr. 40/3 prot., datë 08.03.2024 REF 99389-03-26-2024	2 Njësia e Prokurimit 1. D. H. Kryetar 2. V. K. Anetar 3. S. D. specialist i fushës i kontraktuar	3 Komisioni i Vlerësimit Ofertave Urdhri nr. 40/09 prot., datë 25.03.2024 1. J. A. Kryetar 2. A. S. Anetar 3. R. Sh. specialist i fushës i kontraktuar
4. Fondi Limit (pa tvsh) 3,260,666 lekë	5. Oferta fituese (pa tvsh) 2,216,000 O. C. SHPK	6. Diferenca me fondin limit (pa tvsh) 1,044,666 lekë ose zbritur 32% nga Fondi .Limit
7/1 Data e hapjes së tenderit: Data 26.03.2024	8. Burimi Financimit, Fondet e Korporatës se Investimeve 3,260,666 lekë pa TVSH, vënë në dispozicion për vitin 2024,	9. Operatorët Ekonomike a)Pjesëmarrës në tender Numër 6/OE, b) Kualifikuar 6 OE c) Fitues 1 OE
7/2 Kohëzgjatja e kontratës: sipas garancive respektive		

Nga shqyrtimi i sipërcituar konstatohet që:

a-Mbi realizimin e procedurës së prokurimit.

Këshilli Mbikëqyrës i Shoqërisë “Korporata e Investimeve” pasi është vënë në dijeni me materialin e Planit të Biznesit (Buxhetit) për vitin 2024, të prezantuar nga Drejtori Ekzekutiv në mbledhjen e datës ka miratuar edhe kryerjen e investimit për mallrat të natyrës mobilje në vlerën 5,916,940 lekë.

Me urdhrin nr.40/3 prot., datë 08.03.2024, në bazë të nenit 42 të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, urdhërohet të ngrihet njësia e prokurimit me fond të miratuar prej 5,916,940 lekë.

Me shkresën nr.40/4 datë 13.03.2024 prot AIC, është mbajtur akti Proces-Verbal nga Njësia e Prokurimit për përlllogaritjen e fondit limit dhe specifikime teknike për procedurën e prokurimit me objekt “Blerje Pajisje IT” sipas shkresës të drejtuar nga Divizioni i Financës dhe Administratës drejtuar Drejtorit Ekzekutiv sipas projektit të përgatitur nga personi i kontraktuar për punime arkitekture duke u fokusuar vetëm në anën sasiore dhe specifikime të përmasave të mobiljeve të nevojshme të projektuar për nevoja të Korporatës AIC u janë drejtuar subjekteve që operojnë në këtë fushë dhe me shkresën nr.40/5 datë 13.03.2024 janë detajuar specifikimet teknike nga znj.S. D.

Me shkresën nr.40/7 datë 25.03.2024 prot AIC, është mbajtur procesverbali nr.3 për përcaktimin e fondit limit për procedurën e prokurimit “Blerje Pajisje IT” për zyrat e shoqërisë duke vendosur si fond limit shumë prej 3,260,666 lekë.

Me shkresën nr.40/8 datë 25.03.2024 prot AIC, është ngritur Urdhër Prokurimi me objekt “Blerje Pajisje IT” me fondit limit 3,260,666 lekë pa TVSH.

Me urdhrin nr.40/9 datë 25.03.2024, ngrihet komisioni i vlerësimit të ofertave. Korporata AIC (Njësia e Prokurimit) dhe më pas në vijim ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim.

Me shkresën nr.40/10 datë 26.03.2024 prot AIC, është mbajtur akt Proces-Verbal nr.3 nga Njësia e Prokurimit për përcaktimin e fondit limit për procedurën e prokurimit me objekt “Blerje Pajisje IT” ku janë përcaktuar edhe dokumentet e tenderit konstatohet se:

Me shkresën nr. 40/15 prot., datë 11.04.2024 është mbajtur proces-verbal për disa ndryshime të specifikimeve teknike pasi ka pasur kërkesa nga operatorët ekonomike, të cilat janë detajuar në aktin bashkëlidhur.

Me shkresën nr.40/16 prot., datë 16.04.2024 është mbajtur proces verbal për hapjen e dokumenteve të tenderimit për 6 (gjashtë) operatorë pjesëmarrës dhe me shkresën nr.40/17 prot AIC, datë 30.04.2024, të rendisë të parin subjektin “O. C.” SHPK, dhe me shkresën nr.40/20 prot datë 13.05.2024 të kualifikojë si fitues këtë kompani.

Në përfundim konstatohet se

1-Nuk rezulton të jetë vendosur si kriter në Dokumentet e Tenderit paraqitja e dokumentit teknik të nevojshëm, Deklarata e Origjinës së Mallit për vërtetimin e prodhimit në Territorin Shqiptar ose sipas kushtit preferencial MSABE, i cili vërteton përputhshmërinë e origjinës së mallit brenda zonës EU sipas shpjegimeve dhe përcaktimeve të Ligjit nr.9590 date 27.07.2006 “Për ratifikimin e Marrëveshjes së Stabilizim Asocimit” e cila duhet të ishte vendosur si kriter përcaktues nga Njësia e Prokurimit Publik.

2-Nuk janë dhënë specifikime teknike për pajisjet objekt tenderi nga Njësia e Prokurimit Publik në fazën paraprake të hartimit të dokumenteve.

Personat që kanë nënshkruar aktet në cilësinë e anëtareve të Njesisë së Prokurimit Publik, z. D. H., specialist pranë Sektorit të Prokurimit, znj.V. K. anëtare dhe znj. S. D. specialiste e fushës e kontraktuar.

4. Nga shqyrtimi i dokumentacionit në lidhje me procedurën e prokurimit me objekt: “Blerje Mobilje”, për Korporatën e Investimeve Shqiptare zhvillimi i procedurës viti 2024, në lidhje zhvillimin e procedurës, faza e vlerësimit të ofertave, të vënë në dispozicion nëpërmjet dosjes fizike, procesverbaleve të vlerësimit të ofertave, njoftimit të fituesit dhe sistemit të prokurimit elektronik (SPE), u konstatuan disa parregullsi në shkelje të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, konkretisht si vijon:

Të dhëna mbi objektin e prokurimit:

a.Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Blerje Mobilje”,2024		
1. Lloji/Urdhri i Procedurës së Prokurimit “E hapur e thjeshtuar” Urdhri nr. 24/4 prot., datë 26.02.2022 REF 98657-03-18-2024	2 Njësia e Prokurimit 1. D. H. Kryetar 2. V. K. Anetar 3. A. D. specialist i fushës i kontraktuar	3 Komisioni i Vlerësimit Ofertave Urdhri nr. 24/09 prot., datë 12.03.2024 1. J. A. Kryetar 2. A. S. Anetar 3. R. Sh. specialist i fushës i kontraktuar
4. Fondi Limit (pa tvsh) 2,759,633 lekë	5. Oferta fituese (pa tvsh) 1,800.000 Operatori Fitues: R. shpk	6. Diferenca me fondin limit (pa tvsh) 959,843 lekë ose zbritur 34.7% nga Fondi .Limit
7/1 Data e hapjes së tenderit: Data 02/04/2024	8. Burimi Financimit, Fondet e Korporates se Investimeve 2,759,633 lekë pa TVSH, vënë në dispozicion për vitin 2024,	9. Operatorët Ekonomike a)Pjesëmarrës në tender Numër 9/OE b) S’kualifikuar 1 OE, c) Kualifikuar 8 OE
7/2 Kohëzgjatja e kontratës: 12 muaj		

Nga shqyrtimi i sipërcituar konstatohet që:

a-Mbi realizimin e procedurës së prokurimit.

Këshilli Mbikëqyrës i Shoqërisë “Korporata e Investimeve” pasi është vënë në dijeni me materialin e Planit të Biznesit (Buxhetit) për vitin 2024, të prezantuar nga Drejtori Ekzekutiv në mbledhjen e datës ka miratuar edhe kryerjen e investimit për mallrat të natyrës mobilje në vlerën 3,027,500 lekë.

Me urdhrin nr.24/4 datë 20.02.2022, në bazë të nenit 42 të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, urdhërohet të ngrihet njësia e prokurimit me fond të miratuar prej 3,027,500 lekë.

Me shkresën nr.24/5 datë 27.02.2024 prot AIC, është mbajtur akti Proces-Verbal nga njësia e Prokurimit për specifikime teknike për procedurën e prokurimit me objekt “Blerje mobilje dhe orendi për zyrat e shoqërisë” sipas projektit të përgatitur nga personi i kontraktuar për punime arkitekture duke u fokusuar vetëm në anën sasiore dhe specifikime të përmasave të mobiljeve të nevojshme të projektuar për nevoja të Korporatës AIC.

Me shkresën nr.24/7 datë 08.03.2024 prot AIC, është mbajtur procesverbali nr.3 për përcaktimin e fondit limit për procedurën e prokurimit “Blerje Mobilje dhe Orendi” për zyrat e Shoqërisë, duke vendosur si fond limit shumë prej 2,759,633 lekë, nisur nga përllogaritja e vlerës mesatare sipas çmimeve të ofertuar. Me shkresën nr 24/8 datë 12.03.2024 prot AIC, është ngritur Urdhër Prokurimi me objekt “Blerje mobilje dhe Orendi për zyrat e shoqërisë” me fondit limit 2,759,633 lekë pa TVSH.

Me urdhrin nr.24/9 datë 12.03.2024, ngrihet komisioni i vlerësimit të ofertave. Korporata AIC (Njësia e Prokurimit) dhe më pas në vijim ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim.

Me shkresën nr.24/10 datë 13.03.2024 prot AIC, është mbajtur akt Proces-Verbal nr.3 nga Njësia e Prokurimit për përcaktimin e fondit limit për procedurën e prokurimit me objekt “Blerje mobilje dhe Orendi për zyrat shoqërisë” ku janë përcaktuar edhe dokumentet e tenderit, ku konstatohet se:

-pika 2.3.1 Kapaciteti Teknik, operatorët ekonomike duhet të paraqesin “Dëshmi” të përvojave të ngjashme me këtë objekt prokurimi me punë të kryera dhe të realizuara jo më pak se 20% e vlerës aktuale të prokurimit, për punë të kryera në një Ent Publik, ose fatura tatimore të lëshuara për ente private dhe të deklaruara në organet tatimore bazuar në nenin 77 të Ligjit nr.162 datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 55 pika 4/b të VKM nr.285 datë 19.05.2021 “Për rregullat e Prokurimit Publik” e cila mungon në dokumentet e tenderit.

Me shkresën nr.21/5 prot AIC, datë 15.04.2024, komisioni KVO ka kualifikuar 9 (nëntë) operatorë OE për në fazën e vlerësimit të mëtejshëm dhe fitues paraprak është shpallur subjekti “R.” SHPK, dhe një subjekt i skualifikuar deri në procedurën e afateve të ankimit, bazuar në nenin 100 të Ligjit nr.162/2020 datë 23.12.2020, dhe bazuar në kriterin çmim më të favorshëm ka shpallur fitues operatorin ekonomik “R.

SHPK” me nipt J...M, duke plotësuar edhe Formularin e Njoftimit të Fituesit me shkresën nr.24/17 prot, datë 23.04.2024.

Në përfundim konstatohet se:

1-Nuk rezulton të jetë vendosur si kriter në Dokumentet e Tenderit paraqitja e dokumentit teknik të nevojshëm, Deklarata e Origjinës së Mallit për vërtetimin e prodhimit në Territorin Shqiptar ose sipas kushtit preferencial MSABE, i cili vërteton përputhshmërinë e origjinës së mallit brenda zonës EU sipas shpjegimeve dhe përcaktimeve të Ligjit nr.9590, datë 27.07.2006 “*Për ratifikimin e Marrëveshjes së Stabilizim Asocimit*”, e cila duhet të ishte vendosur si kriter përcaktues nga Njësia e Prokurimit Publik.

2-Nuk janë dhënë specifikime teknike për pajisjet objekt tenderi nga Njësia e Prokurimit Publik në fazën paraprake të hartimit të dokumentave.

Personat që kanë nënshkruar aktet në cilësinë e anëtarëve të Njesisë së Prokurimit Publik, z. D. H., specialist pranë Sektorit të Prokurimit, znj.V. K. anëtare dhe znj. A. D. specialist i fushës i kontraktuar.

II-Auditimi i kontratës së qirasë për marrje në qira të ambienteve për nevoja të ushtrimit të aktivitetit të shoqërisë “Korporata e Investimeve Shqiptare” SHA

Në lidhje me kontratën e qirasë me nr. repertori 1615 dhe nr. koleksioni 233, të nënshkruar me datë 29.10.2021, ndërmjet shoqërisë “*L. SHPK*” dhe “*Korporatës së Investimeve Shqiptare*”, u konstatua se është lidhur kontratë me çmim prej 5,650 Euro pa TVSH me afat 5 vjeçar për ambientet, zyra (71 dhe 72) me sipërfaqe 338 m2 me çmim 5,250 euro/muaj dhe çmim 15.5 Euro/m2 pa TVSH, dhe 4 (katër) vende parkimi me sipërfaqe prej 115 m2, me çmim 400 euro/muaj me çmim 3.5 euro/m2 pa TVSH nr. muaj në pronësi të qiradhënësit shoqërisë L. SHPK, përfshirë edhe shërbimin e pastrimit 2 (dy) herë në javë për kohëzgjatjen e kontratës. Në vijim të kësaj kontrate janë marrë më pas në vijim edhe procedurat përkatëse që kanë filluar me, Urdhrin nr.1, datë 13.09.2021, me nr.U-01-2021 prot, të Drejtorit Ekzekutiv z.E. F. duke autorizuar edhe komisionin që do të kontraktojë me përbërje z.G. Sh., z.A. N., znj.H. Xh. Me shkresën nr.05/01 prot AIC, datë 14.10.2021, nga Komisioni është proceduar me hapjen e ofertave të ardhura nga 4 (katër) shoqëri.

Me shkresën nr.05/03 prot AIC, datë 18.10.2021, është hartuar relacion shpjegues në lidhje me procedurën “*Marrjen me qira të ambienteve për zyra*” të Korporatës së Investimeve Shqiptare (AIC) bazuar në kriteret e vendosura:

1-Vendndodhja në qendër biznesi në Tiranë;

2-Kontraktimi i një sipërfaqeje deri në 270-350 m2;

3-Afati deri në 3 (tre) vite me të drejtë rinovimi pa shprehur ose kontraktuar rezervë të mëparshme.

Me datën 29.12.2023 sipas shkresës nr.127 prot AIC, është kërkuar nga Drejtori i Divizionit Financiar dhe Administrativ z.G. Sh., nisja e procedurave administrative për marrjen me qira të ambienteve shtesë për zyra AIC nisur nga kërkesa për ambiente zyre Arkiv/Protokoll/Dhomë serveri, në një sipërfaqe 60 m2 dhe nisur nga kërkesat dhe detyrimet ligjore për plotësimin e organikës deri në 30 punonjës nga 17 të punësuar, sipas VKM nr.521, datë 06.08.2014, sipas së cilës hapësira e vendit individual të punës është 12 m3, për të cilat sipas përlllogaritjeve nevojitet një sipërfaqe ushtrimi detyre funksionale deri në 100 m2, për të cilën është informuar Drejtori Ekzekutiv sipas shkresës nr.127/5 prot datë 05.01.2024, për miratimin në parim të draft kontratës duke trajtuar në total një sipërfaqe prej 150-170 m2, për të cilën është lidhur kontrata nr.75 sipas koleksion nr.16, mbajtur në datë 11.01.2024, me një çmim prej 15.7 euro/m2 pa TVSH, ndërmjet shoqërisë “*L. SHPK*” dhe “*Korporatës së Investimeve Shqiptare*” përfaqësuar nga Drejtori Ekzekutiv.

Për pjesën e pagesës së qirasë për ambientet e ushtrimit të aktivitetit të Korporatës AIC që korrespondojnë me pjesën e zyrave, kontraktimi është bërë me çmim 15,5 euro/m2, ndërkohë që çmimi referues të njohur për qëllime fiskale është 11 euro/m2 sipas përcaktimeve të:

- Vendimit nr.168 datë 27.03.2019 “Për disa ndryshime në vendimin nr.132, datë 7.3.2018, të Këshillit të Ministrave, “për metodologjinë për përcaktimin e vlerës së taksueshme të pasurisë së paluajtshme “ndërtesa”, e bazës së taksës për kategori specifike, natyrën dhe prioritetin e informacionit dhe të dhënave për përcaktimin e bazës së taksës, si dhe të kriterëve dhe rregullave për vlerësimin alternativ të detyrimit të taksës” dhe sipas Aneksit nr.2, “Çmimet mesatare referuese për metër katror sipërfaqe ndërtimi për vlerësimin e vlerës së taksueshme për ndërtime dhe ambiente jo-banimit a) Çmimi për metër katror sipërfaqe ndërtimi për veprimtari ekonomike tregtimi shërbimi është 1.5 (një pikë pesë) herë më i lartë se çmimi i sipërfaqeve të banimit sipas qyteteve. Në këtë kategori përfshihen edhe njësitë tregtare, ku njëkohësisht realizohen edhe procese të përziera prodhimi, tregtimi apo shërbimi me pakicë. Në zonat që përfshihen në Bashkinë Tiranë ky koeficient është 2 (dy) herë më i lartë”.

-Vendim nr. 469, datë 3.6.2015 “Për përcaktimin e vlerës minimale të çmimit të referencave të qirave të ndërtesave për qëllime tatimore”, përcakton se:

1. Vlera e dhënies me qira të ndërtesës përcaktohet në kontratën e noterizuar të qirasë, sipas legjislacionit të fushës. Në kontratë, veç të tjerave, duhet detyrimisht, të përcaktohet qartë adresa ku ndodhet ndërtesa, sipërfaqja në metër katror, dhe vlera mujore e qirasë së objektit.

2. Në asnjë rast, vlera e dhënies me qira të ndërtesës, sipas pikës 1, të këtij vendimi, nuk do të jetë më e vogël se vlera minimale e qirasë, e përcaktuar në këtë vendim. Vlera minimale mujore, për metër katror sipërfaqe ndërtesë të dhënë me qira, është e barabartë **me 0.3 % (për qind) të çmimit të shitjes së saj**, e përcaktuar në udhëzimin e Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e kostos mesatare të ndërtimit të banesave, nga Enti Kombëtar i Banesave”, që miratohet çdo vit.

Rezulton se ambienti me qira është marrë në zonën 5/1 të zonës së qytetit Tiranë, e cila është ri azhornuar me çmim 190,000 lekë/m², dhe sipas pikës 2 të Vendimit nr.168 datë 27.03.2019 dhe koeficienti i vlerësimit për qëllime tregtare shërbimi në Bashkinë Tiranë është 2 (dy) herë më i lartë duke konkluduar në një çmim referues për nivel taksimi në vlerën prej 380,000 leke/m². Referuar pikës 2 të Vendimit nr. 469, datë 3.6.2015, çmimi minimal orientues dhe referues i qirasë për këtë njësi shërbimi do të ishte 380,000 leke/m²*0,3%=1,140 lekë/m², (11euro/m²). Në funksion të parimit të eficiencës, efektivitetit dhe ekonomicitetit, vlera referuese e qirasë prej 11 euro/m², nuk është respektuar nga Korporata e Investimeve Shqiptare, pasi kontraktimi është bërë me çmim 15,5 euro/m², duke sjellë si pasojë rritjen e shpenzimeve të kësaj shoqërie në vlerën prej 49,151 euro pa TVSH, (periudha 32 mujore), nga nënshkrimi deri në përfundim të periudhës objekt auditimi. Personat nënshkrues që kanë nënshkruar aktet në cilësinë e anëtarëve të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, z. G. Sh., z. A. N., znj. H. Xh. dhe z. E. F., në cilësinë e ish Drejtorit Ekzekutiv.

Sa trajtuar më sipër në këtë pjesë të RPA-së, subjekti ka paraqitur observacione përmes shkresës nr.97/1 prot., datë 03.03.2025, protokolluar në KLSH me shkresën me nr.1096/6 prot., datë 03.03.2025, nga Drejtori Ekzekutiv i AIC-së znj. E. K., si vijon:

1.Në lidhje me Rekomandimin 10.1. të PRA-së, ju sqarojmë se Korporata e Investimeve Shqiptare në cilësinë e qiramarrësit i ka marrë me qira shoqërisë “L.” shpk, me afat 3 vjeçar ambiente për ushtrimin e aktivitetit. Sa i takon çmimit të qirasë për marrjen me qira të ambienteve ku ushtron aktivitetin Korporata, sqarojmë se me qëllim marrjen me qira të ambienteve për zyra, është zhvilluar një procedurë në përfundim të së cilës është përzgjedhur oferta ekonomikisht më e favorshme, si dhe bazuar në objektin e veprimtarisë së AIC-së, ishte e nevojshme që zyrat e shoqërisë të ishin pranë Institucioneve qendrore për shkak të bashkëpunimit me këto Institucione. Referenca ligjore që është bazuar grupi i auditimit (VKM nr.469, datë 03.06.2015), është referencë minimale në lidhje me tatimin e llogarit. Po ashtu në kushtet kur AIC në zbatim të projekteve të pronave, duhet të jap prona me qira në të ardhmen, duhet t’i referohet çmimit të tregut dhe jo çmimit indikativ të llogaritjes së tatimit. Nga komisioni i ngritur për shqyrtimin e ofertave janë marrë ofertat nga disa subjekte që operojnë në fushën e dhënies me qira të ambienteve dhe në procesin e llogaritjes së tyre janë mbajtur parasysh parashikimet e VKM-së nr.132, datë 07.03.2018 “Për metodologjinë për përcaktimin e vlerës së taksueshme të pasurisë së paluajtshme “ndërtesa”, e bazës së taksës për

kategori specifike, natyrën dhe prioritetin e informacionit dhe të dhënave për përcaktimin e bazës së taksës, si dhe të kriterëve dhe rregullave për vlerësimin alternative të detyrimit të taksës”, i ndryshuar me VKM nr.168, datë 27.03.2019. Sqarojmë se në çmimin e qirasë për metër katror në këtë kontratë qiraje përveç përdorimit të ambienteve të brendshme përfshihen edhe shërbimi i sigurisë, receptionit, pastrimit, mirëmbajtja etj. Nga ofertat e marra nga komisioni rezulton se subjektet të cilat kanë dërguar ofertat e tyre për këtë qiramarrje, kanë përcaktuar veç çmimit të qirasë, i cili rezultoi më i lartë se çmimi i ofruar nga qiradhënësi dhe çmimin për shpenzimet operative mujore, që variojnë nga 2.5 euro/m² deri në 3.5 euro/ m². Pra në këtë kontratë qiraje, brenda çmimit të qirasë, Korporata ka përfshirë edhe një sërë shërbimesh të domosdoshme që në rast se do të merreshin veç nga subjekte të tjera do të ngarkonin Institucionin me fatura financiare për secilin shërbim. AIC në kuadër të përdorimit me efektivitet, efikasitet dhe ekonomicitet të fondeve, për marrjen e ambienteve me qira ka zhvilluar procedurën e studimit të tregut në zonën përkatëse dhe është përzgjedhur oferta me çmimin më të ulët.

2.Në lidhje me Rekomandimin 17.1. të PRA-së, sikurse ju kemi sqaruar në mënyrë shteruese në observacionin datë 17.12.2024 dërguar nga ana jonë lidhur me Akt-Konstatimin nr.4, datë 11.12.2024 i mbajtur nga KLSH, AIC në procedurat e prokurimit publik vijon me masat për të garantuar zhvillimin e procedurave të prokurimit në përputhje me legjislacionin në fuqi për prokurimet publike.

Qëndrimi i Grupit të Auditimit:

1.Në lidhje me observacionin e paraqitur nga AIC mbi Rekomandimin nr.10.1 të PRA-së, grupi i auditimit sqaron se pas trajtimit të observacionit ka kryer rishikimin në rekomandimin përkatës.

2.Në lidhje me observacionin e paraqitur nga AIC mbi Rekomandimin nr.17.1 të PRA-së, grupi i auditimit sqaron se nuk ka ndryshime nga trajtimi i observacioneve dhe i qëndron rekomandimit të PRA-së.

2.5 Mbi vlerësimin i funksionimit të sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrolleve të brendshme.

Vlerësimi i funksionimit të sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit në Korporatën e Investimeve Shqiptare u realizua bazuar në ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, Manualin për MFK-në, miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr. 108, datë 17.11.2016, si dhe urdhrat dhe udhëzimet e dala në zbatim të tij. Në kuptimin e ligjit të lartpërmendur, menaxhimi financiar dhe kontrolli përcaktojnë përgjegjshmërinë menaxheriale për planifikimin, zbatimin dhe kontrollin e buxhetit, kontabilitetin dhe raportimin, duke respektuar parimet e transparencës dhe të ligjshmërisë për të arritur objektivat dhe për të shmangur shpërdorimin, keqpërdorimin dhe vjedhjen e pasurisë.

Korporata e Investimeve Shqiptare për periudhën 2021-2022 nuk ka depozituar depozituar tek titullari i njësisë publike dhe nëpunësi i parë autorizues deklaratën dhe raportin përkatës për cilësinë dhe gjendjen e sistemeve të kontrollit të brendshëm të njësisë publike që mbulon, si dhe nuk ka caktim të Nëpunësit Zbatues dhe Autorizues.

Për vitin 2023, Korporata e Investimeve Shqiptare, ka hartuar dhe dërguar pyetësorin vjetor të vetëvlerësimit të sistemit të kontrollit të brendshëm për vitin 2023 me shkresën nr. 104/2 datë 29.03.2024, drejtuar strukturës përgjegjëse për Harmonizimin e Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, jashtë afatit të përcaktuar, veprime në kundërshtim me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar, neni 18/1 dhe neni 19, ku citohet: “Nëpunësi autorizues i çdo njësie të qeverisjes së përgjithshme, në bazë të vetëvlerësimit depoziton te titullari i njësisë publike dhe nëpunësi i parë autorizues deklaratën dhe raportin përkatës për cilësinë dhe gjendjen e sistemeve të kontrollit të brendshëm të njësisë publike që mbulon, për vitin e mëparshëm, jo më vonë se fundi i muajit shkurt aktual”. Korporata e Investimeve Shqiptare ka dërguar deklaratat për cilësinë e sistemit të kontrollit të brendshëm dhe raportet për funksionimin e kontrollit të brendshëm në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë. Struktura e raportimit respekton përcaktimet e Udhëzimit nr. 28, datë 15.12.2011 “Mbi paraqitjen e Deklaratës dhe Raportit Vjetor për cilësinë e Sistemit të Kontrollit të Brendshëm në Njësitë Publike”

Referuar përgjigjeve të pyetësorit, më poshtë rendisim punën e kryer nga institucioni i AIC-së, si dhe mangësitë e konstatuara në plotësimin e kërkesave që kërkojnë komponentët e kontrollit të brendshëm në drejtim të funksionimit me përgjegjshmëri, realizimit të objektivave të institucionit dhe përdorimit me efektivitet të fondeve të tij.

Për vitin 2024, Korporata e Investimeve Shqiptare ka caktuar znj. E. K. (Drejtor Ekzekutiv) si Nëpunës Autorizues dhe z. G. Sh. (Drejtor në Divizionin e Financës dhe Administratës), e përcaktuar me shkresën nr. 104/1 prot., datë 05.01.2024 “Për ngritjen e GMS në AIC”.

Sipas Manualit të MFK, në kreun III, “Komponentët e menaxhimit financiar dhe kontrollit”, neni 19 citohet: *Titullarët e njësive të sektorit publik, zbatojnë menaxhimin financiar dhe kontrollin nëpërmjet komponentëve të ndërlidhur me njëri-tjetrin:*

1. Mjedisi i kontrollit.
2. Menaxhimi i riskut.
3. Veprimtaritë e kontrollit.
4. Informacioni dhe komunikimi.
5. Monitorimi.

1. Mjedisi i kontrollit

Mjedisi i kontrollit përmban: Integritetin personal dhe etikën profesionale të nivelit menaxhues dhe punonjësve të tjerë të njësive publike; politikat menaxheriale dhe stilin e punës; strukturën organizative, garantimin e ndarjes së detyrës, hierarkinë dhe rregulla të qarta, të drejtat, përgjegjësitë dhe linjat e raportimit; Politikat dhe praktikat e menaxhimit të burimeve njerëzore dhe aftësitë profesionale të punonjësve.

a. *Integriteti personal dhe etika profesionale e nivelit menaxhues dhe punonjësve të tjerë të kësaj njësie publike.*

Në referencë të ligjit nr. 9131, datë 08.09.2003 “Për rregullat e etikës në administratën publike”, si dhe ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, nevojitet që punonjësit të respektojnë normat etike dhe profesionale të bashkëpunimit e të ndihmës së ndërsjellë, mbështetur në krijimin e një Kodi të Brendshëm Etik. Nga auditimi u konstatua se, institucioni ka hartuar dhe zbaton një kod etike, i cili është miratuar me Vendimi nr.13 të Këshillit Mbikëqyrës, prot. me nr. 8/1, datë 05.12.2022.

b. *Struktura organizative, garantimi i ndarjes së detyrave, rregullat e qarta, të drejtat, përgjegjësitë dhe linjat e raportimit.*

Korporata e Investimeve Shqiptare ka funksionuar në bazë të strukturës së miratuar me Vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr. 4 dhe nr. 5 datë 22.07.2021 “Për miratimin e strukturës organizative të KISH” dhe “Vendim mbi strukturën e pagave në AIC”.

Aktualisht, AIC funksionon në bazë të strukturës së miratuar Vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr.23 datë 20.12.2023 “Për miratimin e strukturës organizative të AIC”. AIC ushtron veprimtarinë e vet mbi bazën e Rregullores së Organizimit dhe Funksionimit të Brendshëm, miratuar me Vendimin e Këshillit Mbikëqyrës me nr. 23, datë 05.12.2022 “Për miratimin e rregullores së brendshme për organizimin dhe funksionimin e AIC-së.” Nga ana e Grupit të Auditimit konstatohet se Rregulloja e Brendshme e AIC-së nuk ka reflektuar ndryshimet e strukturës organizative, pasi nuk është bërë rishikimi i saj duke sjellë mangësi në ndarjen e detyrave, përgjegjësi dhe linjën e raportimit të punonjësve. Rregullorja e brendshme e funksionimit duhet të reflektojë të gjithë aspektet e organizimit dhe funksionimit administrativ në institucion. Në rregullore mungojnë përcaktimet e përgjegjësisë për kryerjen e raportimeve për buxhetin.

Gjithashtu, nga auditimi konstatohet se për secilën drejtori/divizion përkatës, nuk ka manualet/procedurat e veta të punës.

c. Stili i të vepruarit dhe filozofia e menaxhimit.

Nga ana e Grupit të Auditimit është konstatuar se në AIC nuk ka një rregullore të brendshme të përditësuar ku të jenë evidentuar delegimi i detyrave dhe mënyra e dokumentimit të tyre veprime këto në kundërshtim me me ligjin nr.10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, neni 15 “Rregulla të përgjithshme për delegimin e detyrave”, si dhe Kapitulli III “Delegimi i detyrave”, të Manualit për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin,

d. Politikat dhe praktikat e menaxhimit të burimeve njerëzore.

Në AIC, burimet njerëzore menaxhohen nga Divizioni i Financës dhe Administratës. Nga auditimi u konstatua se për periudhën objekt auditimi janë kryer dhe janë përfshirë në dosje vlerësimet e punonjësve.

e. Për ruajtjen dhe zhvillimin e kompetencave profesionale të punonjësve gjatë viteve objekt auditimi, u konstatua se nga ana e Divizioni i Financës dhe Administratës nuk janë paraqitur programe specifike për trajnimin e punonjësve të administratës, veprime në kundërshtim me Manualin për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, Kap. II, pika 2.5.1 “Mjedisi i kontrollit (ose mjedisi i brendshëm i njësisë)”, paragrafët “Politikat dhe praktikat që lidhen me burimet njerëzore” dhe “Profesionalizmi i stafit”.

2. Menaxhimi i riskut

Risku dhe menaxhimi i riskut përcaktohet në Nenin 21 të Ligjit për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin. Risku zakonisht përcaktohet si pasiguria e rezultatit, qoftë kjo mundësi pozitive apo negative i veprimeve dhe ngjarjeve. Kjo është mundësia që një ngjarje e caktuar, e cila do të ketë ndikim në arritjen e objektivave të njësisë, mund të ndodhë. Risku matet me efektin e tij dhe shkallën e mundësisë së ndodhjes. Menaxhimi i riskut përfshin identifikimin, vlerësimin, kontrollin dhe monitorimin e këtyre ngjarjeve të mundshme apo situatave që mund të kenë një efekt negativ në arritjen e objektivave të njësisë dhe është projektuar për të dhënë siguri të arsyeshme se objektivat do të arrihen.

Nga auditimi u konstatua se nuk janë kryer takime me stafin menaxherial mbi çështjet e menaxhimit të riskut, diskutimin e problematikave dhe dokumentimin e veprimtarisë së përditshme të menaxhimit të riskut. AIC nuk ka hartuar strategjinë për menaxhimin e riskut, veprim në kundërshtim me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar, pika 2, neni 21 “Menaxhimi i Riskut”, ku citohet:...“*Titullari i njësisë publike miraton një strategji, e cila përditësohet çdo tre vjet ose sa herë që ka ndryshime thelbësore të mjedisit të risku. Nëpunësi autorizues analizon dhe përditëson kontrollin që synojnë minimizimin e riskut, të paktën një herë në vit.*”, si dhe me udhëzimin e MFE nr. 16, datë 20.07.2016, “Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe koordinatorit të riskut në njësitë publike”, pika 3.2.1 ku citohet:... “*Titullari i njësisë publike është përgjegjës për përcaktimin e objektivave dhe strategjisë. Kjo përfshin: Menaxhimin efektiv të riskut*”. 3.2.2 “*Nëpunësi autorizues/koordinatori i riskut ka përgjegjësi për: Ngritjen dhe funksionimin e sistemit të MR, përcaktimin e nivelit të oreksit të riskut; Vlerësimin e sistemit të MR (...)*”.

Mbështetur në nenin 18, të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar, me shkresën nr. 104/2 dhe 104/3 prot., datë 29.03.2024, Divizioni i Financës dhe Administratës ka dërguar në Drejtorinë e Përgjithshme të Harmonizimit të Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik në MF, Deklaratën për cilësinë e sistemit të kontrollit të brendshëm; Raportin për funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm të AIC, Pyetësin e vetëvlerësimit për komponentët e MFK-së nëpërmjet të cilit synohet ndërgjegjësim i mëtejshëm mbi rëndësinë dhe efektivitetin e sistemit të kontrollit të brendshëm dhe Planin e veprimit.

Nga auditimi u konstatua se institucioni i AIC-së nuk ka hartuar një regjistër risku, veprim ky në kundërshtim me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, i

ndryshuar pika neni 11, ku citohet... “Menaxherët e tjerë të strukturave të të gjitha niveleve të njësisë publike janë përgjegjës dhe raportojnë dhe i japin llogari eprorit, sipas shkallës hierarkike, për:

2. Identifikimin dhe krijimin e regjistrimit të riskut, vlerësimin, kontrollin e risqeve që vënë në rrezik arritjen e objektivave dhe realizimin me sukses të veprimtarive të strukturave që ata drejtojnë”.

Nga ana e grupit të auditimit konstatohet se për vitet 2021-2023 AIC nuk ka ngritur Grupin e Menaxhimit Strategjik, rrjedhimisht nuk ka takime të dokumentuara të veprimtarisë së GMS-së, i cili duhet të mbledhet të paktën 4 herë në vit, veprime këto në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar, pika nr. 1, e nenit 27 “Takimet periodike ndërmjet menaxherëve të njësisë publike”, si dhe me Udhëzimin nr. 16 të MFE, datë 20.07.2016 “Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe koordinatorit të riskut në njësitë publike” pika nr. 3, paragrafi 2.2.4 “Roli i GMS në sistemin e MFK”, së, e cila përcakton se: “GMS duhet të mbledhet të paktën katër herë në vit. Vendimet duhet të jenë objektive dhe të merren si grup, (...).Vendimet e GMS duhet të regjistrohen nga sekretari dhe vihen në dispozicion të drejtimit të njësisë publike.”

Për vitin 2024, është ngritur Grupi për Menaxhimin Strategjik (GMS) me shkresën nr. 104/1 prot., datë 05.01.2024.

3. Aktivitetet e kontrollit

Nga auditimi u konstatua se sa i përket aktiviteteve të kontrollit, AIC nuk ka hartuar hartë dhe manual të proceseve të punës nga secili divizion i saj.

Gjithashtu, AIC nuk ka të miratuar një rregullore të përditësuar me ndryshimet ligjore në fuqi, duke përfshirë dhe ndryshimet në organikën e institucionit të AIC-së, duke përcaktuar qartë detyrat. Rrjedhimisht, nuk ka miratuar Gjurmën e Auditimit, si një dokument të unifikuar për të gjitha proceset e AIC-së. Nga auditimi konstatohet se nga ana e AIC-së nuk ka një metodologji të hartuar dhe të miratuar nga Këshilli Mbikëqyrës mbi përgatitjen e projekt-propozimeve.

Veprimet e mësipërme janë kryer në kundërshtim ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar, neni 16, pika 2 dhe 3 ku citohet... “2. Titullarët e njësisë publike miratojnë gjurmët e auditimit për procedura që lidhen me veprimtari kryesore të njësisë dhe sigurojnë që të gjitha operacionet e njësisë publike dokumentohen në atë formë, që u mundëson audituesve të brendshëm, të jashtëm dhe autoriteteve mbikëqyrëse të kuptojnë mjedisin e kontrollit. 3. Gjurma e auditimit arkivohet sipas dispozitave ligjore në fuqi”.

4. Informimi dhe komunikimi

Nga auditimi u konstatua se, përgjithësisht komunikimi me titullarin dhe nëpunësit e tjerë është bërë në formën dhe kohën e duhur, për ti ndihmuar ata në përmbushjen e detyrave dhe të përgjegjësisë. Titullari është informuar nga drejtuesit me anë të mbledhjeve, nëpërmjet relacioneve dhe raporteve rreth këtyre mbledhjeve. Punonjësit brenda institucionit komunikojnë me postë elektronike dhe në mënyrë verbale, ndërsa jashtë institucionit komunikohet kryesisht në formë shkresore zyrtare dhe ka korrespondencë të rregullt me subjektet e tjera, pa përjashtuar komunikimin elektronik dhe atë telefonik. Nga auditimi konstatohet se në faqen zyrtare të AIC-së, nuk ka informacion të plotë dhe shterues mbi veprimtarinë, planet e biznesit, planet e punës etj.

5. Monitorimi

Sa i takon raportimit financiar mbi realizimin e buxhetit, AIC raporton nëpërmjet analizave të dhe raporteve 3- mujore, 6-mujore, 9-mujore dhe raportet vjetore. Sa i takon veprimtarisë, nga AIC është

raportuar mbi bazë vjetore për veprimtarinë së institucionit, të cilat nuk janë të detajuara dhe shterues. Sa i takon monitorimit të buxhetit, konstatohet se nga ana e AIC-së, nuk ka raporte monitorimi të buxhetit.

2.6 Mbi administrimin dhe menaxhimin e marrëdhënieve të punës dhe të pagave.

Për auditimin e këtij drejtimi auditimi u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

- Vendimet e Këshillit Mbikëqyrës mbi miratimin e strukturës organizative dhe strukturës së pagave, për periudhën objekt auditimi;
- Dokumentacioni i dosjeve individuale të punonjësve të institucionit;
- Listëpagesat mujore dhe shpërblimet për periudhën objekt auditimi;

Korporata e Investimeve Shqiptare (Korporata këtu e më poshtë) është person juridik, i organizuar në formën e një shoqërie aksionare, sipas ligjit për tregtarët dhe shoqëritë tregtare dhe pronar i vetëm i saj është shteti, i përfaqësuar nga ministri përgjegjës për Ekonominë, Kulturën dhe Inovacionin.

1. Struktura organizative

Neni 11, i ligjit nr. 71/2019 “Për Korporatën e Investimeve Shqiptare” përcakton se: “Organet e Korporatës janë: **1.** Asambleja e Përgjithshme. **2.** Këshilli Mbikëqyrës. **3.** Drejtori Ekzekutiv. **4.** Bordi Këshillimor.”

Asambleja e Përgjithshme përfaqësohet nga aksionari i vetëm i Korporatës, i cili në zbatim të pikës 2 të nenit 4 të ligjit nr. 71/2019 “Për Korporatën e Investimeve Shqiptare” është Ministria përgjegjëse për ekonominë.⁹ Këshilli Mbikëqyrës përbëhet nga anëtarë të institucioneve qendrore dhe të pavarur, që emërohen dhe lirohen nga detyra nga Asambleja e Përgjithshme.

Drejtori Ekzekutiv është përfaqësuesi ligjor i Korporatës dhe emërohet dhe lirohet nga Këshilli Mbikëqyrës. Bordi Këshillimor përbëhet nga 9 anëtarë, që zgjidhen nga Asambleja e Përgjithshme, tre anëtarë përfaqësojnë institucionet qendrore, dy anëtarë janë nga institucionet ndërkombëtare financiare të zhvillimit dhe katër anëtarë të tjerë janë të pavarur.

Këshilli Mbikëqyrës i Korporatës.

Sipas pikës 1 të nenit 13 të ligjit nr. 71/2019 Këshilli Mbikëqyrës i Korporatës (Këshilli, këtu e më poshtë) ka numër tek anëtarësh, jo më pak se 5 anëtarë, ndërsa sipas pikës 1 të nenit 14 të Statutit të Korporatës Këshilli përbëhet deri në 7 anëtarë, nga institucionet qendrore dhe të pavarur, të cilët emërohen nga Asambleja e Përgjithshme. Sipas pikës 3, të nenit 14 të Statutit të Korporatës përcaktohet se: “Anëtarë të Këshillit zgjidhen ata persona që:

- a) Nuk kanë qenë të dënuar me vendim gjykatë të formës së prerë për kryerjen e një vepre ose kundërvajtje penale;
- b) Zotërojnë të paktën gradën “Master shkencor” ose më lart në fushën e ekonomisë, financave, biznesit, drejtësisë ose fusha të ngjashme, si dhe të paktën 7 vite punë në pozicion drejtues publik ose privat;
- c) Kanë shtetësi Shqiptare ose të huaj.”
- d) Gjithashtu në pikën 6 të nenit 14, të Statutit të Korporatës përcaktohet se: “Anëtarët e Këshillit nuk mund të bëjnë pjesë në më shumë se 2 (dy) këshilla të shoqërive tregtare me seli në Republikën e Shqipërisë.”

Korporata, për periudhën objekt auditimi, **nuk disponon informacion** për anëtarët e Këshillit, nëse prej tyre plotësohen kriteret e përcaktuara në gërmat a-c, të pikës 3 dhe të pikës 6 të nenit 14 të Statutit të Korporatës.

⁹ Prej datës 17.01.2024, Ministria e Ekonominë, Kulturës dhe Inovacionit.

Mandati i anëtarëve të Këshillit, sipas pikës 1 të nenit 15 të Statutit të Shoqërisë është jo më i gjatë se 3 vite, me të drejtë rizgjedhje, nga auditimi ka rezultuar se për periudhën objekt auditimi është respektuar mandati i tyre.

Në mënyrë të detajuar përbërja e Këshillit Mbikëqyrës ka qenë si më poshtë:

Tabela nr. 1 “Përbërja e Këshillit Mbikëqyrës për periudhën 2020-30.06.2024”

Nr.	Emër Mbiemër	Data e fillimit	Data e mbarimit	Data që Rizgjidhet	Data e largimit	
1	M. Dh.	15.07.2020	15.07.2023		01.03.2023	
2	E. J. J.	15.07.2020	15.07.2023		13.07.2023	
3	D. W.K.	15.07.2020	15.07.2023	07.08.2023		
4	A. Xh.	15.07.2020	15.07.2023	07.08.2023	08.04.2024	
	A. Xh.	si kryetare e Këshillit Mbikëqyrës periudha Janar-Mars 24				
5	E. Xh.	08.09.2020	08.09.2023		25.08.2021	
6	A. Gj.	06.01.2022	06.01.2025		20.02.2023	
7	M. Dh.	20.02.2023	20.02.2026		08.09.2023	
8	R. Xh.	31.03.2023	31.03.2026		08.08.2024	
	R. Xh.	si kryetare e Këshillit Mbikëqyrës periudha Maj - Korrik 24				
9	O. B.	02.06.2023	02.06.2026		08.09.2023	
10	M. K.	02.06.2023	02.06.2026		08.09.2023	
11	E. K.	13.07.2023	13.07.2026		08.09.2023	
12	E. M.	08.09.2023	08.09.2026			
13	E. F.	13.09.2023	13.09.2026			
		me kontrate specifike periudha Prill 24 e në vazhdim				
14	E. L.	13.09.2023	13.09.2026		25.06.2024	
15	B. S.	27.03.2024	27.03.2027		29.10.2024	
16	O. M.	08.04.2024	08.04.2027		30.10.2024	
17	A. P.	08/04/2024	08/04/2027			
18	A. K.	08/04/2024	08/04/2027			

Burimi: Korporata e Investimeve Shqiptare, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH.

Viti 2020.

Nga tabela më sipër rezulton se Këshilli Mbikëqyrës ka pasur 5 anëtarë, kjo në përputhje me përcaktimet e pikës 1 të nenit 13 të ligjit nr. 71/2019, ku përcaktohet se: “Këshilli Mbikëqyrës i Korporatës ka numër tek anëtarësh, jo më pak se 5 anëtarë”, por jo në përputhje me pikën 1 të nenit 14 të Statutit të Korporatës, ku përcaktohet se: “Këshilli përbëhet nga 7 anëtarë...”. Për vitin 2020 Korporata nuk ka kryer asnjë veprimtari dhe emërimi i tyre nuk ka pasur efekt financiar. Vendimet e emërimit të këtyre anëtarëve nuk akeshohen pranë QKB-së dhe pse data e regjistrimit të Korporatës në QKB është 15.07.2020. Gjatë vitit 2020, 3 anëtarë të Këshillit janë nga MFE dhe 2 të pavarur, kjo në përputhje me kërkesat e pikës 1 të nenit 13 të ligjit nr. 71/2019 ku përcaktohet se: “...Këshilli Mbikëqyrës ka numër tek anëtarësh, jo më pak se 5, ku shumica janë të pavarur.

Gjithashtu **mungon informacioni/dokumentacioni vërtetues** mbi plotësimin e kriterëve të përcaktuara në pikat 3/a-c, të nenit 14 të Statutit të Korporatës.

Për periudhën 2020-31.12.2023 Këshilli nuk ka pasur të caktuar Kryetar, po të gjithë kanë qenë me status “anëtar”.

Viti 2021

Gjatë vitit 2021 Këshilli Mbikëqyrës i Korporatës ka vijuar me 5 anëtarë, pra me **dy anëtarë më pak** se kriteri i përcaktuar në pikën 1 të nenit 14 të Statutit të Korporatës. Prej datës 25.08.2021 Këshilli ka funksionuar me 4 anëtarë, pasi me vendimin e Asamblesë së Përgjithshme të Aksionarëve nr. 73, datë 25.08.2021 z. E. Xh. është liruar nga detyra, **pa u specifikuar arsyeja** e lirimit nga detyra, pasi sipas pikës 4 të nenit 15 të Statutit të Korporatës përcaktohet se: “Një ose më shumë anëtarë mund të lirohen/shkarkohen. Me shkak, nga Asambleja, rastet e lirimit/ shkarkimit përfshijnë neglizhencën në kryerjen e detyrave, shkeljen e rëndë të rregullave të brendshme dhe cënimin e interesit të Korporatës, dënimin nga gjykuara me vendim të formës së prerë për kryerjen e një vepre ose kundërvajtje penale,

falimentimin, ndalimin ose pezullimin nga gjykata për ushtrimin e detyrës si nëpunës shtetëror apo në shërbimin publik ose të ushtrisë veprimtarinë apo mjeshtërinë, marrjen pjesë në mënyrë aktive në veprimtari politike, gjatë kryerjes së detyrës.”

Funksionimi i Këshillit Mbikëqyrës me 4 anëtarë për 4 muaj, përgjatë vitit 2021 është në **kundërshtim** dhe me pikën 1 të nenit 13 të ligjit nr. 71/2019.

Në vitin 2021, Këshilli ka pasur 3 anëtarë nga institucionet qendrore (nga MFE)dhe 2 anëtarë të pavarur ndërkombëtarë, si gjatë vitit 2020. Gjatë vitit 2021 kanë nisur të shpërndahen shpërblimet e anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës, të cilat janë bërë sipas Vendimit të Këshillit Mbikëqyrës nr. 7, datë 07.09.2021, ku Këshilli ka vendosur të miratojë strukturën e pagave dhe shpërblimeve për Korporatën. Këshilli, bazuar në gërmën “h”, pika 1 të nenit 14 të ligjit nr. 71/2019, përcakton pagat dhe shpërblimin e organeve dhe administratës së Korporatës; organ i Korporatës sipas pikës 2 të nenit 11, të ligjit të sipërcituar është dhe vetë Këshilli Mbikëqyrës. Sipas aneksit nr. 2 të Vendimit nr. 7, datë 07.09.2021 të Këshillit Mbikëqyrës pagat e anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës do të shpërblehen sipas skemës së përcaktuar në pikën 5 të nenit 13 të ligjit nr. 71/2019, ku përcaktohet se: “Shpërblimi për anëtarin e Këshillit Mbikëqyrës nuk është më pak se 1/3 e pagës së Drejtorit Ekzekutiv.” Konkretisht sipas këtij aneksi përcaktohet se:

- A. “Për anëtarët që vijnë nga institucionet qendrore, shpërblimi vjetor të jetë në kufirin e 1/3 të pagës minimale të Drejtorit Ekzekutiv.
- B. Për anëtarët e pavarur ndërkombëtarë aktualë, sipas komunikimeve midis Aksionarit dhe anëtarit të pavarur, shpërblimi i anëtarit të jetë në shumën e USD 5,000(pesëmijë)/ muaj (ose ekuivalenti në euro) neto, plus shpenzimet e arsyeshme në funksion të përmbushjes së detyrës për një periudhë fillestare 6 mujore. Duke qenë se anëtari i pavarur vepron në kapacitet individual, Korporata të mbulojë shpenzimet e një police sigurimi profesional në rast të një procedimi të mundshëm gjyqësor. Gjithashtu, Korporata do të mbulojë shpenzimet e udhëtimeve në klasin biznes dhe shpenzimet e lidhura me to, nëse udhëtimi nevojitet për përmbushjen e dhe ushtrimin e detyrës. Shpenzimet për udhëtimin, si dhe ato gjatë kryerjes së detyrës, duhet të miratohen paraprakisht nga Drejtori Ekzekutiv ose Drejtori i Divizionit të Financës. Korporata lidh kontrata individuale me anëtarët e pavarur ku reflektohen termat e shpërblimit.”¹⁰

Paga e anëtarëve nga institucionet qendrore është marrë duke pasur si referencë pagën e Drejtorit Ekzekutiv, e cila sipas tabelës I1 të Vendimit të Këshillit Mbikëqyrës nr. 7 datë 07.09.2021, i përket nivelit A1 dhe sipas tabelës III të këtij vendimi “Tabelë krahasimore e pagave minimale dhe maksimale për pozicionet kyç të punës ndërmjet AIC, FSHZH, KESH dhe OSHEE” është më e lartë krahasuar me institucionet e marra në referencë dhe nuk e përcaktuar fikse, por me kufij minimalë dhe maksimalë, konkretisht 340,000-400,000 lekë. Në mënyrë krahasimore niveli i pagave sipas tabelës së sipërcituar për pozicionin “Drejtor ekzekutiv/administrator” paraqitet si më poshtë:

Tabela nr. 2: “Tabelë krahasimore e pagave minimale dhe maksimale për pozicion AIC, FSHZH, KESH dhe OSHEE”

Në mijë lekë

Pozicioni	AIC	FSHZH	KESH	OSHEE	Mesatarja	% e AIC/Mesatares për MIN-	Max
Drejtor Ekzekutiv/Administrator	340-400	300	300	300	300	13%	33%

Burimi: Korporata e Investimeve Shqiptare, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH.

Nga tabela më sipër rezulton se niveli i pagës për pozicionin Drejtor Ekzekutiv, është më e lartë se paga korrespondente e institucioneve të marra për referencë, 13% më te lartë në kufirin minimal dhe 33% më e lartë për kufirin maksimal.

Nga verifikimi i bërë për nivelin e shpërblimit të anëtarëve nga institucionet qendrore rezulton se niveli i përcaktuar i shpërblimit të tyre është sa 1/3 e nivelit minimal të shpërblimit të Drejtorit Ekzekutiv, pra siç përcaktohet në pikën A të aneksit nr. 2 të Vendimit të Këshillit Mbikëqyrës nr. 7, datë 07.09.2021.

¹⁰ Pika B është miratuar në mbledhjen e Këshillit Mbikëqyrës, të datës 22.07.2021.

Për vitin 2021 shpërblimet e marra nga anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës paraqiten si më poshtë:

Tabela nr. 3: “Shpërblimet e marra nga anëtarët e Këshillit për vitin 2021”

Në lekë

Nr.	Emër Mbiemër	Dt. e fillimit	Dt. e largimit	1.Pagesa e shërbimit mujor	2.Totali i shpërblimit	Muaj shpërblimi (2/1)
1	M. Dh.	15.07.2020	01.03.2023	113,333 ¹¹	679,998	-
2	E. J. J.	15.07.2020	13.07.2023	\$5,882	3,818,824	35,294
3	D. W. K.	15.07.2020		\$5,882	3,818,824	35,294
4	A. Xh.	15.07.2020	08.04.2024	131,333	679,999	-
5	E. Xh.	08.09.2020	25.08.2021	-	-	-
Totali					8,997,645	

Burimi: Korporata e Investimeve Shqiptare, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH.

Nga tabela më sipër rezulton se:

- Shpenzimet totale për shpërblimin e anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës janë 8,997,645 lekë;
- Anëtari z. E. Xh. nuk ka marrë asnjë shpërblim për vitin 2021 dhe pse rezulton të jetë larguar më 25.08.2021;

Këshilli Mbikëqyrës përgjatë vitit 2021 nuk ka pasur Kryetar, por të gjithë kanë qenë anëtarë.

Konkluzion: Për vitin 2021, rezulton se Këshilli ka funksionuar me 2 anëtarë më pak se numri i përcaktuar në pikën 1, të nenit 14 të Statutit të Korporatës dhe prej datës 25.08.2021 ka funksionuar me 3 anëtarë, më pak. Z. Xh. i larguar më 25.08.2021 nuk ka marrë shpërblim.

Viti 2022

Gjatë vitit 2022 Këshilli Mbikëqyrës i Korporatës ka vijuar me 5 anëtarë, pra me dy anëtarë më pak se kriteri i përcaktuar në pikën 1 të nenit 14 të Statutit të Korporatës.

Në vitin 2022, Këshilli ka pasur 3 anëtarë nga institucionet qendrore (MFE) dhe 2 anëtarë të pavarur. Niveli i shpërblimeve për anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës ka qenë në përputhje me Vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr. 7, datë 07.09.2021, konkretisht 113,333 lekë/muaj për anëtarët nga institucionet qendrore dhe 5,882\$/muaj për anëtarët e pavarur. Në mënyrë të detajuar përbërja dhe shpërblimet e anëtarëve të Këshillit paraqiten si në tabelën më poshtë:

Tabela nr. 4: “Përbërja dhe shpërblimet e marra nga anëtarët e Këshillit për vitin 2022”

Nr.	Emër Mbiemër	Data e fillimit	Data e mbarimit	Data e largimit	Shpërblimi Mujor		Shpërblimi		Muaj shpërblimi	
1	M.Dh.	15.07.20	15.07.2023	01.03.2023	ALL	113,333	ALL	1,359,996	-	12
2	E. J. J.	15.07.20	15.07.2023	13.07.2023	\$	5,882	ALL	8,088,852	\$70,584	12
3	D.W.K.	15.07.20	15.07.2023		\$	5,882	ALL	8,088,852	\$70,584	12
4	A.Xh.	15.07.20	15.07.2023	08.04.2024	ALL	113,333	ALL	1,359,996	-	12
5	A. Gj.	06.01.22	06.01.2025	20.02.2023	ALL	113,333	ALL	1,359,996		12
Totali							ALL	20,257,692		

Burimi: Korporata e Investimeve Shqiptare, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH.

Nga tabela më sipër rezulton se:

- Shpenzimet totale për shpërblimin e anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës, për vitin 2022 janë 20,257,692 lekë;
- Shpërblimet për anëtarët nga institucionet qendrore kanë qenë në përputhje me Vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr. 7, datë 07.09.2021, ndërsa anëtarë të pavarur kanë qenë 2 me pagesën sipas pikës 5/B të vendimit të sipërcituar.

¹¹ Llogaritur mbi nivelin minimal të pagës së Drejtorit ekzekutiv (340,000/3=113,333 lekë).

Këshilli Mbikëqyrës përgjatë vitit 2022 nuk ka pasur Kryetar, por të gjithë kanë qenë me status “anëtar”.

Viti 2023

Gjatë vitit 2023 Këshilli Mbikëqyrës i Korporatës ka pasur ndryshime të numrit të anëtarëve të Këshillit, por gjatë gjithë vitit numri i anëtarëve ka qenë mbi 5, por më pak se 7 siç përcaktohet në pikën 1të nenit 14, të Statutit të Korporatës.

Gjatë vitit 2023 Këshilli Mbikëqyrës nuk ka pasur Kryetar, por të gjithë kanë qenë me status “anëtar”. Përbërja e anëtarëve dhe shpërblimet e marra prej tyre, në mënyrë të detajuar për vitin 2023 paraqitet si në tabelën më poshtë:

Tabela nr. 5: “Përbërja dhe shpërblimet e marra nga anëtarët e Këshillit për vitin 2023”

Nr.	Emër Mbiemër	Dt. fillimi	Dt. Mbarimit	Dt.Rizgjidhjes	Dt. largimit	Shpërblimi mujor		Shpërblimi 2023	
1	M. Dh.	15.07.20	15.07.23		01.03.23	113,333		226,666	-
2	E. J. J.	15.07.20	15.07.23		13.07.23		\$5,882	2,486,203	\$23,528.00
3	D. W.K.	15.07.20	15.07.23	07.08.23			\$5,882	8,515,248	\$85,289.53
4	A. Xh.	15.07.20	15.07.23	07.08.23	08.04.24	113,333		1,359,996	-
5	A. Gj.	06.01.22	06.01.25		20.02.23	113,333		-	-
6	M. Dh.	20.02.23	20.02.26		08.09.23	113,333		712,379	-
7	R. Xh.	31.03.23	31.03.26		08.08.24	113,333		1,019,997	-
8	O. B.	02.06.23	02.06.26		08.09.23	113,333		372,380	-
9	M. K.	02.06.23	02.06.26		08.09.23	113,333		372,380	-
10	E. K.	13.07.23	13.07.26		08.09.2023	113,333		215,873	-
11	E. M.	08.09.23	08.09.26			113,333		426,348	-
12	E. F.	13.09.23	13.09.26			113,333		410,158	-
13	E. L.	13.09.23	13.09.26		25.06.2024	113,333		410,158	-
TOTALI								16,527,786	

Burimi: Korporata e Investimeve Shqiptare, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH.

Nga tabela më sipër rezulton se:

- Shpenzimet totale për shpërblimin e anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës, për vitin 2023 janë 16,527,786 lekë;
- Pagesat për anëtarët e pavarur, kanë qenë të diferencuara vetëm për 2 nga anëtarët e pavarur ndërkombëtarë të Këshillit Mbikëqyrës, konkretisht për z. E. J. J. dhe z. D. W. K.

Numri i anëtarëve të Këshillit, sipas muajve të vitit 2023, paraqitet si në tabelën më poshtë:

Tabela nr. 6: “Numri anëtarëve të Këshillit për çdo muaj të vitit 2023”

Muaji	Nr. i anëtarëve të Këshillit
Janar	5
Shkurt	6
Mars	6
Prill	5
Maj	5
Qershor	7
Korrik	7
Gusht	7
Shator	5
Tetor	5
Nëntor	5
Dhjetor	5
Mesatarja/muaj	5.7

Burimi: Korporata e Investimeve Shqiptare, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH.

Nga verifikimi i informacionit të vënë në dispozicion të grupit të auditimit rezultoi se për anëtarët e Këshillit, të paraqitur në tabelën më sipër 8 prej ¹²tyre kanë pasur statusin “të pavarur”, niveli i shpërblimeve për anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës ka qenë në përputhje me Vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr. 7, datë 07.09.2021, në lidhje me anëtarët nga institucionet qendrore dhe anëtarët e pavarur ndërkombëtarë aktualë në kohën e Vendimit nr. 7, datë 07.09.2021, por për anëtarët e pavarur të tjerë vendimi i mësipërm **nuk ka parashikuar termat e shpërblimit**. Nga auditimi rezultoi se shpërblimi i tyre është bërë si për anëtarët e institucioneve qendrore, konkretisht në shumën 113,333 lekë/muaj Me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr. 23, datë 20.12.2023 shpërblimi i anëtarëve të Këshillit ka ndryshuar si më poshtë:

“Shpërblimi i anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës është në nivelin 1/3 e pagës minimale të Drejtorit Ekzekutiv. Duke pasur parasysh kontributet e ndryshme personale të secilit anëtar të Këshillit Mbikëqyrës, ky i fundit mund të miratojë një shtesë mbi shpërblimin deri në 35% të vlerës së sipërpërmendur. Kryetari dhe Zëvendës Kryetari i Këshillit Mbikëqyrës marrin shpërblim shtesë përkatësisht në vlerat 20% dhe 10% të shpërblimit të anëtarit.”

Periudha 01.01.2024-30.06.2024

Gjatë gjashtë mujorit të parë të vitit 2024, Këshilli Mbikëqyrës i Korporatës ka pasur ndryshime të numrit të anëtarëve dhe janë përcaktuar kryetarët e Këshillit. Në mënyrë të detajuar përbërja e anëtarëve dhe shpërblimet e marra nga anëtarët e Këshillit për 6 mujin e parë të vitit 2024 paraqiten si në tabelën më poshtë:

Tabela nr. 7: “Përbërja dhe shpërblimet e marra nga anëtarët e Këshillit për periudhën 01.01-30.06.2024”

Nr.	Emër Mbiemër	Data e fillimit	Data e mbarimit	Data që Rizgjidhet	Data e largimit	Shpërbl/ mujour		Shpërblimi	
								6M2024	
1	D. W. K.	15.07.20	15.07.23	07.08.23			\$5.882	3,393,914	\$35,292
2	A. Xh.	15.07.20	15.07.23	07.08.23	08.04.24	133,333		-	
	A. Xh.	kryetare e Këshillit Mbikëqyrës periudha Janar-Mars 24				160,000		516,364	
3	R. Xh.	31.03.23	31.03.26		08.08.24	133,333		533,332	
	R. Xh.	kryetare e Këshillit Mbikëqyrës periudha Maj - Korrik 24				160,000		320,000	
4	E. M.	08.09.23	08.09.26			133,333		799,998	
		13.09.23	13.09.26			133,333		533,332	
5	E. F.	kontrate specifike periudha Prill 24 e në vazhdim				180,000		437,249	
6	E. L.	13.09.23	13.09.26		25.06.24	133,333		478,787	
7	B. S.	27.03.24	27.03.27		29.10.24	146,666		454,114	
8	O. M.	08.04.24	08.04.27		30.10.24	133,333		369,696	
TOTAL								7,836,786	\$35,292

Burimi: Korporata e Investimeve Shqiptare, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH

Nga tabela më sipër rezulton se:

- Për 6 mujin e parë të vitit 2024, totali i shpërblimeve të marra nga anëtarët e Këshillit është 7,836,786 lekë.
- Me Vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr. 2, datë 07.03.2024 është vendosur të pranohet kërkesa e bërë nga anëtari i Këshillit, z. F. për shtesën 35% mbi shpërblimin bazë si anëtar i Këshillit Mbikëqyrës. Nga verifikimi i kërkesës së bërë nga Z. F. në dispozicion të grupit të auditimit u vu në dispozicion korrespondenca që ky i fundit ka pasur më anëtarët e Këshillit mbikëqyrës nëpërmjet email, nga ku rezultoi se në lidhje me shpërblimin ka sugjeruar të rishitet me arsyetimin si më poshtë: *“Lidhur me masën e shpërblimit, duke patur parasysh kontributin tim në dizejnimin e AIC dhe drejtimin e saj si Drejtor Ekzekutiv në 3 vitet e para, besimin e mirë që kam treguar*


¹² Në tabelën nr. 5: “Përbërja dhe shpërblimet e marra nga anëtarët e Këshillit për vitin 2023” anëtarët të pavarur kanë qenë anëtarët e paraqitur në rreshtat nr. 2; 3; 8; 9; 10; 11; 12; 13.

ndaj AIC si anëtar i Bordit, ku kam plotësuar detyrat edhe në mungesën e një kontrate me AIC dhe me shpërblim minimal, dëshiroj të kërkoj rritjen prej 35% të parashikuar mbi kompensimin bazë.

- Shpërblimi i anëtarit të Këshillit Mbikëqyrës z. B. S., rezulton më i lartë pasi ka dhe shtesën prej 10% për shkak të pozicionit si nënkryetar i Këshillit Mbikëqyrës.

Në mënyrë të përmbledhur totali i shpenzimeve për shpërblimin e anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës për vitet 2020-2023 paraqitet ¹³si më poshtë:

Grafiku nr. 1: “Shpërblimet e anëtarëve të Këshillit për vitet 2020-2023”



Burimi: Korporata e Investimeve Shqiptare, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH.

Nga grafiku më sipër rezulton totali i shpërblimeve më i lartë konsiston në vitin 2023, kjo për faktin se dhe numri mesatar i anëtarëve ka qenë mbi 5 (5.7 sipas ¹⁴përlllogaritjeve të bëra nga grupi i auditimit të KLSH).

Bordi Këshillimor

Pika 1, e nenit 17, të ligjit nr. 71/2019 përcakton se: “Bordi Këshillimor përbëhet nga 9 anëtarë, që zgjidhen nga Asambleja e Përgjithshme” dhe në pika 2 e po këtij neni përcakton se: “Tre anëtarë përfaqësojnë institucionet qendrore, dy anëtarë janë nga institucionet ndërkombëtare financiare të zhvillimit dhe katër anëtarë të tjerë janë të pavarur”. Nga auditimi rezultoi se për periudhën objekt auditimi, janë emëruar më datë 08.04.2024 vetëm dy anëtarë konkretisht, A. P. dhe A. K., kjo në kundërshtim më pikën 1 të nenit 17 të ligjit nr. 71/2019, gjithashtu rezultoi se Bordi nuk është mbledhur asnjëherë, nga data e emërimit deri më 31.06.2024, pavarësisht këtij fakti, kanë marrë shpërblim në shumën 277,273 lekë/anëtar. ¹⁵

Struktura e AIC

Struktura dhe organika e Korporatës miratohen nga Këshilli Mbikëqyrës dhe marrëdhëniet e punës së personelit të Korporatës rregullohen sipas dispozitave të Kodit të Punës, të Republikës së Shqipërisë dhe akteve të brendshme të Korporatës.

Nga auditimi rezultoi se Rregullorja e Brendshme e Korporatës së Investimeve Shqiptare dhe Statuti i saj nuk paraqesin informacion mbi strukturat, divizionet e Korporatës me detyrat, kriteret që duhet të përmbushë çdo pozicion, siç parashikohet për Këshillim Mbikëqyrës, Bordin Këshillimor si dhe

¹³ Për efekt të krahasimit të të dhënave të dhënat e 6 muorit të parë të vitit 2024 nuk janë përfshirë, pasi baza krahasimore është viti.

¹⁴ Në mënyrë analitike llogaritja e mesatares paraqitet në tabelën nr. 6: “Numri anëtarëve të Këshillit për çdo muaj të vitit 2023”.

¹⁵ Nga data e emërimit, deri më 30.06.2024.

ndryshimet në strukturë të bëra me Vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr. 23, datë 20.12.2023 “Miratimi i strukturës organizative të Korporatës së Investimeve Shqiptare” nuk janë reflektuar në to.

Struktura organizative e AIC është miratuar me anë të 2 Vendimeve të Këshillit Mbikëqyrës, konkretisht:

- I. Vendimi i Këshillit Mbikëqyrës nr. 4, datë 22.07.2021 “Miratimi i strukturës organizative të Korporatës së Investimeve Shqiptare”;
- II. Vendimi i Këshillit Mbikëqyrës nr. 23, datë 20.12.2023 “Miratimi i strukturës organizative të Korporatës së Investimeve Shqiptare”;

Nga dy vendimet e mësipërme rezulton se periudha 2020 deri në 22.07.2021 ka **qenë pa strukturë të miratuar**.

Strukturat e miratuara sipas këtyre dy vendimeve të Këshillit Mbikëqyrës, paraqiten më mënyrë krahasimore si në tabelën më poshtë:

Tabela nr. 8: “Tabelë krahasimore me dy strukturat organizative të miratuara të Korporatës”

Struktura/divizioni	Struktura sipas Vendimit	
	nr. 4, datë 22.07.21	nr. 24, dt 20.12.23
Kabineti	4	6
Drejtor Ekzekutiv	1	1
Divizioni Financë dhe Administratë	4	7
Divizioni i Operacioneve	6	10
Divizioni i Zhvillimit të Biznesit	6	9
Divizioni Ligjor	3	8
Kontrolli I brendshëm	N/A	2
Totali	24	43

Burimi: Korporata e Investimeve Shqiptare, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH.

Nga tabela më sipër rezulton se, me Strukturën e miratuar me anë të Vendimit të Këshillit Mbikëqyrës nr.24, datë 20.12.2023 është shtuar si strukturë Kontrolli i brendshëm dhe numri total i punonjësve është rritur me rreth 55%.

Struktura e pagave për strukturën organizative

Strukturat e pagave të Korporatës ka pësuar dy ndryshime, që prej fillimit, konkretisht të miratuara me:

- I. Vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr. 7, datë 07.09.2021 “Miratimi i strukturës së pagave dhe shpërblimeve të Korporatës së Investimeve Shqiptare”
- II. Vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr. 24, datë 20.12.2023 “Miratimi i nivelit të pagave”

Në mënyrë të detajuar struktura e pagave miratuar sipas dy vendimeve të sipërcituara paraqitet si më poshtë:

Tabela nr. 9: “Struktura e pagave sipas vendimeve të Këshillit Mbikëqyrës nr.7, datë 07.09.2021 dhe nr. 24, datë 20.12.2023.”

Nr.	Pozicioni	Niveli	Vendim nr. 7 i dt 07.09.2021		Vendim nr. 23 i dt 20.12.2023		Ndryshimi në %	
			Min.	Max.	Min.	Max.	Min.	Max.
1	Drejtori Ekzekutiv	A1	340,000	400,000	400,000	540,000	18%	35%
2	Drejtori Kabinetit / Divizion / Audit i Brendshëm	A2	220,000	280,000	220,000	297,000	0%	6%
3	Këshilltarë	C1	200,000	240,000	200,000	270,000	0%	13%
4	Specialist	B1	160,000	200,000	160,000	216,000	0%	8%
5	Specialist/asistent	B2	100,000	140,000	100,000	135,000	0%	-4%
6	Specialist	B3	-	-	60,000	81,000		
7	Specialist	D1	60,000	100,000	60,000	81,000	0%	-19%

Burimi: Korporata e Investimeve Shqiptare, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH.

Nga tabela më sipër rezulton se nivelet e pagave, për pozicionet e punës nuk kanë ndryshuar por kanë ndryshuar kufijtë maksimale të secilit nivel page, 35% më shumë për pozicionin Drejtor Ekzekutiv, 6 % për drejtorin e kabinetit, etj. Kategoritë B3 dhe D1 kanë pësuar ulje në kufijtë e tyre maksimalë.

Viti 2020

Viti 2020, ka në listëpagesë vetëm një punonjës të punësuar me pagë mujore, zero lekë dhe nuk ka strukturë organike dhe pagash të miratuar.

Viti 2021

Në vitin 2021 struktura e miratuar me anë të Vendimit të Këshillit Mbikëqyrës nr. 4, datë 22.07.2021 ka 24 punonjës dhe punonjësit faktikë të punësuar gjatë vitit 2021 janë 8, të cilët paraqiten si në tabelën më poshtë:

Tabela nr. 10: “Struktura faktike e punonjësve të Korporatës për vitin 2021”

Pozicioni	Emri	Data e fillimit	Data e largimit	Niveli
DE	E. F.	01.07.2021	17.09.2023	A2
Këshilltar ekonomik	H. Xh.	23.07.2021	22.11.2022	C1
Drejtor	G. Sh.	24.08.2021		A2
Drejtor	A. N.	13.09.2021	15.05.2022	A2
Këshilltar Investimesh	B. B.	01.10.2021	31.12.2023	C1
Specialist Prokurimesh	D. H.	23.11.2021		B1
Arkitekt/interior dizain	A. B.	01.11.2021	06.03.2022	D1
Këshilltar/Specialist IT	D. Gj.	01.11.2021	01.06.2022	C1
Totali i Shpenzimeve të pagave				7,449,406

Burimi: Korporata e Investimeve Shqiptare, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH.

Nga tabela më sipër rezulton se Drejtori Ekzekutiv është punësuar para miratimit të Strukturës organizative, pasi z. F. përcaktohet si i tillë në nenin 26 të Statutit të Korporatës. Gjatë vitit 2021 nuk ka pasur asnjë largim punonjësish. Totali i pagave, për vitin 2021 është 7,449,406 lekë.

Viti 2022

Struktura faktike organizative për vitin 2022 paraqitet si në tabelën më poshtë:

Tabela nr. 11: “Struktura faktike e punonjësve të Korporatës për vitin 2022”

Nr.	Pozicioni	Emri	Data e fillimit	Niveli
1	DE	E. F.	01.07.2021	A2
2	Këshilltar ekonomik	H. Xh.	23.07.2021	C1
3	Drejtor	G. Sh.	24.08.2021	A2
4	Drejtor	A. N.	13.09.2021	A2
5	Këshilltar Investimesh	B. B.	01.10.2021	C1
6	Specialist Prokurimesh	D. H.	23.11.2021	B1
7	Arkitekt/interior dizain	A. B.	01.11.2021	D1
8	Këshilltar/Specialist IT	D. Gj.	01.11.2021	C1
9	Specialist protokolli	E. U.	18.01.2022	B2
10	Drejtor	F. K.	10.01.2022	A2
11	Specialist finance	E. D.	01.02.2022	B1
12	Arkitekt	S. N.	01.02.2022	B2
13	Këshilltar Investimesh	K. A.	01.02.2022	C1
14	Specialist për zhvillimin e biznesit	A. S.	01.02.2022	B2
15	Specialist i operacioneve	J. K.	01.05.2022	B1
16	Drejtor	L. G.	10.06.2022	A2
17	Specialist komunikimi	O. Ç.	28.12.2022	B2
18	Arkitekt	S. G. B.	29.12.2022	B1
Totali i pagave				33,817,489

Burimi: Korporata e Investimeve Shqiptare, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH.

Nga tabela më sipër rezulton se për vitin 2022 nga 24 punonjës sipas strukturës së miratuar kanë qenë 18 dhe totali i shpenzimeve për paga në shumën 33,817,489 lekë.

Viti 2023

Struktura faktike organizative për vitin 2023 paraqitet si në tabelën më poshtë:

Tabela nr. 12: “Struktura faktike e punonjësve të Korporatës për vitin 2023”

Nr.	Pozicioni	Emri	Data e fillimit	Data e largimit	Niveli
1	Specialist protokolli	E. U.	18.01.2022		B2
2	Drejtor	F. K.	10.01.2022	01.07.2024	A2
3	Specialist finance	E. D.	01.02.2022		B1
4	Arkitekt	S. N.	01.02.2022	07.05.2022	B2
5	Këshilltar Investimesh	K. A.	01.02.2022	16.02.2024	C1
6	Specialist për zhvillimin e biznesit	A. S.	01.02.2022		B2
7	Specialist i operacioneve	J. K.	01.05.2022	31.10.2023	B1
8	Drejtor	L. G.	10.06.2022	29.07.2024	A2

9	Specialist komunikimi	O. Ç.	28.12.2022	31.01.2024	B2
10	Arkitekt	S. G. B.	29.12.2022	01.06.2024	B1
11	DE	E. F.	01.07.2021	17.09.2023	A2
12	Drejtor	G. Sh.	24.08.2021		A2
13	Këshilltar Investimesh	B. B.	01.10.2021	31.12.2023	C1
14	Specialist Prokurimesh	D. H.	23.11.2021		B1
15	Specialist ligjor	R. P.	16.01.2023	03.07.2024	B2
16	Specialist i operacioneve	A. H.	13.01.2023	22.05.2024	B1
17	Specialist për zhvillimin e biznesit	X. G.	15.05.2023		B2
18	Specialist ligjor	V. K.	01.06.2023		A2
19	Shofer	E. Ç.	16.08.2023	07.11.2023	D1
20	DE	E. K.	17.10.2023		A1
21	Asistent DE	K. K.	07.11.2023		B2
22	Arkitekt	L. Sh.	01.11.2023		B1
23	Drejtor	J. A.	01.11.2023		A2
Totali i Shpenzimeve të Pagave për 2023					43,843,839

Burimi: Korporata e Investimeve Shqiptare, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH.

Nga tabela më sipër rezulton se për vitin 2023 struktura nuk ka qenë e plotësuar me 24 persona sipas strukturës së miratuar dhe totali i shpenzimeve për paga rezulton 43,843,839 lekë.

Periudha 01.01.2024-30.06.2024

Në fillim të vitit 2024, ka nisur efektivisht zbatimimi i strukturës organizative të miratuar me Vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr. 24, datë 20.12.2023 me 43 punonjës.

Struktura faktike e punonjësve për vitin 2024 ka qenë si më poshtë:

Tabela nr. 13: “Struktura faktike e punonjësve të Korporatës për periudhën 01.01.2024-30.06.2024”

Pozicioni	Emri	Data e fillimit	Data e largimit	Niveli
Drejtor	G. Sh.	24.08.2021		A2
Specialist Prokurimesh	D. H.	23.11.2021		B1
Specialist protokoll	E. U.	18.01.2022		B2
Drejtor	F. K.	10.01.2022		A2
Specialist finance	E. D.	01.02.2022		B1
Këshilltar Investimesh	K. A.	01.02.2022	16.02.2024	C1
Drejtor	L. G.	10.06.2022		A2
Specialist ligjor	R. P.	16.01.2023		B2
Specialist i operacioneve	A. H.	13.01.2023	22.05.2024	B1
Specialist komunikimi	O. Ç.	28.12.2022	31.01.2024	B2
Arkitekt	S. G. B.	29.12.2022	01.06.2024	B1
Specialist per zhvillimin e biznesit	Xh. Gj.	15.05.2023		B2
Specialist ligjor	V. K.	01.06.2023		A2
DE	E. K.	17.10.2023		A1
Asistent DE	K. K.	07.11.2023		B2
Arkitekt	L. Sh.	01.11.2023		B1
Drejtor	J. A.	01.11.2023		A2
Këshilltar I brendshëm PR	J. A.	17.01.2024		C1
Këshilltar I brendshëm Financiar	M. Z.	16.01.2024		C1
Specialiste e Fondeve dhe Investimeve	M. B.	26.02.2024		B1
Specialist inxhinier	R. Sh.	12.02.2024		B1
Specialist finance	M. B.	01.02.2024		B1
Specialist inxhinier	K. B.	01.02.2024		B1
Specialist ligjor	D. H.	15.02.2024		B1
Analist financiar	G. H.	01.02.2024		B1
Drejtor	S. Ll.	12.04.2024		A2
Këshilltar Anti-korrupsion	A. Sh.	01.04.2024	14.05.2024	C1
Specialist per zhvillimin e biznesit	A. M.	10.06.2024		B2
Këshilltar I brendshëm per Investimet	I. M.	10.06.2024		C1
Specialist PR	G. F.	16.07.2024		B2
Specialist ligjor	E. F.	01.08.2024		B1
Protokoll	E. M.	01.08.2024		B2

Burimi: Korporata e Investimeve Shqiptare, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH.

Nga tabela më sipër rezulton se për 6 mujorin e parë të vitit 2024 kanë qenë në strukturë 32 të punësuar, 5 prej të cilëve janë larguar përgjatë 6 mujorit të parë 2024. Gjatë kësaj periudhe struktura ka qenë e paplotë.

Marrëdhëniet e punës

Struktura dhe organika e Korporatës miratohen nga Këshilli Mbikëqyrës, siç përcaktohet dhe në pikën 2 të nenit 40 të Statutit të saj. Marrëdhëniet e punës rregullohen sipas dispozitave të Kodit të Punës në Republikën e Shqipërisë dhe akteve të brendshme të Korporatës.

Rekrutimet

Procedurat e rekrutimit në Korporatë bëhen bazuar në “Rregulloren e brendshme të Korporatës së Investimeve Shqiptare”. Kreu VI. I saj “Procedurat e rekrutimit” tregojnë hapat se si realizohet rekrutimi i punonjësve pranë Korporatës për verifikimin e realizimit të tyre, nga grupi i auditimit u përzgjedhën, në mënyrë rastësore, 6 praktika rekrutimesh, për personelin si më poshtë:

1. H. Xh.;
2. D. H.;
3. S. G. B.;
4. A. S.;
5. Xh. Gj.;
6. E. Ç.

Nga verifikimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion të grupit të auditimit, mbi praktikat e mësipërme të rekrutimit rezultoi se:

- Për 4 nga 6 punonjësit e përzgjedhur, konkretisht për H. Xh., D. H., S. G. B. dhe A. S. nuk disponohet informacion mbi procedurat e rekrutimit të tyre, pasi janë punësuar përpara hyrjes në fuqi të Rregullores së brendshme, sipas informacionit të vënë në dispozicion të grupit të auditimit në pyetësorin e përgatitur nga grupi i auditimit citohet se: “...rekrutimi i tyre është bërë përpara se të hynte në fuqi Rregullorja e brendshme dhe AIC sapo ishte krijuar dhe nuk ishte staf dhe ishte emergjente punësimi i punonjësve më qëllim funksionimin e shoqërisë. Për këtë arsye rekrutimi i këtyre punonjësve është bërë nga Drejtori Ekzekutiv bazuar në CV-të e punonjësve, që janë rekrutuar, të cilët kanë eksperiencë të gjatë punë në profilet e tyre.”

Nga verifikimi i praktikave të dy punonjësve të tjerë rezultoi se:

Për punonjësën E. C.

- Me anë të memos nr. 67, datë 09.08.2023 z. G. Sh., Drejtor e Divizionit Financiar dhe Administrativ i ka kërkuar Drejtorit Ekzekutiv, fillimin e procedurave për punësimin e një shoferi, pranë Korporatës së Investimeve Shqiptare SHA. Kjo kërkesë nuk përmban specifikime mbi kërkesat, pasi sipas paragrafit të fundit të Kreut VI të Rregullores së Brendshme përcaktohet se “Procedurat e sipërpërmendura nuk aplikohen për punësimin e punonjësve jo specialistë, ku përfshihen: shoferët, punonjësit e mirëmbajtjes, pastruese, recepsionist, magazinier, roje, etj. DFA përgatit një rekomandim për DE me kandidatin/kandidatët më të përshtatshëm. DE vendos se cili është kandidati më i përshtatshëm për këtë vend pune.” Me anë të memos nr. 67/1, datë 14.08.2023 Z. Sh. i ka dërguar rekomandimin për punësimin e një shoferi , ku citohet se: “Mbështetur në miratimin Tuaj, në datën 09.08.2023, u publikua në faqen web Njoftimi i shoqërisë për shpalljen e një vendi vakant në pozicionin shofer i shoqërisë, nga shqyrtimi i dokumenteve të paraqitura, është paraqitur vetëm një aplikim , dhe gjykohet se kandidati përmbush kriteret e vendosura për këtë pozicion punë.”
- Shpallja është pjese e praktikës, më datë 09.08.2001123.
- Kontrata e punës është protokolluar me nr. 67/2, datë 16.08.2023.

- Mungon Urdhri i Drejtorit Ekzekutiv, për DFA për fillimin e procedurës përkatëse të rekrutimit, për të angazhuar Komitetin për Burimet Njerëzore dhe Administrimin (KBNJA) për shqyrtimin e aplikimeve dhe përzgjedhjen e siç përcaktohet në pikën b. të kreut VI të Rregullores së Brendshme të Korporatës.
- Mungon memo mbi vlerësimin e bërë nga KBNJA.


Për punonjësin Xh. Gj.,

- Mungojnë kriteret, që duhet të përmbushë kandidati, siç përcaktohet me pikën c.ii të kreut VI të Rregullores së Brendshme të AIC si dhe nuk janë të specifikuar lista e dokumentacioni që duhet paraqitur së bashku me aplikimin ku ndër të tjera, sipas pikës c.iii të Kreut VI të Rregullores së Brendshme të Korporatës miratuar me Vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr. 13, datë 05.12.2022, përfshin dhe Curriculum Vitae dhe Letër për shprehje interesi, kjo e fundit nuk rezulton të jetë pjesë e praktikës si dhe mungon njoftimi i bërë kandidatit fitues nga DFA për nënshkrimin e kontratës së punës, dhe letra e interesit nga kandidatja.

Largimet e stafit

Për periudhën e auditimit rezultojnë 18 punonjës të larguar me dorëheqje. Në mënyrë të detajuar numri i punonjësve të larguar sipas viteve paraqitet si në grafikun më poshtë:

Grafiku nr.2: “Numri i punonjësve të larguar sipas viteve”



Burimi: Korporata e Investimeve Shqiptare, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH.

Rregullsia e Dosjeve të personelit

Kreu XVII. “Regjistri i personelit dhe inventari i aseteve” përcakton se: “DFA plotëson dosjen personale për secilin punonjës. Dosja personale e çdo punonjësi duhet të përmbajë: 1. Kontratën 2. Librezën e punës 3. Raportin Mjekësor për aftësi në punë 4. Dëshminë e penalitetit 5. Diplomën dhe certifikata kualifikimi 6. CV 7. Kopjen e ID 8. Numrin e llogarisë Bankare 9. Procesverbalin për inventarin e aseteve që ka në ngarkim 10. Formulari i Konfliktit të Interesit dhe Konfidencialitetit”.

Për të verifikuar plotësinë dhe saktësinë e dosjeve të personelit të Korporatës nga grupi i auditit u përzgjedhën në mënyrë rastësore 10 dosje nga verifikimi i të cilave rezultoi si më poshtë:

- » Vetëm 2 prej anëtarëve konkretisht z. G. H. dhe z. A. Sh. disponojnë në dosje Diploma dhe dëshmi/certifikata kualifikimi të njehsuara me origjinalin pjesa tjetër fotokopje të tyre të pa njehsuara me origjinalin;
- » z. O. Ç. nuk disponon diplomë por vetëm një certifikatë për përfundimin me sukses të studimeve të integruara, e cila është e pa njehsuar me origjinalin;
- » Në një rast mungon Kontrata e punës;
- » Në 7 raste evidentohet mungesa e Librezës së punës;
- » Në 5 raste evidentohet mungesa e Raportit Mjekësor për aftësi në punë;
- » Në 2 raste evidentohet mungesa Dëshmisë e penalitetit;
- » Në 2 raste evidentohet mungesa e Diplomës/mave dhe certifikatave të kualifikimit;
- » Në 2 raste evidentohet mungesa CV;
- » Në 3 raste evidentohet mungesa e kopjes së ID

- » Në 5 raste evidentohet mungesa numrit të llogarisë Bankare;
- » Në 8 raste evidentohet mungesa e Procesverbalit për inventarin e asetëve, që kanë ngarkim;
- » Në 3 raste evidentohet mungesa e Formularit të Konfliktit të Interesit.
- Në mënyrë të detajuar të dhënat nga verifikimi fizik i dosjeve gjenden në tabelën nr., 1 të Aneksit nr.1.

Këshilltarët dhe ekspertët e jashtëm

Korporata, për periudhën objekt auditimi ka angazhuar ekspertë dhe këshilltarë të jashtëm, të cilët nuk kanë qenë pjesë e organigramës, të cilët për periudhën objekt auditimi në numër dhe si shpërblime kanë përfituar si më poshtë:

Tabela nr. 14: “Numri i Këshilltarëve dhe ekspertëve jashtë organigramës të angazhuar në Korporatë sipas viteve dhe shpërblimet e marra prej tyre”

Në lekë

Viti	2021	2022	2023	2024	Totali
Numri	2	9	4	15	
Shuma	500,000	3,431,654	680,600	3,656,000	8,268,254

Burimi: Korporata e Investimeve Shqiptare, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH.

Nga tabela më sipër rezulton së për periudhën 2021-2014 (6 mujori i parë), nga AIC janë kontraktuar ekspertë të jashtë të cilët janë angazhuar me kontrata shërbimi, sipas parashikimeve të pikës C1 të Vendimit të Këshillit Mbikëqyrës nr. 7 datë 07.09.2021 “Miratimi i strukturës së pagave dhe shpërblimeve të Korporatës së Investimeve Shqiptare”, ku përfshihen ekspertë apo këshilltarë të fushave të ndryshme sipas nevojave të Korporatës.

Për sa trajtuar më sipër në këtë pjesë të raportit të auditimit, në lidhje me mangësitë e konstatuara mbajnë përgjegjësi si më poshtë:

1. Anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës të AIC-së, për periudhën objekt auditimi (Aneks 1 – Tabela 2.1.1.)
2. Zj. E. K., Drejtor Ekzekutiv i AIC-së, për periudhën objekt auditimi;
3. Z. E. F., si ish-Drejtor Ekzekutiv i AIC-së, për periudhën objekt auditimi;
4. Z. G. Sh., në funksionin e Drejtorit të Divizionit të Financës dhe Administratës në AIC, për periudhën objekt auditimi.

Sa trajtuar më sipër në këtë pjesë të RPA-së, subjekti ka paraqitur observacione përmes shkresës nr.97/1 prot., datë 03.03.2025, protokolluar në KLSH me shkresën me nr.1096/6 prot., datë 03.03.2025, nga Drejtori Ekzekutiv i AIC-së znj. E. K., si vijon:

1.Në lidhje me Rekomandimin 13.1. të RPA-së, sipas të cilit duhet administruar dokumentacioni vërtetues për anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës, për përmbushjen e kriterëve të nenit 14, pika 3 shkronja a-c dhe pika 6 të Statutit të AIC, ju bëjmë me dije se do të merren të gjitha masat për administrimin e këtyre dokumenteve. Lidhur me gjetjen tuaj se Këshilli Mbikëqyrës, me Vendimin nr. 2, datë 07.03.2024, ka miratuar shpërblimin e z. E. F. (anëtar me kontribut disa vjeçar në veprimtarinë e Korporatës) në masën 35% mbi shpërblimin bazë të anëtarit të Këshillit Mbikëqyrës, në kundërshtim me metodologjinë dhe praktikën ligjore të miratuara nga ky Këshill, ju sqarojmë se: “ky shpërblim është dhënë në përputhje me politikën e AIC-së, praktikën e ndjekur në korporata dhe vendimin specifik të Këshillit Mbikëqyrës nr. 23, datë 20.12.2023. konkretisht , sipas pikës 7, shkronja a të këtij vendimi, është përcaktuar se: “Anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës mund të marrin një shtesë prej 35% mbi nivelin bazë, bazuar në kontributin personal të dhënë në AIC”. Në këtë kuadër shpërblimi i z. F. është bazuar në kontributin e tij afatgjatë në AIC, angazhimin e tij në mirëbesim dhe përkushtimin e treguar vazhdimisht ndaj interesave të Korporatës. Gjithashtu, në lidhje me konstatimin tuaj se nuk janë përmbushur kushtet e pikës 8/e të Vendimit të sipërcituar për të përfituar këtë shtesë, ju bëjmë me dije se kjo shtesë nuk është në kuadër të shpërblimit të performancës në masën 35% të shpërblimit mujor të anëtarëve, por si një vlerësim për kontributin e tij të vijueshëm dhe të rëndësishëm në funksionimin e AIC-së”.

2.Në lidhje me Rekomandimin 14.1. të RPA-së, ju bëjmë me dije se “në ligjin nr. 71/2019 “Për korporatën e Investimeve Shqiptare, neni 17 “Bordi Këshillimor”, pikat 1 dhe 2, parashikohet se: “Bordi Këshillimor përbëhet nga 9 anëtarë që zgjidhen nga Asambleja e Përgjithshme. Tre anëtarë përfaqësojnë institucionet qendrore, dy anëtarë janë nga institucionet ndërkombëtare financiare të zhvillimit dhe katër anëtarë janë të pavarur”. Në Statutin e Korporatës, Titulli III “Organet e Korporatës”, neni 31 “Mbledhjet e Bordit Këshillimor”, pika 3, parashikohet se: “Kuorumi për mbledhjet e Bordit arrihet nëse pesë nga nëntë anëtarët e tij janë të pranishëm, dy nga të cilët duhet të jenë anëtarë të pavarur, personalisht ose përmes lidhjeve të tjera, si telekonferencë ose mjete të ngjashme të komunikimit.

Në interpretim të dispozitave të sipërcituara numri i anëtarëve për të arritur kuorumin është plotësuar nga Asambleja e Përgjithshme më datë 02.08.2024 dhe pas plotësimit të këtij kuorumi Bordi Këshillimor ka ushtruar funksionin e tij këshillues në raport me këshillin Mbikëqyrës, Drejtorin Ekzekutiv dhe Asamblenë e Korporatës, duke u mbledhur rregullisht. Mbledhja e parë e tij është zhvilluar me datë 28.08.2024.”

3.Në lidhje me Rekomandimin 15.1. të RPA-së, sqarojmë se AIC ka marrë masa të menjëhershme për të përfunduar plotësimin e dosjeve të personelit. Divizioni i Financës dhe Administratës është në proces të draftimit të një rregulloreje të re e cila është e përfshirë në planin e zhvillimit të MFK-së për vitin 2025”.

Qëndrimi i Grupit të Auditimit:

1.Në lidhje me observacionin e paraqitur nga AIC mbi Rekomandimin nr.13.1 të RPA-së, grupi i auditimit sqaron se në observacionin tuaj vijojmë ti mbetemi gjetjes dhe konstatimit të bërë nga grupi i auditimit, kriteret duhet të jenë të matshme e kontributi të përkthehet në performancë/produkte të Korporatës. Për sa më sipër, kjo pjesë e observacionit nuk pranohet.

2.Në lidhje me observacionin e paraqitur nga AIC mbi Rekomandimin nr.14.1 të RPA-së, nga ana e grupit të auditimit është konstatuar për periudhën objekt auditimit, mos plotësimi i këtij Bordi me anëtarë. Kriteret e përmendura në objeksione, janë gjithashtu të cituara dhe në materialin tonë, nuk sjellin evidenca të reja. Plotësimi i anëtarëve, përtej periudhës së auditimit, nuk e ndryshon konstatimin tonë. Në vijimësi ky Bord duhet të jetë i plotësuar me anëtarë, pasi nga auditimi rezultoi se anëtarët (dy) ishin shpërblyer pa asnjë veprimtari. Për sa më sipër kjo pjesë e observimit nuk merret në konsideratë nga grupi i auditimit.

3.Në lidhje me observacionin e paraqitur nga AIC mbi Rekomandimin nr.15.1 të RPA-së, grupi i auditimit sqaron se nuk janë sjellë fakte të reja, por kenë konfirmuar gjetjen e grupit të auditimit dhe kini marrë masa për përmirësimin e konstatimit. Për sa më sipër kjo pjesë e observacionit nuk merret në konsideratë.

IV. GJETJET DHE REKOMANDIMET

A.MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i Raporteve të Veprimtarisë për periudhën objekt auditimi, u konstatua se nga Korporata e Investimeve Shqiptare SHA (AIC) janë raportuar humbje përkatësisht, për vitin 2021 në vlerën prej (19,465,000) lekë, për vitin 2022 në vlerën prej (69,051,000) lekë si dhe për vitin 2023 në vlerën (88,516,000) lekë, ose në total humbje progresive prej (139,683,000) lekë, të cilat kanë ardhur si rrjedhojë e mos gjenerimit të të ardhurave nga projektet e investimeve (*si objektivi kryesor i AIC-së*) dhe nga kryerja e shpenzimeve të personelit, shpenzimeve të shërbimit dhe shpenzimeve të tjera.

Nga viti në vit humbjet kanë ardhur në rritje të konsiderueshme, duke ndikuar në treguesit e performancës ekonomike-financiare të shoqërisë, si dhe nga strukturat drejtuese të AIC-së, nuk janë ndërmarrë masa konkrete mbi analizimin e situatës ekonomike-financiare me qëllim eliminimin e humbjeve dhe reduktimin e shpenzimeve, veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 71/2019 “Për Korporatën e Investimeve Shqiptare”, neni 14/e dhe me Ligjin nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, neni 3/2, neni 4/11, neni 5, neni 8/8.

Deri në fund të periudhës objekt auditimi u konstatua se Korporata nuk disponon një plan vjetor apo strategjik lidhur me të ardhurat që parashikohen të gjenerohen nga veprimtaria e saj.

Për periudhën objekt auditimi u konstatua se të ardhurat e vetme, që janë gjeneruar janë nga investimi i fondeve që i janë alokuar nga buxheti i shtetit për të zhvilluar veprimtarinë e saj.

Pavarësisht mos gjenerimit të të ardhurave nga projektet e investimeve, shpenzimet e AIC rezultuan në vlera të konsiderueshme, ku për vitin **2021** u konstatuan shpenzime në vlerën **19,465,336 lekë**, nga të cilat shpenzime për shërbime në shumën 8,997,645 lekë, shpenzime personeli në shumën 7,449,406 lekë (38 % e totalit të shpenzimeve) dhe shpenzime të tjera të shfrytëzimit në shumën 3,018,285 lekë; për vitin **2022** shpenzime në vlerën **74,765,569 lekë**, nga të cilat shpenzime për Këshillin Mbikqyrës dhe Bordin Këshillimor në shumën 20,257,693 lekë; shpenzime personeli në shumën 33,817,489 lekë (pra 72 % e totalit të shpenzimeve përfaqësohen nga shpenzime personeli dhe shpërblime) dhe shpenzime të tjera shfrytëzimi në shumën 20,123,072 lekë; për vitin **2023** shpenzime në vlerën **77,887,755 lekë**, nga të cilat shpenzime për Këshillin Mbikqyrës dhe Bordin Këshillimor në shumën 18,709,601 lekë; shpenzime personeli në shumën 43,843,839 lekë (pra 80 % e totalit të shpenzimeve përfaqësohen nga shpenzime personeli dhe shpërblime) dhe shpenzime të tjera shfrytëzimi në shumën 13,734,571 lekë. (Më hollësisht trajtuar në pikën 1, faqet nr. 12-59 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

1.1 Rekomandimi: Drejtuesit e AIC-së, të marrin masa të zhvillojë dhe miratojë një plan të detajuar strategjik dhe vjetor, për menaxhimin dhe zhvillimin e projekteve të investimeve, në përputhje me legjislacionin në fuqi, i cili të parashikojë burimet e të ardhurave nga projektet e investimeve, me fokus ritjen e eficiencës dhe mundësive për të gjeneruar të ardhura të qëndrueshme nga aktivitetet e saj.

Menjherë dhe në vijimësi

2. Gjetje nga auditimi: Korporata e Investimeve Shqiptare (AIC), në lidhje me projekt-propozimet në fushën e pronave shtetërore, bazohet në Ligjin nr. 71/2019 “Për Korporatën e Investimeve Shqiptare” dhe VKM-në nr. 137, datë 06.03.2024 “Për përcaktimin e kriterëve dhe të procedurës për dhënien e pronës shtetërore me qira, enfitozë, leasing, shitje, përdorim si kolateral dhe të përdorimit në forma të tjera nga ana e Korporatës së Investimeve Shqiptare”, të cilat funksionojnë të lidhura me njëra-tjetrën, ku ligji përcakton misionin dhe objektivat themelore të AIC-së, ndërsa VKM-ja krijon rregullat operative për të realizuar këto objektiva për pronat shtetërore.

Baza ligjore e sipërcituar i jep AIC-së një pavarësi në administrimin, menaxhimin dhe përdorimin e pronave shtetërore, duke përfshirë dhënien e tyre me qira, enfitozë, leasing, shitje apo përdorim si kolateral, si dhe zhvillimin e projekteve përmes procedurave të veçanta konkurrimi dhe negocimi të drejtpërdrejtë. Nga auditimi u konstatua se këto akte ligjore nuk ofrojnë mekanizma të qartë për monitorimin dhe vlerësimin e vazhdueshëm të efektivitetit të procedurave dhe të ekzekutimit të projekteve, të cilat paraqet një **risk të lartë operacional dhe institucional** për menaxhimin e pronave shtetërore, si dhe nuk garantojnë sigurinë e tyre. Për më tepër, proceset e përcaktuara në këto akte ligjore nuk janë në përputhje me legjislacionin shqiptar mbi Prokurimet Publike, por mbështeten ekskluzivisht në kompetencat dhe procedurat e brendshme të AIC-së.

Gjithashtu, u konstatua se deri në fund të periudhës objekt auditimi, AIC-ja nuk ka hartuar, akte nënligjore / rregullore / manuale specifike për të gjitha proceset e punës që do të kryhen nga kjo strukturë, duke filluar nga përzgjedhja dhe administrimi i pronave shtetërore për t’u zhvilluar, si dhe mbi llojet e procedurave mbi të cilat do të operojë AIC në përputhje me këtë bazë ligjore, për vetë specifikat që këto praktika parashikojnë në vetvete. Veprimet e mësipërme janë kryer në kundërshtim me *Ligjin nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”*. (Më hollësisht trajtuar në pikën 1, faqet 12-59 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

2.1.Rekomandimi:Nga AIC të merren masat e nevojshme për respektimin e plotë të kuadrit ligjor të Republikës së Shqipërisë për ruajtjen dhe sigurinë e pronës publike, si dhe të krijojë mekanizma të qartë

monitorimi dhe vlerësimi, me qëllim që të sigurohet një menaxhim efektiv dhe transparent i pronave shtetërore.

Menjëherë dhe në vijimësi

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i Planeve Vjetore të Punës për periudhën objekt auditimi, u konstatua se AIC nuk ka implementuar manuale apo udhëzues specifikë për hartimin dhe miratimin e projekt-propozimeve, si dhe për menaxhimin e fazave të ciklit të tyre. Gjithashtu nga auditimi konstatohet se nga ana e strukturave përgjegjëse të AIC-së nuk është hartuar apo miratuar një metodologji specifike dhe e standardizuar për seleksionimin e projekt-ideve, e cila është thelbësore për procesin e identifikimit dhe përzgjedhjes së projekteve. Mungesa e kësaj metodologjie riskon menaxhimin strategjik dhe realizimin e objektivave të Korporatës.

Në propozimet e listuara përgjatë periudhës 2022-2023 është parashikuar hartimi i parafizibilitetit dhe fizibilitetit, duke mos përcaktuar në asnjë akt ligjor se çfarë do të duhet të përfshihet në këto dokumente, apo mbi diferencat mes këtyre dy dokumenteve. Për më tepër, në propozimet e vitit 2024 nuk janë përfshirë fazat e parafizibilitetit dhe fizibilitetit.

Veprimet e mësipërme janë kryer në kundërshtim me Ligjin nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, neni 4, pika 19, neni 16, si dhe VKM-në nr.887, datë 27.12.2022 “Për procedurat e menaxhimit të investimeve publike”, aneksi nr.1 “Procedurat e menaxhimit të investimeve publike”. (Më hollësisht trajtuar në pikën 1, faqet 12-59 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

3.1.Rekomandimi: Nga ana e Strukturave Drejtuese të AIC-së, të merren masa konkrete për ngritjen e një grupi pune për hartimin e një manuali ose rregullore të detajuar me fokus të veçantë për hartimin e projekt-ideve gjatë miratimit të Planeve të Punës të Shoqërisë, Ky manual ose rregullore duhet të përfshijë identifikimin e hapave që do të ndiqen, përshkrimin e proceseve të punës dhe ciklit të projektit, si dhe përcaktimin e afateve përkatëse dhe dokumenteve tip, duke përfshirë gjithashtu fazat nga studimi paraprak i përfitueshmërisë së investimit deri te zbatimi i kontratës, me qëllim garantimin e një procesi të qartë dhe transparent për identifikimin dhe përzgjedhjen e projekteve.

Menjëherë

3.2.Rekomandimi: Nga ana e Strukturave Drejtuese të AIC-së, të merren masa konkrete mbi hartimin e një metodologjie mbi seleksionimin e projekt-ideve që do të përfshihen në Planet e Punës, me qëllim përzgjedhjen e tyre me analiza të detajuara dhe të mirë argumentuara mbi objektivat dhe qëllimet që do të arrihen.

Menjëherë

4. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi konstatohet se gjatë periudhës objekt auditimi, nga ana e AIC-së nuk është hartuar një Plan Strategjik Afatmesëm, mbi veprimtarinë e Korporatës, duke identifikuar objektivat strategjike institucionale, e cila ka cënuar vijueshmërinë Institucionale të AIC-së.

- Nga auditimi i veprimtarisë së AIC-së, u konstatua se edhe pse përbërja e Këshillit Mbikëqyrës ka qenë pothuajse e njëjtë, në projekt propozimet e vitit 2024 konstatohet një ndërprerje në realizimin e projekt-propozimeve të mëparshme (2021-2023), duke përfshirë ato në sektorin e energjisë dhe zhvillimit të zonave prioritare. Për këto projekte, përveç shpenzimeve të vetë korporatës dhe personelit të përhershëm të saj, janë kryer edhe shpenzime mbi kontraktimin e ekspertëve të jashtëm për realizimin e parafizibilitetit, përfshirë edhe miratimin me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr.12, datë 04.10.2022 “Mbi autorizimin e Drejtorit Ekzekutiv për të filluar vlerësimet e fizibilitetit për projektet e investimeve dhe miratimin e përdorimit të fondeve të AIC-së për këtë qëllim me propozimin e tij”, situatë e cila ka ndikuar negativisht në vijueshmërinë dhe efikasitetin e funksionimit të institucionit.

Veprimet e mësipërme janë kryer në kundërshtim me Ligjin nr.71/2019 “Për Korporatën e Investimeve Shqiptare”, neni 3. (Më hollësisht trajtuar në pikën 1, faqet 12-59 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

4.1.Rekomandimi: Nga ana e Këshillit Mbikëqyrës së AIC-së, në bashkëpunim me strukturat përkatëse, të marrin masat e nevojshme për hartimin e një Plani Strategjik Afatmesëm, që përcakton objektivat strategjike dhe indikatorët të qartë për vlerësimin e përmbushjen e tyre, seleksionimit të projekt-propozimeve që do të zhvillohen. me qëllim që të mos cënohet vijueshmëria e Institucionit.

Menjëherë

4.2.Rekomandimi: Nga ana e Këshillit Mbikëqyrës si Organ Drejtues i AIC-së, në bashkëpunim me Strukturat Drejtuese, të merren masat për ngritjen e një grupi pune për analizimin e shkaqeve/arsyeve të ndërprerjes së projekt propozimeve të mëparshme, duke identifikuar edhe përgjegjësitë përkatëse, me qëllim shmangien në të ardhmen të këtij fenomeni.

Brenda muajit Qershor 2025

5.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i projekt-propozimeve/projekt-ideve, të hartuara për vitet 2022 dhe 2023, konstatohet se janë hartuar gjithsej (8 projekt-propozime/projekt ide), si vijojnë:

- 1.Projekt-Propozimi - “Ndërtimi i parqeve fotovoltaike si prodhues i energjisë alternative”
- 2.Projekt-Propozimi - “Rivitalizimi i Bazës Detare të Pashalimanit”
- 3.Projekt-Propozimi - “Ndërtimi i parkut verior të biznesit në Shkodër”
- 4.Projekt-Propozimi - “Teknopark Tirana TPT”
- 5.Projekt-Propozimi - “Korça Aerodrome”
- 6.Projekt-Propozimi - “Zhvillimi i një modeli turizmi me natyrën në Syrin e Kaltër”
- 7.Projekt-Propozimi - “Divjaka, një destinacion zhvillimi me modele të qëndrueshme të biznesit”
- 8.Projekt-Propozimi - “Porto Palermo Marina Resort”

Për të gjitha Projekt-idetë e cituara më sipër, konstatohet se AIC, ka filluar hartimin e tyre gjatë vitit 2022 dhe 2023, duke paraqitur vetëm informacione të përgjithshme mbi vendet ku mund të zhvillohen këto projekt-ide, pa analiza të detajuara.

Nga auditimi konstatohet se për projekt-idetë e mësipërme, të filluara gjatë vitit 2022, faza të tilla si para-fizibiliteti dhe kontraktimi i ekspertëve të jashtëm për finalizimin e projekteve, janë kryer **pa u siguruar më parë transferimi i pronës/asetit shtetëror në administrimin e AIC-së**, veprime në kundërshtim me Vendimin nr.10, datë 21.12.2021, të Këshillit Mbikëqyrës të AIC-së, ku ndër të tjera është pjesë e planit të biznesit edhe “shtojca” që përcakton procedurat për zhvillimin e aseteve.

Projekt-propozimet e hartuara përmbajnë informacion të përgjithshëm mbi përshkrimin e tyre, kostot totale potenciale dhe risqet e sektorit, pa përfshirë analiza konkrete dhe të detajuara mbi hapat e punës, afatet, kostot e detajuara, përshkrimin e risqeve potenciale dhe objektivat specifike të zhvillimit.

Nga auditimi konstatohet se për projekt-idetë e mësipërme, nuk janë respektuar afatet e parashikuara nga AIC, për zhvillimin e tyre.

Gjithashtu, nga auditimi u konstatua se deri në fund të periudhës objekt auditimi, asnjë prej këtyre projekt-propozimeve nuk ka kaluar në fazën e zhvillimit, dhe nuk janë mbartur/përfshirë në planin e vitit 2024, situatë kjo që përbën një risk të shtuar referuar faktit se hartimi i këtyre projekt propozimeve ka qenë aktiviteti kryesor i korporatës për periudhën e sipërcituar, dhe për të cilin janë kryer edhe likuidimet përkatëse të shpenzimeve për personat e angazhuar, shpërblime dhe paga të anëtarëve të komisioneve, financuar me fonde të buxhetit të shtetit.

Veprimet e mësipërme janë kryer në kundërshtim me Ligjin nr.71/2019 “Për Korporatën e Investimeve Shqiptare”, neni 3. (Më hollësisht trajtuar në pikën 1, faqet 12-59 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

5.1.Rekomandimi: Nga ana e Strukturave Drejtuese të AIC-së, të merren masa konkrete që gjatë hartimit të projekt-propozimeve (koncept-ideve), të kryhet më përpara transferimi i pronës/asetit në pronësi, duke

vazhduar me identifikimin e objektivave, vlerësimi dhe përgatitja e projektit, analiza e detajuara e risqeve potenciale, analizë e thelluar mbi kostot me përshkrim për secilin zë të buxhetit, si dhe analizë të detajuar mbi përfitueshmërinë që paraqet projekt-propozimi me qëllim vlerësimin e treguesve ekonomik të mirë përcaktuar.

Menjëherë dhe në vijimësi

6.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi konstatohet se, në kuadër të projekt-propozimit, “*Zhvillimi i Pronave Shtetërore*”, janë hartuar 3 (tre), projekt-propozime që synojnë ndërtimin dhe menaxhimin e objekteve të rëndësishme publike për të rritur efektivitetin dhe vlerën e pronave shtetërore, me qëllim gjenerimin e të ardhurave.

1. Projekt-propozimi për "Ndërtimin dhe Menaxhimin e Korpusit të Policisë", synon zhvillimin e një prone shtetërore në zonën e Petrelës me sipërfaqe 165,000 m², të vënë në dispozicion nga Ministria e Mbrojtjes, për të plotësuar nevojat e Ministrisë së Brendshme dhe institucioneve të varësisë, (*Drejtoria e Përgjithshme e Policisë, Akademia e Policisë, Garda e Republikës, IKMT dhe AMP*) me një sipërfaqe ndërtimi prej 43,070 m². Për këtë qëllim, prona ekzistuese e Policisë në Sauk, ku ndodhet Akademia e Policisë, vihet në dispozicion për zhvillim, duke pasur potencial të lartë ndërtimi me sipërfaqe deri në 180,000 m². Projekti, i parashikuar të realizohet brenda 3-5 viteve, përfshin faza të ndryshme nga hartimi i kuadrit rregullator, transferimi i pronave, krijimi i një SPV (Special Purpose Vehicle), deri në përfundimin dhe dorëzimin e ndërtimit.

Në lidhje me këtë projekt-propozim, konstatohet se deri në fund të periudhës objekt auditimi, nuk është proceduar pasi Institucionet në bashkëpunim janë tërhequr nga projekt-propozimi i AIC-së, për të cilën nuk ka një argumentim të bashkëlidhur.

2- Projekt-propozimi "Godina e Kadastrës" synon zhvillimin e një poli administrativ në një truall prej 5,000 m² të vënë në dispozicion nga ASHK në rrugën “Muhamet Gjollësja,” me ndërtimin e një hapësire prej 14,790 m² pa kosto financiare për institucionet publike.

Projekt-propozimi është planifikuar të realizohet brenda 3-5 viteve, duke përfshirë faza të tilla si ngritja e Komisionit të Eficiencës së Përdorimit të Pronës, organizimi i garave ndërkombëtare për projektimin dhe partnerët privatë, dhe krijimi i një SPV (Special Purpose Vehicle).

3.- Projekt-propozimi "Kompleksi Governativ" synon ndërtimin e një Poli Administrativ në zonën e Stadiumit Dinamo në një truall prej 9,400 m², për të plotësuar nevojat e institucioneve publike si disa Institucione varësie të Kryeministrisë, të MIE, MTM, etj, me një hapësirë ndërtimi prej 29,879 m², e financuar plotësisht nga partnerët privatë pa implikime financiare për institucionet.

Projekti përfshin zhvillimin e pronave publike, përfshirë një pronë prej 2,890 m² të vendosur në Bulevardin Zhan D’Ark, për të mbështetur realizimin e objektivave të tij. Afatet e parashikuara për zbatimin e projektit janë 3-5 vite, të ndara në faza të detajuara që përfshijnë organizimin e garave ndërkombëtare dhe krijimin e një SPV (Special Purpose Vehicle).

Nga auditimi i projekt-propozimeve të mësipërme, konstatohet se nuk kanë një analizë se si janë arritur sipërfaqet e propozuara dhe që do të vihen në dispozicion nga Institucionet në bashkëpunim.

Gjithashtu konstatohet se në lidhje me këto prona, janë kryer vetëm analiza të përgjithshme mbi çmimet referencë të tyre ose të tregut, por nuk janë të mirë argumentuara si dhe paraqesin paqartësi mbi përfitueshmërinë që mund të gjenerohet për AIC-në dhe Institucionet në bashkëpunim.

Nga auditimi konstatohet se edhe për afatet për realizimin e projekt-propozimeve, të cilat janë 3-5 vite, janë të pa argumentuara dhe të pa shoqëruara me analiza specifike dhe të detajuara.

Për sa më sipër, për 3 (tre) nën projektet e sipërcituara në kuadër të Zhvillimit të Pronave Shtetërore, konstatohet se nuk ka një dokument/rregullore/manual, mbi identifikimin dhe përzgjedhjen e tyre, si dhe nuk ka një analizë mbi përfitueshmërinë, kostove financiare, risqet

potenciale, vlerën e shtuar të parasë, rentabilitetin e investimit, apo për hapat konkrete që do duhet të ndiqen për çdo projekt propozim përpara shpalljes së tij, të tilla si parafizibiliteti/fizibiliteti sikundër vepruar për projektet e periudhës 2022-2023; si dhe një analizë krahasuese nëse këto projekt-propozimet do të zhvilloheshin nga vetë Institucionet, me financim të brendshëm nga buxheti i shtetit.

Gjithashtu, konstatohet se afatet kohore të fazës parapërgatitore për projekt propozimet e vitit 2024, konstatohet të jenë relativisht më të shpejta se afatet e parashikuara për projekt propozimet e vitit 2022-2023, pavarësisht riskut të lartë që këto procedura mbartin në vetvete.

Veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 71/2019 “Për Korporatën e Investimeve Shqiptare”, dhe me Ligjin nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”. (Më hollësisht trajtuar në pikën 1, faqet 12-59 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

6.1.Rekomandimi: Nga ana e Strukturave Drejtuese të AIC-së, të merren masat e nevojshme që për projekt-propozimet në fushën e pronave shtetërore, të identifikohen në mënyrë të qartë dhe të dokumentuar metodologjinë e përzgjedhjes së tyre, me qëllim sigurimin e transparencës së këtij procesi.

Menjëherë dhe në vijimësi

6.2.Rekomandimi: Nga ana e Strukturave Drejtuese të AIC-së, të merren masat e nevojshme që për projekt-propozimet e vitit 2024, përpara se të vijohet me fazat e tjera të shpalljes së projektit apo publikimit për përcjelljen e interesit për kontraktim, të hartohen analiza të detajuara dhe shteruese mbi përfitueshmërinë e palëve, kostot financiare, risqet potenciale, vlerës së shtuar të parasë, rentabilitetit të investimit, si dhe të hartohen analiza krahasuese nëse do të zhvilloheshin me financim të brendshëm nga buxheti i shtetit.

Menjëherë dhe në vijimësi

7. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i Planeve të Biznesit të AIC për periudhën objekt auditimi, konstatohet se:

-Relacionet mbi parashikimet buxhetore nuk janë hartuar në mënyrë të detajuar dhe nuk përmbajnë analiza përkatëse për secilin zë buxhetor të ardhurash dhe shpenzimesh, duke mos mundur një reflektim dhe vlerësim të saktë të nevojave reale të AIC-së;

-Parashikimet buxhetore për shpenzimet kapitale në projektet e investimeve janë planifikuar në mënyrë të përgjithshme dhe nuk janë specifikuar për secilin projekt individualisht;

-Ka mospërputhje të konsiderueshme ndërmjet parashikimeve dhe realizimeve për zërat kryesorë të të ardhurave dhe shpenzimeve.

Sa më sipër, evidentohet se nga ana e AIC-së planifikimi buxhetor është kryer në mënyrë të pamjaftueshme dhe të paargumentuar, duke ndikuar negativisht në performancën ekonomiko-financiare të shoqërisë. Veprimet e mësipërme janë kryer në kundërshtim me Ligjin nr.10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar, neni 3 ku përcaktohet “Fusha e zbatimit të Ligjit”, pika 2: “Shoqëritë tregtare, organizatat jofitimprurëse dhe autoritetet e përbashkëta, të cilat zotërohen, kontrollohen, financohen ose garantohen financiarisht nga një njësi e qeverisjes së përgjithshme” dhe Udhëzimin e METE nr. 394, datë 21.08.2014 “Mbi programet e zhvillimit ekonomik të shoqërive tregtare me kapital tërësisht shtetëror” i ndryshuar me udhëzimin e MFE nr. 15, datë 02.05.2018 “Mbi programet e zhvillimit ekonomik të shoqërive tregtare me kapital tërësisht shtetëror”.(Më hollësisht trajtuar në pikën 1, faqet nr. 12-59 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

7.1.Rekomandimi: Nga ana e Strukturave Drejtuese të AIC-së në bashkëpunim me Divizionin e Financës, të merren masat e nevojshme për përmirësimin e procesit të planifikimit dhe zbatimit financiar dhe operacional, duke hartuar plane biznesi dhe buxhete të detajuara të bazuara në nevojat reale të Shoqërisë.

Menjëherë dhe në vijimësi

7.2.Rekomandimi: Nga ana e Divizionit të Financës në AIC, të merren masa në vijimësi për detajimin e shpenzimeve kapitale për secilin projekt si dhe monitorimin e vazhdueshëm të zbatimit të buxhetit përmes raportimeve periodike dhe analizës me arsyet dhe shkaqet e mos realizimeve, me qëllim paraqitjen reale të treguesve mbi shpenzimet kapitale për projektet dhe detajimin e tyre.

Menjëherë dhe në vijimësi

8.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dosjeve të Projekt-propozimeve të hartuara nga ana e AIC-së, gjatë periudhës objekt auditimi, konstatohet se për të gjithë procedurat e projekt-propozimeve të audituara nuk ka inventarizim të dosjes, nuk ka grupe pune të ngritura me urdhër të veçantë nga titullari në lidhje me punonjësit e angazhuar për secilin projekt-propozim, veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 9154, datë 06.11.2003 “Për arkivat”, si dhe nenit 21, “Norma tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë” dhe me pikën 3 të nenit 16 të Ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, dhe manualit të MFK miratuar me Urdhrin nr. 108, datë 17.11.2016, ku mungesa e gjurmëve të auditimit nuk i jep mundësinë audituesit të përcaktojë radhën e ngjarjeve, që ndodhin brenda çdo procesi.

- Gjithashtu nga auditimi konstatohet se Raportet e Veprimtarisë së AIC-së, për periudhën objekt auditimi janë të pa protokolluara, veprime në kundërshtim me “Rregulloren e Brendshme” të AIC-së, pika 16.

- Nga auditimi konstatohet se një pjesë e dokumentacionit të vënë në dispozicion të Grupit të Auditimit duke përfshirë edhe Planet e Punës, Projekt-idetë, Planet e Biznesit etj., janë përpiluar vetëm në gjuhën angleze, por nuk rezultojnë të jetë nënshkruar kopja e dokumentit edhe në shqip si variant origjinal, fraksion i së cilës protokollohet kopja në gjuhë të huaj, veprimet e mësipërme janë kryer në kundërshtim me VKLA Nr. 4, datë 19.6.2017 “Për miratimin e “rregullores së njësuar të punës me dokumentet në autoritetet publike të RSH”, neni 4, pika 9. (Më hollësisht trajtuar në pikën 1, faqet 12-59 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

8.1.Rekomandimi: AIC të marrë masat në vijimësi, për realizimin e inventarizimit të dosjeve të projekt-propozimeve, duke bashkëlidhur të gjithë dokumentacionin përkatës, me qëllim krijimin e gjurmës së auditimit.

Menjëherë dhe në vijimësi

8.2.Rekomandimi: AIC të marrë masat në vijimësi, që për çdo projekt-propozim të hartuar, të ngrihen grupe të posaçme, duke përcaktuar detyrat dhe përgjegjësitë e tyre, me qëllim krijimin e gjurmës së auditimit.

Menjëherë dhe në vijimësi

8.3.Rekomandimi: AIC të marrë masat e nevojshme për të siguruar protokollimin e rregullt dhe korrekt të të gjitha dokumenteve dhe raporteve zyrtare, duke garantuar një administrim dhe ndjekje të sigurt, si dhe për dokumentacionin e hartuar në gjuhë të huaj, të sigurohet nënshkrimi i një kopjeje origjinale në gjuhën shqipe, e cila të protokollohet si pjesë e dokumentacionit zyrtar.

Menjëherë dhe në vijimësi

9.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i veprimtarisë së Këshillit Mbikëqyrës të AIC, u konstatua se, me Vendimin nr.20, datë 13.11.2023, të Këshillit Mbikëqyrës, është rishikuar Buxheti i Korporatës së Investimeve Shqiptare me shumën 2 (dy) miliard lekë, në funksion të huadhënies së një huaje në vlerën dy miliard lekë në favor të shoqërisë A. SHA.

Referuar kërkesës sipas shkresës nr.2440 prot., datë 09.11.2023, nga ana e A. i është kërkuar AIC-së, një mbështetje financiare në shumën 2 (dy) miliard lekë, si pasojë e mungesës së likuiditetit, për shkak të lëshimit të një Urdhri Ekzekutimi nga “Gjykata Belge”, kundrejt llogarisë së kompanisë A. SHA, ku palë në këtë proces gjyqësor është edhe “Republika e Shqipërisë”, duke theksuar edhe situatën e mirë financiare

të shoqërisë A. SHA, deri në zhbllokimin e situatës për përthithjen e fondeve të akumuluar nga veprimtaria ajrore e cila është aktive dhe arkëton të ardhura.

Nga auditimi konstatohet se huadhënia nuk është e parashikuar në Ligjin për krijimin e Korporatës së Investimeve, apo statutit të saj. Pavarësisht kësaj, me vendimin nr.21, datë 13.11.2023, është miratuar në parim që ti propozohet Asamblesë së Aksionarëve të Korporatës, (*Ministria e Financave*) miratimi për dhënien e huasë në shumën 2 (dy) miliard lekë, sipas kushteve dhe termave të draft kontratës dhe thërritjen e Asamblesë së Përgjithshme të Aksionarëve të Korporatës AIC, me qëllim vendimmarrjen përfundimtare. Me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës datë 13.11.2023 është vendosur sipas rendit të ditës konsolidimi i kapitalit të korporatës AIC në shumën 4 (katër) miliard lekë, nisur nga miratimi i propozimit për miratimin e huasë prej 2 (dy) miliard lekë, për shoqërinë A. SHA. Në vijim:

1-Me shkresën nr.94 prot., datë 16.11.2023 të AIC-së, është informuar Aksionari Ligjor i Korporatës së Investimeve, Ministri i Financave, mbi vendimet e marra nga Këshilli Mbikëqyrës në lidhje me dhënien e pëlqimit dhe miratimin në parim të dhënies së huasë në shumën 2 (dy) miliard lekë, e cila prek aktivet e korporatës sipas të dhënave të pasqyrave financiare të miratuara dhe të certifikuara, si dhe bazuar në kushtet e nenit 154 dhe 167 të Ligjit për *“Tregtarët dhe shoqëritë tregtare”*, për ndryshime aktivesh mbi 5% të asetëve të shoqërisë për të cilat duhet të thirret Asambleja e Përgjithshme e Aksionareve të Shoqërisë për marrjen e vendimit përkatës.

2-Me shkresën nr.21329 prot., datë 20.11.2023 të MFE-së, është marrë Vendim i Asamblesë së Aksionarit, sipas vendimit nr.103, datë 20.11.2023, *“Për miratimin e vendimit nr.21, datë 13.11.2023, të Këshillit Mbikëqyrës të Korporatës së Investimeve Shqiptare SHA, Tiranë”*, për dhënien e huasë në shumën 2 (dy) miliard lekë, në favor të shoqërisë A. SHA, Tiranë, sipas kushteve të kontratës.

3-Në vijim me shkresën nr.253 prot., datë 06.11.2024, të AIC-së, Drejtori Ekzekutiv i Korporatës AIC, ka kërkuar kthimin e shumës së huasë dhe interesave respektive sipas objektit të huasë së nënshkruar sipas shkresës nr.97 prot., datë 24.11.2023 të AIC, dhe me shkresën nr.253/1 prot., datë 13.11.2024 Drejtori Ekzekutiv i Shoqërisë A. SHA, ka kërkuar shtyrjen e afatit të kthimit të huasë edhe me një vit kalendarik, sipas pikës 1.2/a/b të kontratës, konform miratimeve përkatëse dhe detyrimeve të nënshkruara.

4-Me shkresën nr.253/3 prot., datë 26.11.2024, është njoftuar Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, si Aksionari i vetëm i Korporatës AIC, duke e vënë në dijeni për kërkesën e shoqërisë A. SHA, për shtyrjen e huasë dhe kalimin për mendim në Këshillin Mbikëqyrës, dhe më pas në Asambleshën e Aksionarëve, sipas nenit 154 paragrafi 4, të Ligjit nr.9901, *“Për Shoqëritë Tregtare”* pasi asetet dhe kapitali i dhënë ka vlerë më të lartë se 5% e aktiveve. (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2, faqet 59-66 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*)

9.1.Rekomandimi: Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, si Aksionari i vetëm i Korporatës Shqiptare të Investimeve, dhe Këshilli Mbikëqyrës i Shoqërisë së Korporatës së Investimeve Shqiptare SHA, në cilësinë e organeve drejtuese të kësaj shoqërie aksionare me kapital shtetëror, të marrin të gjitha masat e menjëhershme administrative konform legjislacionit përkatës si dhe kushteve të trajtuara në kontratën e huasë midis shoqërisë aksionare Korporatës së Investimeve Shqiptare dhe shoqërisë A. SHA, për shumën e dhënë hua 2 (dy) miliard lekë, me qëllim kthimin e menjëhershëm të shumës së huasë së dhënë në funksion të ruajtjes së stabilitetit financiar dhe mbarëvajtjes dhe funksionimit të shoqërisë Korporata e Investimeve Shqiptare, në cilësinë e huadhënësit nisur edhe nga fakti që këto aktive kanë prekur më shumë se 5% të aktiveve dhe kapitalit total të kësaj shoqërie.

Menjëherë dhe në vijimësi

9.2.Rekomandimi: Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, si Aksionari i vetëm i Korporatës Shqiptare të Investimeve dhe Këshilli Mbikëqyrës i Shoqërisë së Korporatës së Investimeve Shqiptare SHA, në cilësinë e organeve drejtuese të kësaj shoqërie aksionare në vijim të veprimtarisë së tyre, të eliminojnë marrjen e vendimeve të natyrës huadhënie kundrejt shoqërive aksionare me kapital shtetëror

pasi mbartin risk të mundshëm në sigurinë dhe stabilitetin financiar gjatë ushtrimit të veprimtarisë së kësaj shoqërie aksionare me fushë operimi në objektiva të rëndësishme dhe strategjike për zhvillimin e pronës shtetërore bazuar në ligjin specifik mbi të cilin operon kjo shoqëri aksionare.

Menjëherë dhe në vijimësi

10.Gjetje nga auditimi: Nga verifikimi i afateve të hartimit të pasqyrave financiare, rezultoi se për vitet 2020-2023 në sitemin e tatimeve e-filling janë ngarkuar dy versione të deklaratave të tatim fitimit dhe të pasqyrave financiare, njëri brenda datës 31 mars dhe tjetri më pas, sipas nenit 29, i ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, të ndryshuar “*Tatimi mbi të ardhurat*”. Ndryshmi i versioneve të pasqyrave financiare, të depozituara brenda 31 marsit, të miratuara nga Drejtori Ekzekutiv dhe Drejtori i Financës, mund të ndryshohet brenda 36 muajve, nga data e deklaratës, por ky ndryshim sipas pikës 3, të nenit 67, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008, të ndryshuar “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë, rrit mundësitë që shoqëria të jetë e ekspozuar ndaj penaltiteteve dhe interesave si rezultat i ndryshimeve në këto deklarata si dhe nuk pasqyrohen gjurmët e arsyt e ndryshimeve të ndodhura.

Nga verifikimi i pasqyrave financiare të vitit 2020, rezultoi se hartimi i tyre është bërë nga persona, të cilët nuk kanë qenë të punësuar pranë Korporatës dhe nuk kanë pasur kontratë shërbimi dhe as nuk është kryer pagesë në favor të tyre. Personi, që ka hartuar pasqyrat financiare, rezulton të jetë punësuar në Korporatë, 1 muaj pas ofrimit të shërbimit.

Gjithashtu, pasqyrat e vitit 2022 rezultojnë të jenë certifikuar më 17.07.2023 nga Audituesi i pavarur dhe janë miratuar me Vendimin e Asamblesë së Aksionarit nr. 56, datë 07.08.2023, **në tejkallim** të afatit të përcaktuar në pikën 2 të nenit 33/1, të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, të ndryshuar. Ky veprim, i ka sjellë Korporatës penaltitete për mos depozitim në afat, të pasqyrave financiare. (*Më hollësisht trajtuar në pikën 3, faqet 59-66 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*)

10.1.Rekomandimi: Personat përgjegjës, për kontabilitetin dhe hartimin e pasqyrave financiare, pranë Korporatës së Investimeve Shqiptare, të marrin masa për hartimin e pasqyrave financiare qëndrueshme dhe të respektohen afatet ligjore, për përgatitjen, miratimin dhe depozitimin e tyre brenda afateve ligjore të përcaktuara, pranë organeve tatimore dhe Qendrës Kombëtare të Biznesit.

Brenda datës 31.07.2025

11.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit në AIC, u konstatua se: - AIC nuk ka depozituar në kohë deklaratën dhe raportin për cilësinë dhe gjendjen e sistemeve të kontrollit të brendshëm për periudhat 2021-2022, dhe për vitin 2023, pyetësori vjetor i vetëvlerësimit është dorëzuar me vonesë, në kundërshtim me afatet e përcaktuara në ligj;

- Nuk ka manuale/procedura pune për drejtori specifike, si dhe nuk janë të përcaktuara as në rregulloren e brendshme të institucionit duke sjellë mungesë standardizimi në proceset e punës;

- Nuk është hartuar një strategji e menaxhimit të riskut dhe një regjistër risku, duke mos respektuar kërkesat për monitorim dhe minimizim të riskut si dhe nuk janë kryer takime periodike të Grupit të Menaxhimit Strategjik (GMS) gjatë viteve 2021-2023, duke ndikuar në mungesën e një qasjeje të strukturuar ndaj riskut.

- AIC nuk ka një rregullore të përditësuar që të reflektojë ndryshimet ligjore dhe organizative si dhe nuk ka hartuar harta procesesh, manuale pune dhe gjurmë auditimi për të dokumentuar proceset kryesore. - AIC nuk ka një metodologji të miratuar për përgatitjen e projekt-propozimeve;

- Komunikimi brenda institucionit dhe me palët e jashtme është i përcaktuar, por në faqen zyrtare të AIC-së mungon informacioni i plotë mbi aktivitetin, planet e biznesit dhe planet e punës;

- Raportet mbi realizimin e buxhetit dhe veprimtarinë janë të përgjithshme.

Veprimet e mësipërme janë kryer në kundërshtim me Ligji Nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” (i ndryshuar), neni 11, 15, 16, 18/1, 19, 21 dhe 27; *Manuali për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin*, (miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave Nr. 108, datë 17.11.2016), Kapitulli II, Pika 2.5.1, Kapitulli III - Delegimi i detyrave, Kreu III - Komponentët e Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit; Udhëzimi i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë Nr. 16, datë 20.07.2016, Pika 3.2.1 dhe 3.2.2. (Më hollësisht trajtuar në pikën 5, faqet 89-93 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

11.1.Rekomandimi: Strukturat përgjegjëse të AIC-së, të marrin masa për plotësimin e mangësive të evidentuara, si dhe implementimin e një sistemi të përshtatshëm rregullash të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm, konform përcaktimeve të Ligjit të MFK-së dhe aktet në zbatim të tij, për ta bërë atë efektiv dhe në dobi të veprimtarisë Institucionale.

Menjëherë dhe në vijimësi

12.Gjetje nga auditimi: Nga verifikimi i marrëdhënieve të punës dhe shpërblimit në lidhje me Këshillin Mbikëqyrës (Këshilli) të Korporatës së Investimeve Shqiptare, u konstatua se:

-Korporata, për periudhën objekt auditimi, nuk disponon informacion për anëtarët e Këshillit, nëse prej tyre plotësohen kriteret e përcaktuara në gërmat a-c, të pikës 3 dhe të pikës 6 të nenit 14, të Statutit të Korporatës.

-Struktura e Këshillit ka qenë e paplotë, konkretisht në vitin 2020 dhe 2022 ka qenë me 5 anëtarë, kjo në kundërshtim me pikën 1, të nenit 14, të Statutit të Korporatës, për vitin 2021 gjithashtu ka qenë më 5 anëtarë dhe prej datës 25.08.2021 ka qenë me 4 anëtarë.

-Për periudhën 2020-2023 Këshilli nuk ka pasur Kryetar, por të gjithë anëtarët kanë pasur statusin “anëtar”.

-Nga verifikimi i vendimeve të strukturës së shpërblimeve, rezultoi se përcaktohen termat e shpërblimit për dy kategoritë e tij, konkretisht anëtarë nga institucionet qendrore dhe anëtarë të pavarur ndërkombëtarë aktualë në kohën e Vendimit të Këshillit nr. 7, datë 07.09.2021, por për anëtarët e pavarur të tjerë “jo ndërkombëtarë”, që kanë qenë pjesë e Këshillit **nuk janë parashikuar termat e shpërblimit. Nga auditimi rezultoi se shpërblimi i tyre është bërë si për anëtarët e institucioneve qendrore.**

-Nga verifikimi shpërblimeve të anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës rezultoi se me Vendimin e Këshillit nr. 2, datë 07.03.2024 është vendosur të pranohet kërkesa e bërë nga njëri prej anëtarëve, më parë me funksion Drejtor Ekzekutiv, për shtesën 35% mbi shpërblimin bazë, kjo bazuar në pikën 7/A të Vendimit të Këshillit Mbikëqyrës, nr. 23, datë 20.12.2023, por nga auditimi rezultoi se **nuk janë përmbushur kushtet** e pikës 8/E, në të njëjtin Vendim, **për ta përfituar këtë shtesë.** (Më hollësisht trajtuar në pikën 6, faqet 93-106 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

12.1.Rekomandimi: Nga Korporata e Investimeve Shqiptare, të merren masa për të administruar, dokumentacionin vërtetues, mbi kriteret që duhet të plotësohen nga anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës dhe të përcaktohet qartë termat e shpërblimit për të gjithë kategoritë e anëtarëve të tij, përfshirë anëtarët e pavarur ndërkombëtarë.

Menjëherë dhe në vijimësi

13.Gjetje nga auditimi: Nga verifikimi i organizimit dhe shpërblimit të strukturës “Bordi Këshillimor”, të Korporatës së Investimeve Shqiptare rezultoi se, për periudhën 2020-08.04.2024, Korporata nuk ka marrë masa për organizimin dhe krijimin e kësaj strukture. Prej datës 08.04.2024, në këtë strukturë janë emëruar vetëm dy nga nëntë anëtarë, në kundërshtim me përcaktimet pikës 1, të nenit 27 të Statutit të Shoqërisë, si dhe për periudhën objekt auditimi ky Bord nuk është mbledhur asnjëherë dhe pavarësisht kësaj, anëtarët e tij kanë marrë shpërblim, që nga momenti i nënshkrimit të kontratës me Korporatën. (Më hollësisht trajtuar në pikën 6, faqet 93-106 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

13.1.Rekomandimi: Nga Korporata e Investimeve Shqiptare, të merren masa për të plotësuar strukturën e Bordit Këshillimor dhe shpërblimet e tyre të bëhen, prej datës kur Bordi të nisë veprimtarinë e tij sipas përcaktimeve në Ligj dhe Statutin e Korporatës.

Menjëherë dhe në vijimësi

14.Gjetje nga auditimi: Nga verifikimi i procedurave të rekrutimit, rezultoi se për 4 nga 6 raste të përzgjedhura nga grupi i auditimit nuk disponohet informacion mbi procedurat e rekrutimit të tyre, pasi janë punësuar **përpara hyrjes në fuqi të Rregullores së brendshme**, ndërsa për dy punonjësit e tjerë ku janë kryer procedura standarde rekrutimi, rezultuan mangësi në dokumentacion, në kundërshtim me kërkesat e kreut VI të Rregullores së Brendshme të Korporatës.

Nga auditimi i kryer mbi plotësinë dosjeve të personelit, ku janë përzgjedhur në mënyrë rastësore 10 dosje të punësuarish, pjesë e strukturës për periudhën objekt auditimi, rezultoi se Divizioni Financiar dhe Administrativ, në administrimin e dosjeve nuk ka respektuar të gjitha kërkesat e përcaktuara në Kreut XVII., të Rregullores së Brendshme të Korporatës së Investimeve Shqiptare. Vetëm në dy prej rasteve pjesë e dokumentacionit janë diplomat/certifikatat e njehsuara me origjinalin, në dosjet e tjera të përzgjedhura janë fotokopje, në kundërshtim me pikën 4, të lidhjes nr. 2, të VKM nr. 833, datë 28.10.2020. Gjithashtu kërkesat e përcaktuara në Kreun XVII të Rregullores, mbi dokumentacionin pjesë e dosjes së personelit, nuk reflektojnë kërkesat e përcaktuara në pikat 1-4 të lidhjes nr. 2, të VKM nr. 833/2020 dhe në të gjitha rastet mungon fleta shoqëruese e dosjes. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 6, faqet 93-106 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

14.1.Rekomandimi: Titullari i AIC dhe Divizioni Financiar dhe Administrativ, në bashkëpunim me hallkat përgjegjëse në procesin e rekrutimit, të marrin masa për të realizuar dhe dokumentuar procesin e rekrutimit në përputhje me kërkesat e përcaktuara në Rregullore.

Në vijimësi

14.2.Rekomandimi: Nga Divizioni i Financiar dhe Administrativ të merren masa për të plotësuar dosjet e personelit me dokumentacionin e kërkuar, si dhe të propozohen ndryshime në rregullore, për të siguruar dosje me dokumentacion të plotë, i cili duhet të jetë origjinal ose i vërtetuar me noteri.

Menjëherë dhe në vijimësi

B. MASA PËR ELEMENIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCË DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE.

1.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i projekt propozimeve, konstatohet se gjatë vitit 2022, për 3 (tre), projekt propozimet *(Ndërtimi i parqeve fotovoltaike si prodhues i energjisë alternative; Rivitalizimi i Bazës Detare të Pashalimanit; Divjaka, një destinacion zhvillimi me modele të qëndrueshme të biznesit)*, janë angazhuar ekspertë të jashtëm të fushës me qëllim realizimin e projekt-idesë së këtyre investimeve. Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion, konstatohet se nga ana e AIC-së është vijuar me kontraktimin e ekspertëve të jashtëm (inxhinier ose arkitekt), pa patur një plan pune vjetor të miratuar nga Këshilli Mbikëqyrës si dhe pa marrë më parë transferimin e pronës/asetit për të kryer para-fizibilitetin dhe më pas ciklet e tjera të projektit.

Sa më sipër, veprimet e kontraktimit të ekspertëve të jashtëm për 3 projekt-propozimet, ka shkaktuar një efekt negativ financiar në buxhetin e AIC-së në shumën prej **2,342,980 lekë**, duke ndikuar negativisht në menaxhimin financiar të shoqërisë, pasi asnjë prej projekt-propozimeve nuk ka vijuar më tej me fazat e tjerat të zhvillimit të projektit, duke mos përmbushur qëllimin kryesor të gjenerimit të të ardhurave për

Korporatën, veprime në kundërshtim me Ligjin nr.71/2019 “Për Korporatën e Investimeve Shqiptare”, neni 3. (Më hollësisht trajtuar në pikën 1, faqet 12-59 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

1.1.Rekomandimi: Nga ana e Këshillit Mbikëqyrës në bashkëpunim me Strukturat Drejtuese të AIC-së, të merren masa në vijimësi që për ekspertët e jashtëm të mos kryhet kontraktimi i tyre, nëse nuk është transferuar prona/aseti në përdorim të AIC-së për të cilën do të zhvillohet, si dhe për projektet-propozimet që aktualisht janë në proces të mos vijohet me kontraktimin e tyre pa përfunduar analiza e detajuar lidhur me përfitueshmërinë e tyre.

Menjëherë dhe në vijimësi

1.2.Rekomandimi: Nga ana e Këshillit Mbikëqyrës në bashkëpunim me Strukturat Drejtuese të AIC-së, të marrin masa të analizojnë shkaqet/arsyet dhe të nxirren përgjegjësitë, e përdorimit pa eficiencë të shpenzimeve në vlerë prej 2,342,980 lekë, për projekt-propozime të cilat nuk kanë vijuar me fazat e mëtejshme, si dhe të merren masa që në të ardhmen fondet të shpenzohen sipas parimeve të ekonomicitetit, efektivitetit dhe eficiencës.

Menjëherë dhe në vijimësi

2.Gjetje nga auditimi: Nga verifikimi i të ardhurave të Korporatës, rezultoi se për vitin 2021 ajo ka pasur flukse të lira të mjeteve monetare, në shumën 198,000,000 lekë, të cilat nuk i ka investuar në asnjë nga alternativat e mundshme që do t'i gjeneronin të ardhura. Nga grupi i auditimit, u bënë përlllogaritjet e interesave të mundshme që do të ishin përfituar nga investimi, në instrumente pa risk, me afat maturimi 12 muaj dhe duke supozuar gjithashtu se do të mbante një pjesë të kapitalit, për të mos u përballur më vështirësi për shkak të mungesës së likuiditetit. Nga përlllogaritjet rezultoi se minimalisht nga investimi i këtyre fondeve do të ishin gjeneruar **1,629,961 lekë të ardhura nga interesat.**

Gjithashtu, në lidhje me investimin e kryer për fondet e papërdorura të Korporatës pas vitit 2022, konstatohet se nuk dokumentohet analiza e kryer në treg lidhur me normat e aplikuara në bankat e tjera të nivelit të dytë, për të garantuar se vendimmarrja e korporatës për investim ka qenë me përfitimin më të lartë për gjenerimin e të ardhurave. (Më hollësisht trajtuar në pikën 3, faqet 66-81 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

2.1.Rekomandimi: Strukturat Drejtuese të Korporatës së Investimeve Shqiptare, të marrin masa për të vlerësuar, alternativat e mundshme si më sipër, me leverdi për situatën e saj financiare dhe të ndërmarrin veprimet e duhura me qëllim përdorimin e fondeve me eficiencë.

Menjëherë dhe në vijimësi

C. MASA DISIPLINORE

Mbështetur në nenin 16 të Ligjit nr.71/2019 “Për Korporatën e Investimeve Shqiptare”, si dhe në “Statutin e Korporatës së Investimeve Shqiptare”, neni 25, i rekomandojmë Drejtorit Ekzekutiv të Korporatës së Investimeve Shqiptare, vlerësimin e shkeljeve dhe më pas procedimin me masat disiplinore sipas mangësive të konstatuara për secilin prej punonjësve në Raportin Përfundimtar të Auditimit, në referencë të Kodit të Punës, miratuar me Ligjin nr.7961, datë 12.07.1995, i ndryshuar, neni 21, pika 3, gërma “h”.

Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë vendim ngarkohet Departamenti i Auditimit të Buxhetit të Shtetit.

Për sa më sipër paraqitet ky Raport Përfundimtar Auditimi.

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

